

PËR MËSIMDHËNËSIN/EN

duk gjini
shtëpia botuese publishing house

**Majlind Ferdulli, Nevzat Nevzati,
Pajtim Hodolli**

GJEOGRAFIA

Për klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët

7



PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes	6
Hyrje.....	8
Planifikimi vjetor.....	19
Plani dymujor: shtator—tetor.....	20
Plani dymujor: nëntor—dhjetor	24
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	28
Plani tremujor: prill—maj—qershor	32
Mësimi 1: Regjionet, kuptimet dhe ndarja	36
Mësimi 2: Emri, pozita, kufijtë dhe madhësia.....	38
Mësimi 3: Popullsia dhe veçoritë e saj	40
Mësimi 4: Rregullimi shtetëror i vendeve Evropiane	42
Mësimi 5: Ushtrime me hartën e Evropës.....	44
Mësimi 6: Përthyeshmëria e bregdetit.....	46
Mësimi 7: Relievi i Evropës	48
Mësimi 8: Klima e Evropës: faktorët, karakteristikat dhe tipat e klimës.....	50
Mësimi 9: Hidrografia e Evropës: lumenjtë dhe liqenet	52
Mësimi 10: Ushtrime: Klima dhe hidrografia	54
Mësimi 11: Tokat, bota bimore dhe shtazore	56
Mësimi 12: Pasuritë natyrore dhe zhvillimi ekonomik	58
Mësimi 13: Ndarja regjionale dhe politike e Evropës	60
Mësimi 14: Aktivitetet: Evropa.....	62
Mësimi 15: Evropa Jugore - veçoritë natyrore	64
Mësimi 16: Evropa Jugore - veçoritë shoqërore dhe ekonomike.....	66
Mësimi 17: Italia	68
Mësimi 18: Ushtrime: Italia.....	70
Mësimi 19: Vatikani, San Marino, Malta	72
Mësimi 20: Spanja	74
Mësimi 21: Andorra dhe Gjibraltari.....	76
Mësimi 22: Portugalia	78
Mësimi 23: Greqia.....	80
Mësimi 24: Ushtrime me hartën e Evropës Jugore	82
Mësimi 25: Bullgaria	84
Mësimi 26: Maqedonia e Veriut.....	86
Mësimi 27: Serbia	88
Mësimi 28: Kroacia	90
Mësimi 29: Mali i Zi.....	92
Mësimi 30: Bosnjë dhe Hercegovina	94
Mësimi 31: Evropa e Mesme - veçoritë natyrore - Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia.....	96
Mësimi 32: Evropa e Mesme - veçoritë shoqërore dhe ekonomike	98
Mësimi 33: Ushtrime: Evropa Jugore dhe Evropa e Mesme.....	100
Mësimi 34: Gjermania	102
Mësimi 35: Testim i Gjysmëvjetorit të parë	103
Mësimi 36: Prezantim i punimeve - Gjermania.....	104

Mësimi 37: Polonia	106
Mësimi 38: Çekia dhe Sllovakia	108
Mësimi 39: Sllovenia	110
Mësimi 40: Austria	112
Mësimi 41: Zvicra dhe Lihtenshtajni	114
Mësimi 42: Ushtrime dhe përforsim me hartën e Evropës së Mesme.....	116
Mësimi 43: Hungaria	118
Mësimi 44: Rumania	120
Mësimi 45: Evropa Perëndimore - veçoritë natyrore (Pozita, kufijtë dhe madhësia)	122
Mësimi 46: Veçoritë shoqërore - ekonomike të Evropës Perëndimore - Popullsia	124
Mësimi 47: Ushtrime me hartë	126
Mësimi 48: Britania e Madhe	128
Mësimi 49: Irlanda	130
Mësimi 50: Franca.....	132
Mësimi 51: Aktivitet: Evropa Perëndimore	134
Mësimi 52: Monako dhe Luksemburgu	136
Mësimi 53: Belgjika	138
Mësimi 54: Holanda	140
Mësimi 55: Ushtrime: Evropa Perëndimore.....	142
Mësimi 56: Evropa Veriore dhe Verilindore (shtetet baltike) - veçoritë natyrore.....	144
Mësimi 57: Evropa Veriore dhe Verilindore - veçoritë shoqërore-ekonomike.....	146
Mësimi 58: Suedia	148
Mësimi 59: Norvegjia	150
Mësimi 60: Danimarka	152
Mësimi 61: Finlanda.....	154
Mësimi 62: Islanda.....	156
Mësimi 63: Ushtrime: Shtetet Skandinave.....	158
Mësimi 64: Estonia, Letonia dhe Lituania	160
Mësimi 65: Aktivitet: Evropa Veriore (Shtetet Baltike)	162
Mësimi 66: Evropa Lindore - veçoritë natyrore - Pozita gjeografike dhe kufijtë	164
Mësimi 67: Evropa Lindore - veçoritë natyrore - Pozita gjeografike dhe kufijtë	166
Mësimi 68 Evropa Lindore - veçoritë shoqërore dhe ekonomike	168
Mësimi 69: Fedearata Ruse.....	170
Mësimi 70: Popullsia dhe zhvillimi ekonomik i Federatës Ruse.....	172
Mësimi 71: Ushtrime: Evropa Lindore	174
Mësimi 72: Ukraina	176
Mësimi 73: Bjellorusia	178
Mësimi 74: Moldavia	180

Të dashur mësimdhënës dhe mësimdhënëse,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë në zhvillimin e mësimi, mbështetur në metodologjitë më të përparuara të sotme.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar përmes vështirësive të panumërta dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimit t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për të formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për të gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" në vazhdim të nismës për përfshirjen e metodologjive të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësimdhënësve, ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: *Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për të formësuar të ardhmen e tyre?*

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe nxënies, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues, bashkëpunues dhe kurioz, i aftë për të përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme dhe të nesërme shqiptare.

Cilësia e re e të nxënësve dhe mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por kërkohet të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave është i pranishëm për herë të parë në Kosovë i zbatuar në vitin 2022 dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES

për konceptimin e mësimve model

Faqja në të majtë

- Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.
- Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxënësve, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.
- Rezultatet specifike janë në koherencë me ato të fushës.
- Të gjitha mjetet dhe materialet, e çdo lloji, që shërbejnë për konkretizim në ndihmë të të nxënësve.
- Parashikimi është faza e parë e orës mësimore që siguron përqendrimin dhe aktivizimin e nxënësve në mësim.

Mësimi

ASPEKTE PËR QËRITËSHMIRI TE PLANIT TE ORES MËSIMORE

Faza kurrikulare: Shqipëri dhe rrethet (Gjeo. Gjergj)
 Shkalla e kurrikulës: 3 Klasa VITE
 Tema: Përvoja, jetë dhe mësimi e Empiri

ASPEKTE SPECIFIKË TE PLANIT TE ORES MËSIMORE

Nëbën mësimin: Rrugëtimet, kapërcim dhe ndalo

ASPEKTE SPECIFIKË TE PLANIT TE ORES MËSIMORE

Metodologjia dhe veprimtaria në nxënës

Parashikimi:
 Përgatitja për të mësuar
 Detyra: Përbajtje

Mësimdhënësi i drejtohet me pyetje mësimore:
 - Cilat elemente dominuese në hartë/regionat?
 - Cilat janë ditat në të cilat bëhet dhe kështu?
 - Cilat elemente specifike bëjnë këto dy regionat?

- Paraqitja e faqes së librit të nxënësve ndihmon mësimdhënësin/en gjatë përgatitjes.
- Rezultatet e të nxënësve të temës janë në koherencë me ato të orës mësimore; tema është më e gjerë.
- Rezultatet specifike të të nxënësve janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.
- Janë zbrëthim i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.
- Zakonisht, mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentojnë.

- Paraqitja e faqes së librit të nxënësve ndihmon mësimdhënësin gjatë përgatitjes.
- Vlerësimi formues në raport me rezultatet e të nxënësve.
- Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.

Komentet (si shkurtra) shkruhen në libër si gjatë lëvizjes së cilëve u referohen gjatë procesit të mësimin, kryesisht elemente natyrore-geografike (klima, klima, popullsia, ujit, shkretëtira...), shkëlqim, pëllim...

Në libër: i referohet dhe i diskutueshëm Përpunimi i përbajtjes Detyra: Përbajtje

Argumentet mbledhen në libër që të hapin librin në hartë dhe individuale. Për librin, i plotësohet me ato fragmente që mundohen se e plotësojnë pyetjen e përfundimtare.

Pyetje	Koncepti (përgjigjet nga libri)
1. Cilat janë elementet natyrore? Referencat, siç janë, krahasuesit në të cilat mund të bëhen krahasime të ndryshme.	Shkencë, kultura, me cilat mund të përcaktohen pyetjet.
2. Cilat janë elementet shkencë? Referencat, siç janë, krahasuesit në të cilat mund të bëhen krahasime të ndryshme.	Shkencë, kultura, me cilat mund të përcaktohen pyetjet.

Përfundimi:
 Konsolidim dhe rishikim i të mësuarit dhe mësimin.

Mësimdhënësi krijon nga mësimi që të argumentojë për libër për me kundër çështjeve, duke i rishikuar të organizimit grafik. Mendimet do të shkruhen në libër e në hartë.

Çështje këtu në të cilat bëhet raportimi mësimor e tyre, argumente mund të ndërtojnë pyetjet dhe të shkruhen në grup që ka kryer në libër.

A mendoni që është gjeografikisht mësimin në vartë të punës së librit?
 PO JO

Argumentet për me kundër mësimin i mësimin dhe shprehje me hartë dhe argumente me libër, siç ka.

Vlerësimi i nxënësve
 Vlerësimi për përfundimin aktiv në diskutim, për saktësi e përgjigjeve dhe të detyrës si dhe për bashkëpunimin me mësuesin e tjetër dhe qëllim të mësimin për orën.

Detyra:
 Reflektim për vlerësimin e vlerësimin.

- ### Faqja në të djathtë
- Përpunimi i përbajtjes është faza e dytë e orës mësimore, ku bëhet përzgjedhja e materialit mësimor dhe organizimin metodologjik i tij.
 - Përfundimi është faza e tretë e orës mësimore, ku bëhet integrimi i dijeve dhe shprehjeve, si dhe zbatimi i tyre.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimin

Rezultatet e të nxënësve të temës janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënësve për këtë temë. Në këtë rast, mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënësve të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore - kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënësve dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës. Duke filluar nga klasa e tretë e më lart, nxënësit zotërojnë operacione mendore; të menduarit e tyre është konkret, me elemente të të menduarit abstrakt. Prandaj, mësimi me këta nxënës kalon në tri faza, dhe të menduarit e tyre sipas proceseve njohëse.

Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zbërthehen në rezultate të të nxënës. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës. Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathhtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënës të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënës. Rezultatet specifike të të nxënës janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimi, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënës të temës që janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit janë zbrëthim i rezultateve të të nxënës sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës - fazat e zhvillimit të mësimi. Tashmë nxënësit, duke filluar nga klasa e tretë e lart, zotërojnë operacionet mendore, të cilat kanë karakter konkret, me elemente të të menduarit abstrakt. Me kalimin në klasat më të larta, marrin karakter mbizotërues, pasi të menduarit është formal. Mësimi me këta nxënës kalon në tri faza të të menduarit gjatë të nxënës, sipas proceseve njohëse.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimi?

Mbillet një farë. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësimdhënësi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.



Parashikimi: Përgatitja për të nxënës

Në fazën e parashikimit mbillet një farë në një truall pjellor. Mësimi duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.

Kjo është faza e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të të nxënës. Në këtë fazë kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj çka di rreth temës së mësimi, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.



Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kjo është faza e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënës dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përfutimit të kuptimit të njohurive. Gjithashtu, ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënës

Mësimi përfundon me fazën e përforcimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxënësit konsolidojnë të nxënës e ri dhe ristrukturojnë skemën e tyre për të përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësimdhënësin/en

GJEOGRAFIA 7

Fusha kurrikulare *Shoqëria dhe mjedisi* në nivelin e dytë, realizohet përmes mëimit lëndor. Lëndë mësimore e kësaj fushe në këtë nivel është edhe gjeografia. Meqenëse kjo fushë realizohet përmes mëimit lëndor, mësimdhënësit duhet t'i kenë parasysh qëllimet e përbashkëta të fushës, të cilat do të realizohen përmes përmbajtjeve lëndore duke synuar mësimin e integruar.

Fusha Shoqëria dhe mjedisi i ndihmon nxënësit për t'i njohur dhe për t'i kuptuar më mirë konceptet, proceset dhe zhvillimet historike në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe botëror, duke përfshirë lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve të ndryshme si dhe ngjarjet dhe personalitetet e rëndësishme nga kohët më të lashta deri më sot.

Kjo fushë ndihmon nxënësit për t'i thelluar njohuritë mbi vendet dhe hapësirën, sistemet fizike e humane, rajonet dhe karakteristikat e tyre. Gjithashtu, ndihmon krijimin e shprehive, vlerave dhe qëndrimeve në raport me diversitetin kulturor, identitetin social, trashëgiminë kulturore dhe natyrore, organizimin shoqëror, liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe rolin dhe funksionimin e institucioneve demokratike.

Fusha *Shoqëria dhe mjedisi*, në shkallën e tretë kurrikulare, ka për qëllim zhvillimin e aftësive, shkathëtsive, vlerave dhe qëndrimeve, për të qenë qytetar i përgjegjshëm, për të zhvilluar identitetin personal dhe për të njohur më mirë atë kolektiv (social, kombëtar, shtetëror, etnik, fetar, racor, gjinor, kulturor, regional). Kjo fushë ndihmon zhvillimin e aftësive për të gjykuar drejt dhe për të marrë vendime të përgjegjshme në jetën e përditshme, kultivimin e shprehive dhe marrjen e nismave për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Fusha *Shoqëria dhe mjedisi* në këtë nivel ndihmon nxënësit për t'i zhvilluar e për t'i përforcuar më tej njohuritë e tyre duke siguruar një bazë fillestare për orientim akademik dhe orientim në karrierë.

Udhëzime metodologjike

Për të realizuar qëllimet e kurrikulës, përmes fushës *Shoqëria dhe mjedisi*, këshillohet përdorimi i metodave të ndryshme që plotësojnë njëra-tjetrën dhe që mundësojnë zhvillimin e të menduarit kritik e krijues të nxënësi, për zbatimin e njohurive dhe shkathtësive në situata të ndryshme.


Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënësit/es të fushës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes tematike mësimore dhe të rezultateve të kompetencave për shkallën e tretë kurrikulare, me bazën didaktike dhe me nivelin e formimit të nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë maksimumin e potencialit që zotëron brenda vetes.

Mësimitdhënësi/ja është i/e lirë të përdorë metoda mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash. Këto metoda duhet të jenë në funksion të nxitjes së mendimit të pavarur, kritik e krijues. Metodot dhe teknikat e punës me nxënës, kërkohen të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, në funksion të arritjeve të rezultateve të të nxënësve dhe të zbatimit në jetën e përditshme.

Metodologjia ndërvepruese në mësimitdhënie dhe të nxënësve

Libri që keni në duar, është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimit të shkathtësive. Ai trajton temat mësimore në përputhje “Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës” (e rishikuar) (2016) si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi ku është mbështetur metodologjia me të gjithë elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënësve të fushës, rezultatet specifike të të nxënësve të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimit e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: Reflektim për rrjedhën e orës mësimore. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe dështimet, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënësve - procedurave të mësimitdhënies dhe të nxënësve - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet “treëndësh magjik”. Ky treëndësh paraqet marrëdhëniet koherente midis rezultateve të të nxënësve, veprimtaritë e mësimitdhënies të të nxënësve dhe vlerësimit. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijeve dhe të shkathtësive.



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Musai. B. (2014)

Metodologji e mësimdhënies. Tiranë: CDE, faqe 101-128.

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimin të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimin ka dhënë rezultate mjaft të mira.



Zgjeroni dhe thelloni dijet


Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011)

Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 47-51.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës, sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve, apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimin midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësimdhënësi apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.



Burimi: *Psikologji edukimi*, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE


Zgjeroni dhe thelloni dijet
 Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) *Psikologji edukimi*. Tiranë: CDE, faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 3

Nr. Rezultatet e të nxënit për shkallën 3 dhe kompetencat kryesore	
I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv	
1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës; me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si: libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5.	Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6.	Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik	
1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
3.	Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre, duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrare, shkencore, artistike).
4.	Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose numerike, eksperimentale, dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
5.	Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror), duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatit e njëjtë.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7.	Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8.	Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm	
1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5.	Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6.	Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe për kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
8.	Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

IV Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv	
1.	Përgatit planin për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses.
4.	Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.
5.	Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, dizajnim të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës.
6.	Ndihmon në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve vullnetare apo humanitare në shkollë dhe në komunitet dhe shpreh pastaj përvojat dhe ndjenjat e veta me shkrim dhe forma të tjera të të shprehurit.
7.	Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).

VI Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm	
5.	Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë. Shpjegon, në forma të ndryshme të të shprehurit, domosdoshmërinë e respektimit dhe të zbatimit të rregullave dhe ligjeve për raportet e shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të interesit.
6.	Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

RNL-të në këtë program mësimor, janë bazuar në temat e lëndës, në përputhje me RNF-të dhe konceptet e fushës, në harmoni me RNK-të e shkallës së tretë. Nxënësit në klasën e shtatë i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës duke respektuar obligimet, kërkesat dhe normat e caktuara në këtë dokument.

RNL-të i mundësojnë mësimdhënësit nxjerrjen e njësive mësimore, duke respektuar autonominë e tij dhe të shkollës. Kjo u jep liri mësimdhënësve, që në përputhje me kushtet konkrete, jo të barabarta (nxënësit, pajisjet, lokacioni, etj.), të mund të zgjedhin metodologji përkatëse, por duke u bazuar në RNL dhe RNF. Kjo natyrshëm nënkupton se mësimdhënësit mund të përdorin literaturë alternative dhe informata shumëburimorëshe për të arritur qëllimin e ngritur me këtë program.

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL				
Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore	<p>RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to.</p> <p>1.1. Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe atë hapësinor.</p> <p>1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe të veprimit, shpërndarjen, dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.</p>				
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Tema</th> <th>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Pozita, kufijtë dhe madhësia e Evropës</td> <td> <ul style="list-style-type: none"> Përcakton kriteret për ndarjen e regjioneve gjeografike. Përcakton kufijtë e Evropës dhe i tregon rolin e pozitës së saj. </td> </tr> </tbody> </table>	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)	Pozita, kufijtë dhe madhësia e Evropës	<ul style="list-style-type: none"> Përcakton kriteret për ndarjen e regjioneve gjeografike. Përcakton kufijtë e Evropës dhe i tregon rolin e pozitës së saj.
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)			
Pozita, kufijtë dhe madhësia e Evropës	<ul style="list-style-type: none"> Përcakton kriteret për ndarjen e regjioneve gjeografike. Përcakton kufijtë e Evropës dhe i tregon rolin e pozitës së saj. 				
Specifikat populatave, kulturore dhe politiko-administrative të Evropës	<ul style="list-style-type: none"> Dallon popujt, kulturat dhe grupet më të mëdha të popujve në Evropë, në regjione dhe në shtete. Analizon mënyrën e organizimit shtetëror unitar, federal, republikan dhe mbretëritë. 				

Proceset shoqërore dhe natyrore	RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke	
	<p>2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.</p> <p>2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.</p>	
	Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon njësitë kryesore morfologjike (gadishujt dhe ishujt më të njohur të Evropës, sistemet malore- vargmalet, malet e vjetra, ultësirat, fushat dhe luginat lumore më të njohura). • Dallon tipat kryesorë klimatikë që dominojnë në Evropë. • Analizon përhapjen e lumenjve dhe të liqeneve në kontinentin e Evropës. • Analizon përhapjen e botës bimore dhe shtazore në kontinentin e Evropës.
	Evropa Jugore, veçoritë natyrore	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon gadishujt, ishujt, objektet e tjera natyrore dhe shtetet që e përbëjnë Evropën Jugore. • Analizon pozitën e Evropës jugore dhe ndikim historik të saj. • Vlerëson ndikimin e detit Mesdhe përmes rritjes së bimëve mesdhetare dhe jetës së njerëzve. • Dallon në hartë sistemet malore, fushat, rrafshlartat dhe luginat lumore më të njohura dhe arsyeton pse rreth Mesdheut ka tërmete dhe vullkane (Etna, Vezuvi etj.). • Analizon faktorët klimatikë që ndikojnë në klimën e vendeve të Evropës Jugore. • Arsyeton rrjetin e varfër lumor, sasinë e vogël të ujit gjatë verës dhe varfërinë e liqeneve në Evropën Jugore.
	Evropa e Mesme, veçoritë natyrore	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon pozitën gjeografike të Evropës së Mesme dhe rëndësinë e saj për regjionet e tjera të Evropës. • Identifikon në hartë shtetet e Evropës së Mesme dhe fqinjët e tyre. • Analizon shtrirjen e vargmaleve, malet e vjetra, ultësirat dhe fushat e rëndësishme të këtij regjioni. • Dallon dhe arsyeton tipat e klimës mes pjesëve perëndimore dhe lindore, viseve të larta dhe të ulëta të Evropës së Mesme. • Identifikon lumenjtë më të rëndësishëm dhe i përshkruan veçoritë specifike të tyre. • Dallon në hartën fiziko-gjeografike liqenet më të njohura në Evropën e Mesme.
	Evropa e Mesme, veçoritë shoqërore	<ul style="list-style-type: none"> • Radhit popujt e Evropës së Mesme sipas numrit të popullsisë. • Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.
	Evropa Perëndimore, veçoritë natyrore	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës Perëndimore dhe rolin e saj për Evropën në përgjithësi. • Vlerëson se çfarë ishte roli i pozitës gjeografike në ngjarjet historike të Evropës Perëndimore.

		<ul style="list-style-type: none"> • Arsyeton rëndësinë e detit për jetën dhe në luftën e njerëzve me të. • Vlerëson rëndësinë e Oqeanit dhe të Rrymës së Golfit në klimë dhe në jetën e njerëzve. • Identifikon malet më të njohura molloke, të reja, fushat, polderet dhe luginat lumore. • Arsyeton rolin e grykave të lumenjve në formë të hinkës (estuareve) për lundrim.
	Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë natyrore	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon shtrirjen gjeografike të Evropës Veriore dhe Verilindore. • Vlerëson ndikimin e detit dhe klimës në këtë regjion gjeografik. • Arsyeton ndryshimet e mëdha në reliev si rezultat i ndikimit të akullnajave. • Përshkruan relievin malor, rrafshlartat malore, fjordet, fushat dhe pyjet. • Dallon tiparet e klimës dhe dallimet e saj nga Atlantiku e deri te tajgat ruse. • Arsyeton shkaqet e lumenjve të shkurtër, me shumë ujë dhe me fuqi të madhe energjetike. • Arsyeton praninë e numrit të madh të liqeneve. • Dallon ndërrimin e bimësisë dhe të kafshëve nga veriu e deri në jug dhe nga perëndimi në drejtim të lindjes.
	Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë shoqëro-ekonomike	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon popujt që banojnë në këtë regjion dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike. • Vlerëson rolin e pasurive dhe të kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve. • Nxjerr përfundime pozitive se si kanë arritur njerëzit nivelin e lartë të zhvillimit kulturor e ekonomik në kushte të vështira natyrore.
	Evropa Lindore me Bashkësitë e Shteteve të Pavarura -veçoritë natyrore	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon në hartë shtetet e Evropës Lindore dhe sqaron Bashkësinë e Shteteve të Pavarura. • Analizon deri ku shtrihet Evropa Lindore dhe deri ku Bashkësia e Shteteve të Pavarura si dhe sqaron pozitën transitive socio-ekonomike dhe politike të këtyre shteteve. • Dallon tërësitë e mëdha relievore: Ultësirën e Evropës Lindore, Ultësirën Perëndimore të Sibirit, të Turanit, vargmalet e Karpateve, Kaukazit të Madh, të Vogël, Malet e Azisë Qendrore deri te lumi Amur dhe Gadishulli Kamçatka. • Analizon tipat e klimave prej Evropës Lindore e deri në bregdetin e Pacifikut dhe prej Oqeanit të Ngrirë të Veriut e deri te vargmalet e larta në jug. • Ndërlidh klimën me tipat e vegjetacionit sipas zonave. • Identifikon, rrjedhjet, drejtimin e rrjedhjes dhe veçoritë specifike të lumenjve. • Identifikon, emërton dhe krahason liqenet më të njohura të Evropës Lindore dhe të Bashkësisë së Shteteve të Pavarura sipas veçorive të tyre. • Identifikon në hartë shtrirjen e shkretëtirave, emrat e tyre dhe arsyeton praninë e tyre.

<p>Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë</p>	<p>RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.</p> <p>3.1 Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, të ligjeve dhe të zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.</p> <p>3.2 Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, të traditave, të bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.</p>
	<p>Evropa Jugore, veçoritë shoqëro-ekonomike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizojnë specifikat natyrore, popullore, kulturore, ekonomike dhe politike të shteteve të Evropës Jugore. • Identifikojnë veçoritë e ujit, të klimës, të pasurive kulturore dhe elementeve të tjera etnike të zonës mesdhetare dhe rolin e tyre turistik-ekonomik. • Identifikojnë popujt që jetojnë në vendet e Evropës Jugore. • Analizojnë shpërndarjen hapësimore të popullsisë, shpjegojnë dallimet në dendësi, në vendet e ndryshme të Evropës Jugore. • Identifikojnë zonat turistike më të njohura në këtë regjion dhe vlerësojnë ndikimin e turizmit në ekonominë e shteteve të Evropës Jugore.
<p>Vendimmarrja dhe institucionet</p> <p>Proceset shoqërore dhe natyrore</p>	<p>RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme</p> <p>4.1. Vlerësojnë ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijojnë qëndrime personale për to dhe i përdorin në jetën e tij të përditshme.</p> <p>4.2. Tregojnë kujdes, respekt e përgjegjëshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).</p> <p>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.</p> <p>2.1. Përdorin burime të ndryshme kur prezantojnë dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.</p> <p>2.2. Shpjegojnë orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.</p>
	<p>Evropa Perëndimore, veçoritë shoqëro-ekonomike</p> <p>Evropa Perëndimore, veçoritë shoqëro-ekonomike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësojnë rëndësinë e shumë kanaleve që lidhin lumenjtë mes veti. • Identifikojnë pesë limanet më të njohura të Evropës Perëndimore. • Analizojnë shtrirjen gjeografike dhe rëndësinë ekonomike të vendburimeve të qymyrit, të naftës, të gazit, të hekurit dhe të metaleve të tjera. • Analizojnë aspekte tjera të ndërlidhura me pozitën që i kanë mundësuar zhvillim ekonomik dhe turistik këtij regjioni. • Identifikojnë popujt e Evropës Perëndimore sipas shteteve. • Radhitin shtetet e Evropës Perëndimore sipas numrit të banorëve si dhe të ardhurave për kokë banori.

<p>Vendimmarrja dhe institucionet</p> <p>Proceset shoqërore dhe natyrore</p>	<p>RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.</p> <p>4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme.</p> <p>4.2. Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).</p> <p>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.</p> <p>2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.</p> <p>2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.</p>	
<p>Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm</p>	<p>Evropa Lindore me Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, veçoritë shoqërore</p>	<ul style="list-style-type: none"> Dallon popujt më të njohur në Evropën Lindore dhe Bashkësinë e Shteteve të Pavarura sipas përkatësisë etnike e fetare. Identifikon në hartat e punës qytetet më të njohura dhe më të mëdha të Evropës Lindore dhe të Bashkësisë së Shteteve të Pavarura. Analizon shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, popullative, nivelit të arsimit, sistemit politik, urbanizimit dhe strukturës ekonomike të tyre.
	<p>Evropa e Mesme, veçoritë ekonomike</p>	<ul style="list-style-type: none"> Analizon shtrirjen e vendburimeve më të njohura të qymyrit dhe të hekurit në këtë region. Analizon zhvillimin ekonomik të shteteve të Evropës së Mesme, duke u bazuar edhe në resurset e tyre.
	<p>Evropa Lindore me Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, veçoritë ekonomike</p>	<ul style="list-style-type: none"> Dallon viset e tundrave, tajgeve, stepeve, shtrirjen gjeografike dhe rolin e tyre në ekonomi. Arsyeton hapjen e kanaleve dhe rëndësinë e tyre ekonomike në pjesën evropiane. Identifikon në hartë vendburimet e mineraleve më të njohura në hapësirën e Bashkësisë së Shteteve të Pavarura dhe rëndësinë e tyre ekonomike.

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Shkencat natyrore **Klasa VII**

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkallë)
	Gjysmëvjetori I		Gjysmëvjetori II		
	shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor	
Gjeografi	<p>1. Pozita, kufijtë dhe madhësia e Evropës</p> <p>2. Kontinenti i Evropës</p> <p>2.1 Specifikat popullore, kulturore dhe politiko-administrative të Evropës</p> <p>2.2. Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës</p> <p>3. Evropa Jugore</p>	<p>3. Evropa Jugore</p> <p>4. Evropa e mesme</p>	<p>4. Evropa e mesme</p> <p>5. Evropa Perëndimore</p>	<p>6. Evropa veriore dhe verilindore</p> <p>7. Evropa Lindore</p>	<p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit –</p> <p>Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6;</p> <p>Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ 1, 3, 4, 5, 7, 8;</p> <p>Kompetenca e të nxënit- Nxënës i suksesshëm 1, 3, 5, 6, 8;</p> <p>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë 1, 4, 5, 6;</p> <p>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm 3,5,6.</p>
	Gjithsej 17 orë	Gjithsej 17 orë	Gjithsej 21 orë	Gjithsej 19 orë	

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Gjeografi 7

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: VII

Temat mësimore: Pozita, kufijtë dhe madhësia e Evropës; Specifikat popullore, kulturore dhe politiko-administrative të Evropës; Evropa Jugore.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: I. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*

1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si: libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5.	Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ dhe kritik

1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
4.	Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
8.	Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

Kompetenca e të nxënësve – Nxënës i suksesshëm

1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5.	Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6.	Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
8.	Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribuues produktiv

5.	Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, dizajnim të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës.
7.	Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndiërlidhja me lëndë të tjera, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Natyrë grimore e lëndës</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcakton kriteret për ndarjen e regjioneve gjeografike; - Përcakton kufijtë e Evropës dhe i tregon rolin e pozitës së saj; - Dallon popujt, kulturat dhe grupet më të mëdha të popujve në Evropë, në regjione dhe në shtete; - Analizon mënyrën e organizimit shtetëror unitar, federal, republikan dhe mbretëritë - Identifikon njësit kryesore morfologjike (gadishujt dhe ishujt më të njohur të Evropës; sistemet malorë- vargmalet, malet e vjetra, ulësirat, fushat dhe luginat lumore më të njohura); - Dallon tipat kryesore klimatike që dominojnë në Evropë; - Analizon përhapjen e lumenjve dhe të liqeneve në kontinentin e Evropës; - Analizon përhapjen e botës bimore dhe shtazore në kontinentin e Evropës; - Identifikon gadishujt, ishujt, objektet tjera natyrore dhe shtetet që e përbëjnë Evropën Jugore; - Analizon pozitën e Evropës jugore dhe ndikimin historik të saj; - Vlerëson ndikimin e Detit Mesdhe përmes rritjes së bimëve mesdhetare dhe jetës së njerëzve; - Dallon në hartë sistemet malore, fushat, rrafshlartat dhe luginat lumore më të njohura dhe arsyet pse rreth Mesdheut ka termete dhe vullkane (Etna, Vezuvi etj.); 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Regjionet, kuptimet dhe ndarja 2. Emri, pozita, kufijtë dhe madhësia 3. Popullsia dhe veçoritë e saj 4. Rregullimi shtetëror i vendeve Evropiane 5. Ushtrime me hartën e Evropës 6. Përthyeshmëria e bregdetit 7. Relievi i Evropës 8. Klima e Evropës: faktorët, karakteristikat dhe tipat e klimës 9. Hidrografia e Evropës: lumenjtë dhe liqenet 10. Ushtrime: Klima dhe hidrografia 11. Tokat, bota bimore dhe shtazore 12. Pasuritë natyrore dhe zhvillimi ekonomik 13. Ndarja regjionale dhe politike e Evropës 14. Aktivitet: Evropa 15. Evropa Jugore – veçoritë natyrore 	<p>17</p>	<p>Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);</p> <p>Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);</p> <p>Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);</p> <p>Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale;</p> <p>Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;</p> <p>Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale.</p>	<p>- Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke pasur parasysh kriteret;</p> <p>Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke pasur parasysh kriteret;</p> <p>- Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.);</p> <p>- Vlerësimi me anë të dëgjimit; Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke pasur parasysh kriteret;</p>	<p>Historia; Edukata Qytetare.</p>	<p>Teksti bazë; Atlas; Enciklopedi; Internet; Harta; Globi; Fletore pune 7.</p>	

	<ul style="list-style-type: none"> - Analizon faktorët klimatikë që ndikojnë në klimën e vendeve të Evropës Jugore: - Arsyeton rrjetin e varfër lumor, sasinë e vogël të ujit gjatë verës dhe varfërinë e liqeneve në Evropën Jugore. 	<p>16. Evropa Jugore – veçoritë shoqërore dhe ekonomike</p> <p>17. Italia</p>	<p>- Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.);</p> <p>- Vlerësimi me anë të dëgjimit; Vlerësimi i punimeve dhe paraqitjeve të fakteve për trupat qiellore dhe paraqitja dhe renditja e tyre në formën vizuale (vizatimit). Shënimet mbahen në listën e kontrollit me nota.</p>		
--	---	---	---	--	--

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Gjeografi 7

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi
Temat mësimore: Evropa Jugore; Evropa e Mesme

Klasa: VII

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ temave: I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si: libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5.	Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ dhe kritik

1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
4.	Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
8.	Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5.	Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6.	Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
8.	Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribuues produktiv

5.	Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, dizajnim të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës.
7.	Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Njësitë mësimore	Burimet
	<ul style="list-style-type: none"> - Analizon pozitën gjeografike të Evropës së Mesme dhe rëndësinë e saj për regionet e tjera të Evropës; - Identifikon në hartë shtetet e Evropës së Mesme dhe fqinjët e tyre; - Analizon shtrirjen e vargmaleve, malet e vjetra, ultësirat dhe fushat e rëndësishme të këtij regjioni; - Dallon dhe arsyeton tipat e klimës mes pjesëve perëndimore dhe lindore, viseve të larta dhe të ulëta të Evropës së Mesme; - Identifikon lumenjtë më të rëndësishëm dhe i përshkruan veçoritë specifike të tyre; - Dallon në hartën fiziko-gjeografike liqenet më të njohura në Evropën e Mesme; - Radhit popujt e Evropës së Mesme sipas numrit të popullsisë; - Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre; - Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës Perëndimore dhe rolin e saj për Evropën në përgjithësi; - Vlerëson se çfarë ishte roli i pozitës gjeografike në ngjarjet historike të Evropës Perëndimore. - Arsyeton rëndësinë e detit për jetën dhe në lufitën e njerëzve me të; - Vlerëson rëndësinë e Oqeanit dhe të rrymës së Golfit në klimë dhe në jetën e njerëzve; 	<p>17</p> <p>18. Ushtrime: ITALIA Vatikani, San Marino, Malta</p> <p>19. Spanja</p> <p>20. Andorra dhe Gjibraltari</p> <p>21. Portugalia</p> <p>22. Greqia</p> <p>23. Ushtrime me hartën e Evropës Jugore</p> <p>24. Bullgaria</p> <p>25. Maqedonia e Veriut</p> <p>26. Serbia</p> <p>27. Kroacia</p> <p>28. Mali i Zi</p> <p>29. Bosnjë dhe Hercegovina</p> <p>30. Evropa e Mesme – veçoritë natyrore</p> <p>31. Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia</p> <p>32. Evropa e Mesme – veçoritë shoqërore dhe ekonomike</p> <p>33. Ushtrime: Evropa Jugore dhe Evropa e Mesme</p> <p>34. Gjermania</p>		<p>- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);</p> <p>- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);</p> <p>- Diskutimi dhe të nxënërit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);</p> <p>- Të mësuarit dhe të nxënërit përmes mjeteve multimediale;</p> <p>- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;</p> <p>- Të mësuarit dhe të nxënërit përmes mjeteve multimediale.</p>	<p>- Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke pasur parasysh kriteret;</p> <p>- Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke e pasur parasysh kriteret;</p> <p>- Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.);</p> <p>- Vlerësimi me anë të dëgjimit;</p> <p>- Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke e pasur parasysh kriteret;</p>	<p>Historia;</p> <p>Edukata Qytetare.</p>	<p>Teksti bazë; Atlas; Enciklopedi; Internet; Harta; Glob; Fletore pune 7.</p>

Njësitë mësimore
me çështjet
ndërkurrikulare
dhe
situatat jetësore

	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikon malet më të njohura molloke, të reja, fushat, polderet dhe luginat lumore; - Arsyeton rolin e grykave të lumenjve në formë të hinkës (estuarëve) për lundrim. 			<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); - Vlerësimi me anë të dëgjimit; - Vlerësimi i punimeve dhe paraqitjeve të fakteve për trupat qjellor dhe paraqitja dhe renditja e tyre në formën vizuale (vizatimet). Shënimet mbahen në listën e kontrollit me nota. 		
--	--	--	--	--	--	--

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Gjeografi 7

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Klasa: VII

Temat mësimore: Evropa Perëndimore; Evropa e Mesme

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ temave: I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5.	Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ dhe kritik

1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
4.	Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
8.	Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5.	Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6.	Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
8.	Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribuues produktiv

- | | |
|----|--|
| 5. | Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, dizajnim të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës. |
| 7. | Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj). |

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<ul style="list-style-type: none"> - Analizon pozitën gjeografike të Evropës së Mesme dhe rëndësinë e saj për regionet e tjera të Evropës; - Identifikon në hartë shtetet e Evropës së Mesme dhe fqinjët e tyre; - Analizon shtrirjen e vargmaleve, malet e vjetra, ultësirat dhe fushat e rëndësishme të këtij regjioni; - Dallon dhe arsyeton tipat e klimës mes pjesëve perëndimore dhe lindore, viseve të larta dhe të ulëta të Evropës së Mesme; - Identifikon lumenjtë më të rëndësishëm dhe i përshkruan veçoritë specifike të tyre; - Dallon në hartën fiziko-gjeografike liqenet më të njohura në Evropën e Mesme; - Radhit popujt e Evropës së Mesme sipas numrit të popullsisë; - Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre; - Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës Perëndimore dhe rolin e saj për Evropën në përgjithësi; - Vlerëson se çfarë ishte roli i pozitës gjeografike në ngjarjet historike të Evropës Perëndimore; - Arsyeton rëndësinë e detit për jetën dhe në luftën e njerëzve me të; 	<p>35. Testim i Gjysmëvetorit të parë</p> <p>36. Prezantim i punimeve</p> <p>37. Gjermania</p> <p>38. Polonia</p> <p>39. Çekia dhe Sllovakia</p> <p>40. Slovenia</p> <p>41. Austria</p> <p>42. Zvicra dhe Lihten-shtajni</p> <p>43. Ushtrime dhe forçim me hartën e Evropës së Mesme</p> <p>44. Hungaria</p> <p>45. Rumania</p> <p>46. Evropa Perëndimore – veçoritë natyrore (Pozita, kufijtë dhe madhësia)</p> <p>47. Veçoritë shoqërore - ekonomike të Evropës Perëndimore - Popullsia</p> <p>48. Ushtrime me hartë</p> <p>49. Britania e Madhe</p> <p>50. Irlanda</p> <p>51. Franca</p> <p>52. Aktivitet: Evropa Perëndimore</p> <p>53. Monako dhe Luksemburgu</p> <p>54. Belgjika</p> <p>55. Holanda</p> <p>56. Ushtrime: Evropa Perëndimore</p>	21	<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj); - Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve). - Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); - Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale; - Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve; - Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale. 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke pasur parasysh kriteret; - Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke pasur parasysh kriteret; - Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.); - Vlerësimi me anë të dëgjimit; - Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke pasur parasysh kriteret; 	<p>Historia;</p> <p>Edukata Qytetare.</p>	<p>Tekst bazë;</p> <p>Atlas;</p> <p>Enciklopedi,; Internet;</p> <p>Harta;</p> <p>Globi;</p> <p>Fletore pune 7.</p>	

	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikon malet më të njohura molloke, të reja, fushat, polderet dhe luginat lumore; - Arsyeton rolin e grykave të lumëve në formë të hinkës (estuareve) për lundrim. - Vlerëson rëndësinë e Oqeanit dhe të rrymës së Golfit në klimë dhe në jetën e njerëzve; 		<p>- Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.)</p> <p>- Vlerësimi me anë të dëgjimit</p> <p>Vlerësimi i punimeve dhe paraqitjeve të fakteve për trupat qiellore dhe paraqitja dhe renditja e tyre në formën vizuale (vizatimit).</p> <p>Shënimet mbahen në listën e kontrollit me nota.</p>		
--	--	--	---	--	--

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Gjeografi 7

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi
Temat mësimore: Evropa Veriore-Verilindore;
Evropa Lindore

Klasa: VII

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ temave: I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5.	Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ dhe kritik

1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
4.	Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
8.	Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5.	Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6.	Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
8.	Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribuues produktiv

5.	Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, dizajnim të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës.
7.	Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Toka dhe atmosfera	<ul style="list-style-type: none"> - Analizon shtrirjen gjeografike të Evropës Veriore dhe Verilindore; - Vlerëson ndikimin e detit dhe klimës në këtë region gjeografik; - Arsyeton ndryshimet e mëdha në relief si rezultat i ndikimit të akullnajavë; - Përshkruan relievin malor, rrafshlartat malore, fjordet, fushat dhe pyjet; - Dallon tiparet e klimës dhe dallimet e saj nga Atlantiku e deri te tajgat ruse; - Arsyeton shkaqet e lumenjve të shkurtër, me shumë ujë dhe me fuqi të madhe energetike; - Arsyeton praninë e numrit të madh të liqeneve; - Dallon ndërrimin e bimësisë dhe të kafshëve nga veriu e deri në jug dhe nga perëndimi në drejtim të lindjes; - Identifikon popujt që e banojnë këtë region dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike; - Vlerëson rolin e pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve; - Nxjerr përfundime pozitive si kanë arritur tjerëzitet nivelin e lartë të zhvillimit kulturor e ekonomik në kushte të vështira natyrore; - Identifikon në hartë shtetet e Evropës Lindore dhe sqaron Bashkësinë e Shteteve të Pavarura; 	<p>56. Evropa Veriore dhe Verilindore (shtetet baltike) – veçoritë natyrore</p> <p>57. Evropa Veriore dhe Verilindore – veçoritë shoqërore-ekonomike</p> <p>58. Suedia</p> <p>59. Norvegjia</p> <p>60. Danimarka</p> <p>61. Finlanda</p> <p>62. Islanda</p> <p>63. Ushtrime: Shtetet Skandinave</p> <p>64. Estonia, Letonia dhe Lituania</p> <p>65. Aktivitet: Evropa Veriore (Shtetet Baltike)</p> <p>66. Evropa Lindore – veçoritë natyrore - Pozita gjeografike dhe kufijtë</p> <p>67. Evropa Lindore – veçoritë shoqërore dhe ekonomike</p> <p>68. Federata Ruse</p> <p>69. TESTIM VP2</p> <p>70. Popullsia dhe zhvillimi ekonomik i Federatës Ruse</p> <p>71. Ushtrime: Evropa Lindore</p> <p>72. Ukraina</p> <p>73. Bjellorusia</p> <p>74. Moldavia</p>	19	<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shp-jegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt); - Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve). - Diskutimi dhe të nxënimit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); - Të mësuarit dhe të nxënimit përmes mjeteve multimediale; - Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve; - Të mësuarit dhe të nxënimit përmes mjeteve multimediale. 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke paasur parasysh kriteret; - Nxënësit vlerësohen sipas veprimtarive të listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke paasur parasysh kriteret; 	Historia; Edukata Qytetare.	Teksti bazë; Atlas; Enciklopedi; Internet; Harta; Glob; Fletore pune 7.

	<ul style="list-style-type: none"> - Analizon deri ku shtrihet Evropa Lindore dhe deri ku Bashkësia e Shteteve të Pavarura si dhe sqaron pozitën transitive socio-ekonomike dhe politike të këtyre shteteve. - Dallon tërësitë e mëdha relievo-re: Ullësirën e Evropës Lindore, Ullësirën Perëndimore të Sibirit, të Turanit, vargmalet e Karpatëve, Kaukazit të Madh, të Vogël, Malet e Azisë Qendrore deri te lumi Amur dhe Gadishulli Kamçatka; - Analizon tipat e klimave prej Evropës Lindore e deri në bregdetin e Pacifikut dhe prej Oqeanit të Ngrirë të Veriut e deri te vargmalet e larta në jug; - Ndërlidh klimën me tipat e vegjetacionit sipas zonave; - Identifikon, rrjedhjet, drejtimin e rrjedhjes dhe veçoritë specifike të lumenjve; - Identifikon, emërton dhe krahason liqenet më të njohura të Evropës Lindore dhe Bashkësisë së Shteteve të Pavarura sipas veçorive të tyre; - Identifikon në hartë shtrirjen e shkretëtirave, emrat e tyre dhe arsyeve praninë e tyre. 		<p>- Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.);</p> <p>- Vlerësimi me anë të dëgjimit;</p> <p>Vlerësimi i punimeve dhe paraqitjeve të fakteve për trupat qiellore dhe paraqitja dhe renditja e tyre në formën vizuale (vizatimit). Shënimet mbahen në listën e kontrollit me nota.</p>	
--	--	--	--	--

Mësimi 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Pozita, kufijtë dhe madhësia e Evropës

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përcakton kriteret për ndarjen e regjioneve gjeografike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1, 2, 4, 6; II-1; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe të përfshirjes në to. 1.1; 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Regjionet, kuptimet dhe ndarja

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon kuptimin e regjionit gjeografik si tërësi e individualizuar gjeografike;
- Identifikon elementet natyrore të një regjioni.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Individ, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, glob, atlas, libri i Gjeografisë 7, Fletore Pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Diskutim i përbashkët

Mësimdhënësi iu drejtohet me pyetje nxënësve:
- Cilat elemente dominojnë në hartë/fotografi?
- Cili është dallimi në mes të Saharës dhe Amazonës?
- Cili element i specifikojnë këto dy regjione?



Mësimi 2

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Pozita, kufijtë dhe madhësia e Evropës

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përcakton kufijtë e Evropës dhe tregon rolin e pozitës së saj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I-1, 2, 3, 4, 6; II-4; III-3, 5, 8.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe të përfshirjes në to. 1.1; 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Emri, pozita, kufijtë dhe madhësia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan në hartë kufijtë natyror të Evropës;
- Identifikon detet, ngushticat detare, siudhesat dhe ujdhesat e mëdha në Evropë

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Individit, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, glob, libri i Gjeografisë 7 Fletore Pune

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

“Asociacion”

Arsimtari fillon orën duke formuar një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asociojnë.

A	B	C	D
“Gadishull”	“Perëndimi i Diellit”	“ereb”	Brexit


EVROPA

Emri, pozita kufijtë
dhe madhësia

Kontinenti i Evropës e ka marrë emrin nga fjala e vjetër asire “ereb”, që do të thotë tokë e perëndimit të diellit. Me këtë fjalë asirët quanin tokën që shtrihet në perëndim të vendit të tyre. Ky emërtim përcillet te fenikasit, grekët e vjetër e deri në ditët e sotme. Disa gjeografë, për shkak të vazhdimësisë natyrore të Evropës me Azinë, nuk e konsiderojnë atë kontinent të veçantë, por së bashku me Azinë e quajnë **Euroazi**. Euroazia përbën masën më të madhe kontinentale në Tokë, brenda së cilës Evropa përbën “gadishullin” më të madh të saj. Megjithatë, për shkak të shkallës së lartë të zhvillimit ekonomik, dendësisë së madhe të popullsisë dhe rolit prijës të Evropës në zhvillimin e gjithëmbarshtëm dhe proceseve të rëndësishme historike, ajo ka fituar epitetin e kontinentit të veçantë. Pozita qendrore e kontinentit të Evropës në hemisferën veriore e ka bërë atë urë lidhëse ndërmjet “Botës së Re” dhe “Botës së Vjetër”. Botës së vjetër i takojnë Evropa, Azia dhe Afrika, ndërsa në botën e re bëjnë pjesë kontinentet më vonë të zbuluara, si Amerika Veriore dhe Jugore, Australia, Oqeania dhe Antarktika. Pozita gjeografike e Evropës është mjaft e volitshme sepse Evropa shtrihet ndërmjet 71° dhe 36° të gjerësisë gjeografike veriore dhe ndërmjet 9° 30’ të gjatësisë gjeografike perëndimore dhe 66° të gjatësisë gjeografike lindore.

Pikat më të skajshme të Evropës janë: kepi Nordkap (Norvegji), kepi Tarifa (Spanjë), kepi Roka (Portugali) dhe mali Ural (Rusi). Kufiri lindor i Evropës me Azinë fillon me malin Ural, i cili ka shtrirje veri-jug dhe vazhdon me lumin Ural dhe bregdetin perëndimor të liqenit Kaspik, vargmalet e Kaukazit, Detin e Zi, ngushticën e Bosforit, detin Marmara dhe detin Egje. Me kontinentin e Afrikës në jug ndahet përmes detit Mesdhe. Te ngushtica e Gjibraltarit, Evropa i afrohet Afrikës vetëm 14 kilometra. Për shkak të pozitës së volitshme gjeografike, Evropa shumë herët është bërë vatër e civilizimeve dhe kulturave, e cila ka shtrirë ndikimin e vet në të katër anët e botës. Pas zbulimeve të mëdha gjeografike, Evropa fillon me proceset kolonizuese dhe zhvillimin e tregtisë. Shtetet e fuqishme detare të Evropës e bëjnë ndarjen e botës sipas kolonive, të cilat i kishin pushtuar. Duke shfrytëzuar pasuritë natyrore të kolonive, i zhvillojnë ekonomikisht shtetet e veta. Këto shtete në shekullin XIX bëhen perandori të fuqishme kolonialiste me territore të shumta gjithandej nëpër botë. Të tilla kanë qenë Britania e Madhe, Franca, Spanja, Holanda, Belgjika etj. Me sipërfaqe prej 10.390.000 km², është kontinenti i parafundit për nga madhësia, menjëherë pas Australisë.

8



Europa dhe Demit (Muzeu "Tareumia", rreth 480 vjet para erës sonë)

Në mitologjinë greke, Evropa është gruaja të cilën e kishte rrëmbyer Zeusi. Megjithatë nga ky mit nuk kuptojmë se pse kontinenti është quajtur me këtë emër. Qysh në shekullin VI para erës sonë, në Greqinë e vjetër, me Evropë filloi të quhej toka në veri të gjirit të Korintit, kurse më vonë edhe vendet përreth Greqisë, të cilat dilyn në detin Mesdhe.

Pyetje

1. Shpjego kuptimin e fjalës **Evropë** dhe trego kush e ka përdorur për herë të parë atë.
2. Përmend dallimet ndërmjet Evropës dhe Azisë, të cilat kanë bërë që Evropa të konsiderohet kontinent më vete.
3. Përshkruaj kufirin lindor të Evropës me të cilin ajo ndahet prej Azisë.
4. Cilat janë pikat më të skajshme të kontinentit evropian?


Mësimdhënësi, pasi që zbulohet asociacioni, pyet nxënësit për fjalët kyçe: Pse “gadishull”, “perëndimi i Die-llit”, “ereb”, “Brexiti”?

Gjithashtu, pyet nxënësit për fjalët kyçe dhe njihen me njësinë e re që do zhvillohet pasi që zbulohet asociacioni.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**
Organizues grafik i njohurive

Diagrami i njohurive mund të përdoret me mjaft sukses në këtë fazë të kësaj teme mësimore dhe synohet nxitja e të menduarit dhe e interesit të nxënësve për çështjet që do të shtjellohen. Vizatohet harta e të pyeturit, e plotësuar me pyetje, që nxënësit gjatë leximit t’i identifikojnë përgjigjet dhe pastaj plotësojnë tabelën.



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatim i të nxënit**
Punë me hartë dhe fletore të punës

Mësimdhënësi paraqet një hartë në të cilën vendos disa numra (letër ngjitëse) ngjashëm me Fletore Pune, ku nxënësit duhet të identifikojnë pikat që paraqesin kufijtë e Evropës në atlaset e tyre dhe plotësojnë fletoren e punës.

- | | |
|--------------------|--------------------|
| 1. Mali _____ | 2. Lumi _____ |
| 2. Liqeni _____ | 4. Mali _____ |
| 5. Deti _____ | 6. Ngushtica _____ |
| 7. Ngushtica _____ | 8. Ngushtica _____ |

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 7-9.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 3

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Specifikat e popullatave, kulturore dhe politiko - administrative të Evropës

Rezultatet e të nxënimit të temës:

Dallon popujt, kulturat dhe grupet më të mëdha të popujve në Evropë, në regjione dhe në shtete.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe të përfshirjes në to. 1.1; 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Popullsia dhe veçoritë e saj

Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:

- Identifikon grupet kryesore të popujve në Evropë;
- Evidenton në hartë shtrirjen e popujve sipas shteteve;
- Liston shtetet evropiane sipas religjionit (dominimit të besimit).

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti Gjeografia 7-Dukagjini, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi, projektor, Tv...

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim i përbashkët

Mësimdhënësi paraqet një hartë politike të Evropës, ku kërkon nga nxënësit të identifikojnë së paku nga pesë shtete (territore sovraane) sipas ngjyrave përkatëse, dhe të tregojnë se cilët popuj dhe grupe të popujve jetojnë në ato shtete. Kërkohet që nxënësit t'i plotësojnë sipas njohurive paraprake që kanë për popullsinë në Evropë.

Popullsia dhe veçoritë e saj

Në të kaluarën e lashtë, në Evropë ka banuar njeriu i paleolitit. Në Evropën Jugore dhe Qendrore, janë zbuluar disa gjurmë që dëshmojnë jetën e njeriut të asaj kohe. Gjatë neolitit, popullimi është zgjeruar edhe në pjesët e tjera të kontinentit, ndërsa pas paraqitjes së bujqësisë dhe blegtorisë, ka filluar rritja graduale e numrit të popullsisë. Për shkak të afërsisë me Azinë Jugperëndimore, nga e cila kanë filluar të depërtojnë vlerat civilizuese, në ishullin e Kretës (Greqi) rreth 3000 vjet para erës sonë, nisi të zhvillohej një vatër kulturore në truallin evropian. Prandaj hapësira e mesdheut lindor u bë djepi i civilizimit dhe kulturës evropiane. Gjatë mijëvjeçarit të dytë para erës sonë, në Evropë u vendos popullsia indoevropiane. Në fazën e parë të popullimit, ata pushtuan Evropën Juglindore, kurse më pastaj gadishullin Apenin, Pirinej dhe Evropën Qendrore. Vatra e civilizimit u zhvendos nga Mesdheu në Evropën Perëndimore, duke bërë që të zgjerohet kuptimi (përceptimi) gjeografik për Evropën.

Zbulimet gjeografike kanë mundësuar këmbimin e llojeve bimore dhe shtazore ndërmjet kontinenteve të Botës së Vjetër dhe Botës së Re. Shtetet e fuqishme evropiane nga kolonitë e tyre kanë marrë shumë lëndë të para, të cilat i kanë përpunuar në mënyrë industriale. Prandaj popullsia është ofruar një sasi më e madhe dhe e llojshme e produkteve. Revolucioni industrial dhe ai shkencor e teknologjik në shekullin XIX përmirësuan dukshëm kushtet e jetesës, duke zvogëluar vdekshmërinë në mesin e popullsisë, në veçanti të asaj foshnjore. Kjo ka bërë që të ngriheshin normat e lindshmërisë dhe rritja e shpejtë e numrit të popullsisë, e cila ka vazhduar deri në mesin e shekullit XX.

Evropa, në krahasim me kontinentet e tjera, ka përjetuar një rritje më të shpejtë të popullsisë për të pasuar më vonë ngadalësimi dhe stagnimi i rritjes. Periudha e tranzicionit demografik ka zgjatur rreth 150 vjet.

Në Evropë, po ashtu, jetojnë edhe disa popuj të tjerë indoevropianë, por që nuk u takojnë grupeve të sipërpërmendura. Këtu bëjnë pjesë: shqiptarët dhe grekët në Gadishullin Ballkanik, irlandezët, skocezët dhe uellsianët si pasardhës të keltëve në ishujt e Britanisë së Madhe, lituanezët dhe letonezët në vendet baltike, hungarezët, finlandezët dhe estonezët si pjesëtarë të popullsisë ugrofine me prejardhje nga brendësia e Azisë, si dhe baskët në Spanjë dhe Francë. Origjina e këtyre të fundit ende nuk është e qartë. Popujt më të vjetër të Evropës janë shqiptarët, grekët e vjetër, baskët dhe keltët.



Pjesa më e madhe e popullsisë evropiane i përket besimit të krishterë. Në vendet e Evropës Perëndimore, Qendore dhe në disa të asaj Jugore, popullsia është kryesisht e krishterë katolike. Feja katolike dominon në Francë, Belgjikë, Luksemburg, Gjermani, Austri, Irlandë, Poloni, Sllovakia, Çeki dhe Hungari. Në Evropën Jugore, të fesë katolike janë: italianët, spanjollët, portugezët, maltezët, slovenët dhe kroatët. Besimit të krishterë të drejtimit protestan i takon popullsia e Evropës Veriore, por edhe e asaj të mesme, si e: Norvegjisë, Suedisë, Danimarkës, Zvicrës, Britanisë së Madhe, Holandës, Gjermanisë etj. Besimit të krishterë ortodoks i takojnë popujt e Evropës Lindore dhe disa të Evropës Juglindore. Këtyri besim i takojnë rusët, bjellorusët, ukrainasit, rumunët, moldavët, serbët, malazezët, grekët, bullgarët dhe maqedonët.

14

Popullsia gjermane	Popullsia sllave	Popullsia romane	Të tjera.
Gjermania	Rusia	Franca	Shqipëria
.....			



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Të nxënësit me këmbime - Grupet e ekspertëve

Nxënësit ndahen në grupe. Mësuesi i jep secilit grup nga një detyrë (pyetje) të caktuar dhe punojnë duke u bërë ekspertë të çështjes për të cilën janë caktuar. Mësimi ndahet në pesë paragrafë, duke iu referuar pyetjeve përkatëse.

Grupi 1

- Në të kaluarën e lashtë, cila pjesë e Evropës filloi të bëhej djepi i civilizimit dhe kulturës Evropiane?
- Gjatë mijëvjeçarit të dytë, cila popullsi ishte vendosur në Evropë?
- Tregoni fazat e popullimit të Evropës nga popullsia indoevropiane.

Grupi 2

- Renditni kontinentet sipas popullsisë nga më i madhi deri te më i vogli.
- Sa ka zgjatur periudha e tranzicionit demografik në kontinentin e Evropës?
- Në cilin shekull kishte filluar Revolucioni Industrial në Evropë?

Në mënyrë të njëjtë vazhdohet edhe për tre grupet e tjera

Përfaqësuesit e grupeve iu përgjigjen pyetjeve dhe debatojnë lidhur me to.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatim i të nxënit

Reflektim i punës nga grupet e ekspertëve

Në pjesën e tretë, formën e diskutimit nxënësit e shpjegojnë hartën e shtrirjes së gjuhëve, të besimeve dhe të popujve sipas grupeve të punës, duke i identifikuar edhe shtetet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 10-12

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

Mësimi 4

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Specifikat e popullatave, kulturore dhe politiko - administrative të Evropës

Rezultatet e të nxënimit të temës:

Analizon mënyrën e organizimit shtetëror unitar, federal, republikan dhe mbretëritë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to. 1.1; 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rregullimi shtetëror i vendeve evropiane

Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:

- Evidenton në hartën e punës shtetet Evropiane;
- Kategorizon në grupe shtetet sipas madhësisë dhe organizimit shtetëror të tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Individ, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, glob, libri i Gjeografisë 7

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë paraprake

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që njohuritë nga njësia e kaluar të diskutohen. *Çfarë pozite gjeografike ka Evropa?; Cilët janë popujt më të mëdhenj në Evropë?...*

Rregullimi shtetëror i vendeve evropiane

Sipas formës së organizimit të pushtetit, shtetet mund të jenë republika dhe monarki. Prej 45 shteteve sa ka sot në Evropë, 33 prej tyre kanë rregullimin shtetëror të republikave. Te republikat, në krye të shtetit është presidenti, i cili zgjidhet me votën e popullit apo përmes votimit në kuvend.

Kosova është republika më e re parlamentare në Evropë. Derisa në fillim të shekullit XX vetëm tri shtete ishin republika (Franca, Zvicra dhe San Marinoja), sot janë vetëm 12 shtete që në krye të shtetit kanë trashëgimtarin e fronit.

Në republika parlamentare, pushteti kryesor i takon parlamentit dhe qeverisë, ndërsa në monarki, në krye të shtetit është mbreti. Megjithatë, kohëve të fundit, mbreti gjithnjë e më tepër po merr karakter ceremonial dhe reprezentativ, ndërsa udhëheqjen e shtetit e bëjnë qeveria dhe parlamenti.

Monarki janë shtetet e Evropës Veriore, të Beneluxit dhe shtetet e vogla si Andora, Lihtenshtejni dhe Monakoja. Në këto tri shtete të vogla udhëheq princin, prandaj këto quhen principata.

Cjbraltari është pronë tejetdare e Mbretërisë së Bashkuar dhe e Irlandës Veriore.



Republika Federale Gjermane - Bundestagu



Buckingham Palace, Sela e Mbretërisë së Bashkuar

Me rëndësi të dihet

Pas rënies së Bastijës, më 14 korrik të vitit 1789, në Francë nisi revolucioni borgjez francez. Kuvendi popullor francez më 5 gusht vendosi për heqjen e sistemit feudal. Akti i dytë i rëndësishëm që pasoi ishte aprovim i deklaratës universale për të drejtat e njeriut dhe kushtetutës, të cilat u sollën në vitin 1791. Me këtë kushtetutë Franca u shpall monarki kushtetuese. Në vitin 1792 u hoq monarkia dhe Franca u shpall republikë.

Mbretëria e Suedisë është një nga shtetet me udhëheqjen më të mirë në botë. Ky shtet është i përkushtuar shumë në ruajtjen e paqes dhe tolerancës. Kjo dëshkohet me faktin se në Suedi nuk ka pasur luftëra që nga shekulli XIX. Ajo është një monarki e pasur kushtetuese, e cila radhitet në vendin e shtatë në botë për nga vlera e bruto-prodhimit shoqëror. Aktualisht, mbret i Suedisë është Karl Gustavi XVI, i cili do të trashëgohet nga princeshë Viktoria.

18

Gjatë diskutimit, mësimmhënësi i njofton nxënësit me njësinë e re. Formon tabelë të kategorizuar sipas pikave që kërkohen.

Të mëdha	Të vogla	Të mesme
Suedia	Lihtenshtajni	Çekia



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes *Ditari dypjesësh*

Mësimmhënësi kërkon nga nxënësit që të lexojnë tekstin individualisht dhe në heshtje. Gjatë kohës që nxënësit lexojnë, mësimmhënësi shënon disa pyetje në tabelë.

Pasi të lexohet teksti, nxënësit plotësojnë me përgjigje tabelën.

Pyetje	Komente (fragmente nga teksti)
1. Sa shtete ka kontinenti Evropian?	
2. Çka paraqet sistemi republikan?	
3. Çka paraqet sistemi monark?	
4. Cilat vende kanë sistem mbretëror?	
Njëjtë vazhdohet me pyetje të tjera	



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatim i të nxënësve *Punë me hartë/atlas*

Mësimmhënësi i pajis nxënësit me nga një fletë A4, në të cilën është paraqitur harta memece e Evropës. Nxënësit duhet të plotësojnë detet, shtetet, oqeanin dhe pikat kyçe që janë si kufi natyror i Evropës ndaj kontinenteve të tjera me anën e letrave ngjitëse ose ngjyra. Identifiko: një mbretëri, një shtet federal, një republikë dhe një shtet të vogël.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, demonstrim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 12-13.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

Mësimi 5

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Pozita, kufijtë dhe madhësia e Evropës

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon mënyrën e organizimit shtetëror unitar, federal, republikan dhe mbretëritë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I-1,2,3,4,6; II-4; III-3,5,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: RNF: 1. Njeh rolën e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe të përfshirjes në to. 1.1; 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime me hartën e Evropës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkruan kufijtë e Evropës dhe elementet dalluese të relievit si dhe tregon rolin e pozitës së saj.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti Gjeografia 7 - Dukagjini, fletore pune, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Video-prezantim në PPT Show.


Mësimdhënësi para nxënësve paraqet një video, në të cilën përfshin njësinë mësimore që do të zhvillohet, Evropa. Kërkohet nga një nxënës të shënojë në tabelë disa fjalë që shërbejnë si fjalë kyçe.



Fjalët kyçe: Evropa, Alpet, Kaukazit, Ultësira Lindore, Ballkani, Mesdheu...

Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Harta e të pyeturit

Mësimdhënësi, vizaton hartën e të pyeturit (diagram i degëzuar) për kuptimin, ku ata i plotësojnë pas transmetimit të videos.



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Paragraf përshkrues

Gjatë shkrimit të paragrafi nxënësit shkruajnë në formë përshkruese, me qëllim që të shkruarit e tyre të jetë i kuptimshëm.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për kriteret e arritura gjatë shkrimit, për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

Mësimi 6

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës

Rezultatet e të nxënimit të temës:

- Identifikon njësitë kryesore morfologjike (gadishujt dhe ishujt më të njohur të Evropës, sistemet malore- vargmalet, malet e vjetra, ultësirat, fushat dhe luginat lumore më të njohura).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2, 4; II-6; III-5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke 2.1; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përthyeshmëria e bregdetit

Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:

- Evidenton në hartë format kryesore bregdetare të Evropës;
- Shpjegon rëndësinë e detit Mesdhe për ekonominë e vendeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti Gjeografia 7-Dukagjini, fletore pune, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim i përbashkët

Përthyeshmëria e bregdetit

Evropa në përfundim laget nga oqeani Atlantik, në jug del në detin Mesdhe, ndërsa në veri del në Oqeanin e Ngrirë të Veriut. Ajo ka vijën më të gjatë bregdetare në krahasim me të gjitha kontinentet e tjera. Siujdhësja më e madhe në Oqeanin e Ngrirë të Veriut është Kola, ndërsa ishujt më të mëdhenj janë ishujt Toka e Franc Jozefit, Toka e Re dhe Svalbard. Përthyerja e madhe e bregdetit bën që sidomos ujërat e oqeanit Atlantik, përmes deteve anësore, gjireve dhe ngushticave, të futen thellë në brendësi të kontinentit. Deti Verior, përmes ngushticave Skagerrak dhe Kattegat, lidhet me detin Baltik e gjirin Botnik, si dhe përmes kanalit të Kilit.



Fjord në brigjet e Norvegjisë

Pothuajse 1/3 e sipërfaqes së Evropës e përbëjnë dhe gadishujt. Gadishujt më të mëdhenj janë ai i Skandinavisë dhe Jiland në veri, Gadishulli Pirinej në jugperëndim dhe gadishujt Apenin e Ballkanik në jug. Përthyeshmëria e bregdetit është e dukshme sidomos në brigjet e Skandinavisë ku veprimtaria erozive e akullnajave në të kaluarën ka krijuar një numër të madh të gjireve të ngushta dhe të thella që quhen **fjorde**. Përgjatë gadishujve, shtrihen shumë ishuj të madhësive të ndryshme. Ishujt më të mëdhenj në oqeanin Atlantik janë ai i Britanisë së Madhe, i Irlandës dhe i Islandës. Ishulli i Britanisë së Madhe nga Irlanda ndahet përmes kanalit Saint George dhe Kanalit Verior, ndërsa nga pjesa kontinentale e Evropës ndahet përmes kanalit të La Manshit, i cili të ngushtica e Doverit është i gjerë vetëm 34 km. Në detin Mesdhe, në jug, Evropa del përmes gadishujve Pirinej, Apenin dhe Ballkanik, ndërmjet të cilëve ndodhen disa dete anësore si deti Egje, deti Adriatik, deti Jon, deti Tiren dhe deti Ligur. Ishujt më të mëdhenj janë ai i Sicilisë, Sardenjës, Korzikës, Kretës, Qipros dhe Baleareve. Përthyerja e madhe bregdetare e Evropës shihet si përparësi ndaj kontinenteve të tjera, të cilën evropianët kanë arritur me sukses ta shfrytëzojnë për zhvillimin ekonomik. Evropa është kontinenti më "maritim" i botës, meqenëse ndikimi i detit në Evropë është më i madh se në çdo kontinent tjetër. Pjesa më e madhe e kontinentit evropian aktivitetet e saj i ka të orientuara apo të lidhura me detin, si peshkimin, anijendërtimin, turizmin dhe tregtinë. Deti Egje ndodhet ndërmjet Gadishullit Ballkanik dhe Azisë së Vogël. Vija bregdetare është shumë e përthyer, ndërsa nëpër detin Egje ndodhet një numër i madh i ishujve, të cilët janë të grupuar në disa arkipelagë.



Ngushtica e Bosforit

Këto janë Sporadet veriore, Sporadet jugore dhe Kikladet. Gadishujt më të mëdhenj janë: i Peloponezitet, i Atikës dhe i Halkidikit. Në lindje, deti Egje përmes ngushticës së Dardaneleve lidhet me detin Marmara. Ky det njihëresh ndan Gadishullin Ballkanik që ndodhet në perëndim prej gadishullit të Azisë së Vogël që ndodhet në lindje. Përmes ngushticës së Bosforit, deti Marmara lidhet me Detin e Zi dhe detin Azov. Bosfori ndan dhe bashkon kontinentin e Evropës dhe Azisë, ndërsa në brigjet e tij është ngritur qyteti i Stambollit. Evropianët kanë arritur të shfrytëzojnë të gjitha përparësitë që ofron dalja në dete, duke e shfrytëzuar qysh herët detin për pushtimin e territoreve të reja dhe zgjerimin e njohurive për botën. Për këtë arsye, kontinenti i Evropës është bërë vatrë e civilizimeve dhe kulturave, të cilat në periudhat e mëvonshme historike kanë bartur ndikimet e tyre edhe në kontinentet dhe tokat e reja të zbuluara. Në ditët e sotme, oqeani Atlantik është një hapësirë nëpër të cilën lundrojnë shumë anije tejoqeanike që e lidhin Evropën me Amerikën. Deti Verior është i njohur për gjuetinë e peshkut, ndërsa deti Mesdhe është një ndër rajonet kryesore turistike në botë.

Me rëndësi të dihet

- Gadishujt përbëjnë 27 % të sipërfaqes, kurse ishujt 8 % të sipërfaqes së kontinentit evropian.
- Bregdeti i Evropës është i gjatë 40.075 km, pothuajse sa vija e ekuatorit.
- Më shumë ka rrezik të ndotet ujërat e deteve të mbyllura sesa ato të oqeanit Atlantik, për shkak se te detet e mbyllura përzierja e ujit të pastër dhe të ndotur bëhet më ngadalë. Detet më të rrezikuara janë deti Mesdhe, Baltik dhe Deti Verior.
- Ndotësit më të mëdhenj të deteve janë ujërat e zezë nga kapacitetet industriale të ndërtuara në bregdet e në veçanti nafta dhe industria petrokimike. Ujin e detit e ndotin shpeshherë edhe derdhjet e naftës nga tankerët e mëdhenj naftëmbajtës.
- Kur uji i oqeanit tërhiqet gjatë zbatcave, vija bregdetare tërhiqet për 13 km në brendësi të detit. Atëherë ishulli Mon Mishel krijon lidhje tokësore me pjesën kontinentale të Francës. Ai gjatë baticës është ishull, kurse gjatë zbatcës bëhet një tërësi tokësore me pjesën kontinentale.

Pyetje

1. Cilët janë gadishujt më të mëdhenj të Evropës?
2. Për çka e kanë shfrytëzuar evropianët daljen në dete?
3. Përmendi grupet më të mëdha të ishujve në detin Egje.

Mësimdhënësi para nxënësve paraqet hartën e Evropës dhe të kontinenteve të tjera. Ai iu drejtohet me pyetjen: Cili nga kontinentet ka vijën bregdetare më të përthyer?

Cila vijë bregdetare paraqet më shumë forma?
.....
Komentet diskutohen në detaje.

**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Lexim i drejtuar**

Mësimdhënësi drejton nxënësit të lexojnë paragrafin e parë, individualisht. Kur nxënësit ta përfundojnë leximin e këtij paragrafi, mbyllin tekstin.

- Pas këtij leximi, nxënësve iu shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përmbajtjes:
Ç'kuptoni me përthyeshmëri bregdetare?
Nga cilat ujëra (oqeanë, dete...) laget Evropa?
Cilët janë katër gadishujt më të mëdhenj të Evropës?

...
- Për dallim nga "DRTA" që jemi mësuar deri më sot, mundet që mendimet/komentet më të logjikshme të shënohen në tabelë (një koment përmbledhës).
Hapa të njëjtë merren edhe te leximi i pjesës 2, 3...

**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Intervista**

Përforcimi i mësimit bëhet duke performuar në role. Ndahen nxënësit në grupe me nga 3 pjesëtarë/nxënës. Pyetjet (maksimumi 5 pyetje) mund të formohen vetë ose të merren nga fletore pune.
A-Intervistuesi; B-Shënuesi; C-Personi që intervistohet
Intervistuesi formon 4 pyetje sipas kritereve, ia drejton personit që intervistohet (nxënësit C). Nxënësi B nxjerr shënime në një fletë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për realizimin e saktë të punës, për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:
Plotëso fletore pune.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

Mësimi 7

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Aspektet e përgjithshme-fiziko gjeografike të Evropës

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon njësitë kryesore morfologjike (gadishujt dhe ishujt më të njohur të Evropës, sistemet malore - vargmalet, malet e vjetra, ultësirat, fushat dhe luginat lumore më të njohura).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe të përfshirjes në të. 1.1' 1.3

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Relievi i Evropës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon në hartë format kryesore të relievit të Evropës;
- Analizon relievin sipas regjioneve gjeografike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, glob, libri i Gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
"Asociacion"

Relievi i Evropës



Kontinenti i Evropës ka lartësi mesatare mbidetare prej 295 m, prandaj, së bashku me Australinë, janë kontinentet më ulëta në Tokë. Maja më e lartë e Evropës është **Elbrusi** me 5641 m në pjesën qendrore të Kaukazit, ndërsa pika më e ulët ndodhet në depresionin e **liqenit Kaspik**, ku toka është 28 m nën nivelin e detit botëror. Rreth 2/3 e territorit të Evropës e mbulojnë **ultësirat**, ku lartësia mbidetare nuk kalon 200 m mbi nivelin e detit. Ultësira më e madhe është Ultësira e Evropës Lindore. Kjo është një nga ultësirat më të mëdha në Tokë, e cila shtrihet prej Oqeanit të Ngjirë të Veriut e deri te Deti i Zi e liqeni Kaspik në jug, si dhe prej malit Ural në lindje e deri te deti Baltik e malet e Karpateve në perëndim. Ultësira e Evropës Lindore nga mali Ural vazhdon në drejtim të brendësisë së kontinentit, duke përfunduar me Ultësirën Pranëbaltike, ndërsa më në jug ajo përmes Ultësirës Gjermano-Polake vazhdon deri te ultësira e Evropës Perëndimore. Ultësira Gjermano-Polake përfshin pjesët veriore të Gjermanisë dhe Polonisë dhe e cila del në Detin Verior dhe detin Baltik. Ultësira e Evropës Perëndimore shtrihet përgjatë brigjeve të oqeanit Atlantik dhe Detit Verior, ndërsa kah jugu përfundon në relievin kodrinor-malor të Evropës së Mesme. Në brendësi të Evropës shtrihen ultësira e Panonisë dhe e Vllahisë. Në jug të Evropës ndodhen disa ultësira më të vogla, të cilat janë krijuar përgjatë luginave të lumenjve. Përgjatë luginës së Lumit Guadalkivir, është krijuar ultësira e Andaluzisë, përgjatë luginës së lumit Ebro është krijuar ultësira e Aragonisë, përgjatë Lumit Po, ultësira e Lombardisë dhe në jug të Gadishullit Ballkanik ultësira e Thesalisë.

Relievi ultësitor i Evropës përbën masën e vjetër kontinentale nga e cila në drejtim të periferisë fillojnë të ngrihen malet mollake. Në pjesën qendrore ndodhen Harci, Shumava,

21

Karpatet janë vargmalet më të gjata në Evropë me 1500 km gjatësi. Nisin nga lugina e Danubit në Sllovakë dhe në formë të harkut shtrihen deri në Serbinë Lindore. Kaukazi është sistem malor që shtrihet ndërmjet liqenit Kaspik dhe Detit të Zi. Ato njëherësh paraqesin një segment të caktuar të vijës kufitare të Evropës me Azinë. Janë male të larta, disa prej të cilave janë më të larta se 5000 m. Maja më e lartë është Elbrusi me 5642 m.


Ndikim të konsiderueshëm në formimin e relievit të Evropës ka pasur edhe aktiviteti vullkanik, i cili është i pranishëm në disa pjesë të saj. Këta janë ishulli i Islandës dhe pjesa jugore e gadishullit Apenin dhe disa ishuj të detit Mesdhe. Ishulli i Islandës është një ishull i tipit vullkanik. Në një sipërfaqe prej 103000 km² ka gjithsej 150 vullkane, nga të cilat 26 janë aktive. Vullkani më i njohur i Islandës është **Hekla**. Në jugperëndim të gadishullit Apenin ndodhet vullkani i Vezuvit, e në ishullin e Sicilisë ndodhet vullkani Etna. Në veri të Sicilisë, në kuadër të ishujve Lipare ndodhen dy vullkane të tjera: Stromboli dhe Vullkano.

Me rëndësi të dihet

- Sipas disa gjeografëve dhe regionalistëve, kufiri i Evropës me Azinë nuk ndjek kurrizin e malit Kaukaz, por shtrihet më në veri, prandaj në këtë rast maja më e lartë e Evropës është Mont Blank me 4807 m lartësi mbidetare. Kjo majë malore ndodhet në Alpe, në kufirin midis Francës dhe Italisë.
- Alpet janë vargmalet më të gjata dhe më të larta të Evropës. Shtrihen në formë të harkut nga deti Ligur e deri te ultësira e Panonisë. Disa maja të maleve kalojnë lartësinë mbi 4000 metra dhe disa akullnaja, prej të cilave më e madhja është akullnaja Alet, e gjatë gjithsej 26 km.



Vullkani Hekla (Islandë)



Vullkani Vezuvi (Napoli, Itali jugore)

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asociojnë.

A	B	C	D
Sipërfaqe	Modelim	Malet	Ultësirat
RELIEVI			

Mësimdhënësi pyet nxënësit për fjalët kyçe.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Organizues grafik i njohurive**

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën (tekstin) e njësisë mësimore që do të zhvillohet. Pasi që lexohet, në tabelë formohet organizues grafik i njohurive, dhe në qendër të tabelës shënohet (relievi i Evropës), ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptojnë nga leximi i pjesës.



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatim i të nxënët
Puna me fletoren e punës**

Plotëso fletore pune së bashku me mësimdhënësin si ndihmës (detyrat 14-22).

Detyrë: Duke ditur pikën më të lartë dhe më të ulët të kontinentit evropian, llogarit dallimin hispomëtrik ndërmjet tyre.

Së pari identifikoj elementet në hartë dhe pastaj realizo detyrën.

- Maja më e lartë e Evropës është Elbrusi, me 5.641 m.
 - Maja më e ulët ndodhet në depresionin e liqenit Kaspik, ku toka është 28 m nën nivelin e detit botëror.
- Puna të zhvillohet individualisht në klasë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 13-17.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

Mësimi 8

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Aspektet e përgjithshme-fiziko gjeografike të Evropës

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon tipat kryesore klimatike që dominojnë në Evropë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke 2.1; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Klima e Evropës: faktorët, karakteristikat dhe tipat e klimës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon me hartë dominimin e klimës sipas regjioneve gjeografike;
- Ilustron shtrirjen klimatike në aspektin vertikal në kontinentin Evropian.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, glob, libri i Gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit


Identifikim i fjalëve kyçe

Mësimdhënësi në tabelë shkruan: Evropa, reshjet, temperatura e ajrit, erërat, presioni atmosferik, rrezatimi diellor...

Klima e Evropës


Pozita gjeografiko-matematikore, Rryma e Gollfit, shtrirja e tokës dhe detit, relievi dhe lartësia mbidetare janë faktorët kryesorë që ndikojnë në klimën e Evropës. Pjesa më e madhe e kontinentit shtrihet në brezin e mesëm klimatik me praninë e tipave klimatikë mesatarë, të cilët dallohen me ndërrimin e katër stinëve të vitit. Megjithatë, janë të dukshme dallimet ndërmjet viseve të skajshme veriore dhe jugore të kontinentit. Kontakti i Evropës me oqeanin Atlantik, përmes një vije të gjatë bregdetare, bën që oqeani Atlantik të ketë ndikim të madh në klimën e saj. Kjo për shkak se uji i detit ngrohet dhe ftohet më ngadalë se toka, prandaj kjo bën që të zvoglohen dallimet në temperatura gjatë stinës së verës dhe të dimrit. Faktor i rëndësishëm për klimën e Evropës është edhe Rryma e Gollfit.

Kjo është rrymë detare e ngrohtë, e gjerë 100 km dhe është një nga rrymat më të shpejta oqeanike. Ajo e sjell ujin e ngrohtë nga gjiri i Meksikës, nëpër oqeanin Atlantik deri në Evropë. Prandaj shpeshherë quhet edhe Rryma e Atlantikut Verior. Para brigjeve evropiane, kjo rrymë ndahet në disa degë. Kjo rrymë, e cila lëviz përgjatë brigjeve perëndimore të Evropës, arrin të rrisë nivelin e avullimit të ujit. Masat e ajrit të ngrohtë dhe të ngopur me avull uji nga oqeani lëvizin në drejtim të kontinentit, duke ndikuar në zbutjen e klimës dhe sasinë e konsiderueshme të reshjeve. Sasia më e madhe e reshjeve bie në viset bregdetare, ndërsa duke u larguar nga bregdeti, vjen duke rënë sasia mesatare e reshjeve.



Përmasat dhe drejtimi i shtrirjes së maleve është një faktor tjetër, i cili ndikon në klimën e Evropës. Malet e larta pengojnë depërtimin e masave të lagështa ajrore në brendësi të kontinentit. Vargmalet me shtrirjen e tyre pengojnë depërtimin e masave të ftohta ajrore nga brendësia e kontinentit. I hapur nga jugu, ky regjion ndikohet nga masat e ngrohta dhe të thata prej veriut të Afrikës.

Kjo shpjgohet me faktin se me rritjen e lartësisë mbidetare bien temperaturat dhe rritet sasia e reshjeve. Verat bëhen më të shkurtra dhe të freskëta, ndërsa dimrat më të gjatë dhe më të ftohtë. Relievi i ulët në pjesët e brendshme të Evropës Veriore dhe në Evropën Lindore mundëson depërtimin e masave të ftohta ajrore nga viset polare, por edhe të atyre prej Siberisë së largët. Lartësia mbidetare si faktor klimatik paraqitet në hapësirat e larta malore të Alpeve, Pirinejeve, Karpateve dhe maleve të Skandinavisë. Meqenëse atmosfera (ajri) ngrohet nga toka, më të ngrohta janë shtresat e poshtme të ajrit, ndërsa me rritjen e lartësisë, temperatura e ajrit fillon të bjerë. Në stinën e dimrit, të shpeshta janë edhe inverzionet e temperaturës, me ç'rast, në vend se të bjerë, ajo rritet me rritjen e lartësisë mbidetare. Ajri i ftohtë si më i rëndë grumbullohet (stacionohet) në fushëgropa dhe lugina, i cili bën që në viset e ulëta temperatura të jetë më e ulët se ato në viset e larta. Viset e larta malore marrin sasi më të madhe të reshjeve sepse, kur ajri ndeshet me pengesat malore, detyrohet të ngrihet lart, me ç'rast ftohet, avulli i ujit kondensohet, prandaj në anët e kthyer kah drejtimi i erës bien shumë reshje.



? Çka është Gradienti Termik Vertikal?

Pasi që i shkruan këto fjalë në tabelë, ai i pyet nxënësit se si do t'i kishin përmbledhur të gjitha këto me pak fjalë.

Biseda hapet dhe nxënësit duhet të zbulojnë vetë njësinë që do zhvillohet - Klima e Evropës.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Lexim i drejtuar

Mësimdhënësi drejton nxënësit të lexojnë paragrafin e parë, individualisht.

Kur nxënësit ta përfundojnë leximin e këtij paragrafi, mbyllin tekstin.

Pas këtij leximi, nxënësve iu shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përmbajtjes:

- Cilët janë faktorët kryesorë të cilët ndikojnë në klimën e Evropës?

- Çfarë klime mbizotëron në vendin tonë?

- Cili është roli i Rrymës së Golfit për Evropën?

Për dallim nga "DRTA" që jemi mësuar deri më sot, mundet që mendimet/komentet më të logjikshme të shënohen në tabelë.

Hapa të njëjtë merren edhe te leximi i pjesës 2, 3... etj.



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit *Punë në dyshe*

Në çdo hapësirë të dhënë në formë të katërkëndëshit shëno tipin e klimës, duke i lidhur ato me veçoritë e tyre dhe në cilat pjesë të Evropës dominojnë.

Klima kontinentale	Klima mesdhetare
--------------------	------------------

Tregoni elementet dalluese të klimës kontinentale dhe asaj mesdhetare.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 21.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

Mësimi 9

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon përhapjen e lumenjve dhe të liqeneve në kontinentin e Evropës.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Hidrografia e Evropës: lumenjtë dhe liqenet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Evidenton ujëmbledhësit dhe tregon se cilët lumenj evropianë derdhen në atë ujëmbledhës;
- Vlerëson rolin e klimës dhe të relievit në natyrë dhe sasinë e ujërave rrjedhëse në Evropë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, glob, libri i Gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:


Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi fillon orën e mësimit me pyetje. Për të ngjallur diskutim në klasë për temën mësimore, parashtron

Hidrografia e Evropës – Lumenjtë dhe liqenet

Llojlojshmëria e relievit e tipave të klimës dhe vegetacionit ka mundësuar që në Evropë të zhvillohet një rrjet i dendur lumor dhe liqene të shumta. Prandaj Evropa nuk ka hapësira pa rrjedhje ujore ashtu siç i kanë, për shembull, Afrika apo Azia. Në Evropë nuk janë zhvilluar lumenj të gjatë. Njatl kryesore hidrografike prej ku burojnë lumenjtë më të mëdhenj të Evropës janë Alpet dhe Pllaja e Valdajit në Rusi. Prej Alpeve burojnë disa nga lumenjtë më të njohur të Evropës, ndërsa në Evropën Lindore, për shkak të sasive të vogla të reshjeve, nuk është zhvilluar një rrjet i dendur lumor, mirëpo relievi ultësor ka bërë që këtu të zhvillohen lumenjtë më të gjatë të Evropës. Sasia konstante e ujit gjatë vitit mundëson shfrytëzimin e tyre sidomos për transport lumor. Lumenjtë e Evropës u takojnë katër pellgjeve kryesore detare. Këta janë: pellgu i oqeanit Atlantik, pellgu i Oqeanit të Ngriretë të Veriut, pellgu i detit Mesdhe dhe i Detit të Zi dhe pellgut të liqenit Kaspik. Ujëndarësi kryesor i kontinentit evropian shtrihet nga ngushtica e Gjibraltarit, kalon nëpër Pirineje dhe Alpe duke shkruar në drejtim të veri-perëndimit deri te mali Ural.



Harta: Pellgjet detare të Evropës



Lumi i Drinit

shiu grumbullohet në rezervuare apo edhe bartet prej largësive të mëdha. **Pellgut të Detit të Zi** i takojnë disa lumenj të njohur të Evropës si Danubi, Dnjeprri dhe Dnjestri. Ky pellg është i rëndësishëm sepse i takojnë lumenjtë e pasur me ujë që janë, po ashtu, rrugë të rëndësishme lundruese për mbarë Evropën. Lumenjtë shfrytëzohen edhe për prodhimin e energjisë elektrike, furnizimin me ujë dhe peshkim. Danubi me 2857 km është lumi i dytë më i gjatë i Evropës. Buron në veri të Alpeve, në malin e Shfarçvaldit (Gjermani), rrjedh nëpër ultësirën e Panonisë, përmes grykës së Djerdapit depërton nëpër malet karpato-balkanike dhe, përmes degëzimit në formë të deltes, i derdh ujërat e tij në Detin e Zi.

? Vështro rrjedhjen e Danubit dhe gjej katër kryeqytetet evropiane nëpër të cilat rrjedh ai.

Pellgu i liqenit Kaspik dallohet prej pellgjeve të tjera sepse është i vetmi që është i mbyllur, që do të thotë se nuk është i lidhur me dete të tjera. Ky fakt aspak nuk e zvogëlon rëndësinë ekonomike, sepse këtij pellgu i takojnë dy lumenj të mëdhenj: Volga dhe Urali. Me 3688 km, Volga është lumi më i gjatë i Evropës. Buron në Pllajën e Valdajit, rrjedh nëpër ultësirën e Evropës Lindore dhe derdhet në liqenin Kaspik. Përmes hapjes së kanaleve lumore, Volga ka bërë të mundur lidhjen e disa deteve si atij Kaspik, të Zi, Azov, Baltik dhe të Bardhë. Prandaj Volga është shndërruar në një ndër rrugët më të gjata lundruese në botë. Po ashtu, nëpër rrjedhjen e saj janë ngritur akumulime ujore dhe hidrocentrale për përfitim të energjisë. Këto janë dëshmi për shfrytëzimin e shumëllojshëm të ujërave të Vollgës nga ana e njeriut.

pyetje me përgjigje të shumta:

- Cilët janë lumenjtë që ju i njihni në Kosovë?
- Cilët lumenj të Evropës njihni?

Përdorni hartën dhe tregoni se cilat liqene po i identifikoni në Evropë.

Komentet përshkruhen dhe diskutohen së bashku me mësimdhënësin (2 ose 3).



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Të nxënësit me këmbime - Grupet e ekspertëve

Nxënësit ndahen në grupe, ku secili nxënës ka një numër.

Pasi nxënësit kanë përcaktuar numrat bashkohen njëshet dhe kështu me radhë...

Mësuesi i jep secilit grup nga një detyrë

Grupi 1

- Cilave pellgje u takojnë lumenjtë e Evropës?
- Cilët janë elementet dalluese të lumenjve të Evropës?
- Cili është lumi më i gjatë në Evropë?

Grupi 2

- Cili është lumi i dytë më i gjatë në Evropë?
- Cilët lumenj i takojnë pellgut të Atlantikut?
- Cilët lumenj derdhen në pellgun e detit Mesdhe?

Në mënyrë të njëjtë vazhdohet edhe me dy grupet e tjera.

Përfaqësuesit e grupeve iu përgjigjen pyetjeve dhe debatojnë lidhur me to.



Përforsimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit *Reflektim*

Pasi kryejnë detyrën në grupet e reja që janë krijuar me njëshet, dyshet, treshet e kështu me radhë, kthehen dhe riformohen përsëri grupet bazë, në të cilat çdo nxënës ka një detyrë specifike të cilën do ta prezantojë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 22-24.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Aspektet e përgjithshme-fiziko gjeografike të Evropës

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon përhapjen e lumenjve dhe të liqeneve në kontinentin e Evropës;

Dallon tipat kryesorë klimatikë që dominojnë në Evropë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I-3,4,6; II-5,6,7; III-3,5,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime: Klima dhe hidrografia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon me hartë hidrografinë e Evropës;
- Tregon ndikimin e klimës në hidrografinë e Evropës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, glob, libri i Gjeografisë 7, atlas.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Misioni

Hidrografia e Evropës – lumenjtë dhe liqenet

Llojlojshmëria e relievit e tipave të klimës dhe vejetacionit ka mundësuar që në Evropë të zhvillohet një rrjet i dendur lumor dhe liqene të shumta. Prandaj Evropa nuk ka hapësira pa rrjedhje ujore ashtu siç i kanë, për shembull, Afrika apo Azia. Në Evropë nuk janë zhvilluar lumenj të gjatë. Njëat kryesore hidrografike prej ku burojnë lumenjtë më të mëdhenj të Evropës janë Alpet dhe Pllaja e Valdajit në Rusi. Prej Alpeve burojnë disa nga lumenjtë më të njohur të Evropës, ndërsa në Evropën Lindore, për shkak të sasive të vogla të reshjeve, nuk është zhvilluar një rrjet i dendur lumor, mirëpo relievi ultësior ka bërë që këtu të zhvillohen lumenjtë më të gjatë të Evropës. Sasia konstante e ujit gjatë vitit mundëson shfrytëzimin e tyre sidomos për transport lumor. Lumenjtë e Evropës u takojnë katër pellgjeve kryesore detare. Këta janë: pellgu i oqeanit Atlantik, pellgu i Oqeanit të Ngriretë Veriut, pellgu i detit Mesdhe dhe i Detit të Zi dhe pellgut të liqenit Kaspik. Ujëndarësi kryesor i kontinentit evropian shtrihet nga ngushtica e Gjibraltarit, kalon nëpër Pirineje dhe Alpe duke shkruar në drejtim të veri-perëndimit deri te mali Ural.



Harta: Pellgjet detare të Evropës



Lumi i Drinit

shiu grumbullohet në rezervuare apo edhe bartet prej largësive të mëdha. **Pellgut të Detit të Zi** i takojnë disa lumenj të njohur të Evropës si Danubi, Dnjeprri dhe Dnjestri. Ky pellg është i rëndësishëm sepse i takojnë lumenjtë e pasur me ujë që janë, po ashtu, rrugë të rëndësishme lundruese për mbarë Evropën. Lumenjtë shfrytëzohen edhe për prodhimin e energjisë elektrike, furnizimin me ujë dhe peshkim. Danubi me 2857 km është lumi i dytë më i gjatë i Evropës. Buron në veri të Alpeve, në malin e Shfarçvadtit (Gjermani), rrjedh nëpër ultësirën e Panonisë, përmes grykës së Djerdapit depërton nëpër malet karpato-balkanike dhe, përmes degëzimit në formë të deltesë, i derdh ujërat e tij në Detin e Zi.

? Vështro rrjedhjen e Danubit dhe gjej katër kryeqytetet evropiane nëpër të cilat rrjedh ai.

Pellgu i liqenit Kaspik dallohet prej pellgjeve të tjera sepse është i vetmi që është i mbyllur, që do të thotë se nuk është i lidhur me dete të tjera. Ky fakt aspak nuk e zvogëlon rëndësinë ekonomike, sepse këtij pellgu i takojnë dy lumenj të mëdhenj: Vollga dhe Urali. Me 3688 km, Vollga është lumi më i gjatë i Evropës. Buron në Pllajën e Vall-dajit, rrjedh nëpër ultësirën e Evropës Lindore dhe derdhet në liqenin Kaspik. Përmes hapjes së kanaleve lumore, Vollga ka bërë të mundur lidhjen e disa deteve si atij Kaspik, të Zi, Azov, Baltik dhe të Bardhë. Prandaj Vollga është shndërruar në një ndër rrugët më të gjata lundruese në botë. Po ashtu, nëpër rrjedhjen e saj janë ngritur akumulime ujore dhe hidrocentrale për përfitim të energjisë. Këto janë dëshmi për shfrytëzimin e shumëfish të ujërave të Vollgës nga ana e njeriut.

Mësimdhënësi njofton nxënësit për punën që do zhvillohet, i ndan nxënësit nga tre në grup (i përzier) që të mësojnë nga njëri tjetri.

Teknika bazohet në kërkesa të paraqitura nga mësimdhënësi, ku me anën e tyre synon që të arrihen rezultatet e orës mësimore.

Misioni	Përshkrim dhe fakte	Pozicioni
Oqeani Atlantik	(fakte të mësuara)	(përshkruan pozicionin)
Deti Mesdhe		
Deti i Veriut		
.....		

Tregoni 3 përparësi dhe 3 mangësi të klimës mesdhetare për shtetet e rajonit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune.

Reflektim për rrjedhjen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Analizon përhapjen e lumenjve dhe të liqeneve në kontinentin e Evropës.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2,4,5; 2-1,6; III-3,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tokat, bota bimore dhe shtazore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan shtrirjen e zonave bimore në hartën e Evropës nga veriu drejt jugut;
- Ilustron shtrirjen klimatike në aspektin vertikal në kontinentin evropian.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Gjeografia 7, atlas enciklopedik, fotografi, harta, projektor, laptop.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Biologjia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Tokat, bota bimore dhe shtazore



Harta e bimësisë së Evropës

Llojet e tokat mbi të cilat zhvillohen formacione të ndryshme bimore varen nga ndërtimi gjeologjik, veçoritë klimatike dhe hidrografike. Në skajin verior të kontinentit, hasen tokat e ngrira, ranore ose gurorë, të varfra me materie ushqyese, prandaj si të tilla janë jopjellore. Kur ngrihen temperaturat gjatë verës së shkurtër, në këto toka zhvillohet bimësia e rrallë e tundrave. Prej bimëve rriten likenet, mushqet, mështekna etj. Në kushtet e klimës së ftohtë dhe bimësisë së rrallë, ka mundur të adaptohet vetëm një numër i caktuar i kafshëve. Këto kafshë janë: lrvasi, ariu polar, dhelpira polare, ujku, lepuri polar etj. Në jug të tundrave, hasen tokat që, edhe pse të varfra me kripëra minerale, kanë përmbajtje të konsiderueshme të humusit, që i bëjnë ato më të pëlleshme se tokat e ngrira në veri. Në këto toka është zhvilluar bimësia e tajgave, ku rriten formacionet bimore gjethebartëse si llojet e ndryshme të pishave dhe të bredhit. Prej shtazëve rriten ujku, derri i egër, ariu i murrmë, lepuri etj. Poshtë tajgave kanë përhapje më të madhe tokat që, për shkak të përmbajtjes më të lartë të humusit, kanë ngjyrë më të mbyllët, prandaj quhen **toka të murrme**. Në këto toka dominojnë formacionet bimore gjethebartëse ku rriten lloje të ndryshme si ahu, dushku, frashri, bliri etj. Në këto bashkësi bimore jeton një botë e llojlojshme shtazore. Përveç botës shtazore të tajgave, këtu jetojnë edhe ariu i murrmë, dreri, ujku, dhelpira, lepuri etj. Tokat e çernozemeve kanë përhapje të madhe sidomos në ultësirën e Evropës Lindore e diçka më pak në atë juglindore. Ato kanë përmbajtje të lartë të humusit, i cili u jep atyre ngjyrën e zezë. Formacion tipik bimor i këtyre tokave është stepa, ku arrijnë të zhvillohen bashkësitë bimore që mund të zhvillohen në mungesë të ujit të mjaftueshëm siç janë barishtet e ulëta. Në zonat e stepave jetojnë lepuri, minjtë dhe brejtësit e tjerë. Tokat stepike të Evropës Lindore dhe Qendrore janë regjionet më të rëndësishme të kultivimit të drithërave në Evropë dhe më gjerë.




Lrvasi



Tundrat



Tajgat



Stepat



Makiet

? Pse bimësia e Evropës Mesdhetare është gjethetrashë dhe përherë e gjelbëruar?

Nga nxënësit që të rikujtojnë mësimet e klasës së gjashtë:

- Cili ishte roli i njeriut në mbrojtjen dhe shkatërrimin e pyjeve?
- A mundet që në secilin vend të botës të kemi bimësi të njëjtë? Nëse jo, pse?
- A janë tokat e njëjta në të gjithë rruzullin tokësor?

Kështu hapet biseda rreth tokave, botës bimore dhe asaj shtazore dhe nxënësit njoftohen me temën.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Ditari dypjesësh

Mësimdhënësi ndan tabelën në dy shtylla. Në shtyllën e parë, shënon disa fjalë kyçe dhe kërkon nga nxënësit që, duke lexuar njësinë mësimore “Tokave, botës bimore dhe shtazore”, të bëjnë përshkrimin në shtyllën e dytë për këto fjalë.

Citati	Komenti që jepet nga nxënësit
Zonaliteti horizontal	Shtirirja e botës bimore nga kushtëzimi i gjerësisë gjeografike.
Çernozem	Toka të zeza, të përhapura në zonën e stepave, humus të theksuar, mbillen drithërat dhe bimët industriale.
Tajga	Formacion i pyjeve halore që shtrihen në jug të tundrave (Rusi, Suedi, Kanada...).
Zonaliteti vertikal	Shtirirja e bimëve varësisht lartësisë mbidetare



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Demonstrim dhe ushtrime

Paraqitet harta ku janë të paraqitura zonat gjeografike të bimëve. Ai kërkon nga ata që të identifikojnë zonat dhe të shpjegojnë specifikat.

Stepat, tajgat, tundrat, makiet, pyjet e përziera...

Plotësoni së bashku Fletoren e punës nga pyetja 29-31.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune 27-28.

• *Reflektim për rojedhën e orës mësimore:*

Mësimi 12

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike të Evropës.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2,6; II-1,7; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet 3.1; 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pasuritë natyrore dhe zhvillimi ekonomik

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon zhvillimin ekonomik të Evropës dhe arsyeton zhvillimin e ndryshëm në disa pjesë të saj;
- Arsyeton ndikimin e resurseve natyrore në zhvillimin ekonomik në disa vende të Evropës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, globi, libri i Gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi, për të ngjallur diskutim në klasë për temën mësimore, parashtron pyetje që nxënësit të japin shumë përgjigje “stuhishëm”.

Pasuritë natyrore dhe zhvillimi ekonomik

Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore kanë mundësuar në kontinentin e Evropës praninë dhe llojllojshmërinë e resurseve natyrore. Rrjeti i pasur hidrografik ka mundësuar përfitim të energjisë dhe transportin e mallrave; sipërfaqe të mëdha të tokave pjellore dhe livadheve shfrytëzohen për bujqësi e blegtori; xeheroret e pasura kanë mundësuar zhvillimin e industrisë ekstraktive; vija e gjatë bregdetare dhe kushtet klimatike kanë mundësuar zhvillimin e turizmit bregdetar, ndërsa në viset e larta malore është zhvilluar turizmi dimëror, në detet e pasura me peshq është zhvilluar detaria etj.

Prandaj, kushtet dhe resurset natyrore kanë bërë që Evropa të arrijë shkallë të lartë të zhvillimit ekonomik. Megjithatë, në Evropë janë të pranishme dallime të mëdha ndërmjet regjioneve sipas nivelit të zhvillimit ekonomik. Këto dallime janë rezultat jo vetëm i kushteve të ndryshme natyrore, por edhe i rrethanave shoqërore, historike dhe politike. Kushtet e llojllojshme natyrore kanë mundësuar zhvillimin e bujqësisë, e cila dallohet me përdorimin e madh të mjeteve agroteknike, por me pjesëmarrjen e vogël të popullsisë që merret me bujqësi. Ultësira e Panonisë, e Lombardisë, Gjermano-polake, e Evropës Perëndimore janë hapësira ku është e zhvilluar lavërtaria dhe kultivimi i drithërave, perimeve e kulturave industriale. Në shpatet kodrinore të Francës, Italisë, Spanjës dhe gjetu janë ngritur plantacione të vreshtave dhe pemëve, kurse kushtet e përshatshme klimatike dhe gjeoekologjike në Evropën Jugore mundësojnë rritjen e agrumeve dhe vreshtave.

38






Platforme e naftës në Detin Verior

Ajo në pjesën më të madhe të Evropës është bërë e karakterit intensiv. Në vitet e fundit në Evropë ka ardhur deri te zvogëlimi i sipërfaqeve të punueshme për shkak të rritjes së qyteteve dhe ndërtimit të rrugëve e zgjerimit të industrisë. Sipërfaqet e shumta me pyje në Evropën Veriore kanë mundësuar zhvillimin e pylltarisë dhe industrisë së drurit. Në pjesë të tjera të Evropës, për shkak të prerjes së vazhdueshme të pyjeve, ato janë rrralluar tej mase, megjithatë disa vende evropiane kanë nisur procesin e ripyllëzimit të hapësirave të zhveshura.



Shpërndarja e centraleve atomike në Francë



Hidrocentralet në Zvicër



Gjeneratorët e erës në Austri

- Cilat janë burimet energjetike?
- Ç'kuptoni me ekonomi?
- Cilët janë sektorët kryesorë të ekonomisë (sektori primar, sekondar, terciar...)?

Komentet shkurtimisht përshkruhen dhe diskutohen së bashku me mësimdhënësin (2 ose 3).



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Të nxënësit me këmbime – Grupet e ekspertëve

Nxënësit ndahen në grupe, ku secili nxënës ka një numër.

Pas nxënësit kanë përcaktuar numrat bashkohen njëshet bashkë dhe kështu me radhë.

Grupi 1

- Në cilat Ulltësira të Evropës janë zhvilluar lavërtaria dhe kultivimi i drithërave, i perimeve e i kulturave industriale?

- Në cilat pjesë të Evropës ofrohen kushte të volitshme për vreshtari dhe për prodhimin e agrumeve?

Grupi 2

- Në cilat pjesë të Evropës ofrohen kushte të volitshme për blegtori dhe çfarë karakteri ka ajo?

- Në cilat pjesë të Evropës është e zhvilluar peshkataria?

.....

Në mënyrë të njejtë vazhdohet edhe me dy grupet e tjera



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Reflektim**

Pasi kryejnë detyrën në grupet e reja që janë krijuar me njëshet, dyshet treshet e kështu me radhë, kthehen dhe riformohen përsëri grupet bazë, në të cilat çdo nxënës ka një detyrë specifike të cilën do ta prezantojë. Të gjithë së bashku marrin pjesë me pyetje dhe komente

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune.

• *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Aspektet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Evropës

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përcakton kufijtë e Evropës dhe dallon regionet mbi bazën e kushteve të ndryshme fiziko-gjeografike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet 3.1; 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndarja regjionale dhe politike e Evropës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon me hartë ndarjen regjionale të Evropës, duke qartësuar specifikat fiziko-gjeografike të regjionit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, globi, libri i Gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë paraprake

Mësimdhënësi paraqet para nxënësve hartën (hartë në projektor) politike të Evropës.

Pyet nxënësit:

Evropa Jugore - veçoritë natyrore

Evropa Jugore përbëhet prej tre gadishujve, të cilët e formësojnë vijën bregdetare të detit Mesdhe. Këta janë: gadishulli Pirinej, Apenin dhe Ballkanik. Këta gadishuj në veri kufizohen me vargmalet e Pirinejeve dhe Alpeve, të cilat në të vërtetë paraqesin kufirin ndërmjet Evropës Jugore dhe asaj të Mesme. Edhe pse gadishulli Pirinej në perëndim dhe në veri del në oqeanin Atlantik, deti Mesdhe i përcakton shumicën e elementeve natyrore, duke i dhënë atij tipare mesdhetare. Për Evropën Jugore shpeshherë përdoret edhe emërtimi Evropa Mesdhetare. Megjithatë, në kuptimin gjeografik, Mesdheu është një hapësirë që tejkalon kufijtë e Evropës Jugore dhe përfshin edhe brezin e ngushtë bregdetar të Afrikës Veriore apo edhe brezin e ngushtë mesdhetar të Azisë Jugperëndimore. Në anën tjetër, përmes bregdetit Azur, Franca del në detin Mesdhe, mirëpo në kuptimin gjeografik, ajo nuk i takon Evropës Jugore. Në vendet e Evropës Jugore që dalin në detin Mesdhe, shumë herët janë ngritur civilizimet që e kanë bërë regjionin vatrë të rëndësishme kulturore të "Botës së Vjetër". Rëndësia e këtij regjioni zgjat deri në periudhën e zbulimeve të mëdha gjeografike, ku pas zbulimit të rrugës detare për Indi përreth Afrikës dhe kontinentit të Amerikës, kjo rëndësi zhvendoset në brigjet e oqeanit Atlantik. Pas hapjes së kanalit të Suezit në vitin 1869, Mesdheut i kthehet rëndësia sepse andejpasi kalojnë disa prej rrugëve më të rëndësishme detare. Sipërfaqja e Evropës Jugore është 1426 milionë km² ose rreth 14 % e territorit të Evropës.



Veçoritë e relievit

Relievi i Evropës Jugore përbëhet nga gadishujt Pirinej, Apenin dhe Ballkanik, të cilët e përthejnë në masë të konsiderueshme vijën bregdetare. Përveç gadishujve, nëpër detin Mesdhe ka edhe ishuj të madhësive të ndryshme, ku vërehen sidomos Korfuzi, Sardenja, Sicilia, Qiproja, Kreta dhe ishujt Balearë. Vargmalet janë njësitë kryesore të relievit

Evropa Mesdhetare: hapësira mesdhetare është kuptim më i gjerë gjeografik se Evropa Jugore

të Evropës, të cilat shtrihen prej perëndimit kah lindja. Ato nisin me Pirinejet në perëndim të regjionit, vazhdojnë me vargmalet e Alpeve në pjesën e mesme dhe përfundojnë me vargmalet Dinarike dhe Sharro-Pinde dhe ato të Ballkanit në lindje. Vargmale janë edhe Apeninet, të cilat nga Alpet në veri lëshohen deri në jugun e skajshëm të gadishullit me të njëjtin emër. Në aspektin gjeologjik këto janë vargmale të reja, prandaj janë më të larta dhe më të thepisura. Janë të ndërtuara kryesisht nga shkëmbinjtë gëlqerorë dhe dolomiti, prandaj hasen forma të ndryshme të relievit karstik. Gëlqerorët në kontakt me ujin treten, duke krijuar format sipërfaqësore të relievit karstik (vorbullat, skribat, lapiezat dhe fushat karstike) dhe format nëntokësore të relievit karstik (shpellat dhe humerat karstike). Ndërsa nga gëlqerorët janë krijuar edhe mermerët, të cilët paraqesin një material të rëndësishëm ndërtimor dhe dekorativ.



Eksplorimi i mermerit



Bjeshkët e Nemuna

Përpos vargmaleve, në Evropën Jugore ndodhen edhe malet mollake, të cilat janë male më të ulëta, më të sheshuara që për një kohë të gjatë u janë ekspozuar fuqive të jashtme. Prandaj, kjo përbën një dëshmi për vjetërsinë më të madhe se vargmalet. Në malet mollake bëjnë pjesë: Rila, Pirini, Rodopet dhe Olimpi në Greqi.

Për shkak të shtrirjes në një zonë kufitare tektonike, trualli i Evropës Jugore është mjaft jostabil dhe manifestohet me shfaqjen e tërmeteve të shumta. Paralelisht me tërmetet, në Evropë shfaqen edhe vullkanet, disa prej të cilave janë aktive edhe në ditët e sotme. Ndër më të njohurat janë: Vezuvi afër Napolit të Italisë dhe Etna në Sicili. Vargmalet ndërmjet vete ndahen përmes ultësirave, të cilat kryesisht shtrihen përgjatë luginave më të mëdha lumore.

- Çfarë paraqesin ngjyrat në hartën politike?
- Cilat shtete kanë territor më të madh (shëno në tabelë)?
- Si bëhet regionalizimi i një regjioni?
- Cilat shtete mbretëri i njihni në Evropë?

Në formën e diskutimit, vlerësohet stadi i njohurive të nxënësve për njësinë që do zhvillohet.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes *Lexim i drejtuar*

Mësimdhënësi drejton njërin nga nxënësit ose lexon vetë me zë pjesën e njësisë (mësimin). Kur përfundon leximi, analizohet harta politike e Evropës.

Pas këtij leximi, nxënësve iu shtrohen pyetjet, varësisht nga natyra e përmbajtjes:

-Tregoni nga pesë shtete të mëdha, të mesme dhe të vogla të Evropës.

-Cilat janë regjionet kryesore të Evropës?

Nxënësit gjatë kësaj kohe përdorin atlaset e tyre.

• Fjalët kyçe ose ato referenca interesante, shënohen në tabelë (shtet federal, monarki, regjion...)

• Hapa të njëjtë merren edhe te leximi i pjesës/paragrafit 2, 3... para leximit të fundit shtohen pyetje.

Pas leximit të fundit, u jepet mundësi nxënësve të flasin me njëri-tjetrin



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatim i të nxënit *Ditari dypjesësh*

Kërkohet nga nxënësit të punojnë në dyshe. Secili grup pajiset me nga një glob/hartë/atlas si mjet pune gjatë aktivitetit.

Pyetje	Përgjigje
Çka paraqet regjioni?	
Tregoni karakteristikat e Evropës Veriore.	
Tregoni karakteristikat e Evropës së Mesme.	
...	

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune.

● *Reflektim për rojedhën e orës mësimore:*

● _____

● _____

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa

Rezultatet e të nxënit të temës:

Hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore, duke parashikuar rrugë dhe mundësi të parandalimit ose të trajtimit të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlikohjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2; 3-3.1; 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Aktivitet: Evropa

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Komponon hartën e Evropës mbi bazën e aktivitetit, duke bashkëpunuar me nxënësit e tjerë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, glob, libri i Gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Mësimdhënësi përgatit një hartë të Evropës në formën e puzzle/ enigmës.

Me projektor paraqet një hartë “blanko” të pashënuar mbi një hapësirë të bardhë (hamer), ku me laps vizaton të tërën. Pasi që vizatohet (dy kopje) një për bazë dhe një për prerje, njërën me brisk (skallper) e copëton në vijat që janë shenjuar mbi kufijtë e shteteve dhe të vijës bregdetare.

Pasi që copëtohet, shtetet ngjyrosen me ngjyra të ndryshme, ku secila ngjyrë paraqet territorin sovran të një shteti. Kopja tjetër nuk duhet copëtohet por vetëm hapësira ujore (oqeanet dhe detet) ngjyrosen me të kaltër. Kjo kopje

Mdarja regjionale dhe politike e Evropës

Llojlojshmëria e kushteve natyrore, pozita gjeografike dhe depërtimi i oqeanit Atlantik në brendësi të kontinentit bën që në Evropë të dallohen disa regjione me kushte të ndryshme fiziko-gjeografike. Kushtet natyrore kanë përcaktuar rrjedhën e proceseve historiko-kulturore, mënyrën e banimit dhe të jetesës dhe aktivitetet njëzore në përgjithësi. Prandaj në Evropë dallojmë pesë regjione kryesore. Këto janë: Evropa Jugore, Evropa e Mesme, Evropa Veriore, Evropa Perëndimore dhe Evropa Lindore.



Shtetet e Evropës

- Përthyerja e vijës bregdetare, klima e butë oqeanike në bregdet dhe e flohtë kontinentale në brendësi, zhvillimi i lartë ekonomik janë tiparet kryesore të Evropës Veriore.

- Ndërthurja e maleve dhe e ultësirave, klima kontinentale, rrjedhjet e lumenjve të gjatë, pozita e ndërmjetme gjeokomunikative, përzjerja e popujve dhe kulturave janë tiparet kryesore regjionale të Evropës së Mesme.

- Dalja e gadishujve Pirinej, Apenin dhe Balkanik në detin Mesdhe, klima mesdhetare, mungesa e resurseve të mjaftueshme ujore dhe vatrat e hershme të kulturave kanë formësuar tiparet regjionale të Evropës Jugore.

- Relievi i ulët, diku edhe nën nivelin e detit, klima e butë atlantike, grykëderdhjet e lumenjve në formë të estuareve, zhvillimi i hershëm industrial dhe ekonomik kanë formësuar tiparet regjionale të Evropës Perëndimore.

- Dominimi i ultësirës, klima e ashpër kontinentale, zonaliteti horizontal i tokave dhe i bimësisë nga tundrat në veri e deri te stepat dhe bimësia subtropikale në jug, lavërtaria dhe kultivimi i drithërave janë tipare kryesore regjionale të Evropës Lindore.

Evropa Jugore - veçoritë natyrore

Evropa Jugore përbëhet prej tre gadishujve, të cilët e formësojnë vijën bregdetare të detit Mesdhe. Këta janë: gadishulli Pirinej, Apenin dhe Ballkanik. Këta gadishuj në veri kufizohen me vargmalet e Pirinejeve dhe Alpeve, të cilat në të vërtetë paraqesin kufirin ndërmjet Evropës Jugore dhe asaj të Mesme. Edhe pse gadishulli Pirinej në perëndim dhe në veri del në oqeanin Atlantik, deti Mesdhe i përcakton shumicën e elementeve natyrore, duke i dhënë atij tipare mesdhetare. Për Evropën Jugore shpeshherë përdoret edhe emërtimi Evropa Mesdhetare. Megjithatë, në kuptimin gjeografik, Mesdheu është një hapësirë që tejkalon kufijtë e Evropës Jugore dhe përfshin edhe brezin e ngushtë bregdetar të Afrikës Veriore apo edhe brezin e ngushtë mesdhetar të Azisë Jugperëndimore. Në anën tjetër, përmes bregdetit Azur, Franca del në detin Mesdhe, mirëpo në kuptimin gjeografik, ajo nuk i takon Evropës Jugore.

Në vendet e Evropës Jugore që dalin në detin Mesdhe, shumë herët janë ngritur civilizimet që e kanë bërë regionin vatrë të rëndësishme kulturore të "Botës së Vjetër". Rëndësia e këtij regjioni zgjat deri në periudhën e zbulimeve të mëdha gjeografike, ku pas zbulimit të rrugës detare për Indi përreth Afrikës dhe kontinentit të Amerikës, kjo rëndësi zhvendoset në brigjet e oqeanit Atlantik. Pas hapjes së kanalit të Suezit në vitin 1869, Mesdheut i kthehet rëndësia sepse andejpari kalojnë disa prej rrugëve më të rëndësishme detare. Sipërfaqja e Evropës Jugore është 1426 milionë km² ose rreth 14 % e territorit të Evropës.



Veçoritë e relievit

Relievi i Evropës Jugore përbëhet nga gadishujt Pirinej, Apenin dhe Ballkanik, të cilët e përthejnë në masë të konsiderueshme vijën bregdetare. Përveç gadishujve, nëpër detin Mesdhe ka edhe ishuj të madhësive të ndryshme, ku vërehen sidomos Korfuzi, Sardinia, Sicilia, Qiproja, Kreta dhe ishujt Baleare. Vargmalet janë njësitë kryesore të relievit

45

shërben si bazë për ngjitje e cila vendoset në tabelë magnetike ose rrafsh i cili varet në mure.

Përcaktohen detyrat e grupeve dhe rregullat e aktiviteteve

Pjesa shtesë

Mësimdhënësi u ndan grupeve nga 5-7 letra të vogla ku janë të shënuar emrat e deteve, të ngushticave, të oqeanëve... dhe kërkon nga ata që, për kohën rreth 5 minuta, t'i ngjisin në vendin e caktuar. Të njëjtat rregulla aplikohen edhe në këtë pjesë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitetet, diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Jugore, veçoritë natyrore

Rezultatet e të nxënit të temës: - Identifikon gadishujt, ishujt, objektet e tjera natyrore dhe shtetet që e përbëjnë Evropën Jugore;

- Analizon pozitën e Evropës Jugore dhe ndikimin historik të saj;
- Vlerëson ndikimin e Detit Mesdhe përmes rritjes së bimëve mesdhetare dhe jetës së njerëzve;
- Dallon në hartë sistemet malore, fushat, rrafshnaltat dhe luginat lumore më të njohura dhe arsyeton se pse rreth Mesdheut ka tërmete dhe vullkane (Etna, Vezuvi etj.).
- Analizon faktorët klimatikë që ndikojnë në klimën e vendeve të Evropës Jugore;
- Arsyeton rrjetin e varfër lumor, sasinë e vogël të ujit gjatë verës dhe varfërinë e liqeneve në Evropën Jugore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2,4,6; II-3,5,6; III-3,8, VI-3

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2; 2.1; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa Jugore – Veçoritë natyrore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike dhe të Detit Mesdhe në Evropën Jugore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, globi, libri i Gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

Evropa Jugore - veçoritë natyrore

Evropa Jugore përbëhet prej tre gadishujve, të cilët e formësojnë vijën bregdetare të detit Mesdhe. Këta janë: gadishulli Pirinej, Apenin dhe Ballkanik. Këta gadishuj në veri kufizohen me vargmalet e Pirinejeve dhe Alpeve, të cilat në të vërtetë paraqesin kufirin ndërmjet Evropës Jugore dhe asaj të Mesme. Edhe pse gadishulli Pirinej në perëndim dhe në veri del në oqeanin Atlantik, deti Mesdhe i përcakton shumicën e elementeve natyrore, duke i dhënë atij tipare mesdhetare. Për Evropën Jugore shpeshherë përdoret edhe emërtimi Evropa Mesdhetare. Megjithatë, në kuptimin gjeografik, Mesdheu është një hapësirë që tejkalon kufijtë e Evropës Jugore dhe përfshin edhe brezin e ngushtë bregdetar të Afrikës Veriore apo edhe brezin e ngushtë mesdhetar të Azisë Jugperëndimore. Në anën tjetër, përmes bregdetit Azur, Franca del në detin Mesdhe, mirëpo në kuptimin gjeografik, ajo nuk i takon Evropës Jugore.

Në vendet e Evropës Jugore që dalin në detin Mesdhe, shumë herët janë ngritur civilizimet që e kanë bërë regionin vatër të rëndësishme kulturore të "Botës së Vjetër". Rëndësia e këtij regjioni zgjat deri në periudhën e zbulimeve të mëdha gjeografike, ku pas zbulimit të rrugës detare për Indi përrreth Afrikës dhe kontinentit të Amerikës, kjo rëndësi zhvendoset në brigjet e oqeanit Atlantik. Pas hapjes së kanalit të Suezit në vitin 1869, Mesdheut i kthehet rëndësia sepse anëtpari kalojnë disa prej rrugëve më të rëndësishme detare. Sipërfaqja e Evropës Jugore është 1426 milionë km² ose rreth 14 % e territorit të Evropës.



Veçoritë e relievit

Evropa Mesdhetare: hapësira mesdhetare është kuptim më i gjërë gjeografik se Evropa Jugore

Relievi i Evropës Jugore përbëhet nga gadishujt Pirinej, Apenin dhe Ballkanik, të cilët e përthejnë në masë të konsiderueshme vijën bregdetare. Përveç gadishujve, nëpër detin Mesdhe ka edhe ishuj të madhësive të ndryshme, ku vërehen sidomos Korzika, Sardenja, Sicilia, Qiproja, Kreta dhe ishujt Balearë. Vargmalet janë njësitë kryesore të relievit

Ullësira e Andaluzisë shtrihet përgjatë luginës së lumit Guadalquivir, ullësira e Lombardisë shtrihet përgjatë luginës së lumit Po, ndërsa në jugun kontinental të Gadishullit Ballkanik, në drejtimin perëndim-lindje shtrihet ullësira e Thesalisë. Relievi malor bëhet i kalueshëm përmes qafave malore, ndërsa luginat lumore paraqesin korridore natyrore për lidhjen më të shkurtër ndërmjet regjioneve.



Kontakti i gjerë me detin Mesdhe bën që në pjesët bregdetare të Evropës Jugore të dominojnë elementet e klimës mesdhetare. Duke u larguar nga bregdeti drejt brendësisë kontinentale, kjo klimë zëvendësohet nga klima e mesme kontinentale, ndërsa me rritjen e lartësisë mbidetare, në viset malore paraqitet klima alpine. Klima atlantike dominon në pjesët perëndimore të gadishullit Pirinej, të cilat lagen nga ujërat e oqeanit Atlantik. Rrjeti lumor i Evropës Jugore është mjaft i rrallë. Përveç disa lumenjve kryesorë, lumenjtë e tjerë janë të shkurtër dhe me regjim të pavoluitshëm hidrologjik. Kjo bën që niveli i ujit në këta lumenj të ndryshojë shumë. Sipërfaqet e shumta të ndërtuara nga shkëmbinjtë gëlqerorë bëjnë që këto

terrene të kenë mungesë të ujërave sipërfaqësore, duke vështirësuar furnizimin me ujë të popullsisë. Po ashtu, një ndërtim i tillë gjeologjik ka kushtëzuar zhvillimin intensiv të erozionit karstik. Prania e konsiderueshme e shkëmbinjve gëlqerorë ka bërë që të dominojnë tokat e kuqërremta, të cilat e kanë marrë ngjyrën nga prania e hekurit. Bimësia tipike është ajo e shkurreve mesdhetare, e makijeve, të cilat janë krijuar pas degradimit të pyjeve mesdhetare. Bimët me gjethe të tyre gjembore, lekurëtrasha apo edhe të mbuluara me qime të imëta u janë përshtatur thatësisirave të gjata verore. Nga kulturat bujqësore, më shumë rriten hardhia e rrushit, ulliri, agrumet, fiku dhe bajamet. Gadishulli Apenin, Sicilia dhe kalimi i saj e ndajnë detin Mesdhe në pjesët perëndimore, e cila është më e vogël, dhe pjesën lindore, e cila është më e madhe, më e përthyer dhe më e thellë. Ky det, sipas veçorive fizike e kimike, bën pjesë në detet më të ngrohta, të njelmëta dhe me dukshmëri më të madhe në botë. Temperatura në brendësi është 13 °C, kurse temperatura në sipërfaqe varet kryesisht nga nxehtësia diellore. Kripshmëria është 38 promila. Nxehtësia, tejdukshmëria dhe ngjyra e kaltër e kanë mundësuar zhvillimin e turizmit veror. Zhvillimi i turizmit e ndihmon zhvillimin ekonomik të shteteve, por edhe e ndot mjedisin përmes hedhjes së sasive të mëdha të mbeturinave.

Pyetje

1. Ku qëndron dallimi ndërmjet Evropës Jugore dhe Mesdhetare?
2. Përshkruaj karakteristikat e lumenjve të Evropës Jugore.
3. Çka e ndan detin Mesdhe në pjesët perëndimore dhe atë lindore?

47

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Diskutim i përbashkët

Prezantohen disa fotografi të flamujve që përfaqësojnë shtetet e Evropës Jugore dhe kërkon nga nxënësit t'i identifikojnë se cilat janë këto shtete.

- Në cilët gadishuj pozicionohen këto shtete?
- Cilit regjion gjeografik të Evropës i takojnë këto shtete?
- Cilët gadishuj ndahen në Evropën Jugore?
- Cilat nga shtetet e paraqitura në foto janë ishuj?

Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Lexim i drejtuar

Mësimdhënësi drejton njërin nga nxënësit ose lexon vetë me zë pjesën e njësisë (mësimin).

- Pas leximit (paragrafëve), nxënësve iu shtrohen pyetjet, varësisht nga natyra e përmbajtjes:
 - Prej cilëve gadishuj përbëhet Evropa Jugore?
 - Cilat shtete shtrihen në Evropën Jugore?

Nxënësit gjatë kësaj kohe përdorin atlasat e tyre.

- Fjalët kyçe ose ato referenca interesante, shënohen në tabelë (gadishull, klimë mesdhetare, Kosova, Shqipëria...).
- Hapa të njëjtë merren edhe te leximi i pjesës/paragrafit 2, 3... Para leximit të fundit shtohen pyetje.

Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Intervista

Të nxënit (përmbledhja e mësimin) bëhet duke performuar në role. Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe me nga 3 pjesëtarë/nxënë. Pyetjet (maksimumi 5 pyetje) mund të formohen vetë ose të merren nga fletore pune.

A-Intervistuesi; B-Shënuesi; C-Personi që intervistohet.

Intervistuesi formon 4 pyetje (sipas kriteve të orës që synojnë rezultatet), të cilat ia drejton personit që do të intervistohet (nxënësit C). Deri sa këta të dy përfundojnë aktin e tyre, nxënësi B nxjerr shënime në një fletë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:
 Plotëso fletore pune 29-30.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Jugore, veçoritë shoqërore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përkufizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike të shteteve të Evropës Jugore. Identifikon veçoritë e ujit, klimës, pasurive kulturore dhe elementeve tjera etnike të zonës mesdhetare dhe rolin e tyre turistike-ekonomike.

Identifikon popujt që jetojnë në vendet e Evropës Jugore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I-2,4,6; II-3,5,6; III-3,8, VI-3

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 2; 2.1; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa Jugore – veçoritë shoqërore dhe ekonomike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon shpërndarjen hapësinore të popullsisë, shpjegon dallimet në dendësi, në vendet e ndryshme të Evropës Jugore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, globi, Libri i gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Evropa Jugore - veçoritë shoqërore dhe ekonomike

Në Evropën Jugore sot jetojnë rreth 164 milionë banorë ose 21% e popullsisë së Evropës. Me 115 b/km² është rajoni i dytë për nga dendësia e popullsisë në Evropë. Rajonet dhe shtetet e Evropës Jugore dallohen shumë ndërmjet vete sipas dendësisë së popullsisë. Shtetet e Evropës Jugore kanë shtim natyror të ulët, kurse Greqia dhe Portugalia kanë shtim natyror negativ, duke shkaktuar rritjen e popullsisë së moshuar. Në këtë mes bëjnë përjashtim Kosova dhe Shqipëria, të cilat ende vazhdojnë të kenë një shtim natyror mesatar. Pjesa më e madhe e popullsisë në Evropën Jugore i takojnë grupit të popujve romanë.

Në ditët e sotme, këtij grupi të popujve i takojnë italianët, spanjollët dhe portugezët. Në grupin e popujve sllavë bëjnë pjesë slovenët, kroatët, serbët, bullgarët, maqedonasit dhe malazezët. Në Gadishullin Ballkanik popujt më të vjetër janë shqiptarët dhe grekët, ndërsa në gadishullin Pirinej jetojnë baskët dhe katalonjasit.



Bujqësia e terracave në Evropën Jugore



Plantacion i agrumeve në Andaluzi të Spanjës

Evropa Jugore është një trevë tradicionalisht emigruese. Historikisht migrimet janë shtyrë nga rrethanat e vështira ekonomike dhe luftërat e konflikteve. Emigrantët e parë nga ky regjion ishin spanjollët dhe portugezët, të cilët në shekullin XV emigruan në kontinentin e ri të zbuluar. Në shekujt në vijim, vazhdojnë të emigrojnë edhe italianët, irlandezët, gjermanët, polakët, popujt nga vendet e Gadishullit Ballkanik. Në fillim të shekullit XX, shqiptarët emigrojnë në SHBA. Në fillim të viteve të 70-ta të shekullit të kaluar, nis emigrimi i popujve nga Ballkani në drejtim të vendeve të Evropës Perëndimore. Edhe në këtë periudhë më shumë migrojnë shqiptarët nga trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë, kryesisht në vendet e zhvilluara të Evropës Perëndimore.

Me përjashtim të Spanjës, vendet e tjera të Evropës Jugore kanë pjesëmarrje më të vogël të popullsisë urbane. Në vitin 2018, pjesëmarrja e popullsisë urbane në Evropë Jugore arriti shifrën prej 72 %. Pozita gjeografike, kushtet natyrore dhe rrethanat historike kanë përcaktuar ritmet dhe orientimin e zhvillimit ekonomik të vendeve të Evropës Jugore. Edhe pse kushtet natyrore për zhvillimin e bujqësisë nuk janë të volitshme, disa shtete të Evropës Jugore janë prodhuesit kryesorë botërorë të rrushit dhe verës, ullinjve, vajit të ullirit dhe agrumeve. Është e zhvilluar bujqësia mesdhetare, ndërsa kultivohen ullinjtë, agrumet, hardhia e rrushit, frutat që eksportohen në tregjet e jashtme.

Në Evropën Jugore janë evidente dallimet në shkallën e zhvillimit ekonomik ndërmjet shteteve. Për shkak të mungesës së heheve, industria në këtë rajon ka filluar të zhvillohet më vonë se në Evropën e Perëndimore dhe Mesme.

Nga pasuritë e pakta minerale ka boksiti, lëndë minerale për material ndërtimor, ku vlen të përmenden sidomos mermëret, të cilët njihen gjithandëj nëpër botë. Lëndë djegëse nuk ka në sasi të mjaftueshme, ndërsa fuqia e lumenjve shfrytëzohet për përfitim e energjisë. Deri tani, energjia më së tepërmi prodhohet nga termoelekttranat, pastaj nga hidrorcentralet etj. Prodhimtaria industriale zhvillohet në sajë të importimit të lëndës së parë, për këtë arsye shumë degë të industrisë përpunuese janë zhvilluar në ose afër porteve, për shkak të transportit më të lehtë dhe më të lirë të lëndës së parë dhe prodhimeve finale.



Kulla e shtrembër e Pizës në Itali



Pallati "Alhambra" (në gjuhën arabe: Kelat al-hamra ose Qyteti i Kuq) në Granada të Spanjës është një pallat islamik i mesjetës, i cili është futur në listën e trashëgimisë kulturore botërore të UNESCO-s.

Hapet diskutimi në klasë përmes disa pyetjeve.

- Cilët janë tre gadishujt e Evropës Jugore?
- Cilat shtete gjenden në Evropën Jugore?
- Cilët popuj indoevropianë të Evropës Jugore njihni?

Pasi identifikohet shteti, mësimdhënësi njofton nxënësit me njësinë që do të zhvillohet.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Sistemi ndërveprues i shënimeve (INSERT)

Udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë e re duke i përdorur shenjat e INSERTIT.

- Pse quhet "Bota e vjetër"?
- Si mendoni, ky numër prej 45 shtetesh në Evropë, a mund të rritet?

√	+	-	?
(√- Informacion i njohur)	(+- Informacion i ri)	(- Informacion që ndryshon nga ai që di)	(? - sqarime për informacionin)



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Puna me fletore të punës

Së bashku me nxënësit plotësohen Fletore Pune. Identifikohen shtetet (te shtetet shpjegojnë se cilit grup të popujve i takojnë) dhe kryeqytetet përkatëse të Evropës Jugore. Në vazhdim, plotësohen pyetjet nga faqe 31-33.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

• *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

Mësimi 17

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Jugore, veçoritë shoqërore ekonomike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I-2,6; II-1,III-1,3,5,6, 8.VI-3, V-5

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2, 2.1; 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Italia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Italisë dhe rolin e saj në zhvillimin e vendit;
- Analizon veçoritë natyrore të Italisë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, glob, libri i Gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Asociacion



Italia është shteti më i zhvilluar i Evropës Jugore dhe njëri nga shtatë shtetet më të zhvilluara industriale të botës. Një zhvillim të tillë Italia e ka arritur në saje të pozitës gendrore në hapësirën mesdhetare. Ajo shtrihet në gadishullin Apenin. Vija bregdetare e këtij gadishulli nuk është aq e përtshyer. Ajo në jugun e skajshëm degëzohet në dy gadishuj më të vegjël, brenda të cilëve ndodhet gjiri i Tarantos. Ky gadishull deperton thellë në detin Mesdhe, ndërsa ndodhet ndërmjet detit Adriatik në lindje dhe detit Tiren e Ligur në perëndim. Përveç gadishullit, Italisë i takojnë edhe dy ishuj të mëdhenj, këta janë: Sardenja dhe Sicilia. Kjo e fundit është vetëm 120 km larg brigjeve të Afrikës. Në aspektin gjeografik, në Itali veçojmë katër tërësi kryesore. Këto janë Alpet, Apeninet, ultësira e Lombardisë dhe ishujt e Sicilisë e Sardenjës. Në skajin verior të Italisë shtrihen vargmalet e Alpeve, të cilat paraqesin kufirin natyror ndërmjet Evropës Jugore dhe asaj të Mesme.

Në shpatet e Alpeve të kthyer kah jugu janë krijuar disa liqene akullnaje si: Komo, Garda dhe Maxhore.

? Si janë krijuar liqenet akullnaje në Alpe?



Koloseumi në Rome

Pompeii shkataruar gjatë erupcionit të Vezuivit



Venediku (Kanali i Madh dhe ura "Rialto")

Firence

Roma është qendra më e madhe urbane dhe kryeqyteti i Italisë. Qendrat e tjera janë: Milano, qendër e madhe industriale, kulturore, e modës etj.; Torino, qendër e madhe e industrisë së automobilave, Gjenova, port në brigjet e detit Ligur dhe qendër e anijëdërtimit, Venediku, qendër e madhe turistike, Napoli, qytet milionësh dhe port në brigjet e detit Tiren etj.

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asociojnë.

A	B	C	D
"Çizme"	Po	Lombardia	Piza
ITALIA			

Identifikohen elementet e asociacionit që nxënësit t'i shohin se për çfarë bëhet fjalë, ose formon sipas dëshirës një asociacion.

"Çizme" - Forma e Italisë; Po- Lumë në Lombardi; Lombardia – Ultësirë; Pizza (pica)- Ushqim shumë i njohur italian.

Në fund, do të formohet një asociacion për Italinë



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Organizues grafik i njohurive

Kërkohet nga nxënësit të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht. Vizatohet harta e të pyeturit në formën e diagramit. Gjatë leximit që bëjnë nxënësit, mësimdhënësi shënon disa pyetje në hartën e të pyeturit, ku nxënësit pas leximit duhet të japin përgjigje/plotësojnë hapësirat.

- Sa është sipërfaqja e Italisë? Sa tërësi gjeografike dallohen në Itali?
 - Çfarë klime mbizotëron në Itali (përshkruaj)? Ku ndodhet "Trekëndëshi industrial Italian"?
- Njejtë vazhdohet me pyetje të tjera



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Punë individuale me hartë

Duke e përdorur atlasin/hartën dhe Fletore Pune, plotësohen pyetjet nga 123 – 128.

Në hartën memece të Italisë janë vendosur numrat që nxënësit në fjalët e përshkruara më poshtë t'u bashkëngjisin numrat përkatës:

- a) Kryeqyteti _____ (me fjalë)
- b) Lumi Po___ dhe Lombardia___

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune.

● *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

● _____

● _____

Mësimi 18

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Jugore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përkufizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike të shteteve të Evropës Jugore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2,6; II-1,7; VI-3,5,6.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet; 3.1; 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime: Italia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon pozitën gjeografike të Italisë dhe identifikon elementet kryesore fiziko-gjeografike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, glob, libri i Gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukata qytetare, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Misioni

Mësimdhënësi në fillim u tregon punën/aktivitetin se si do zhvillohet në klasë.

Ndan nxënësit në dyshe dhe i pajis me nga një fletë A4, e cila është e strukturuar me një tabelë “Misioni”, ku nxënësit duhet të plotësojnë hapësirat që të përmbushet misioni i tyre.

Italia

Sipërfaqja: 301.318 km²
Popullsia: 60.960.000
Kryeqyteti: Roma

Italia është shteti më i zhvilluar i Evropës Jugore dhe njëri nga shtatë shtetet më të zhvilluara industriale të botës. Një zhvillim të tillë Italia e ka arritur në saje të pozitës qendrore në hapësirën mesdhetare. Ajo shtrihet në gadishullin Apenin. Vija bregdetare e këtij gadishulli nuk është aq e përtwyer. Ajo në jugun e skajshëm degëzohet në dy gadishuj më të vegjël, brenda të cilëve ndodhet gjiri i Tarantos. Ky gadishull deperton thellë në detin Mesdhe, ndërsa ndodhet ndërmjet detit Adriatik në lindje dhe detit Tiren e Ligur në perëndim. Përveç gadishullit, Italisë i takojnë edhe dy ishuj të mëdhenj, këta janë: Sardenja dhe Sicilia. Kjo e fundit është vetëm 120 km larg brigjeve të Afrikës. Në aspektin gjeografik, në Itali veçojmë katër tërësi kryesore. Këto janë Alpet, Apeninet, ultësira e Lombardisë dhe ishujt e Sicilisë e Sardenjës. Në skajin verior të Italisë shtrihen vargmalet e Alpeve, të cilat paraqesin kufirin natyror ndërmjet Evropës Jugore dhe asaj të Mesme.

Në shpatet e Alpeve të kthyer kah jugu janë krijuar disa liqene akullnaje si: Como, Garda dhe Maxhore.

? Si janë krijuar liqenet akullnaje në Alpe?

51



Koloseumi në Romë

Pompeii shkatërruar gjatë erupcionit të Vezuivit



Venediku (Kanalet e Madh dhe ura "Rialto")

Firence

Roma është qendra më e madhe urbane dhe kryeqyteti i Italisë. Qendrat e tjera janë: Milano, qendër e madhe industriale, kulturore, e modës etj.; Torino, qendër e madhe e industrisë së automobilave, Gjenova, port në brigjet e detit Ligur dhe qendër e anijendërtimitarisë, Venediku, qendër e madhe turistike, Napoli, qytet milionësh dhe port në brigjet e detit Tiren etj.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**
Punë në dyshe

Ndahen nxënësit në dyshe dhe u jep atyre nga ½ të fletës A4 me detyrat e një misioni. Në fletë duhet të jetë e bashkëngjitur edhe harta fiziko-gjeografike e Italisë, në të cilën janë pozicionuar disa numra (pika) për identifikim.

Detyra e tyre është që të identifikojnë vendet në hartë. Teknika e “misionit” bazohet në kërkesa të paraqitura ku me anën e tyre synon që të arrihen rezultatet e orës mësimore.

Fletat e “misionit” sillen të gatshme nga mësimdhënësi me të gjithë objektivat që duhet të plotësohen.



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatim i të nxënësve**
Punë individuale me hartë

Italia ka gjithsej 301.318km²
Popullsia 60.960.000 banorë
Gjeni dendësinë mesatare.

Misioni	Përshkrimi
1 - Malet Alpe	Alpet në pjesën e Italisë shtrihen në veri të saj.
2 -	

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune.

● *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

Mësimi 19

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Jugore, veçoritë shoqërore ekonomike

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I-2,6; II-1,7; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet; 3.1; 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vatikani, San Marino, Malta

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të tri shteteve të vogla dhe tregon ngjashmëritë dhe dallimet e të përbashkëta mes tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, glob, libri i Gjeografisë 7.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit hapin atlaset në fund dhe identifikojnë flamujt që mësimdhënësi paraqet para tyre.

- Tregoni faktet dhe të dhënat e shteteve.



Vatikani është shteti më i vogël i pavarur në botë dhe ndodhet brenda qytetit të Romës. Është i rrethuar me mure të larta, ku brenda ndodhet bazilika e Shën Pjetrit, Pallati i apostujve dhe kopshti. Vatikani i takon edhe sheshi i Shën Pjetrit, i cili është i hapur për vizitorë. Muret mesjetare e ndajnë Vatikani nga pjesët e tjera të qytetit të Romës. Ai është seli e papës, të parit të kishës katolike. Për arsye fetare, por edhe nga kureshtja, çdo vit vizitohet nga turistë të shumtë prej katër anëve të botës. Kështu që, të ardhurat e mëdha Vatikani i fiton nga turizmi. Aty ndodhen veprat artistike me vlera të mëdha botërore, përmendore të shumta kulturore-historike dhe ndërtesa shumë të bukura. Pas marrëveshjes politike të vitit 1929, Vatikani e fitoi pavarësinë nga Italia. Ai i ka forcat e armatosura, të cilat përbëhen nga garda zvicerane me 110 ushtarë profesionalë, ndërsa detyra e tyre kryesore është kujdesi dhe siguria për papën. Gjuhë zyrtare janë italishtja dhe latinishtja.



Sheshi i Shën Pjetrit



Kapella Sistina



Republika e Maltës është shtet ishullor në detin Mesdhe. Ajo në të vërtetë përbëhet nga ishujt Malta, Gozo dhe Komino, të cilët shtrihen rreth 100 km në jug të Sicilisë. Këta ishuj shtrihen përgjatë kurrizores nënujore ndërmjet Sicilisë dhe Afrikës. Në ndërtimin e tyre marrin pjesë shkëmbinjtë gëlqerorë, prandaj hasen forma të shumta të relievit karstik.

Klima është mesdhetare, ka pak ujë sipërfaqësor dhe mungesë të ujit të pijshëm, prandaj atë duhet ta sjellin nga larg ose duke bërë shkripëzim të ujit të detit. Për shkak të klimës së thatë dhe terreneve karstike, nuk ka kushte për zhvillimin e bujqësisë. Përveç turizmit si veprimtari kryesore, popullsia merret edhe me anijëndërtimtarë dhe detari. Malta ka strukturë etnike mjaft homogjene. Maltezët janë pasardhës të popujve që e kishin pushtuar dhe sunduar Maltën përgjatë historisë.



- Cilat janë këto shtete dhe ku gjinden (të gjinden me ndihmën e mësimdhënësit në atlaset e tyre)?

.....
Të gjitha të dhënat u bashkëngjiten flamujve përkatës me anën e letrave ngjitëse.

Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Organizues grafik: Diagrami i Venit

Ndahen nxënësit në grupe treshe, ku për secilin e ndan nga një njësi mësimore (shtet) dhe kërkon që të lexojë dhe të nxjerrë shënime sipas elementeve gjeografike: pozita, klima, popullsia dhe ekonomia si dhe të dhëna nga atlasit.

Në fazën e dytë kërkohet nga nxënësit të krahasohen dhe të gjejnë të përbashkëtat në mes të këtyre tri shteteve në formën e Diagramit të Venit ose në formën e shtyllave vertikale, ku në fund të ketë një hapësirë horizontale që të shënohen të përbashkëtat.

Vatikani	San Marino	Malta
Të përbashkëtat		

Përforsimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Punë individuale (vlerësim kategorik i shteteve)

Mësimdhënësi formon një tabelë sipas elementeve gjeografike për të tria shtetet dhe kërkon nga nxënësit që, në mënyrë individuale, të vlerësojnë elementet për shtetet, duke u bazuar nga informacionet që fituan nga mësimi. Nxënësit vlerësojnë vendet sipas të dhënave të nxjerra gjatë krahasimit (fletore e klasës), atlaset dhe hartat.

Malta	Pozita	Popullsia	Sipërfaqja	Klima	Gjuha	Specifikat/eko
San Marino						
Vatikani						

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:
Plotëso fletore pune.

• *Reflektim për rryjedhën e orës mësimore:*

• _____

Mësimi 20

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Jugore, veçoritë shoqërore ekonomike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-2,6; II-1,7; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet; 3.1; 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Spanja

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Spanjës;
- Identifikon elementet kryesore fiziko-gjeografike në hartë;
- Arsyeton zhvillimin turistik të Spanjës dhe tregon benefitet (dobitë) në zhvillimin ekonomik.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në klasë së bashku me nxënësit.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Gjeografia 7, atlas enciklopedik, fotografi, harta, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit
"Asociacion"

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet, dhe të pyesin për rubrikat se çka asociojnë.





Palati Eskorial në Madrid, seli e mbretërore spanjolle



Sheshi i Siles në Madrid

Barcelona me 1.7 milionë banorë është qyteti i dytë më i madh i Spanjës. Është kryeqendër e regionit të Katalonisë dhe qendra më e madhe industriale e Spanjës. Qendra të tjera të mëdha të Spanjës janë Valencia në brigjet e detit Mesdhe dhe Sevilla, qytet në ultësirën e Andaluzisë.



Katedralja "Sagrada Família" në Barcelonë



La Rambla, shëtitorja kryesore në Barcelonë

63

A	B	C	D
"La Furia Roja"	Mbretëri	"Korida"	Juan Karlos
SPANJA			

Identifikohen elementet e asociacionit, që nxënësit t'i shohin se për çfarë bëhet fjalë, ose formon sipas dëshirës një asociacion.

"La Furia Roja" - Furia e kuqe- Ekipi kombëtar i Spanjës; Mbretëri; "Korida" - Lufta me dema; Juan Karlos- Mbreti aktual i Spanjës.

Pyeten si do ta formonin një asociacion për Spanjën.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Lexim i drejtuar

Kërkohet nga nxënësit që të lexohet paragrafi i parë. Kur nxënësit ta përfundojnë, i udhëzon që t'i mbyllin tekstet. Kërkon nga ta që gjatë diskutimit të marrin shënime shkurtimisht, të kursehet koha.

- Pas këtij leximi, nxënësve iu shtrohen pyetjet, varësisht nga natyra e përmbajtjes:
 - Cila është pozita gjeografike e Spanjës?
 - Sa është sipërfaqja e Spanjës?

.....

- Hapa të njëjtë merren edhe te leximi i pjesës 2, 3...



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Punë individuale me fletore pune

Në hartën mece të Spanjës, gjej dhe shëno:

- a. Kryeqytetin
- b. Ultësirën e Andaluzisë dhe të Aragonisë
- c. Malet Pireneje dhe Kantabrike
- d. Ishujt Baleare dhe ngushticën e Gjibraltarit.
- e. Cilët janë faktorët kryesorë të zhvillimit ekonomik të Spanjës?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 35-37.

● *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Jugore, veçoritë natyrore; Evropa Jugore, veçoritë shoqëro-ekonomike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon pozitën gjeografike, veçoritë natyrore, shoqërore dhe lidhjen e tyre në zhvillimin ekonomik të shteteve të Andorrës dhe Gjibraltarit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Andorra dhe Gjibraltari

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon shtetet e Andorrës dhe Gjibraltarit;
- Përkufizon strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore;
- Vlerëson pozitën gjeografike të tyre në zhvillimin ekonomik.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, hartë apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomike të Andorrës dhe Gjibraltarit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:


Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Pyetje e mundshme:

Çka dini ose mendoni se dini për Andorrën dhe Gjibraltarin?






Gjibraltarin në vitin 1704 e kanë pushtuar anglezët. Në vitin 1830, ai u bë koloni e Britanisë së Madhe, në të cilën u stacionua marina luftarake britanike. Pas Luftës së Dytë Botërore u bë port i rëndësishëm detar dhe tregtar. Gjatë viteve të 60-ta të shekullit XX, Gjibraltari e ndryshoi statusin e vet juridik. Ai përfundoi së qeni koloni, shpalli kushtetutën e vet, guvernatorin dhe një shkallë të lartë të vetëqeverisjes nën sovranitetin britanik, meqenëse politiken e jashtme dhe mbrojtjen vazhdojnë edhe më tutje t'ia besojnë Mbretërisë së Bashkuar. Shumicën e të ardhurave i realizon nga turizmi, tregtia, shërbimet portuale dhe bankare. Popullsia ka prejardhje nga Spanja, Malta dhe Portugalia.

Një pjesë të popullsisë e përbëjnë të huajt, nga të cilët më të shumtë janë britanikët dhe marokenët. Qyteti i Gjibraltarit (City of Gibraltar) është i ngritur në hapësirën e ngushtë, rrëzë shpateve të pjerrëta gëlqerore të Kodrës së Tarikut, të lartë 426 m.

Gjibraltari



Pista e aeroplanëve në Gjibraltari e pret rrugën mjaft të frekuentuar automobilistike

Nxënësit ta përdorin atlasin gjeografik për t'i marrë informacionet rreth elementeve natyrore. Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Pyetja sjell pyetjen

Paraqitet video ose harta politike dhe fizike e Andorrës dhe e Gjibraltarit.

Gjatë shikimit të videos ose të hartës, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:


1. Me cilat shtete kufizohen Andorra dhe Gjibraltari?
2. Cilat shtete kanë ndikim në to?
3. Cilat përkatësi etnike jetojnë?
4. Cili është besimi fetar dhe cila është shkalla e arsimimit?
5. Cila është veprimtaria kryesore ekonomike?



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Diagrami i Venit

Mësimdhënësi u shpërndan nxënësve fletat të përgatitura me Diagramin e Venit, brenda rrethit shënohen

të veçantat për Andorrën dhe Gjibraltarin, kurse në mes shënohen të përbashkëtat mes dy shteteve. Në mënyrë individuale, nxënësit shënojnë idetë e tyre në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore dhe për përshkrimin e strukturave shoqërore dhe ekonomike.

Detyrë:

Pyetjet faqe 66, libri bazë.

● *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

●

Mësimi 22

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Jugore, veçoritë natyrore; Evropa Jugore, veçoritë shoqëro-ekonomike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Hulumton mbi pozitën gjeografike, veçoritë natyrore, shoqërore dhe lidhjen e tyre në zhvillimin ekonomik të Portugalisë

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Portugalia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon shtetin e Portugalisë;
- Shpjegon prej hartës - atlasit elementet natyrore të saj;
- Përshekruan strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore dhe ekonomike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, hartë apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomike të Portugalisë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Pyetje e mundshme:

Çka dini ose mendoni se dini për Portugalinë?





Portugalia prodhon rreth 50 % të sasisë botërore të tapës me të cilën e zë vendin e parë në botë. Tapa përfitohet nga lisi i tapës dhe shfrytëzohet për mbylleset (kapakët) e verës. Në aspektin e zhvillimit ekonomik, Portugalia bën pjesë në grupin e shteteve më pak të zhvilluara të Bashkësisë Evropiane. Bujqësia është përhapur sidomos në pjesën jugore të vendit. Këtu rriten drithërat, pemët mesdhetare, ullinjët dhe perimet. Industria që është më e zhvilluar në veri të vendit bazohet në rezervat e xeheve, të cilat nuk i ka edhe aq të mjaftueshme. Në mesin e atyre që i ka, vlen të përmenden vend burimet e uranit dhe volframit.

Lisbona është qendra më e madhe dhe kryeqendra e Portugalisë. Është një nga qytetet më të vjetra të Evropës. Shtrihet në grykëderdhjen e lumit Tezho në oqeanin Atlantik.

Tapat



Kryeqyteti i Portugalisë - Lisbona



Monumenti kushtuar lundërimit të portugezëve



Turizmi masiv në Asturia

68

Nxënësit ta përdorin atlasin gjeografik për t'i marrë informacionet rreth elementeve natyrore.

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Pyetja sjell pyetjen

Paraqitet video ose harta politike dhe fizike e Portugalisë.


Gjatë shikimit të videos ose të hartës, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:

1. Me cilat shtete kufizohet Portugalia?
2. Cilat ishin malet, fushat, lumenjtë, liqenet kryesore të saj?
3. Çfarë klime ka Portugalia?
4. Cilin sektor të veprimtarisë ekonomike e ka më të zhvilluar?



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatim i të nxënit
Organizues grafik

Në mënyrë individuale, nxënësit përgatitin organizues grafik për Portugalinë – Pozita, elementet natyrore, shoqërore- ekonomike. Pastaj, secili në mënyrë individuale i shënon idetë e tij/saj në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore, për përshkrimin e strukturave shoqërore-ekonomike.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 37.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 23

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Jugore, veçoritë natyrore; Evropa Jugore, veçoritë shoqëro-ekonomike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Arsyeton pozitën gjeografike, veçoritë natyrore, shoqërore dhe lidhjen e tyre në zhvillimin ekonomik të Greqisë

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Greqia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon shtetin e Greqisë;
- Identifikon prej hartës/atlasit elementet natyrore: ishujt, gadishujt, gjiret, malet, ultësirat, lumenjtë dhe liqenet;
- Arsyeton ndikimin e klimës në turizëm-ekonomi;
- Përshkruan strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomisë të Greqisë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Organizues grafik

Në mënyrë individuale nxënësit përgatitin organizues grafik për Greqinë – pozita, elementet natyrore, shoqërore dhe ekonomike. Pastaj, secili në mënyrë individuale i shënon idetë e tij/saj në tabelë.






Ishulli vullkanik i Santorinit

Në Greqi dominon relievi malor. Në perëndim shtrihen Pindet, të cilat lëshohen deri te gadishulli i Peleponezit dhe ishulli i Kretës. Në veri-perëndim ndodhen Rodopet me malin më të lartë - Olimp (2917 m), i cili nga mitologjia greke njihet si "Mali i Perëndive". Relievi ultësinor është më pak i pranishëm dhe haset në pjesë e epërme të vendit. Atë e përbëjnë ultësirat e Selanikut, Thesalisë dhe Trakisë. Territori i Greqisë shtrihet në një zonë mjaft aktive sizmike dhe vullkanike me tërmete të shpeshta, ndërsa ka edhe disa vullkane aktive.

Klima është tipike mesdhetare, e cila duke shkuar në brendësi të vendit, fillon të modifikohet në atë të ndryshuar mesdhetare, kurse në viset e larta malore haset klima malore. Reshjet e pakta kanë kushtëzuar edhe rrjetin e varfër hidrografik, i cili ka një regjim tejet të pavolitshëm hidrologjik. Edhe ata pak lumenj hyjnë në territorin e Greqisë nga shtetet fqinje. Këta janë: Vardari, Struma dhe Marica.

Grekët janë popull indoevropian dhe pasardhës të helenëve, të cilët në periudhën antike në territorin e sotshëm të Greqisë zhvilluan një civilizim të fuqishëm. Gjatë periudhës së civilizimit grek vendosën themelet e shkencës, kulturës dhe sistemeve politike, të cilat janë zhvilluar deri në ditët e sotme. Greqia dallohet me një shkallë të lartë të homogjenitetit etnik. Kjo situatë është edhe për shkak të mohimit të të drejtave elementare njerëzore, të cilat kanë çuar deri në asimilimin e popujve të tjerë jogrekë. Në veçanti duhet të përmendim shqiptarët e krahinës së Çamërisë, të cilët, pas vendimeve të Konferencës së Londrës, padrejtësisht kanë mbetur brenda kufijve të shtetit grek. Në lindje të vendit ka edhe një pakicë të popullsisë turke.

Në Greqi kultivohen agrumet, ulliri, mollët, pjeshkat etj. Prandaj pemëtaria së bashku me perimtarinë janë shtylla kryesore e bujqësisë së Greqisë. Nga kulturat lavértare mbillen drithërat, elbi, orizi, kurse prej atyre industriale mbillen duhani e pambuku. Veprimtari e rëndësishme në kuadër të bujqësisë është edhe peshkataria. Prej resurseve minerale ka boksitë, plumb, zink, nikel, hekur, mermer, kripë deti etj. Për nga zhvillimi dhe rëndësia prin industria e lehtë ushqimore, e cila bazohet në lëndën parë vetanake, ajo kimike, e anijendërtimtarisë etj.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Ditari dypjesësh**

Mësimdhënësi u shpërndan nxënësve fletët e letrës së formatit A4, me një vijë në mes të tërhequr vertikalisht, ku në anën e majtë shënohet **citati** (pjesët të cilat i kanë pëlqyer gjatë së lexuarit), ndërsa, në anën e djathtë **komenti** (të arsyetojnë pse i kanë pëlqyer ato pjesë).

Citati	Komenti



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Paragraf argumentues**

Kërkohet nga nxënësit që në mënyrë individuale të punojnë një paragraf, duke arsyetuar ndërlidhjen e klimës në zhvillimin ekonomik të Greqisë. Disa nga punimet lexohen nga nxënësit, pjesa e palexuar merret nga arsimtari dhe vlerësohet në shtëpi.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore, për përshkrimin e strukturave shoqërore dhe ndikimin e klimës në ekonominë e Greqisë.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 38 dhe 39, dhe pyetjet faqe 72 te libri bazë.

• *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

Ullësira e Andaluzisë shtrihet përgjatë luginës së lumit Guadalquivir, ullësira e Lombardisë shtrihet përgjatë luginës së lumit Po, ndërsa në jugun kontinental të Gadishullit Ballkanik, në drejtimin perëndim-lindje shtrihet ullësira e Thesalisë. Relievi malor bëhet i kalueshëm përmes qafave malore, ndërsa luginat lumore paraqesin korridore natyrore për lidhjen më të shkurtër ndërmjet regjioneve.



Kontakti i gjërë me detin Mesdhe bën që në pjesët bregdetare të Evropës Jugore të dominojnë elementet e klimës mesdhetare. Duke u larguar nga bregdeti drejt brendësisë kontinentale, kjo klimë zëvendësohet nga klima e mesme kontinentale, ndërsa me rritjen e lartësisë mbidetare, në viset malore paraqitet klima alpine. Klima atlantike dominon në pjesët perëndimore të gadishullit Pirinej, të cilat lagen nga ujërat e oqeanit Atlantik. Rrjeti lumor i Evropës Jugore është mjaft i rrallë. Përveç disa lumenjve kryesorë, lumenjtë e tjerë janë të shkurtër dhe me regjim të pavoluitshëm hidrologjik. Kjo bën që niveli i ujit në këta lumenj të ndryshojë shumë. Sipërfaqet e shumta të ndërtuara nga shkëmbinjtë gëlqerorë bëjnë që këto

terrene të kenë mungesë të ujërave sipërfaqësore, duke vështirësuar furnizimin me ujë të popullsisë. Po ashtu, një ndërtim i tillë gjeologjik ka kushtëzuar zhvillimin intensiv të erozionit karstik. Prania e konsiderueshme e shkëmbinjve gëlqerorë ka bërë që të dominojnë tokat e kuqërremta, të cilat e kanë marrë ngjyrën nga prania e hekurit. Bimësia tipike është ajo e shkurreve mesdhetare, e makijeve, të cilat janë krijuar pas degradimit të pyjeve mesdhetare. Bimët me gjethe të tyre gjembore, lekuretrasha apo edhe të mbuluara me qime të imëta u janë përshatur atësisirave të gjata verore. Nga kulturat bujqësore, më shumë rriten hardhia e rrushit, ulliri, agrumet, fiku dhe bajamet. Gadishulli Apenin, Sicilia dhe kalimi i saj e ndajnë detin Mesdhe në pjesën perëndimore, e cila është më e vogël, dhe pjesën lindore, e cila është më e madhe, më e përthyer dhe më e thellë. Ky det, sipas veçorive fizike e kimike, bën pjesë në detet më të ngrohta, të njelmëta dhe me dukshmëri më të madhe në botë. Temperatura në brendësi është 13 °C, kurse temperatura në sipërfaqe varet kryesisht nga nxehtësia diellore. Kripshmëria është 38 promila. Nxehtësia, tejdukshmëria dhe ngjyra e kaltër e kanë mundësuar zhvillimin e turizmit veror. Zhvillimi i turizmit e ndihmon zhvillimin ekonomik të shteteve, por edhe e ndot mjedisin përmes hedhjes së sasive të mëdha të mbeturinave.

Pyetje

1. Ku qëndron dallimi ndërmjet Evropës Jugore dhe Mesdhetare?
2. Përshkruaj karakteristikat e lumenjve të Evropës Jugore.
3. Çka e ndan detin Mesdhe në pjesën perëndimore dhe atë lindore?

47

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Aktivitet

Nxënësit e klasës ndahen në katër grupe. Pasi mësimdhënësi t'u ketë shpërndarë fletat e formatit A3, atyre iu kërkohet që secili grup të shkruajnë në aspektin e sasisë, cilësisë, përmbajtjes dhe arsyeshmërisë së rezultateve të kërkuara.

Nxënësit iu kërkohet që të gjitha elementet natyrore t'i identifikojnë prej atlasit/hartës së Evropës Jugore.

<https://www.liveworksheets.com/w/en/geography/136142>

<https://www.liveworksheets.com/w/en/geography/1175462>

Në këtë fazë të orës mësimdhënësi shtron pyetje: a ka rëndësi struktura e popullsisë në zhvillimin ekonomik?

Nxënësit i shprehin- argumentojnë mendimet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore, për përshkrimin e strukturave shoqërore dhe për vlerësimin e ndërlidhjes mes resurseve humane dhe të atyre natyrore në zhvillimin ekonomik.

Detyrë:

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

Mësimi 25

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Jugore, veçoritë natyrore; Evropa Jugore, veçoritë shoqëro-ekonomike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përkufizon prej atlasit/hartës shtetin;
Identifikon prej hartës/atlasit elementet natyrore;
Përkufizon strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore;
Vlerëson ndikimin e klimës në zhvillimin e turizmit dhe lidhjen e saj me bujqësinë dhe blegtorinë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bullgaria

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon prej atlasit/hartës shtetin e Bullgarisë;
- Identifikon prej hartës/atlasit elementet natyrore të Bullgarisë;
- Përkufizon strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore;
- Arsyeton ndikimin e klimës në zhvillimin e turizmit dhe lidhjen e saj me bujqësinë dhe blegtorinë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomike të Bullgarisë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Organizues grafik

Bullgaria

Sipërfaqja: 110.910 km²
Popullsia: 7 milionë
Kryeqyteti: Sofja

Bullgaria është republikë parlamentare, e cila ndodhet në pjesën lindore të Gadishullit Ballkanik. Kufiri natyror i saj me Rumaninë është rrjedha e lumit Danub, ndërsa në lindje del në Detin e Zi. Dalja në këtë det dhe afërsia shumë e madhe ndaj detit Egje ia rrisin vlerat pozitive gjeografike dhe komunikative të saj. Në Bullgari mund të veçojmë disa tërësi kryesore rrethore. Në pjesën qendrore, në drejtim paralel (lindje-perëndim) shtrihen Malet e Ballkanit. Maja më e lartë e tyre është Botev me 2376 m. Në jugperëndim ndodhen Rodopet, ku për nga lartësia spikaten malet Pirin dhe Rilla. Në këtë të fundit ndodhet maja Musala (2925 m), e cila është pika më e lartë e tërë Gadishullit Ballkanik. Më në veri, nëpërmjet ultësirës së Danubit në Bullgari depërton ultësira e Vllahisë. Ndërmjet maleve të Ballkanit dhe Rodopeve shtrihet përgjatë luginës së lumit Marica.

Harta e Bullgarisë

fushëgropa e Sofjes, ndërsa ultësira më e madhe është ajo e Trakisë, e cila shtrihet përgjatë luginës së lumit Marica.

? Nëse Rodopet janë male të vjetra mollake, çfarë male janë ato të Ballkanit dhe kur janë krijuar?

Malet e Ballkanit me shtrirjen e tyre imponohen si një faktor i rëndësishëm i klimës. Derisa në veri të tyre klima është kontinentale, në jug të saj dhe sidomos në ultësirën e Trakisë, klima është nën ndikimin e fuqishëm të detit Mesdhe. Atom


73

paraqesin ujëndarësin kryesor lumor, ndërsa së bashku me Rodopot paraqesin nyjet kryesore hidrografike prej nga burojnë lumenjtë e Bullgarisë.




Nga Ballkani në mënyrë vertikale, paralel njëri me tjetrin rrjedhin disa lumenj që derdhen në Danub dhe nëpërmjet tij në Detin e Zi, kurse sistemin kryesor lumor të Bullgarisë e përbën lumi Marica, i cili derdhet ujërat e veta në detin Egje.

Rreth 80 % të popullsisë e përbëjnë bulgarët, ndërsa turqit jetojnë kryesisht në pjesën juglindore të vendit. Kushitet natyrore kanë bërë që shpërndarja e popullsisë të mos jetë e barabartë. Dendësinë më të madhe të banimit e ka fushëgropa e Sofjes. Kulturat kryesore bujqësore janë drithërat, perimet, hardhia e rrushit, kultura industriale e duhanit dhe pambukut. Disa treva në jug të maleve të Ballkanit janë të specializuara në kultivimin e trëndafilave. Në viset fushore, prej bagëtisë kultivohen gjedhët dhe derrat, kurse blegtoria e viseve kodrinore-malore është gjysmëekstenzive, ku rriten kryesisht delet. Prej resurseve natyrore, Bullgaria ka vendburime të qymyrit të murrmë dhe linjtit, xehe të hekurit, plumbit dhe zinkut, bakrit etj. Degët kryesore të industrisë janë metalurgjia e zezë dhe ajo me ngjyra, ushqimore, e tekstilit, kimike etj. Bullgaria me një vijë bregdetare të gjatë 378 km del në Detin e Zi. Prandaj, përgjatë tërë vijës bregdetare, janë ngritur resorte të shumta turistike. Në mesin e tyre mund të veçojmë Varnën dhe Nesebarin, ndërsa në afërsi të Varnës ndodhet pushmoriaj mondana e Zlatni Pjascit. Qendra më e madhe urbane dhe kryeqendra e Bullgarisë është Sofja, e cila ndodhet në fushëgropën me të njëjtin emër. Në luginën e Maricës ndodhet Plovdivi, në jugperëndim të vendit ndodhet Bllagoevgradit, kurse Ruse është porti më i madh lumor në Danub, ndërsa qendrat më të mëdha në bregdet janë Varna dhe Burgasi.



Qendra e njohur turistike Zlatni Pjasci

Në mënyrë individuale nxënësit përgatitin organizues grafik për Greqinë – pozita, elementet natyrore, shoqërore dhe ekonomike. Pastaj, secili në mënyrë individuale i shënon idetë e tij/saj në tabelë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Di-Dua të di-Mësova

Pasi sigurohemi që nxënësit kanë përfunduar së lexuari njësinë mësimore, merren mendimet e tyre për atë dhe çfarë kanë lexuar/kuptuar dhe shënohen në kolonën “mësova”, më pas e shqyrtojnë kolonën “dua të di”, për të parë nëse janë gjetur ato që nxënësit kishin shtruar si pyetje për t’i ditur. Në kolonën “mësova” shënohen edhe informacione të reja, që janë si rezultat i të nxënës.

Di	Dua të di	Mësova



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënës
Paragraf argumentues

Kërkohet nga nxënësit që në mënyrë individuale të punojnë një paragraf, duke arsyetuar ndikimin e klimës në turizëm dhe ndikimin e saj në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Disa nga punimet lexohen nga nxënësit, pjesa e pallexuar merret nga arsimtari dhe vlerësohet në shtëpi.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore, për përshkrimin e strukturave shoqërore dhe për arsyetimin e ndikimit të klimës në turizëm dhe në zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune faqe 39 dhe 40, si dhe pyetjet faqe 78 te libri bazë.

• *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Jugore, veçoritë natyrore; Evropa Jugore, veçoritë shoqëro-ekonomike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon veçoritë natyrore dhe shoqërore të Maqedonisë së Veriut

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Maqedonia e Veriut

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon prej atlasit/hartës shtetin e Maqedonisë së Veriut.
- Identifikon prej hartës/atlasit elementet natyrore të Maqedonisë së Veriut.
- Përshkruan strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomike të Maqedonisë së Veriut.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Minileksion

Mësimdhënësi jep shumë pak informacion mbi njësinë e re, por më tepër i orienton nxënësit në drejtim të rezultateve të lëndës, temës dhe të orës mësimore.






Kultivimi i hardisë së rrushit në luginën e Tikveshit.

Në fushën e Pellagonisë kultivohen drithërat dhe duhanit. Aty po ashtu ndodhen vendburimet e linjtit, të cilat shfrytëzohen për përfitimin e energjisë. Nga resurset e tjera minerale ka xehe të plumbit dhe zinkut, hekurit, bakrit, mermerit dhe lëndëve të para të materialit ndërtimor. Prej industrisë ka të zhvilluar metalurgjinë, industrinë kimike, të duhanit, të tekstilit dhe ushqimore. Liqenet e Ohrit, Prespës, Dojranit, Malet e Sharrit dhe qytetet me trashëgimi të pasur historiko-kulturore janë disa nga motivet kryesore turistikë të Maqedonisë së Veriut. Qendrat më të njohura turistike janë Ohri, Shkupi, Kodra e Diellit në Tetovë etj.



Ohri



Qendra e turizmit dimëror "Kodra e Diellit" në Tetovë

Qyteti më i madh dhe kryeqyteti i Maqedonisë së Veriut është **Shkupi**, me rreth 500 mijë banorë. Shtrihet në fushëgropën me të njëjtin emër. Lumi Vardar, i cili rrjedh nëpër qytet, e ndan Shkupin në pjesën e vjetër të qytetit të banuar kryesisht me shqiptarë dhe pjesën e re, të banuar kryesisht me maqedonas. Në Shkup, viteve të fundit, janë ndërtuar godina e përmendore, të cilat duan të sfancojnë identitetin maqedonas të qytetit. Megjithatë, Kalaja e Shkupit, Qarshia e Vjetër dhe lokalitete e toponime të tjera dëshmojnë për autoktoninë dhe rëndësinë që ka pasur Shkupi për shqiptarët nëpër periudha të ndryshme historike. Qytete të tjera të mëdha janë edhe Manastiri, Tetova, Kumanova, Velesi dhe Gostivari.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Sistemi ndërveprues i shënimeve (INSERT)

Ftohen nxënësit t'i hapin librat dhe ta lexojnë njësinë mësimore sipas teknikës së insertit, ku kërkohet nga nxënësit që në çdo fund paragrafi të vendosin shenjat; (√) për informacionin e njohur, (+) për informacionin e ri, (-) për informacionin e ditur, por më ndryshe, (?) për informacionin e paqartë, që ka nevojë për pyetje dhe sqarim.



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatim i të nxënit
Lexim i drejtuar

Mësimdhënësi përgatit dhe u shpërndan nxënësve tabelën e insertit dhe kërkon nga ta që të gjeturat; vendosjen e shenjave gjatë së lexuarit, t'i vendosin në tabelën e insertit. Varësisht nga niveli i njohurive të nxënësve, për të njëjtin informacion, nxënësit mund të vendosin shenja të ndryshme.

√	+	-	?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore, për përshkrimin e strukturave shoqërore.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune faqe 41 dhe pyetjet faqe 78 te libri bazë.

• *Reflektim për rojedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Jugore, veçoritë natyrore; Evropa Jugore, veçoritë shoqëro-ekonomike

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Identifikon veçoritë natyrore dhe shoqërore të Serbisë

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Serbia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon prej atlasit/hartës shtetin e Serbisë;
- Identifikon prej hartës/atlasit elementet natyrore të saj;
- Përshekruan strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomike të Serbisë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Di-Dua të di-Mësova


Pyetje e mundshme:
 Çka dini ose mendoni se dini për Serbinë?
 Nxënësit ta përdorin atlasin gjeografik për t'i marrë informacionet rreth elementeve natyrore.



Serbët i takojnë grupit të popujve sllavë, të cilët në shekullin VII janë vendosur në Gadishullin Ballkanik. I takojnë besimit ortodoks. Serbia është një shtet me strukturë të përzier etnike. Mozaiku etnik dhe demografik vjen në shprehje sidomos në Vojvodinë ku përveç serbëve, jetojnë edhe hungarezët, kroatët, gjermanët, sllovakët, rumunët etj. Në Serbi jetojnë rreth 100.000 shqiptarë. Komunitatet me popullsi shumicë shqiptare ndodhen në jug të Serbisë. Këto janë Presheva (95 %), Bujanoci dhe Medvegja.

? Çka është "Mortaja e Bardhë" dhe pse ndodh ajo?

Kushtet e vulltshme klimatike dhe tokat pjellore sidomos në veri të vendit kanë mundësuar zhvillimin e bujqësisë. Përdorimi i mjeteve agroteknike në lavërtari dhe perimtari bën që bujqësia e këtij regionit të dallohet për rendimente të larta. Nga kulturat bujqësore rriten drithërat, luledielli, rrepa e sheqerit, perimet dhe bimët foragjere. Industria bazohet në përfitimim të energjisë nga termoelektranat. Degët më të zhvilluara industriale janë industria e rëndë ekstraktive, e metaleve, kimike, ushqimore, e tekstilit, e duhanit, e letres etj.



Kopaoniku (2000 m)

Beogradi është qyteti më i madh dhe kryeqyteti i Serbisë. Është ngritur në grykëderdhjen e Savës në Danub. Qendrat e tjera të mëdha janë: Novi-Sadi, Nishi, Kragujevci, Uzhdica etj.

Mendimet e nxënësve shënohen në kolonën "Di", më pas pyeten nxënësit se çfarë dëshirojnë të dinë rreth njësisë së re, dhe pyetjet e nxënësve shënohen në kolonën "Dua të di".



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Di-Dua të di-Mësova

Pasi sigurohemi që nxënësit kanë përfunduar së lexuari njësinë mësimore, merren mendimet e tyre për atë se çfarë kanë lexuar/kuptuar dhe shënohen në kolonën "mësova", më pas e shqyrtojnë kolonën "dua të di" për të parë nëse janë gjetur ato që nxënësit kishin shtruar si pyetje pë t'i ditur. Në kolonën "mësova" shënohen edhe informacione të reja, që janë si rezultat i të nxënësve.

Di	Dua të di	Mësova




Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënësve

Organizues grafik

Në mënyrë individuale nxënësit përgatitin organizues grafik për Serbinë – Pozita, elementet natyrore, shoqërore dhe ekonomike. Pastaj, secili në mënyrë individuale i shënon idetë e tij/saj në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore, për përshkrimin e strukturave shoqërore.

Detyrë:

Të plotësohen pyetjet faqe 81 në librin bazë.

• *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Jugore- veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 4, 6; II. 1,2;7;8. III. 1, 2, 4;5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlihdjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kroacia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Kroacisë, lidhjen me shtetet e tjera dhe rëndësinë që i jep pozita;
- Analizon veçoritë natyrore-shoqërore të Kroacisë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta e Evropës, atlas gjeografik, fotografi dhe të dhëna nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

 **Parashikimi:**
Përgatitja për të nxënësit
Stuhi mendimesh

Nxënësve iu parashtrihen disa pyetje nga mësimdhënësi, në mënyrë që t'i nxitë ata të mendojnë rreth pozitës gjeografike të Kroacisë dhe, në bazë të njohurive paraprake që ata kanë marrë, mund të japin disa mendime.





Liçenët e Plitvices

e varfër me ujëra sipërfaqësore. Kroatët i takojnë grupit të popujve sllavë dhe janë të besimit katolik. Kroatët përbëjnë rreth 90 % të popullsisë së vendit. Nga pakicat jetojnë edhe serbët, italianët dhe boshnjakët. Në rrethinën e Zares, në Dalmaci, jeton edhe një numër i caktuar i arbëneshëve, të cilët janë shpërngulur nga Shqipëria qysh në shekullin XVII.

Në bujqësinë e Kroacisë Panonike dominon lavërtaria, ku rriten drithërat, frutat dhe bimët industriale, duhani, hardhia e rrushit etj. Në zonën bregdetare rriten ullinjtë dhe agrumet, ndërsa për shkak të terreneve gëlqerore në zonën kodrinore-malore ka pak toka të punueshme dhe kulturat bujqësore mbillen nëpër vorbulla dhe fusha karstike.

Kroacia nuk është edhe aq e pasur me xehe dhe burime energjetike. Në zonën panonike ndodhen rezerva të naftës dhe gazit natyror. Nga degët industriale ka të zhvilluar industrinë kimike, të makinave, ushqimore dhe të tekstilit. Në bregdet ndodhen disa kantiere ku prodhohen anijet tejoqeanike. Në ishujt Pag, Nin dhe Ston prodhohet kripa e detit. Bregdeti i gjatë, ishujt e shumtë, klima e volitshme dhe trashëgimia e pasur kulturore-historike kanë mundësuar zhvillimin e turizmit.



Lavërtari e zhvilluar në Kroacinë Panonike



Dubrovniku



Pula

Qyteti më i madh dhe kryeqyteti i Kroacisë është Zagrebi. Qendrat e tjera të mëdha janë Rijeka, Spliti, Zara e Dubrovniku në Kroacinë Adriatike dhe Osijeku e Varazdini në Kroacinë Panonike.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Të nxënësit me këmbime - Grupet e ekspertëve

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup bëhet ekspert i pjesës që do t'i jepet për detyrë. Ata do ta lexojnë në grup, do ta diskutojnë, do ta përvetësojnë dhe do ta përgatisin për ta prezantuar para të tjerëve.

Grupi 1: Pozita gjeografike dhe relievi

Grupi 2: Klima

Grupi 3: Ujërat dhe bota e gjallë

Njëjtë vazhdohet edhe me grupet e tjera.

Secili grup ka për detyrë të përvetësojë njohuritë e pjesës së vet dhe t'i shpjegojë të tjerët në mënyrën më të mirë.

Më pas arsyetohet pozita e mirë gjeografike e Kroacisë dhe disa nga veçoritë e saj natyrore e shoqërore.



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatim i të nxënësve

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Përmes hartës dhe atlasit, nxënësit i bëjnë pyetje të

ndryshme njëri-tjetrit, si për: pozitën gjeografike, përkufizimin e shtetit, malet dhe ultësirat, dallimet klimatike brenda shtetit, lumenjtë, botën bimore, popujt që jetojnë në Kroaci, pasuritë natyrore dhe rol i veçantë u kushtohet turizmit dhe ekonomisë së këtij shteti.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të saktësisë së përgjigjeve për pozitën gjeografike dhe përdorimin e hartës gjatë përgjigjeve, analizimit të veçorive natyrore dhe shoqërore të shtetit të Kroacisë.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 42 dhe 43, në detyrat për Kroacinë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Jugore- veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2, 6; II. 1,2;. III. 4;5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mali i Zi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon dhe shpjegon pozitën gjeografike të Malit të Zi;
- Vlerëson veçoritë natyrore dhe shoqërore të saj;
- Arsyeton rëndësinë e turizmit në zhvillimin ekonomik të këtij shteti.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë gjeografike, atlas.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi para nxënësve paraqet hartën fizike të Ballkanit (apo të Malit të Zi) duke u folur atyre pak për këtë vend. Mësimdhënësi bënë disa pyetje për të nxitur interesim të nxënësve për mësim, si:






Ulqini, qytet në skajin jugor të zonës bregdetare. Qender e njohur turistike. Qyteti i Vjetër, Plazhi i Nogu dhe Plazhi i Madh janë atraksione turistike, të cilat gjatë stinës së verës vizitohen nga mijëra turistë.

Derisa pjesa bregdetare e Malit të Zi ka klimë mesdhetare, në brendësi ajo është kontinentale dhe malore. Zona bregdetare e Malit të Zi merr sasi të madhe të reshjeve. Lokaliteti Crkvice merr mesatarisht 5000 mm reshje në vit. Me 45 b/km², është vendi më rrallë i banuar në Gadishullin Ballkanik. Në strukturën etnike të popullsisë dominojnë malazezët, por jetojnë edhe popuj të tjerë si shqiptarët, boshnjakët, serbët etj. Popullsia shqiptare është shumicë në rrethinën e Ulqinit dhe Anamalit, pastaj në Malësinë e Tuzit, por jetojnë edhe në Tivar e Krajë, Plavë dhe Guci, Rozhajë etj. Mali i Zi nuk ka një bujqësi edhe aq të zhvilluar. Për shkak të rrelievit të lartë malor dhe terreneve karstike, Mali i Zi ka pak toka të punueshme. Në bregdet rriten ullinjë, agrumet, shega, kurse në fushën e Zetës, duhani dhe perimet. Nëpër kullosat e shumta rriten delet. Ka të zhvilluara degët e industrisë energjetike, metalurgjisë së zeze dhe me ngjyra, ushqimore etj.

Mali i Zi e ka zhvilluar turizmin bregdetar (veror). Qendra të njohura turistike janë Ulqini, Budva, Herceg-Novi, Kotorri etj. Qendra më e madhe dhe kryeqendra e Malit të Zi është **Podgorica**. Qendra të tjera janë Nikshiqi, Plevla, Ulqini, Budva, Cetinja etj. Cetinja ka qenë seli e mbretërisë së Malit të Zi, ku edhe sot e kësaj dite vazhdon të mbajë epitetin e kryeqytetit historik të Malit të Zi.



Kryeqyteti i Malit të Zi – Podgorica



Cetinja

1. Çfarë pozite gjeografike ka Mali i Zi?
2. Cilat lloje të klimës i hasim në Mal të Zi?

Vazhdohet me pyetje të tjera.

Për t'u përgjigjur pyetjeve përdoret ndihma e hartës dhe e atlasit.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Sistemi ndërveprues i shënimeve (INSERT)

Udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë e re, duke i përdorur shenjat e INSERTIT. Pastaj diskutojnë me radhë se cilat informata ishin të njohura, cilat të reja dhe sqarohen pyetjet nga mësimdhënësi të shënuara nga nxënësit.

√	+	-	?
Informacion i njohur	Informacion i ri	Informacion që ndryshon nga ai që di	Sqarime për informacionin



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatim i të nxënit *Paragraf përshkrues*

Nxënësve do të iu kërkohet të shkruajnë një paragraf përshkrues për Malin e Zi, duke përdorur vetëm atlasin dhe fletoren e tyre. Dikush mund të shkruajë për shqiptarët në Mal të Zi, për turizmin, ekonominë etj. Më pas, disa nga nxënësit i lexojnë paragrafët që kanë shkruar.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të saktësisë së përgjigjeve duke identifikuar gjërat më të rëndësishme në Malin e Zi, arsyetimin për turizmin dhe përdorimin e hartës.

Detyrë:

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Jugore - veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2, 6; II. 1,2;7; III. 1, 2, ;5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bosnjë dhe Hercegovina


- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Vlerëson pozitën gjeografike të Bosnjës dhe Hercegovinës;
 - Analizon veçoritë natyrore e shoqërore;
 - Përshkruan strukturën etnike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë e Evropës, atlas gjeografik, tabelë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

 **Parashikimi:**
Përgatitja për të nxënësit
 "DI"

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të tregojnë se çfarë dinë ata rreth popullsisë në botë. Pas çdo informacioni që ata theksojnë se dinë, e shkruajnë në tabelë te rubrika "DI".





Meqenëse Malet Dinarike marrin sasi të madhe të reshjeve (deri 2500 mm), aty ndodhen burimet e lumenjve, të cilët përmes Savës derdhen në Danub dhe në Detin e Zi dhe përmes Neretvës derdhen në detin Adriatik. Degët më të mëdha të lumit Sava janë: Drina, Bosna dhe Una. Terrenet karstike janë të varfra me ujëra sipërfaqësore, por të pasura me ujëra nëntokësore, të cilat shfaqen në formë të gurrave (burimeve) karstike që janë të shumta.

Fondi më i madh i tokave të punueshme ndodhet në pjesën veriore të vendit dhe nëpër luginat lumore, prandaj në këto pjesë është e zhvilluar lavërtaria, ku kultivohen drithërat, rrepa e sheqerit, perimet dhe frutat. Në luginën e Neretvës kultivohen duhanit, hardhia e rrushit dhe agrumet. Zona kodrinore-malore është e pasur me livadhe dhe kullosa të shumta, të cilat kanë krijuar kushte për zhvillimin e blegtorisë. Në këtë zonë ka sipërfaqe të konsiderueshme me pyje, të cilat janë parakusht i mirë për zhvillimin e pylltarisë dhe industrisë së drurit. Përveç pyjeve, Bosnjë dhe Hercegovina ka rezerva të konsiderueshme të thëngjillit, hekurit, boksitëve dhe kripës së gurit. Thëngjilli shfrytëzohet për prodhimin e energjisë. Energjia prodhohet edhe nga shfrytëzimi i potencialit hidroenergjetik të lumenjve Drina dhe Neretva. Degët më të zhvilluara të industrisë janë industria ekstraktive, e metalurgjisë së zezë, industria ushqimore etj. Shtrirja e saj ndërmjet Kroacisë dhe Serbisë është reflektuar në strukturën etnike mjaft të përziera, të cilën e përbëjnë boshnjakët, kroatët dhe serbët. Gjatë ekzistimit të ish-Jugosllavisë, Bosnjë dhe Hercegovina shërbente si shtet i diversitetit dhe tolerancës ndëretnike dhe kulturore. Mirëpo në fillim të viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, kur nisi procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, ky vend përjetoi një luftë të ashpër qytetare, ku humbën jetën me mijëra njerëz. Struktura e popullsisë është heterogjene: boshnjakët marrin pjesë me 51 %, serbët me 31 %, kroatët me 15 % dhe 3 % të tjerët. Dendësia e popullsisë është rreth 70 b/km².

Di	Dua të di	Mësova
<ul style="list-style-type: none"> - Kryeqytet e ka Sarajevën. - Jetojnë boshnjakët, serbët dhe kroatët. - Gjendet në Gadishullin Ballkanik. - Ka dalje në detin Adriatik. 		



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
"Dua të di"

Nxënësit i parashtrajnë pyetje rreth popullsisë së botës njëri-tjetrit dhe mësimdhënësit. Të gjitha i vendosin në rubrikën "Dua të Di".

Di	Dua të di	Mësova
<ul style="list-style-type: none"> - Kryeqytet e ka Sarajevën; - Jetojnë boshnjakët, serbët dhe kroatët; - Gjendet në gadishullin Ballkanik; - Ka dalje në detin Adriatik. 	<ul style="list-style-type: none"> - Sa banorë jetojnë? - Me çka merret popullsia e këtij vendi? - Çfarë klime ka ky shtet? - Me çfarë pasurish natyrore cilësohet? 	

Sipas nevojës, përdoret edhe harta e Bosnjës dhe Hercegovinës.



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
"Mësova"

Pasi që nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore, ata shpjegojnë pjesë-pjesë mësimin që mësuuan gjatë orës.

Di	Dua të di	Mësova
<ul style="list-style-type: none"> - Kryeqytet e ka Sarajevën; - Jetojnë boshnjakët, serbët dhe kroatët; - Gjendet në Gadishullin Ballkanik; - Ka dalje në detin Adriatik. 	<ul style="list-style-type: none"> - Sa banorë jetojnë? - Me çka merret popullsia e këtij vendi? - Çfarë klime ka ky shtet? 	<ul style="list-style-type: none"> - Jetojnë 3.5 milionë banorë. - Bujqësi dhe disa lloje të industrisë. - Kryesisht të mesme kontinentale

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në përgjigje për pozitën gjeografike, analizën dhe përshkrimin e strukturës etnike.

Detyrë:

Të punohen përgjigjet e pyetjeve në librin bazë, faqe 91.

● *Reflektim për rojedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa e Mesme - veçoritë natyrore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon pozitën gjeografike të Evropës së Mesme dhe rëndësinë e saj për regjionet e tjera; Identifikon kufijtë dhe shtetet e Evropës së Mesme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 4, 6; II. 1,2;7;8. III. 4;5;.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa e Mesme – veçoritë natyrore - Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon pozitën gjeografike të Evropës së Mesme dhe rëndësinë e saj për regjionet e tjera;
- Identifikon kufijtë dhe shtetet e Evropës së Mesme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlas, hartë, projektor, laptop, foto.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Veprimtari praktike- përshkrim i hartës

Mësimdhënësi/ja, duke përdorur hartën e rëndomtë ose projektorin, duke treguar kufijtë e regjionit të Evropës së Mesme, kërkon nga nxënësit të pozicionohen në atlas dhe ta përcjellin përkufizimin dhe pozitën gjeografike. Më pas kërkohet nga nxënësit që t'i identifikojnë një shtet dhe t'i caktojnë shtetet që shtrihen në këtë regjion të Evropës.

Evropa e Mesme - veçoritë natyrore

Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia

Evropa e Mesme përfshin pjesën qendrore të kontinentit. Ajo shtrihet nga lugina e lumit Rajna dhe shtetet e Beneluksit në perëndim e deri te Deti i Zi dhe Karpatet në lindje, si dhe nga Alpet, Danubi e Sava në jug e deri te Deti Verior dhe deti Baltik në veri. Ajo ka pozitë të volitshme gjeografike, edhe pse disa shtete të saj nuk kanë dalje të drejtpërdrejta në det. Pozita gjeografike është e volitshme edhe për shkak të faktit se nëpër territorin e saj rrjedhin Rajna dhe Danubi, të cilët, të bashkuar përmes kanalit, kanë krijuar rrjetin më të gjatë lundrues në Evropë. Për shkak të pozitës së ndërmjetme, ajo paraqet një territor kalues ku gërshtohen ndikimet e elementeve natyrore dhe shoqërore nga Evropa Veriore dhe Jugore, si dhe Perëndimore dhe Lindore. Prandaj, në këtë regjion ekziston një diversitet i madh kulturor, demografik dhe etnik. Megjithatë, një pozitë e tillë është reflektuar në rrethanat e vullshme historike dhe gjeopolitike siç janë luftërat dhe konfliktet, migrimet dhe zhvendosjet e popullsisë. Evropa e Mesme ka një sipërfaqe prej 1.25 milionë km² në të cilën jetojnë 184 milionë banorë.


Veçoritë gjeografiko-natyrore

Në relievin e Evropës dallohen në mënyrë të qartë Ultësira Gjermano-Polake në veri, malet mollake dhe të pasura me xehe në mes dhe vargmalet e Alpeve dhe Karpatet në jug. Ndërmjet Alpeve, Karpatëve dhe Maleve Dinarike ndodhet ultësira e Panonisë, ndërsa përgjatë rrjedhës së poshtme të Danubit shtrihet ultësira e Vllahisë. Pranë Detit Verior dhe atij Baltik shtrihet Ultësira Gjermano-Polake, e cila është vazhdimësi e asaj të Evropës Lindore. Në perëndim arrin deri te lumi Rajna, kurse në lindje deri te lumi Visla. Në jug, kjo ultësirë përfundon me malet mollake të lartësisë mesatare. Në jug të Ultësirës Gjermano-Polake ngrihen malet mesatare. Këto male kanë maja të sheshuara dhe shpate të buta. Këtij grupi të maleve i takojnë Vogezet, Shvarcvaldi, Harci, Shumava, Sudetet etj. Këto male janë të pasura me xehe të shumta minerale. Ndërmjet këtyre maleve shtrihen luginat dendur të banuara dhe ekonomiksht të zhvilluara siç është lugina e Rajnës, lugina e Tyingisë etj.

Në skajin e poshtëm të regjionit ndodhen vargmalet e Alpeve dhe Karpateve. Alpet janë malet më të larta të Evropës. Shtrihen në formë harku nga gjiri i Gjenovës në perëndim e deri te ultësira e Panonisë në lindje. Pamja e sotme e tyre është rezultat i veprimtarisë së gjatë të akullnajave. Këtë e dëshmon prania e liqeneve të shumta akullnajore. Karpitet po ashtu shtrihen në formë harku dhe e rrethojnë nga ana lindore ultësirën e Panonisë. Largësia nga detet bën që klima në Evropën Jugore të jetë kryesisht kontinentale. Në Ultësirën Pranëbaltike ndeshen masat e ftohta dhe të thata ajrore nga Evropa Lindore me masat më të ngrohta dhe të lagështa të ajrit nga oqeani Atlantik. Prandaj pjesët perëndimore të regjionit marrin sasi më të madhe të reshjeve dhe kanë klimë të mesme kontinentale. Pjesët lindore marrin sasi më të vogla të reshjeve dhe kanë klimë më të ashpër kontinentale me vera të ngrohta dhe dimra të ftohtë. Zonat e larta kanë klimë malore me vera të shkurtra e të freskëta dhe dimra të gjatë, të ashpër dhe me borë.



Danubi



Ujëvara e lumit Raina në Shafhausen të Zvicrës

Evropa e Mesme ka një rrjet të zhvilluar lumor. Lumenjtë më të gjatë janë Danubi, Rajna, Elba, Odra dhe Visla. Ata burojnë nga viset e larta malore dhe rrjedhin në drejtim të Detit Verior, Baltik dhe Detit të Zi. Danubi, me 2850 km, është lumi i dytë për nga gjatësia në Evropë. Buron nga mali Shvarcvald në Gjermani, kurse derdhet në Detin e Zi. Rajna buron në Alpe, rrjedh nëpër liqenin e Bodenit, kalon përgjatë kufirit ndërmjet Francës dhe Gjermanisë, kurse në Holandë derdhet në Detin Verior. Në Alpe ndodhen shumë liqene akullnajore, ku më të mëdhenjtë janë: liqeni i Bodenit, i Cyrihut, i Neshatellit dhe i Gjenevës.

Pyetje

1. Trego kufijtë e shtrirjes së Evropës së Mesme.
2. Përshkruaj ndërtimin e Ultësirës Gjermano-Polake.
3. Përmendi malet mollake të regjionit.
4. Cilët janë lumenjtë më të gjatë të Evropës së Mesme dhe ku derdhen ata?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes *Lexim i orientuar*

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të lexojnë në heshtje temën. U kërkon që të nxjerrin shënime me informacionet kyçe të temës. Pastaj i ndan ata në dy grupe për të hapur diskutimin me temën “Pyetje dhe përgjigje”.

Pyetje	Përgjigje
Çfarë pozite gjeografike ka Evropa e Mesme? Arsyeto.	
Sa është sipërfaqja e saj?	
A ka dalje në dete?	
Cilat janë malet dhe ultësirat kryesore në këtë regjion?	
Çfarë klime dominon në Evropën e Mesme?	
Përmend lumenjtë më të gjatë që gjenden në Evropën e Mesme.	



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit *Rrjet i diskutimit*

Për të reflektuar rreth temës, nxënësit do të tregojnë:

- 3 – tri gjëra të reja që mësuam;
- 2 – dy gjëra që duhet mbajtur mend për pozitën;
- 1 – një gjë që i bën kureshtarë të dinë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të angazhimit në hartë, të pyetjeve dhe saktësisë së përgjigjeve dhe në bazë të analizimit të njësisë mësimore rreth pozitës së Evropës së Mesme.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune në faqe 46 dhe 47.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa e Mesme – veçoritë shoqërore dhe ekonomike

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Radhit popujt e Evropës së mesme sipas numrit të popullsisë, - Analizon specifikat popullore, kulturore, ekonomike e politike të Evropës së Mesme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 4, 6; II. 1, 2; 7; 8. III. 1,4;5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa e Mesme – veçoritë shoqërore dhe ekonomike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:


- Radhit popujt e Evropës së Mesme sipas numrit të popullsisë;
- Analizon specifikat popullore, kulturore, ekonomike e politike të Evropës së Mesme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, atlas, tabelë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

 **Parashikimi:**
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi para nxënësve paraqet hartën politike të Evropës së Mesme, duke u folur atyre pak për këtë vend. Mësimdhënësi bën disa pyetje për të nxitur interesim të nxënësve për mësim, si:

Evropa e Mesme – veçoritë shoqërore dhe ekonomike

Për shkak të pozitës gjeografike, Evropa e Mesme ka përjetuar zhvillime të vullshme historike të luftërave, konflikteve dhe ndryshimit të shpeshtë të hartës politike. Për këtë arsye, ajo vazhdon të jetë një mozaik i popujve dhe gjuhëve. Në këtë regjion jetojnë popujt gjermanë, romanë dhe sllavë. Grupit të popujve gjermanë i takojnë gjermanët, të cilët përbëjnë më se gjysmën e popullsisë së këtij regjioni. Përveç tyre, këtij grupi i takojnë edhe austriakët dhe gjermanët e Zvicrës. Grupit të popujve romanë i takojnë rumunët, zviceranët me origjinë frënge dhe italiane dhe retoromanët. Grupit të popujve sllavë i takojnë polakët, çekët, slllovakët dhe sllovenët.




Cjermanë me veshje tradicionale nga Bavaria

Në një sipërfaqe prej 1,25 milionë km² jetojnë 184 milionë banorë. Dendësia e mesatare e banimit është 146 b/km², mirëpo ajo nuk është e njëjtë në tërë regjionin. Hapësirat më të banuara janë basenet industriale të Rurit, Sarit dhe Silezisë, si dhe lugina e lumit Rajna. Në këto pjesë, dendësia e banimit arrin edhe deri mbi 1000 b/km². Tërvat më rrallë të banuara janë ato të Ultësirës Gjermano-Polake me rreth 60 b/km² dhe viset e larta malore. Shtimi natyror i popullsisë në këtë regjion është më i ulët në krahasim me regjionet e tjera. Në decaeniet e fundit, shtimi natyror në disa shtete është shumë i ulët, bile edhe negativ. Kjo çon deri te çrregullimi i piramidës së moshës, ku rritet pjesëmarrja e grupmoshave të vjetra të popullsisë dhe zvogëlohet pjesëmarrja e grupmoshave të reja. Prandaj vjen deri te mungesa e fuqisë punëtore për veprimtari të ndryshme sekondare. Shtetet që përballen me situata të tilla demografike, provojnë ta zgjidhin problemin duke sjellë fuqi punëtore nga regjionet e tjera të Evropës. Sot në Gjermani, Zvicër dhe Austri kanë migruar dhe jetojnë me qindra e mijëra migrantë nga Evropa Jugore, Lindore dhe Lindja e Afërt.



Transporti lumor në Austri

Pas Luftës së Dytë Botërore, shtetet e Evropës së Mesme u ndan në dy blloqe. Kjo ndarje më së miri ilustrohet me ngritjen e Murit të Berlinit, i cili e ndau qytetin në dy pjesë, ndërsa Gjermania ndahet në Republikën Federative të Gjermanisë dhe Republikën Demokratike Gjermane. E para i takon bllokut kapitalist, kurse e dyta bllokut socialist. Kjo ndarje ekzistoi gjatë tërë kohës sa vazhdoi "lufta e ftohtë" ndërmjet lindjes dhe perëndimit. Në vitin 1989, u shemb Muri i Berlinit dhe u bashkuan dy Gjermanitë. Në vitin 1992, ndodhi ndarja paqësore në mes të Çekisë dhe Sllovakisë, ndërsa Sllovenia ishte e para që u shkëput nga ish-Jugosllavia.




1. Në cilën pjesë të Evropës së Mesme shtrihet populli sllav (identifiko shtetet)?
2. Në cilën pjesë shtrihen populli gjerman? Vazhdohet me pyetje të tjera.

Për t'u përgjigjur pyetjeve përdoret ndihma e hartës dhe e atlasit.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Organizues grafik

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit ta lexojnë njësinë mësimore në heshtje dhe në mënyrë individuale. Gjatë kësaj kohe, vizatohet organizuesi grafik dhe plotësohet.



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Krijë mendimin tënd

Nxënësit udhëzohen ta shikojnë një dokumentar për vendet e Evropës së Mesme dhe shtrojnë ndonjë pyetje, apo tregojnë ndonjë karakteristikë për ndonjë shtet të këtij regjioni që ata e dinë vetë apo e kanë vizituar.

<https://www.bing.com/videos/riverview/relatedvideo?&q=Zvicrra&&mid=27153D52C05CD-051633627153D52C05CD0516336&&FORM=VRDGAR>

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për angazhimin gjatë orës dhe për saktësinë e përgjigjeve që japin duke përcaktuar popujt dhe shtetet e Evropës së Mesme dhe analizës së përgjigjeve.

Detyrë:

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Jugore dhe Evropa e Mesme

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon kufijtë dhe shtetet e Evropës së Mesme;
Analizon specifikat popullore, kulturore, ekonomike e politike të Evropës së Mesme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 4, 6; II. 1, 2; 7; 8. III. 1,4;5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime: Evropa Jugore dhe Evropa e Mesme

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Krahason regionet sipas elementeve natyrore e shoqërore dhe identifikon pjesët e përbashkëta.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike e Evropës, atlas gjeografik, fletore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Rikujtim i njohurive paraprake

Duke përdorur hartën e Evropës, nxënësit bëjnë përkufizimin e Evropës së Mesme dhe të Evropës Jugore.

Evropa Jugore - veçoritë natyrore

Evropa Jugore përbëhet prej tre gadishujve, të cilët e formësojnë vijën bregdetare të detit Mesdhe. Këta janë: gadishulli Pirinej, Apenin dhe Ballkanik. Këta gadishuj në veri kufizohen me vargmalet e Pirinejeve dhe Alpeve, të cilat në të vërtetë paraqesin kufirin ndërmjet Evropës Jugore dhe asaj të Mesme. Edhe pse gadishulli Pirinej në perëndim dhe në veri del në oqeanin Atlantik, deti Mesdhe i përcakton shumicën e elementeve natyrore, duke i dhënë atij tipare mesdhetare. Për Evropën Jugore shpeshherë përdoret edhe emërtimi Evropa Mesdhetare. Megjithatë, në kuptimin gjeografik, Mesdheu është një hapësirë që tejkalon kufijtë e Evropës Jugore dhe përfshin edhe brezin e ngushtë bregdetar të Afrikës Veriore apo edhe brezin e ngushtë mesdhetar të Azisë Jugperëndimore. Në anën tjetër, përmes bregdetit Azur, Franca del në detin Mesdhe, mirëpo në kuptimin gjeografik, ajo nuk i takon Evropës Jugore.

Në vendet e Evropës Jugore që dalin në detin Mesdhe, shumë herët janë ngritur civilizimet që e kanë bërë regionin vatër të rëndësishme kulturore të "Botës së Vjetër". Rëndësia e këtij regjioni zgjat deri në periudhën e zbulimeve të mëdha gjeografike, ku pas zbulimit të rrugës detare për Indi përrreth Afrikës dhe kontinentit të Amerikës, kjo rëndësi zhvendoset në brigjet e oqeanit Atlantik. Pas hapjes së kanalit të Suezit në vitin 1869, Mesdheut i kthehet rëndësia sepse andejpasi kalojnë disa prej rrugëve më të rëndësishme detare. Sipërfaqja e Evropës Jugore është 1426 milionë km² ose rreth 14 % e territorit të Evropës.



Veçoritë e relievit

Evropa Mesdhetare: hapësira mesdhetare është kuptim më i gjërë gjeografik se Evropa Jugore

Relievi i Evropës Jugore përbëhet nga gadishujt Pirinej, Apenin dhe Ballkanik, të cilët e përthejnë në masë të konsiderueshme vijën bregdetare. Përveç gadishujve, nëpër detin Mesdhe ka edhe ishuj të madhësive të ndryshme, ku vërehen sidomos Korzika, Sardinia, Sicilia, Qiproja, Kreta dhe ishujt Balearë. Vargmalet janë njësitë kryesore të relievit

Evropa e Mesme - veçoritë natyrore

Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia

Evropa e Mesme përfshin pjesën qendrore të kontinentit. Ajo shtrihet nga lugina e lumit Rajna dhe shtetet e Beneluxit në perëndim e deri te Deti i Zi dhe Karpitet në lindje, si dhe nga Alpet, Danubi e Sava në jug e deri te Deti Verior dhe deti Baltik në veri. Ajo ka pozitë të volitshme gjeografike, edhe pse disa shtete të saj nuk kanë dalje të drejtpërdrejta në det. Pozita gjeografike është e volitshme edhe për shkak të faktit se nëpër territorin e saj rrjedhin Rajna dhe Danubi, të cilët, të bashkuar përmes kanalit, kanë krijuar rrjetin më të gjatë lundruar në Evropë. Për shkak të pozitës së ndërmjetme, ajo paraqet një territor kalues ku gërshetohen ndikimet e elementeve natyrore dhe shoqërore nga Evropa Veriore dhe Jugore, si dhe Perëndimore dhe Lindore. Prandaj, në këtë regjion ekziston një diversitet i madh kulturor, demografik dhe etnik.

Megjithatë, një pozitë e tillë është reflektuar në rrethanat e vrullshme historike dhe gjeopolitike siç janë luftërat dhe konfliktet, migrimet dhe zhvendosjet e popullsisë. Evropa e Mesme ka një sipërfaqe prej 1.25 milionë km² në të cilën jetojnë 184 milionë banorë.

Veçoritë gjeografiko-natyrore

Në relievin e Evropës dallohen në mënyrë të qartë Ultësira Gjermano-Polake në veri, malet mollake dhe të pasura me xehe në mes dhe vargmalet e Alpeve dhe Karpitet në jug. Ndërmjet Alpeve, Karpateve dhe Maleve Dinarike ndodhet ultësira e Panonisë, ndërsa përgjatë rrjedhës së poshtme të Danubit shtrihet ultësira e Vllahisë. Pranë Detit Verior dhe atij Baltik shtrihet Ultësira Gjermano-Polake, e cila është vazhdimësi e asaj të Evropës Lindore. Në perëndim arrin deri te lumi Rajna, kurse në lindje deri te lumi Vlsa. Në jug, kjo ultësirë përfundon me malet mollake të lartësisë mesatare. Në jug të Ultësirës Gjermano-Polake ngrihen malet mesatare. Këto male kanë maja të sheshuara dhe shpate të buta. Këtij grupi të maleve i takojnë Vogezi, Shvarcvaldi, Harci, Shumava, Sudetet etj.

Këto male janë të pasura me xehe të shumta minerale. Ndërmjet këtyre maleve shtrihen luginat dendur të banuara dhe ekonomikisht të zhvilluara siç është lugina e Rajnës, lugina e Tyingisë etj.

92



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Tabela e koncepteve

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit ta vizatojnë tabelën që ai e paraqet në fletoret e tyre dhe më pas në dyshe ta plotësojnë.

Evropa Jugore	Elementet	Evropa e Mesme
	Pozita gjeografike	
	Relievi (malet, ultësirat)	
	Klima (llojet e klimës)	



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatim i të nxënit

Veprimtari përforcuese

Nxënësit lexojnë ato që kanë punuar në fletoret e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në krahasimin e regjioneve sipas elementeve natyrore e shoqërore dhe identifikon pjesët e përbashkëta.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa e Mesme, veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultatet e të nxënit të temës: Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gjermania

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon hapësirën e Gjermanisë në hartën e punës;
- Analizon faktorët kryesorë që çuan në zhvillimin ekonomik të Gjermanisë;
- Tregon zonat më të zhvilluara ekonomike dhe qendrat kryesore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike, glob, atlas, libri i Gjeografisë 7, fletore pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
 "Asociacion"



Gjermania

Sipërfaqja: 357.368 km²
 Popullsia: 82 milionë
 Kryeqyteti: Berlini

Gjermania është shteti më i madh i Evropës së Mesme dhe një ndër shtetet më të mëdha të Evropës. Ajo shtrihet në pjesën perëndimore të Evropës së Mesme. Në veri del në Detin Verior dhe në Baltik, kurse në jug kufizohet me Alpet. Sipas veçorive gjeografiko-natyrore, por edhe ekonomike, në Gjermani mund të dallojmë qartë disa tërësi, të cilat janë: Gjermania Veriore, e Mesme, Jugore dhe Lugina e Rajnës.

Në Gjermaninë Veriore shtrihet Ultësira Pranëbaltike, e cila është formësuar pas periudhës së fundit të akullzimit. Skaji më jugor i mbulesës akullnajore ndodhej pikërisht në ultësirën e Gjermanisë Veriore. Kjo mbulesë ka lënë pas vetes lqene të shumta akullnajore, moçale dhe sedimente morenike të zhavorrit, rërës dhe argjilës, të thella edhe deri në 300 m. Brezi i ngushtë moçalor i bregdetit kah brendësia kalon në terrenin e pllajës së ulët ranore. Pjesët jugore të kësaj ultësire janë të mbuluara me sedimentet lumore të rërës, por edhe të pluhurit, të cilat i ka sjellë era gjatë dhe pas periudhës së fundit të akullzimit. Këtë material e quajmë les. Për shkak të këtij ndërtimi gjeologjik, tokat në veri të ultësirës kanë pëlleshmëri më të vogël, e cila, duke shkuar kah jugu, sa vjen e shtohet. Bregdeti është i ulët dhe ranor, prandaj janë ngritur bedeme për t'u mbrojtur nga depërtimi i detit. Brigjet e ulëta nuk janë të përshtatshme për ngritjen e porteve, prandaj ato janë ngritur më në brendësi, në estuaret e lumenjve Laba, Vezër, Emsa dhe Odra. Gjermania e Mesme shtrihet ndërmjet Ultësirës Pranëbaltike në veri dhe Pllajës Shvabo-bavareze e Alpeve në jug. Këtu shtrihen malet e ulëta mollaqe, të cilat, për shkak të vjetërsisë gjeologjike, janë të pasura me xehe të ndryshme. Për shkak të shterjes së xeheorëve dhe konkurrencës në tregun botëror të mineraleve, prodhimtaria e xeheve sot është shumë më e vogël se që ishte dikur. Malet më të rëndësishme të këtij grupi janë: Shvarcvaldi, Harci, Pylli



Berlini

Mynihu

! Me rëndësi të dihet

- Që nga viti 1990, Republika Federale Gjermane përbëhet prej 16 landeve, tri prej të cilave janë qyteti i Berlinit, Hamburgut dhe Bremenit.
- Holokausti është nocion për gjenocidin ndaj hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, të cillin e kishte ushtruar Gjermania naziste në shtetet që ishin nën okupimin dhe ndikimin e saj. Në llogoret e koncentrimin ishin mbytur mbi 6 milionë njerëz, kryesisht hebrenj. Vetëm në Aushvic ishin vranë mbi 1,1 milion njerëz.
- Gjermania ka punësuar një numër të madh të punëtorëve të huaj dhe është duke pranuar refugjatë të shumtë nga shtetet në të cilat zhvillohen luftëra apo ka mungesë të stabilitetit politik.
- Anija e parë me avull lundroi nëpër Rajna, në vitin 1816, nga Roterdami i Holandës deri në Këln të Gjermanisë.

? Pyetje

1. Cilat tërësi kryesore gjeografike dallohen në Gjermani?
2. Përshkruaj ndërtimin e Pllajës Shvabo-bavareze.
3. Pse Gjermania ka nevojë për fuqi punëtoresh nga jashtë?
4. Cilat janë qendrat më të mëdha industriale në Basenin e Rurit?

Grupi 1

- Në sa dete ka dalje Gjermania. Cilët dete?
- Në sa tërësi gjeografike ndahet Gjermania?
- Përshkruaj specifikat natyrore të Gjermanisë Veriore dhe të mesme?
- Sa është sipërfaqja e Gjermanisë?

Njëjtë ndërtohen pyetjet për grupin 3 dhe 4. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve dhe debatojnë lidhur me to.



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit**
Reflektim i grupeve të ekspertëve

Kthehen dhe riformohen përsëri grupet bazë në të cilat çdo nxënës ka një detyrë specifike të cilën do ta prezantojë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë dhe aplikim të teknologjisë për orën.

Detyrë:

Punim për Gjermaninë në ½ hamer ose A3 (Puna me katër nxënës). Pjesët: Pozita gjeografike, relievi, klima, ujërat, ekonomia, popullsia.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

Formohet një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asociojnë.

A	B	C	D
“Pastori”	Bavaria	J.S.Bah	Federal
Gjermania			

Nëse klasa është e pajisur me projektor dhe internet, identifikon elementet e asociacionit që nxënësit t'i shohin se për çfarë bëhet fjalë. Ose formon sipas dëshirës një asociacion.

- “Pastori” - pastori gjerman (racë e qenve me origjinë në Gjermani).
- Bavaria- shtet i lirë në jug të Gjermanisë Federale
- “J.S.Bah” – kompozitor gjerman i muzikës klasike
- Federal- Gjermania është shtet federal

Në fund mësimdhënësi i pyet se si do ta formonin ata një asociacion për Gjermaninë. Diskutim 2 min.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Të nxënësit me këmbime - Grupet e ekspertëve

Nxënësit ndahen në grupe, ku secili nxënës ka një numër 1,2,3,4.

Pasi nxënësit kanë përcaktuar numrat bashkohen njëshet bashkë, dyshet bashkë dhe kështu me radhë.

Grupi 2

- Përshkruaj specifikat natyrore të Gjermanisë Jugore.
- Cilët janë lumenjtë më të njohur të Gjermanisë?
- Cilat dete lidh kanali i Kilit?

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Pozita, kufijtë dhe madhësia e Evropës

Rezultatet e të nxënit të temës: Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,3,4,6; II-4; III-3,5,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Prezantim i punimeve - Gjermania

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan në hartë vetitë fiziko-gjeografike të Gjermanisë;
- Vlerëson rolin e Gjermanisë në zhvillimin ekonomik të BE-së.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, glob, libri i Gjeografisë 7 fletore pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Turi i galerisë

Të formohet një galeri për prezantim 5 minuta dhe nxënësit, pasi që i shikojnë punimet, etiketojnë pesë punimet më të mira duke vendosur ngjitës.




Gjermania

Sipërfaqja: 357.368 km²
 Popullsia: 82 milionë
 Kryeqyteti: Berlini


Gjermania është shteti më i madh i Evropës së Mesme dhe një ndër shtetet më të mëdha të Evropës. Ajo shtrihet në pjesën perëndimore të Evropës së Mesme. Në veri del në Detin Verior dhe në Baltik, kurse në jug kufizohet me Alpet. Sipas veçorive gjeografiko-natyrore, por edhe ekonomike, në Gjermani mund të dallojmë qartë disa tërësi, të cilat janë: Gjermania Veriore, e Mesme, Jugore dhe Lugina e Rajnës.

Në **Gjermaninë Veriore** shtrihet Ultësira Pranëbaltike, e cila është formësuar pas periudhës së fundit të akullzimit. Skaji më jugor i mbulesës akullnajore ndodhej pikërisht në ultësirën e Gjermanisë Veriore. Kjo mbulesë ka lënë pas vetes liqene të shumta akullnajore, moçale dhe sedimente morenike të zhavorrit, rërës dhe argjilës, të thella edhe deri në 300 m. Brezi i ngushtë moçalor i bregdetit kah brendësia kalon në terrenin e pllajës së ulët ranore. Pjesët jugore të kësaj ultësire janë të mbuluara me sedimentet lumore të rërës, por edhe të plururit, të cilat i ka sjellë era gjatë dhe pas periudhës së fundit të akullzimit. Këtë material e quajmë les. Për shkak të këtij ndërtimi gjeologjik, tokat në veri të ultësirës kanë pëlleshmëri më të vogël, e cila, duke shkuar kah jugu, sa vjen e shtohet. Bregdeti është i ulët dhe ranor, prandaj janë ngritur bedeme për t'u mbrojtur nga depërtimi i detit. Brigjet e ulëta nuk janë të përshtatshme për ngritjen e porteve, prandaj ato janë ngritur më në brendësi, në estuaret e lumenjve Laba, Vezer, Emsa dhe Odra. **Gjermania e Mesme** shtrihet ndërmjet Ultësirës Pranëbaltike në veri dhe Pllajës Shvabo-bavareze e Alpeve në jug. Këtu shtrihen malet e ulëta mollake, të cilat, për shkak të vjetërsisë gjeologjike, janë të pasura me xehe të ndryshme. Për shkak të shterjes së xeheroreve dhe konkurrencës në tregun botëror të mineraleve, prodhimitaria e xeheve sot është shumë më e vogël se që ishte dikur. Malet më të rëndësishme të këtij grupi janë: Shvarcvaldi, Harci, Pylli

i Tiringisë, malet e xeheve dhe Jura. Këto male ndërmjet vete janë të ndara me fushëgropa pjellore dhe me dendësi të madhe të banimit.



Alpet Bavareze



Harta e Gjermanisë

Në kuadër të Gjermanisë Jugore bëjnë pjesë Pilaja Shvabo-bavareze dhe vargmalet e Alpeve në jug. Pilaja Shvabo-bavareze është e ndërtuar nga sedimentet që i kanë sjellë akullnajat prej Alpeve, prandaj nuk ka pëlleshmëri të madhe, kurse është e mbuluar me livadhe dhe kullosa. Në jug të saj ngrihen shpatet veriore të Alpeve me majën më të lartë Cugshpic me 2963 m. Për shkak të depërtimit të masave ajrore nga Deti Verior, pjesa veriperëndimore e Gjermanisë ka klimë të lagësht atlantike me dimra të butë dhe vera të freskëta. Pjesa lindore dhe e brendshme kanë klimë kontinentale për shkak se deri në këto pjesë depërtojnë pa u penguar fare masat ajrore prej ultësirës së Evropës Lindore. Viset e larta malore të Alpeve kanë klimë malore. Nga Alpet dhe malet e Gjermanisë së Mesme burojnë lumenjtë më të gjatë të Evropës së Mesme, të cilët derdhen në Detin Verior, detin Baltik dhe Detin e Zi. Në Detin Verior derdhen Rajna, Elba, Vezeri dhe Emsi, në detin Baltik derdhet Odra, kurse në Detin e Zi derdhet Danubi. Shumica e këtyre lumenjve janë të lundrueshëm, duke lidhur krahinat e shumta industriale të Gjermanisë. Këta lumenj janë të lidhur ndërmjet vete nëpërmjet kanaleve të shumta. Përveç kanalit Rajna-Majna-Danub, në Gjermaninë Veriore është ndërtuar edhe kanali i Kililit, i cili lidh Detin Verior me detin Baltik. Në Ultësirën Pranëbaltike dhe shpatet veriore të Alpeve ndodhen plot liqene akullnajore. Në kufirin ndërmjet Gjermanisë, Austrisë dhe Zvicrës ndodhet liqeni i Bodenit.

Punimet e përzgjedhura prezantohen.

Nxënësit i kanë krijuar më parë këto punime.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Prezantim i punimeve në dyshe.

Prezantimi bëhet përmes teknologjisë, në PowerPoint.

Punimi duhet t'iu përmbahet kritereve që mësimdhënësi i ka paraqitur me detyrën, disa orë (dy javë) më herët.

Emri i nxënësit	Ilustrimet 20%	Burimet 20%	Artikulimi 10%	Shpjegim 30%	Bashkëpunimi 20%	Nota
1	3	5	4	5	3	4



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Vlerësimi i punimeve

Kërkohe nga nxënësit të votojnë për tri punimet më të mira.

Nxënësit me letra ngjitëse me ngjyra, vlerësojnë punimet me pikët 3- e kuqe, 2- e gjelbër dhe 1- e verdhë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 7-9.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa e Mesme, veçoritë shoqërore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Polonia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan në hartë vetitë fiziko-gjeografike të Polonisë;
- Vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Polonisë;
- Liston faktorët e zhvillimit ekonomik të Polonisë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti Gjeografia 7-Dukagjini, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi, projektor, TV.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Përshkrim dhe identifikim me hartë

Polonia

Statistika:
 Sipërfaqja: 312.697 km²
 Popullsia: 58.3 milionë
 Kryeqyteti: Varshava

Polonia është shteti i dytë për nga madhësia në Evropën e Mesme dhe ndodhet në verilindje të saj. Ajo shtrihet ndërmjet detit Baltik në veri dhe Karpateve në jug. Kufirin natyror në perëndim e përbën rrjedha e lumit Odër, ndërsa në lindje rrjedha e lumit Bug. Një pjesë të madhe të territorit të saj e zë Ultësira Gjermano-Polake që i jep asaj epitetin e vendit fushor. Emri Poloni rrjedh nga fjala "pole" që në gjuhën shqipe do të thotë fushë. Lartësia mesatare mbidetare e Polonisë është vetëm 175 m, ndërsa vetëm 3 % e territorit ka lartësi mbi 500 m.

Polonia në veri del në detin Baltik, mirëpo ky bregdet është i ulët, pak i përthyer prandaj si i tillë nuk është i përshtatshëm për lundrim. Menjëherë nga bregdeti fillon Ultësira Gjermano-Polake e cila është e ndërtuar nga sedimentet morenike, prandaj nuk është mjaft e pëllësme. Sipërfaqe të shumta janë të mbuluara me moçale dhe liqene, të cilat kanë po ashtu prejardhje akullnajore. Tërësia liqenore në lindje të lumit Vislla quhet Mazuria, kurse ajo në perëndim të tij quhet Pomorje. Në jug të kësaj ultësire, ngrihet rrafshnalta e ulët e Mallopolaskës. Në jugperëndim, në kufi me Çekinë, ndodhen malet mollake të Sudeteve, kurse në jug, në kufi me Sllovakinë, ndodhet mali Tatra, pjesë e Karpateve perëndimore. Relievi i ulët bën që klima e Polonisë të ndikohet fuqishëm nga masat e ajrore kontinentale, të cilat depërtojnë nga Ultësira e Evropës Lindore. Prandaj klima është kontinentale me dimra të ftohtë e të gjatë dhe vera të nxehta e të shkurtra. Shumica e lumenjve të Polonisë burojnë nga jugu malor i vendit, vazhdojnë të rrjedhin në drejtim të verit dhe derdhen në detin Baltik. Vislla është lumë nacional (autokton) i Polonisë.

Harta e Polonisë

103



Krakovi, sell e vjetër e mbretërve polakë



Toruni, vendlindja e astronomit polak Nikolla Kopernikut



Industria e rëndë në basenin e Silezisë

Me rëndësi të dihet

- Polakët janë ndër popujt që më së shumti kanë vuajtur pasojat e Luftës së Dytë Botërore. Nga 32 milionë sa ishin para fillimit të luftës, numri i popullsisë ra në 26 milionë pas përfundimit të saj. Shkatërrimet më të mëdha i përjetoi qyteti i Varshavës. Është e njohur nga ajo periudhë "Geto" e Varshavës. Kjo ishte një lagje e qytetit në të cilën kanë jetuar rreth 300.000 hebrenj. Pas kryengritjes së pasuksesshme kundër okupimit nazist gjerman, në vitin 1943, gjermanët vranë pothuajse tërë popullsinë e kësaj lagjeje.

- Në veri të Polonisë ndodhet qyteti i Torunit. Ai është zhvilluar në brigjet e lumit Visla dhe ka rreth 200 mijë banorë. Është qytet i vjetër me monumente të shumta kulturore-historike. Polakët e quajnë ndryshe "Krakovi i Veriut". Toruni është vendlindja e astronomit të madh polak, Nikolla Kopernikut, i cili e shpjegoi teorinë heliocentrike në veprën e tij "Mbi lëvizjen e trupave qiellore". Sipas kësaj teorie, Dielli është në qendër, ndërsa Toka dhe planetat e tjerë rrotullohen rreth tij. Për shkak të trashëgimisë së pasur kulturore dhe shkencore, e gjithë pjesa e vjetër e qytetit (Old Town) është futur në listën botërore të trashëgimisë që ruhet nga UNESCO.

Pyetje

1. Trego kufijtë natyrorë të shtrirjes së Polonisë.
2. Përmendi lumenjtë më të gjatë të Polonisë dhe trego ku derdhen ata.
3. Me cilat prodhime bujqësore Polonia e zë vendin e parë në Evropë?
4. Për çka njihet baseni i Silezisë?

105



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit Punë individuale në fletore pune

Gjej, shëno dhe plotëso në hartën mece të Polonisë dhe në fletore:

- a) Kryeqytetin e Polonisë;
- b) Shtetet me të cilat kufizohet;
- c) Detin ku del dhe dy lumenjtë kryesorë;
- d) Listo në një tabelë 5 resurset kryesore të Polonisë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për detyrat e realizuara në formë individuale, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

Mësimdhënësi/ja njofton nxënësit me orën e re duke e hapur diskutimin në formën e një pyetjeje. Paraprakisht, mësimdhënësi/ja paraqet një hartë të printuar të Polonisë (hartë fizike të pashkruar).

-Përdorini atlaset dhe tregoni se cila hartë është kjo.

-Cili është shteti më i madh që kufizohet me Gjermaninë?

Vazhdohet me pyetje të tjera.

Pasi identifikohet njësia (shteti), nga nxënësit kërkohet të shprehin se çka dinë për Poloninë.

Komentet shënohen në tabelë shkurtimisht.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbytjes Ditari dypjesësh

Udhëzohen nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje. Derisa nxënësit lexojnë, arsimtari shënon në tabelë disa pyetje ku nxënësit, pas leximit, i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

Pyetje	Komente (fragmente nga teksti)
1. Sa është sipërfaqja e Polonisë?	312.697km ²
2. Me cilat shtete kufizohet Polonia?	Gjermaninë, Çekinë, Sllovakinë, Rusinë, Bjellorusinë, Ukrainën, Lituanië.
3. Nga e mori emrin Polonia?	Emri "Poloni" rrjedh nga fjala "pole" që në gjuhën shqipe do të thotë fushë.
4. Pse bregdeti i Polonisë nuk është i përshtatshëm për lundrim?	ky bregdet është i ulët, pak i përthyer, prandaj si i tillë nuk është i përshtatshëm për lundrim.
Vazhdohet më tej me pyetje të tjera...	

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa e Mesme, veçoritë shoqërore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,4,6; II-1; III-3,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Çekia dhe Sllovakia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të dy shteteve;
- Analizon në hartë veçoritë natyrore të Çekisë dhe të Sllovakisë;
- Krahason dy shtetet, identifikon të përbashkëtat dhe përshkruan dallimet/specifikat mes tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartat gjeografike, glob, libri i Gjeografisë 7.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Identifikimi i hartave

Mësimdhënësi paraqet një hartë memece para nxënësve dhe kërkon që të identifikojnë shtetet për të cilët bëhet fjalë.





Sllovakia ndodhet në lindje të Evropës së Mesme. Është shtet kontinental dhe ka pozitë tranzite. Meqenëse nëpër territorin e saj rrjedh Danubi, ajo i takon grupit të shteteve danubiane. Në territorin e Sllovakisë dominon relievi malor. Prej perëndimit kah lindja shtrihen vargmalet e Karpateve. Në pjesën qendrore ndodhen Tatra e Ulët dhe malet me xehe të Sllovakisë. Relievi i ulët është më pak i pranishëm dhe shtrihet në jugperëndim e juglindje të vendit. Në jugperëndim ndodhet skaji verilindor i ultësirës së Panonisë nëpër të cilën rrjedh Danubi.



Largësia nga detet ka bërë që klima të jetë e mesme kontinentale, ndërsa në viset e larta edhe klima malore. Vargmalet e Karpateve janë hapësira ku burojnë lumenjtë që derdhen në Danub, Tisë e Moravë. Bërthamën e rrjetit hidrografik e përbën Danubi tek i cili derdhen Vahu, Morava dhe Nitra. Këta lumenj dallohen për potencial të madh hidroenergjetik. Në viset e larta malore të Tatrave ka edhe liqene akullnajo-re. Sllovakët janë popull sllav të besimit katolik. Ata përbëjnë shumicën e popullsisë në vend. Sllovakia, një kohë të gjatë ka qenë nën sundimin e Hungarisë, nga e cila ka trashëguar një pakicë kombëtare hungareze. Dendësia e popullsisë nuk është e njëjtë. Koncentrimi më i madh i popullsisë është në ultësirën e Danubit. Veprimtaritë kryesore ekonomike të Sllovakisë janë bujqësia, industria dhe turizmi. Bujqësia ka impakt të madh në zhvillimin ekonomik të vendit. Megjithatë, për shkak të mekanizimit të vazhdueshëm të saj, shpie drejt zvogëlimit të numrit të popullsisë së angazhuar në këtë sektor. Nga kulturat bujqësore rriten drithërat, rrepa e sheqerit, luledielli, pemët dhe perimet. Edhe blegtoaria është e zhvilluar.

110

Gjithashtu, pasi i identifikojnë shtetet, kërkohet që t'i përkufizojnë ato.

- Cilat janë këto dy shtete?
- Po shtetet me të cilat këto dy vende kufizohen, i dini?
- Gjeni në atlas faktet dhe statistikat për shtetet.

Në pjesën e pasme të fletës, nxënësit shënojnë emrat e tyre që të identifikohen se cilët anëtar (nxënës) ishin.




Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përbajtjes

Organizues grafik: *Diagrami i Venit*

Ndahen nxënësit në grupe dyshe (sipas bankës), ku për secilin e ndan nga një njësi mësimore (shtet) dhe kërkon që të lexojë dhe të nxjerrë shënime sipas elementeve gjeografike: pozita, klima, popullsia dhe ekonomia si dhe të dhëna nga atlasit.

Në fazën e dytë kërkohet nga nxënësit t'ia shpjegojnë pjesën e tyre njëri-tjetrit dhe të krahasohen dhe të gjejnë të përbashkëtat në mes të këtyre tri shteteve në formën e diagramit të Venit.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënës

Punë individuale (vlerësim i shteteve)

Formohet një tabelë sipas elementeve gjeografike për të tria shtetet dhe kërkon nga nxënësit që në mënyrë individuale të vlerësojnë elementet për shtetet, sipas të dhënave të nxjerra gjatë krahasimit atlasit dhe hartat si më poshtë:

Shteti	Relievi-	Klima-	Pasuritë-	Popullsia-	Ekonomia-
--------	----------	--------	-----------	------------	-----------

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, demonstrim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 12-13.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Mesme, veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultatet e të nxënimit të temës:
 Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,3,4,6; II-4; III-3,5,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sllovenia

- Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:**
- Vlerëson pozitën gjeografike të Sllovenisë;
 - Analizon veçoritë natyrore të Sllovenisë duke shpjeguar me hartë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti Gjeografia 7 - Dukagjini, fletore pune, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
 "Asociacion" (punë në grupe të mëdha)



Sllovenia me shekuj ka qenë nën sundimin e monarkisë Habsburge, më pastaj e asaj Austro-Hungareze, kurse pas Luftës së Parë Botërore bëhet pjesë e Jugosllavisë deri në vitin 1991 kur e shpalli pavarësinë e vet. Sllovenia shtrihet në kontaktin ndërmjet Evropës së Mesme dhe asaj Jugore. Sipas pozitës gjeografike, është vend alpik, panonik dhe adriatik. Sllovenia ka reliev kryesisht malor. Aty shtrihen skajet lindore të Alpeve të cilat vazhdojnë me Dinaridet. Në zonën e alpike dallohen disa maja të larta, lugina dhe liqene akullnajore. Maja më e lartë e alpeve sllovene është Triglav me 2.864 m. Alpet në veri nga Dinaridet në jug i ndan fusha e Lubljanës. Malet Dinarike zënë pjesën jug-perëndimore të vendit. Për shkak të pjesëmarrjes së madhe të shkëmbinjve gëlqerorë në ndërtimin e tyre, paraqiten forma të ndryshme të relievit karstik. Ndër shpellat më të mëdha janë ajo e Postojnës dhe e Shkocjanit. Sllovenia me një vijë bregdetare prej 43 km del në detin Adriatik, ndërsa pjesa lindore ose panonike e vendit është fushore dhe bregore. Alpet kanë klimë malore; në bregdet shfaqen elementet e klimës së ndryshueshme mesdhetare, ndërsa pjesa dërrmuese e vendit ka klimë të mesme kontinentale. Pjesa dërrmuese e lumenjve rrjedhin në drejtim të Detit të Zi. Lumi më i madh është Sava, i cili rrjedh nëpër pjesën qendrore të vendit. Lumenjtë tjerë të pellgut të zi janë kryesisht degë të Savës si Kupa dhe Krka dhe degë të Danubit si Drava dhe Mura etj. Në detin Adriatik derdhet lumi Soça. Në shpatet e Alpeve ndodhen liqenet akullnajore të Bledit dhe Bohinjit.



Kryeqyteti i Sllovenisë - Lubljana

Rreth 88 % të popullsisë së vendit e përbëjnë sllovenët. Këta janë popull sllav të besimit katolik. Nga pakicat jetojnë kroatët, serbët etj. Sllovenia është republika e parë e cila në vitin 1991 është shkëputur nga ish-Jugosllavia. Sa ishte në kuadër të saj, ajo kishte një zhvillim më të lartë ekonomik se republikat e tjera. Kushtet natyrore kanë bërë që në bujqësinë sllovene të jetë më e zhvilluar blegtoaria se bujqësia. Prej bagëtisë rriten gjedhët dhe delet. Nga kulturat bujqësore më së shumti kultivohen gruri, misri, rrepa e sheqerit dhe hardhia e rrushit. Rreth 60 % të territorit slloven e mbulojnë pyjet që janë një pasuri e madhe dhe kanë mundësuar zhvillimin e pylltarisë. Sllovenia nuk ka edhe aq pasuri minerale. Lumenjtë e vendit dallohen për potencialin e madh hidroenergjetik. Megjithatë Sllovenia e fiton energjinë edhe nga centralët nukleare. Nga degët industriale është e zhvilluar ajo kimike, elektronike, e aparateve të amvisërisë, e drurit, kurse qendra më e madhe dhe kryeqyteti i Sllovenisë është **Lubljana** me 290 mijë banorë. Qyteti shtrihet në fushën me të njëjtin emër, ndërsa nëpër të rrjedh lumi Lubllana. Hapësirat e mëdha të gjelbëruara brenda qytetit i japin asaj epitetin e "Kryeqytetit të Gjelbër". Qendra të tjera të mëdha janë Maribori, Celeja, Kranji, Novo-Mestoj dhe Kopri.



Shpella e Postojnës

Me rëndësi të dihet

- Shpella e Postojnës në jugperëndim të Sllovenisë është një sistem i shpellave karstike, i gjatë 23.340 m. Shpellën e ka krijuar lumi Pivka. Kjo është njëra ndër shpellat më të njohura në Evropë. Qysh në vitin 1819 është e rregulluar dhe hapur për vizitorë. Është futur në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s. Është shumë e pasur me stoli dhe ornamente të shpellës. Vizitorëve dhe turistëve të shumtë ua tërhoq vëmendjen edhe prania e "Peshkut të Njeriut" që jeton në ujërat e shpellës. Në të vërtetë, ky është një ujëtokësor i gjatë vetëm 2 cm dhe u përngjan shumë hardhucave.

- Fusha e Lubllanës ka rëndësi të madhe komunikative për shkak se në të kryqëzohet: rruga që vjen nga drejtimi i Posavinës me atë të drejtimit Vjenë-Triestë.

Pyetje

1. Cilat tërësi të relievit i ndan fusha e Lubllanës?
2. Përmend lumenjtë më të gjatë të Sllovenisë.
3. Pse Sllovenia e ka të zhvilluar industrinë e drurit dhe të mobilieve?

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegës që nxënësit të gjejnë njësinë që do zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asocojnë.

A	B	C	D
Alpinë	Shpella e Postojnës	Lubljana	Triglav
Sllovenia			

Identifikon elementet e asociacionit.
 Psh., Alpinë – shtet alpin; Shpella e Postojnës - shpellë në Slloveni, rreth 24,340 m gjatësi e sistemit karstik.
 Në fund mësimdhënësi i pyet se si do ta formonit ju një asociacion për Spanjën? Diskutim 2 min.

Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Lexim i drejtuar

Lexohet paragrafi i parë. Kur nxënësit ta përfundojnë leximin e këtij paragrafi, mbyllin tekstin.

- Pas këtij leximi, nxënësve iu shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përmbajtjes:
 - Cila është pozita gjeografike e Sllovenisë?
 - Cilat tërësi të relievit i ndan fusha e Lubllanës?
 - Sa është sipërfaqja e Sllovenisë?
 - Gjeni në hartë kryeqytetin slloven.
 - A mendoni se i përshtatet të thuhet se Sllovenia është shtet alpin?

Hapa të njëjtë merren edhe te leximi i pjesës 2, 3... etj.

Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Paragraf shpjegues

Tema: Sllovenia - Veçoritë natyrore dhe shoqërore (përmbledhje pa libër, me atlas)
 Nxënësit shkruajnë paragrafin, me qëllim që të shkruarit e tyre të shpjegojë pozitën gjeografike, veçoritë natyrore, popullsia, shtetet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për kriteret e arritura gjatë shkrimit, për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:
 Plotëso fletore pune.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Mesme, veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-1,2,3,4,6; II-4; III-3,5,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke; 2.1; 2.2

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Austria

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Evidenton në hartë shtetin e Austrisë dhe shtetet përreth;
 - Shpjegon rëndësinë e Alpeve për ekonominë e vendit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Proceset shoqërore dhe natyrore

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti Gjeografia 7-Dukagjini, fletore pune, atlas gjeografik, fletë A4, mjete shkrimi.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
 Diskutim/përshkrim me anën e hartës

Mësimdhënësi hap diskutimin në klasë përmes disa pyetjeve, ku kërkon nga nxënësit të hapin atlaset te pjesa e



Austria është shtet alpin dhe danubian i Evropës së Mesme. Nuk ka dalje në det, mirëpo mangësitë e pozitës kontinentale i zbut rëndësia komunikative dhe tranzite të territorit të saj. Nga perëndimi deri në lindje, në tërë gjatësinë e saj shtrihen kurorat e Alpeve. Këto janë Alpet e Tiroilit, Tauerni i Ulët dhe i Epërm, Karavanket etj. Maja më e lartë e Austrisë është Grosglockneri me 3.797 m. Majat e larta malore, luginat e thella lumore, liqenet, akullnajat dhe qafat malore e formësojnë fizionominë e pazakohur të Alpeve austriake. Mbi Alpe ndodhet baseni i Vjenës dhe skaji veriperëndimor i ultësirës së Panonisë. Në veri të Danubit relievi fillon të ngrihet në mënyrë të valëzuar deri te masivi malor i Çekisë. Derisa në pjesën perëndimore dhe të mesme është e pranishme klima malore, në lindje ajo fiton karakterin e klimës së mesme kontinentale. Nëpër veri të Austrisë rrjedh Danubi. Degët më të mëdha të Danubit janë Inni, Drava dhe Mura. Lumenjtë e Austrisë në pjesën e epërme të shtratit, për shkak të rrjedhjes së shpejtë, kanë fuqi të madhe energjetike. Në Alpe ndodhet po ashtu edhe një numër i madh i liqeneve akullnajore. Më i madhi ndër ta është liqeni i Bodinit, në kufi me Gjermaninë dhe Zvicrën.



Me rëndësi të dihet

- Anija e parë me avull ka lunduar nëpër Danub në vitin 1817, ndërsa linja e rregullt Vjenë-Budapest ka nisur të operojë që nga viti 1830.
- Ushqimet e kuzhinës austriake, siç është "Schnicla vjeneze" apo torta "Za-her", janë të njohura gjithandej nëpër botë. Edhe pse jetojmë në një kohë moderne, këto ushqime vazhdojnë të bëhen pa ndihmën e teknologjisë, prandaj kanë shije të veçantë dhe kualitet të lartë.
- Pallati i Shenbrunit është një nga pikat kryesore turistike të Vjenës. Ndërtimi i tij ka zgjatur nga viti 1694 deri në vitin 1750. Ka shërbyer si rezidencë e mbretëreshës Maria Tereza dhe mbretit Franz Jozefi. Ka një park të bukur dhe të madh me shumë labirinte dhe fontana të shumta. Prej vitit 1966 është në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Pyetje

1. Përmendi disa nga kurorat e Alpeve që shtrihen në Austri.
2. Cilat janë degët kryesore lumore të Danubit që rrjedhin nëpër Austri?
3. Cila prej pakicave kombëtare jeton në krahinën e Korushkës?
4. Cilat janë portet më të mëdha lumore në Danub?

116



Përforsimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënësve Detyrë me fletoren e punës

Gjej dhe shëno në hartën memece të Austrisë:

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të plotësohet harta memece sipas kërkesave që janë paraqitur.

Puna zhvillohet individualisht.

- a. Kryeqytetin e Austrisë
- b. Shtet me të cilat kufizohet
- c. Malet Alpe
- d. Luginën e lumit IN

Argumento me fjalë se cilat janë përparësitë e Alpeve për shtetin e Austrisë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për realizimin e saktë të punës, për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për saktësinë e përgjigjeve dhe të detyrave si dhe për bashkëpunimin me nxënësit e tjerë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

Evropës Qendrore.

- Cili është që kufizohet me Zvicrën, Sllovakinë dhe Gjermaninë?
- Në cilin vend të botës prodhohet pija e njohur energjike "Red Bull"?
- Gjени në hartë kryeqytetin e Austrisë.
- Nxirrini të dhënat/faktet për Austrinë nga pjesa e fundit e atlaseve dhe shënoni në tabelë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Sistemi ndërveprues i shënimeve (INSERT)

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë e re duke i përdorur shenjat e insertit:

Aktiviteti të përshkruhet në tabelë (nga nxënësit) si dhe të përshkruhet në fletoren e klasës.

√	+	-	?
(√- Informacion i njohur)	(+ Informacion i ri)	(- Informacion që ndryshon nga ai që di)	(?-s qarime për informacionin)

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa e Mesme - veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 4, 6; II. 1,2;7;8. III. 4;5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zvicra dhe Lihtejshtajni

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Zvicrës dhe të Lihtejshtajnit në Evropën e Mesme;
- Identifikon popujt dhe kulturat e këtyre shteteve;
- Shpjegon nivelin e lartë të zhvillimit ekonomik në këto shtete.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlas, hartë, projektor, laptop, foto.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësve

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi para nxënësve paraqet hartën fizike të Evropës së Mesme, duke u folur atyre pak për këtë vend. Mësimdhënësi bën disa pyetje për të nxitur interesim të nxënësve për mësim, si:





Lihtenshtejni është një principatë e pavarur e cila shtrihet ndërmjet Zvicrës dhe Austrisë. Ai është në union të përbashkët doganor me Zvicrën. Lihtenshtejni shtrihet në drejtimin veri-jug në një gjatësi përafërsisht 25 km, kurse në drejtimin perëndim-lindje është i gjerë vetëm 10 km. Njihet si “parajsë” për tatimpaguesit për shkak të normave tejet të ulëta të tatimeve. Ky është shteti i vetëm në botë ku numri i ndërmarrjeve të regjistruara është më i madh se numri i banorëve. Kjo principatë më së shumti fiton të ardhura nga shërbimet bankare, turizmi, tregtia, industria ushqimore dhe shitja e pullave postare. Kryeqyteti është Vaduzi.

Harta e Lihtenshtejnit



Vaduzi - kryeqyteti i Lihtenshtejnit



Keshitjellë në Vaduz

121

1. Çfarë pozite gjeografike kanë këto shtete?
2. Në cilat zona jetojnë më shumë shqiptarët në Zvicër, a njihni ndonjë shqiptar që jeton atje?
3. Si ka ardhur deri te zhvillimi ekonomik i këtyre vendeve dhe me çfarë merren?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Diagrami i Venit

Nxënësit ndahen në grupe dyshe (sipas bankës) dhe i ndajnë detyrat që ua cakton mësimmshënësia/ja e i komentojnë në rrethin e vizatuar në fletoret e tyre të klasës.

Nxënësi 1 i shkruan karakteristikat e Zvicrës, kurse nxënësi 2 në rrethin tjetër i shkruan karakteristikat e Lihtenshtajnit, më pas në mes i shkruajnë të përbashkëtat.

ZVICRA - TË PËRBASHKËTA - LIHTEJNSHTAJNI		



Përforsimi:

Konsolidim dhe zbatim i të nxënësve

Mësimdhënia e ndërsjellë

Mësimdhënia/ja paraqet përmes slajdeve nga një foto për secilin grup, kurse nxënësit, atë që e kanë lexuar nga teksti dhe komentuar në fletore e shpjegojnë duke e lidhur me fotot që paraqiten në slajde.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për angazhimin gjatë orës dhe për saktësinë e përgjigjeve që japin, duke përcaktuar pozitën gjeografike në hartë, duke indentifikuar popujt dhe kulturat e këtyre vendeve dhe për shpjegimin se si janë zhvilluar ekonomisht këto shtete.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 57 dhe 58.

• Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa e Mesme - veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 4, 6; II. 1, 2, 3; 7; 8. III. 1, 3, 4; 5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlikohjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime dhe përfundim me hartën e Evropës së Mesme

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Identifikon veçoritë natyrore, shoqërore, kulturore, fetare dhe ekonomike të Evropës së Mesme;
- Shpjegon pozitën gjeografike dhe lidhjen me rajonet e tjera të Evropës;
- Analizon zhvillimin ekonomik të këtij rajoni.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabela, foto, projektor, laptop, harta e Evropës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Teknologji.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë e fituara

Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që përmes hartës së Evropës së Mesme t'i shpjegojnë disa nga pjesët kyçe të saj,

Evropa e Mesme - veçoritë natyrore

Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia


Evropa e Mesme përfshin pjesën qendrore të kontinentit. Ajo shtrihet nga lugina e lumit Rajna dhe shtetet e Beneluxit në perëndim e deri te Deti i Zi dhe Karpatet në lindje, si dhe nga Alpet, Danubi e Sava në jug e deri te Deti Verior dhe deti Baltik në veri. Ajo ka pozitë të volitshme gjeografike, edhe pse disa shtete të saj nuk kanë dalje të drejtpërdrejta në det. Pozita gjeografike është e volitshme edhe për shkak të faktit se nëpër territorin e saj rrjedhin Rajna dhe Danubi, të cilët, të bashkuar përmes kanalit, kanë krijuar rrjetin më të gjatë lundruar në Evropë. Për shkak të pozitës së ndërmjetme, ajo paraqet një territor kalues ku gërshetohen ndikimet e elementeve natyrore dhe shoqërore nga Evropa Veriore dhe Jugore, si dhe Perëndimore dhe Lindore. Prandaj, në këtë regjion ekziston një diversitet i madh kulturor, demografik dhe etnik.

Megjithatë, një pozitë e tillë është reflektuar në rrethanat e vrullshme historike dhe gjeopolitike siç janë luftërat dhe konfliktet, migrimet dhe zhvendosjet e popullsisë. Evropa e Mesme ka një sipërfaqe prej 1,25 milionë km² në të cilën jetojnë 184 milionë banorë.

Veçoritë gjeografiko-natyrore

Në relievin e Evropës dallohen në mënyrë të qartë Ultësira Gjermano-Polake në veri, malet mollake dhe të pasura me xehe në mes dhe vargmalet e Alpeve dhe Karpatet në jug. Ndërmjet Alpeve, Karpateve dhe Maleve Dinarike ndodhet ultësira e Panonisë, ndërsa përgjatë rrjedhës së poshtme të Danubit shtrihet ultësira e Vllahisë. Pranë Detit Verior dhe atij Baltik shtrihet Ultësira Gjermano-Polake, e cila është vazhdimësi e asaj të Evropës Lindore. Në perëndim arrin deri te lumi Rajna, kurse në lindje deri te lumi Visla. Në jug, kjo ultësi përfundon me malet mollake të lartësisë mesatare. Në jug të Ultësisë Gjermano-Polake ngrihen malet mesatare. Këto male kanë maja të sheshtuara dhe shpate të buta. Këtij grupi të maleve i takojnë Vogezet, Shvarcvaldi, Harci, Shumava, Sudetet etj. Këto male janë të pasura me xehe të shumta minerale. Ndërmjet këtyre maleve shtrihen luginat dendur të banuara dhe ekonomiksht të zhvilluara siç është lugina e Rajnës, lugina e Tyringsisë etj.

Në skajin e poshtëm të regjionit ndodhen vargmalet e Alpeve dhe Karpateve. Alpet janë malet më të larta të Evropës. Shtrihen në formë harku nga gjiri i Gjenovës në perëndim e deri te ultësira e Panonisë në lindje. Pamja e sotme e tyre është rezultat i veprimtarisë së gjatë të akullnajave. Këtë e dëshmon prania e liqeneve të shumta akullnajore. Karpitet po ashtu shtrihen në formë harku dhe e rrethojnë nga ana lindore ultësirën e Panonisë.



Danubi

Largësia nga detet bën që klima në Evropën Jugore të jetë kryesisht kontinentale. Në Ultësirën Pranëbaltike ndeshen masat e ftohta dhe të thata ajrore nga Evropa Lindore me masat më të ngrohta dhe të lagështa të ajrit nga oqeani Atlantik. Prandaj pjesët perëndimore të regjionit marrin sasi më të madhe të reshjeve dhe kanë klimë të mesme kontinentale. Pjesët lindore marrin sasi më të vogla të reshjeve dhe kanë klimë më të ashpër kontinentale me vera të ngrohta dhe dimra të ftohtë. Zonat e larta kanë klimë malore me vera të shkurtra e të freskëta dhe dimra të gjatë, të ashpër dhe me borë.



Ujevara e lumit Rajna në Shaffhauzen të Zvicrës

Evropa e Mesme ka një rrjet të zhvilluar lumor. Lumenjtë më të gjatë janë Danubi, Rajna, Elba, Odra dhe Visla. Ata burojnë nga viset e larta malore dhe rrjedhin në drejtim të Detit Verior, Baltik dhe Detit të Zi. Danubi, me 2850 km, është lumi i dytë për nga gjatësia në Evropë. Buron nga mali Shvarcvald në Gjermani, kurse derdhet në Detin e Zi. Rajna buron në Alpe, rrjedh nëpër liqenin e Bodenit, kalon përgjatë kufirit ndërmjet Francës dhe Gjermanisë, kurse në Holandë derdhet në Detin Verior. Në Alpe ndodhen shumë liqene akullnajore, ku më të mëdhenjtë janë: liqeni i Bodenit, i Cyrihut, i Neshatelit dhe i Gjenevës.



Pyetje

1. Trego kufijtë e shtrirjes së Evropës së Mesme.
2. Përsëkrual ndërtimin e Ultësirës Gjermano-Polake.
3. Përmendi malet malake të regjionit.
4. Cilët janë lumenjtë më të gjatë të Evropës së Mesme dhe ku derdhen ata?

93

si: përkufizimin e regjionit, relievin, klimën, lumenjtë dhe liqenet, shtetet që bëjnë pjesë në këtë regjion. Në hartë dalin nxënësit të cilëve iu thirret numri i ditarit nga mësimdhënësit, apo sipas dëshirës së nxënësve.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Prezantim

Një grup nxënësish, përmes punimit në *power point* prezantojnë për Evropën e Mesme, duke përfshirë veçoritë natyrore dhe shoqërore-ekonomike të saj. Nxënësit e tjerë e përcjellin prezantimin me vëmendje dhe në fletoret e tyre shkruajnë gjërat që nuk i kuptojnë, ndonjë sugjerim që kanë apo pyetjet që dëshirojnë t'i bëjnë pas prezantimit.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatim i të nxënës

Diskutim i përbashkët

Nxënësit do të diskutojnë për njësinë mësimore të Evropës së Mesme që është prezantuar nga grupi i klasës,

komentojnë prezantimin, japin komente të ndryshme dhe bëjnë pyetje. Nëse ka ndonjë pyetje të paqartë, përgjigjet mësimdhënësi/ja.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të angazhimit në hartë, prezantimit të projektit, pyetjeve dhe përgjigjeve të dhëna gjatë orës mësimore.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 43

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa e Mesme - veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2; 4, 6; II. 2;7;8. III. ;5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Hungaria

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Hungarisë, lidhjen me shtetet e tjera dhe rëndësinë që i jep pozita;
- Analizon veçoritë natyrore – shoqërore të Hungarisë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta e Evropës, atlas gjeografik, fotografi dhe të dhëna nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Harta e konceptit – përkufizimit

Nxënësve iu parashtrihen disa pyetje nga mësimdhënësi, në mënyrë që t'i nxisë ata të mendojnë rreth pozitës



Hungaria është shtet me pozitë kontinentale. Ajo shtrihet në pjesën qendrore të ultësirës së Panonisë, prandaj është një shtet tipik panonik, ndërsa epitetin e shtetit danubian Hungaria e ka meqenëse nëpër territorin e saj prej veriut kah jugu rrjedh lumi i Danubit. Në Hungari dominon relievi i ulët me rrafshje aluviale, plato të lesit dhe ranishta. Alfeldi në lindje është ultësira më pjellore e Hungarisë. Ndërmjet rrjedhave të mëdha lumore ndodhen sipërfaqet e mbuluara me les dhe ranishta.

Harta e Hungarisë

? Çka është lesi?

Njëtrajtshmërinë e relievit të ulët e prishin malet e ulëta mollake. Në veri ndodhet mali më i lartë i Hungarisë, **Matra**, me 1015 m; në veriperëndim ndodhet pylli i Bakonjskës, ndërsa në jugperëndim ndodhet Meceku. Hungaria ka një klimë tipike kontinentale me dimra të ftohtë e të gjatë dhe vera shumë të nxehta. Duke shkuar kah lindja, mungesa e reshjeve shkakton thatësira. Lumenjtë më të gjatë që rrjedhin nëpër territorin e Hungarisë janë Danubi, Tisa dhe Drava. Danubi me rrjedhjen e vet meridionale e ndan Hungarinë në pjesën perëndimore dhe lindore. Tisa është degë e madhe e Danubit e cila po ashtu ka rrjedhje meridionale në lindje të Danubit. Drava rrjedh përgjatë kufirit me Kroacinë. Liqeni i Balatonit, për shkak të rëndësisë së madhe turistike që ka, quhet ndryshe edhe "Deti Hungarez". Liqen tjetër i madh është ai i Nezhiderit, i cili ndodhet në kufi me Austrinë.

122

Në pjesën dërrmuese të vendit dominojnë tokat e zeza humurore me pëlleshmëri të lartë. Duke shkuar kah lindja, për shkak të zvogëlimit të reshjeve, shfaqen thatësitrat të cilat ia zvogëlojnë pëlleshmërinë tokave. Në krahinën e Alfeldit bimësia përbëhet nga stepa natyrore, e cila me aktivitetin e njeriut është shndërruar në tokë të punëshme dhe shumë produktive. Pjesën më të madhe të popullsisë e përbëjnë hungarezët. Këta janë popull ugrofin me prejardhje nga stepat e Azisë së Mesme. Janë të afërt me finlandezët dhe estonezët. Përveç hungarezëve, jetojnë edhe gjermanët dhe romët. Popullsia e Hungarisë dallohet me shtim të ulët, madje edhe negativ që po çon drejt rënies së numrit të popullsisë. Relievi i ulët fushor dhe tokat pjellore kanë mundësuar zhvillimin e bujqësisë, në veçanti të lavëtarisë. Në komplekset e mëdha të tokave të punëshme kultivohen gruri, misri, patatja, luledielli, rrepa e sheqerit, duhani, soja, kanpi etj. Është e zhvilluar edhe perimtaria, sidomos prodhimi i specave të kuq "paprika" dhe pipërit të kuq me të cilët Hungaria njihet nëpër botë. Në stepat e thata është e zhvilluar edhe blegtoaria, veçanërisht rritja e kuajve. Nga burimet energjetike, Hungaria ka shumë rezervat të gazit natyror dhe diçka më pak të thëngjillit, ndërsa rezervat e naftës janë të pakta. Nga pasuritë xeherore ka rezervat e shumta të boksitit, kryesisht në afërsi të pyllit të Bakonjskës. Ajo është ndër prodhuesit më të mëdhenj të boksitit në Evropë. Ka të zhvilluar industrinë e makinave dhe mjeteve transportuese, kimike, të tekstilit, elektroindustrisë, farmaceutike, ushqimore etj. Më se gjysma e industrisë është e koncentruar në rajonin e Budapestit. Hungaria, një pjesë të të ardhurave kombëtare i siguron edhe nga turizmi. Rajone të njohura turistike janë Budapesti dhe liqeni i Balatonit.



Budapesti në brigjet e Danubit

Qyteti më i madh dhe kryeqyteti i Hungarisë është **Budapesti** me 1.8 milionë banorë. Shtrihet në brigjet e Danubit dhe është formuar në shekullin XIX nga bashkimi i Budimit në bregun lindor dhe Pestit në bregun lindor të Danubit. Për shkak të burimeve të shumta termominerale, në qytet ka shumë banja shëruese. Qytete të tjera janë Segedi, Gyori, Mishkolci, Peçuji etj.

123

gjeografike të Hungarisë dhe, në bazë të njohurive para-prake që ata kanë marrë, mund të japin disa mendime për pozitën gjeografike të këtij shteti. Mësimdhënësi/ja merr disa mendime dhe i shkruan në tabelë



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Të nxënë të këmbime - Grupet e ekspertëve

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup do të bëhet ekspert i pjesës që do t'i jepet për detyrë. Ata do ta lexojnë në grup, do ta diskutojnë, do ta përvetësojnë dhe do ta përgatisin për ta prezantuar para të tjerëve.

Grupi 1: Pozita gjeografike;

Grupi 2: Relievi;

Grupi 3: Klima;

Grupi 4: Ujërat dhe bota e gjallë;

Njëjtë vazhdohet me grupet e tjera.

Secili grup përvetëson njohuritë e pjesës së vet dhe i transmeton ato të tjerët në mënyrën më të mirë.

Më pas argumentohen ato mendime dhe arsyetohet pozita e mirë gjeografike e Hungarisë.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Nxënësit udhëzohen ta shikojnë një dokumentar të shkurtër për Hungarinë, dhe të mbajnë shënime për gjërat për të cilat kanë interesim të dinë më shumë për veçoritë natyrore-shoqërore, më pas diskutohet për to në klasë.

<https://www.bing.com/videos/riverview/relatedvideo?&q=Hungaria&&mid=B4D89EDF54DC8D7D8788B4D-89EDF54DC8D7D8788&&FORM=VRD GAR>

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për angazhimin gjatë orës dhe saktësinë e përgjigjeve që japin, duke përcaktuar pozitën gjeografike në hartë, dhe për mënyrën e analizimit të veçorive natyrore dhe shoqërore të shtetit.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 60.

Reflektim për rryedhën e orës mësimore:

Mësimi 44

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa e Mesme - veçoritë natyrore dhe shoqërore të shteteve

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 4, 6; II. 1,2;7;8. III. 4;5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rumania

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Rumanisë, lidhjen me shtetet e tjera dhe rëndësinë që i jep pozita;
- Analizon veçoritë natyrore – shoqërore të Rumanisë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta e Evropës, atlas gjeografik, fotografi dhe të dhëna nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Nxënësve iu kërkohet që të mendojnë për pak çaste në bazë të shtrirjes gjeografike dhe të veçorive natyrore të Ru-



Rumania është shteti më i shkajshëm lindor i Evropës së Mesme. Ajo është vend i Karpateve, panonik dhe danubian. Me një bregdet të gjatë 245 km, del në Detin e Zi. Territori i saj është urë lidhëse ndërmjet Evropës së Mesme, Jugore dhe Lindore. Vullën kryesore reliefiv të Rumanisë ia japin malet Karpate, të cilat duke u shtrirë në formë të harkut, e ndajnë vendin në pjesën veriperëndimore dhe juglindore. Këto male nga ana lindore e kufizojnë tërësinë kodrinore dhe pyjore të Transilvanisë. Një tërësi tjetër e reliefit të Rumanisë është hapësira kodrinore e Moldavisë në lindje dhe fusha e valesuar e Dobrukhës në juglindje. Në jug të Karpateve shtrihet ultësira e Vllahisë, ndërsa në perëndim depërton skaji lindor i ultësirës së Panonisë.


Derisa në Transilvani klima është e mesme kontinentale, në pjesët ultësimore ajo është kontinentale, ndërsa në Karpate dominon klima mallore. Rumania ka një rrjet lumor mjaft të pasur. Nëper lindje të vendit rrjedh Danubi i cili është lumë kufitar me Serbinë në lindje dhe me Bullgarinë në jug. Para derdhjes në Detin e Zi, degëzohet në tri degë të mëdha dhe formon deltën e madhe lumore. Delta e Danubit është moçalore dhe e pasur me botë bimore dhe shtazore, sidomos asaj të zogjve. Nga Karpateve burojnë Mureshi, Tamishi, Olta, Sereti dhe Pruti. Të gjithë këta derdhen në Tisë dhe Danub.



Karpatet



Bukureshti - kryeqyteti i Rumanisë



Timishoara

Vegetacion natyror në ultësirën e Vllahisë, Panonisë dhe Dobruhës janë stepat të cilat me punën e njeriut janë shndërruar në toka të punueshme. Në Karpate, formacionet bimore shtrihen sipas zonave vegetative dhe klimatike. Në brezin e ulët malor shtrihen pyjet gjetherëne, ndërsa mbi to pyjet halore dhe në fund kullosat e hapësirat e zhveshura shkëmbore. Pjesën dërrmuese të popullsisë së vendit e përbëjnë rumunët. Këta i takojnë grupit të popujve romanë. Popullsia e Rumanisë ka shtim të ulët natyror dhe emigron jashtë vendit. Në qytete jeton më së gjysma e popullsisë, kurse me bujqësi merren më shumë se 40 % e tyre. Për shkak të kushteve natyrore, bujqësia në Rumani është mjaft e zhvilluar. Më së shumti kultivohen drithërat, bimët industriale, hardhia e rrushit, pemët dhe perimet. Në kullosat dhe livadhet e zonës kodrinore-malore, por edhe në zonat fshore është e zhvilluar edhe blegtoaria. Rumania është e pasur me naftë, (rrethina e Ploeshtit), në Karpate ndodhen pasuritë e shumta të xeheve të hekurit, plumbit, zinkut, bakrit dhe boksiteve. Përfitim i energjisë bëhet nga termoelektranat, hidrocentralet dhe centralet atomike. Dëgët më të rëndësishme të industrisë janë xehetaria, industria petrokimike, e makinave, industria e drurit, e letres, e mobilieve, e tekstilit etj. Turistët gjithnjë e më shumë po tërhiqen nga këshqillat në Transilvani, banjat shëruese në Karpate, Bukureshti dhe bregdeti rumun.

Qyteti më i madh dhe kryeqyteti i Rumanisë është Bukureshti me 2.4 milionë banorë. Ndodhet rreth 60 km në veri të Danubit dhe kufirit të Bullgarisë. Për shkak të arkitekturës së veçantë dhe kulturës, ai ka epitetin e "Parisit të Lindjes". Në ditët e sotme qyteti ka përjetuar një transformim paksa kaotik, ku gërshetohen mes vete godina dhe pjesë të qytetit me objekte neoklasike, komuniste dhe bashkëkohore.

Ndërmjet ndërtesave të shumta e të bukura veçohet ajo e parlamentit rumun e cila ka 12 kate dhe është një nga më të mëdhatë në Evropë. Bukureshti është qendër e madhe industriale, administrative, diplomatike, universitare dhe kulturore e Rumanisë. Qendra të tjera të mëdha janë edhe Timishoara, Brailla, Krajova, Turnu-Severini etj.

manisë, më pas mësimdhënësi/ja në hartë bën përkufizimin e Hungarisë.

Pas përkufizimit ua përshtron disa pyetje nxënësve, si:

- Cila pjesë e Rumanisë hyn në pjesën e Gadishullit Ballkanik?
- A ka dajle në dete? Nëse po, në cilin det?
- Cila pjesë ka pozitë më të mirë gjeografike dhe pse?

.....



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Ditari dypjesësh

Në këtë fazë mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të lexojnë tekstin e temës nga libri dhe të zgjedhin një pjesë që atyre iu bën përshtypje. E shënojnë citatin në kolonën e parë dhe japin komentet e tyre për atë pjesë; shtojnë diçka më shumë apo edhe pyesin lidhur me atë pjesë.

Citati	Komenti
Sipërfaqja e Rumanisë është?	238,397 km ²
Në Rumani jetojnë?	18.9 milionë banorë sipas të dhënave (2023).



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Rrjet i diskutimit

Për të reflektuar rreth temës, nxënësit do të tregojnë:

- 3 – tri gjëra të reja që mësuam;
- 2 – dy gjëra që duhen mbajtur mend për ekonominë e Rumanisë;
- 1 – një gjë që i bën kureshtarë të dinë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për angazhimin gjatë orës dhe saktësinë e përgjigjeve që japin, duke përcaktuar pozitën gjeografike në hartë, dhe për mënyrën e analizimit të veçorive natyrore dhe shoqërore të shtetit.

Detyrë:

Iu përgjigjen pyetjeve në librin bazë, fq. 127.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Perëndimore - veçoritë natyrore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon pozitën gjeografike, rëndësinë e detit për jetën dhe luftën e njerëzve me të dhe rëndësinë e Oqeanit dhe rrymës së Golfit në klimë dhe jetën e njerëzve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 4, 5, 6, 8 II. 1, 2, 3; 7; 8. III. 1, 2, 4; 5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa Perëndimore – veçoritë natyrore (Pozita, kufijtë dhe madhësia)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan në hartë relievin e Evropës Perëndimore;
- Analizon rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës Perëndimore dhe rolin e saj për Evropën në përgjithësi;
- Vlerëson rëndësinë e Oqeanit dhe rrymës së Golfit në klimë dhe jetën e njerëzve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta e Evropës, atlas gjeografik, fotografi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Historia, Edukatë qytetare.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Përmbledhje e strukturuar

Në fillim mësimdhënësi/ja përmbledh në pika të shkurtra ato që do të mësojnë në këtë njësi mësimore:

Evropa Perëndimore - veçoritë natyrore




Deri para periudhës së zbulimeve të mëdha gjeografike, ky region i Evropës kishte pozitë të skajshme dhe ishte larg rrugëve kryesore detare të cilat e përshkonin detin Mesdhe. Pas zbulimit epokal të kontinentit të ri, përpos që u bë një kthesë e madhe shoqërore dhe u ndryshuan perceptimet e gabuara për formën dhe madhësinë e Tokës, fillon e rritet rëndësia komunikative e qyteteve dhe vendeve që dalin në oqeanin Atlantik. Nga kjo kohë, prej porteve detare të Evropës Perëndimore nisnin ekspeditat e shumta pushtuese dhe kolonialiste, të cilat pushtojnë vende dhe popuj në të katër anët e botës, duke i dhënë këtij regionit pozitë qendrore në kuadër të rrugëve lundruese botërore. Evropa Perëndimore ka sipërfaqe prej 956.000 km² ose 9% nga sipërfaqja e përgjithshme e Evropës.

Vija bregdetare e Evropës Perëndimore është mjaft e përthyer. Kjo përtsheshmëri e madhe, përveç të tjerash, është edhe rezultat i estuareve të shumta, të cilat janë gryka të përmblytura lumore që janë krijuar nga ulja e kores së Tokës. Estualet krijojnë gjatë shfaqjes së baticave dhe zbatave. Gjatë baticave, të cilat në këtë bregdet ngrihen edhe deri në 15 m, uji i detit depërton nëpër estuare dhe ngre nivelin e ujit në lumenj. Prandaj gjatë baticës edhe anijet e mëdha oqeanike mund të futen thellë në brendësi të kontinentit. Valet e larta që ngrihen në oqeanin Atlantik, në shumë pjesë të bregdetit kanë formuar brigje të larta e të pjerrëta shkëmbore të cilat quhen klife.

? Cjej në hartë se cilat porte janë ngritur në estuaret e lumenjve.



Klif në bregdetin e Evropës Perëndimore



Panorë satelitore e estuarit të Temzës

Tërësitë kryesore të relievit të Evropës Perëndimore janë Ultësira e Evropës Perëndimore, malet mollake të Britanisë së Madhe, Ardenet në Belgjikë, Vogezet dhe Masivi Qendror

në Francë. Pirinejet dhe Alpet vetëm me pjesët e skajshme të tyre hyjnë në kuadër të këtij regjioni të Evropës. Ultësira e Evropës Perëndimore shtrihet përgjatë brigjeve të oqeanit Atlantik. Kjo ultësirë është e ndërprerë nga rrjedhat e lumenjve të gjatë të Evropë. Disa pjesë të kësaj ultësire ndodhen nën nivelin e detit. Të tilla janë brigjet e Holandës. Këto pjesë të tokës quhen **depresione** dhe shtrihen ndërmjet bemeve ranore në perëndim, të cilat pengojnë depërtimin e ujit të detit dhe relievit të valëzuar e bregor në lindje të vendit. Holandezët janë një popull shumë i vyeshtë të cilët zhvillojnë një "luftë shekullore" me detin. Këtë "luftë" ata kanë arritur ta fitojnë duke ndërtuar përgjatë brigjeve të detit me mijëra kilometra beme ranore dhe penda mbrojtëse. Duke hequr ujin, ata kanë tharë moçalet dhe pjesët e ulëta të detit, duke i shndërruar ato në "poldere". Polderet janë toka të thara në të cilat holandezët zhvillojnë bujqësinë intensive.

Klima e Evropës Perëndimore


Klima e Evropës Perëndimore është nën ndikimin e fuqishëm të oqeanit Atlantik. Rryma e Golfit e cila kalon përkaj brigjeve të Evropës Perëndimore sjell me vete ujin e ngrohtë të oqeanit i cili e zbut klimën. Prandaj, në pjesën dërrmuese të këtij regjioni, klima është e lagësht dhe e butë. Moti gjatë pjesës dërrmuese të vitit është me vranësira, i lagësht dhe me shi, ndërsa për shkak të lagështisë së madhe dukuri e shpeshtë janë edhe mjegullat. Kështu, për shembull, në Irlandë, mesatarisht gjatë vitit, 260 ditë janë të vrenjtura dhe me shi, kurse në Holandë, rreth 200 ditë gjatë vitit kanë mot të vrenjtur dhe me shi. Verat janë të freskëta, dimrat e butë, ndërsa bora arrin të mbulojë vetëm malet më të larta. Në Alpe, për shkak të lartësisë, ndodhen akullnajat, kurse në brigjet e Mesdheut klima është mesdhetare.

- Ka pozitë të mirë gjeografike për shkak të daljes në Oqeanin Atlantik, e sidomos pas zbulimit të Amerikës.
- Ndryshe quhet dritarja e Evropës në botë.
- Një pjesë e madhe e tokave të saj shtrihet nën nivelin e detit, që ndryshe quhen si poldere.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Harta e koncepteve

Klasa ndahet në grupe dhe secilit grup do t'i jepet për detyrë të plotësojnë hartën e koncepteve. Pasi kryhet puna në grup, diskutohet me të gjitha grupet. Mësuesja plotëson hartën e koncepteve në tabelë me ndihmën e nxënësve.



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatim i të nxënit
Veprimtari në dyshe

Nxënësve iu kërkohet që nga njësia e mësuar të provojnë njohuritë me anë të detyrave dhe të pyetjeve në fletoren e punës, të plotësohet faqe 62 dhe 63. Puna do të jetë individuale dhe do të shfrytëzohet edhe atlas gjeografik. Ata do të jenë në gjendje ta vlerësojnë rëndësinë e rrymës së Golfit dhe Oqeanit në klimë, ujëra dhe botën e gjallë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për angazhimin gjatë orës dhe saktësinë e përgjigjeve që japin, duke përcaktuar pozitën gjeografike dhe relievin në hartë, dhe për mënyrën e vlerësimit të rrymës së Golfit e Atlantikut në klimë dhe jetën e njerëzve.

Detyrë:

Ushtime në atlasin gjeografik për Evropën Perëndimore.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Perëndimore – veçoritë shoqërore dhe ekonomike

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Analizon shtrirjen gjeografike dhe rëndësinë ekonomike të vendbanimeve të qymyrit, të naftës, të gazit, të hekurit dhe të metaleve të tjera; Identifikon popujt dhe shtetet e Evropës Perëndimore sipas banorëve dhe numrit të të ardhurave ekonomike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 4, 6; II. 1,2;7;8. III. 4;5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Veçoritë shoqërore – ekonomike të Evropës Perëndimore - Popullsia

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Përshkruan tiparet kryesore të popullsisë së Evropës Perëndimore;
- Identifikon popujt e Evropës Perëndimore sipas shteteve;
- Analizon rëndësinë e pasurive natyrore në zhvillimin ekonomik.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta politike e Evropës, atlas, fletore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/ja e fillon orën mësimore duke shtruar disa pyetje lidhur me temën, që të nxënësit interesim për mësim:

Evropa Perëndimore - veçoritë shoqërore dhe ekonomike

Evropa Perëndimore, me 158 milionë banorë, është regjioni më i banuar i Evropës. Dendësinë më të madhe të banimit e kanë Holanda, Belgjika si dhe hapësirat metropolitane të Parisit dhe Londrës. Shteti më pak i banuar është Irlanda, në të cilën në një kilometër katror jetojnë vetëm 15 banorë. Në këtë regjion jetojnë popujt romanë, gjermanë dhe keltë. Popujt romanë janë francezët dhe valonët e Belgjikës; popujt gjermanë janë anglezët, holandezët dhe flamanët e Belgjikës, ndërsa irlandezët, uellsianët, skocezët dhe bretonët janë pasardhës të keltëve të vjetër. Popullsia e Evropës Perëndimore ka shtim natyror shumë të ulët. Për këtë arsye është gjithnjë e më i madh kontigjenti i grupmoshave të vjetra të popullsisë, ndërsa popullsia po shkon duke u mplakur. Pas zbulimeve të mëdha gjeografike, nga ky regjion emigroi një numër i madh i njerëzve në vendet e pushtuara. Gjatë shekullit XX, regjioni bëhet një hapësirë e fuqishme imigruese për shumë arsye. Shtimi i ulët natyror rrit nevojën dhe kërkesat për fuqi punëtore, të cilën vendet e Evropës Perëndimore e sigurojnë përmes imigrimit. Në Britani të Madhe, Francë dhe shtetet e Beneluxit jetojnë dhe punojnë një numër i madh i emigrantëve nga vendet e ndryshme të Evropës Jugore, Afrikës dhe Azisë Jugperëndimore. Nga këto të fundit, popullsia shpërngulet dhe tenton të arrijë në Evropë Perëndimore edhe për shkak të situatës jostabile politike, varfërisë dhe urisë së skajshme, konflikteve dhe luftërave qytetare etj.

Popujt e Evropës Perëndimore kanë nivel të lartë të kulturës, shkallë të ulët deri në zero të analfabetizimit, nivel të lartë të urbanizimit dhe standard të lartë jetësor. Pjesa dërmuese e popullsisë është e punësuar në industri dhe veprimtari të tjera jobujqësore. Në bujqësi janë të angazhuar më pak se 10 % e popullsisë. Megjithatë popullsia bujqësore është e shkolluar dhe e përgatitur për zhvillimin e bujqësisë intensive.



Tuneli nënujor në kanalit La Mansh



Porti i Roterdamit

Sot Evropa Perëndimore është rajoni më i zhvilluar ekonomik në mbarë Evropën. Veçoritë kryesore ekonomike të saj janë zhvillimi dhe avancimi i veprimtarive terciare dhe kuartare, industria dhe bujqësia e specializuar, komunikacioni i shpejtë dhe efikas etj.

Me rëndësi të dihet

- Kanali i La Manshit bashkon oqeanin Atlantik me Detin Verior, kurse ndan Britaninë e Madhe nga Franca dhe pjesa tjetër e Evropës kontinentale. Ky kanal është i gjatë 565 km dhe i gjerë 240 km. Cjërësia më e vogël e këtij kana-li është te ngushtica e Doverit me vetëm 34 km. Pikërisht te kjo ngushticë, në vitin 1994 është hapur kanali nënujor, i gjatë 51 km. Treni "Eurostar" distancën ndërmjet Parisit e Londrës e kalon për vetëm 2 orë e gjysmë.

Pyetje

1. Përmendi disa zbulime që bëhen në B. të Madhe në fund të shekullit XVIII dhe fillim të shekullit XX.
2. Si u bë përhapja e gjuhëve nëpër botë?
3. Cilët popuj janë pasardhës të keltëve të vjetër?
4. Ku dhe kur fillon Revolucioni Industrial?

- Cilët popuj jetojnë në Evropën Perëndimore?
- Pse kemi kaq shumë popuj të huaj që jetojnë në këto shtete, çfarë i ka shtyrë të vijnë?
- Në cilat nga këto shtete ka më shumë shqiptarë dhe cilat ishin disa nga arsyet që erdhën?



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Sistemi ndërveprues i shënimeve (INSERT)**

Udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë e re duke i përdorur shenjat e insertit. Pastaj diskutojnë me radhë se cilat informata ishin të njohura, cilat të reja dhe sqarohen pyetjet nga mësimdhënësi të shënuara nga nxënësit.

√	+	-	?
Informacion i njohur	Informacion i ri	Informacion që ndryshon nga ai që di	Sqarime për informacionin
...



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Marrëdhëniet pyetje-përgjigje**

Përmes hartës dhe atlasit, nxënësit shpjegojnë popullsinë dhe ekonominë e Evropës Perëndimore, si: popujt, besimet, dendësinë e popullsisë, gjuhët, pasuritë natyrore, zonat industriale etj.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të saktësisë së përgjigjeve që kanë dhënë gjatë orës mësimore duke identifikuar popujt në këtë region, dhe për mënyrën e analizimit të shfrytëzimit të pasurive natyrore në zhvillimin ekonomik të vendit.

Detyrë:

Iu përgjigjen pyetjeve në librin bazë, fq. 133.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Perëndimore – veçoritë natyrore dhe shoqërore

Rezultatet e të nxënit të temës: Analizon pozitën gjeografike, rëndësinë e detit për jetën dhe luftën e njerëzve me të dhe rëndësinë e Oqeanit dhe rrymës së Golfit në klimë dhe jetën e njerëzve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 3 4, 6; II. 1, 2; 3, 4, 5; 8. III. 1, 3, 4; 5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime në hartën fizike dhe politike të Evropës Perëndimore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon pozitën gjeografike dhe përthyerjen bregdetare;
- Analizon polderet (tokat nën nivelin e detit) duke treguar luftën e njerëzve me detin;
- Identifikon popujt e Evropës Perëndimore;
- Analizon zhvillimin ekonomik dhe shfrytëzimin e pasurive natyrore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletore pune, atlase gjeografike, harta e Evropës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim i njohurive paraprake

Në pjesën e parë të orës kontrollohen dhe vlerësohen detyrat e shtëpisë, lexohen dhe diskutohen me nxënësit. Nëse ka ndonjë paqartësi, mësimdhënësi/ja jep sqarime për to.

Evropa Perëndimore - veçoritë shoqërore dhe ekonomike

Evropa Perëndimore, me 158 milionë banorë, është regjioni më i banuar i Evropës. Dendësinë më të madhe të banimit e kanë Holanda, Belgjika si dhe hapësirat metropolitane të Parisit dhe Londrës. Shteti më pak i banuar është Irlanda, në të cilën në një kilometër katror jetojnë vetëm 15 banorë. Në këtë regjion jetojnë popujt romanë, gjermanë dhe keltë. Popujt romanë janë francezët dhe valonët e Belgjikës; popujt gjermanë janë anglezët, holandezët dhe flamanët e Belgjikës, ndërsa irlandezët, uellsianët, skocezët dhe bretonët janë pasardhës të keltëve të vjetër. Popullsia e Evropës Perëndimore ka shtim natyror shumë të ulët. Për këtë arsye është gjithnjë e më i madh kontigjenti i grupmoshave të vjetra të popullsisë, ndërsa popullsia po shkon duke u mplakur. Pas zbulimeve të mëdha gjeografike, nga ky regjion emigroi një numër i madh i njerëzve në vendet e pushtuara. Gjatë shekullit XX, regjioni bëhet një hapësirë e fuqishme imigruese për shumë arsye. Shtimi i ulët natyror rrit nevojën dhe kërkesat për fuqi punëtore, të cilën vendet e Evropës Perëndimore e sigurojnë përmes imigrimit. Në Britani të Madhe, Francë dhe shtetet e Beneluxit jetojnë dhe punojnë një numër i madh i emigrantëve nga vendet e ndryshme të Evropës Jugore, Afrikës dhe Azisë Jugperëndimore. Nga këto të fundit, popullsia shpërngulet dhe tenton të arrijë në Evropë Perëndimore edhe për shkak të situatës jostabile politike, varfërisë dhe urisë së skajshme, konflikteve dhe luftërave qytetare etj.

Popujt e Evropës Perëndimore kanë nivel të lartë të kulturës, shkallë të ulët deri në zero të analfabetizimit, nivel të lartë të urbanizimit dhe standard të lartë jetësor. Pjesa dërrmuese e popullsisë është e punësuar në industri dhe veprimtari të tjera jobujqësore. Në bujqësi janë të angazhuar më pak se 10 % e popullsisë. Megjithatë popullsia bujqësore është e shkolluar dhe e përgatitur për zhvillimin e bujqësisë intensive.

Pasuritë natyrore dhe zhvillimi ekonomik



Xhejms Vati

Kontakti i Evropës Perëndimore me oqeanin Atlantik ua mundësoi vendeve të saj ta zhvillonin detarinë dhe tregtinë. Përmes detit, ata zbuluan, pushtuan dhe krijuan koloni në të katër anët e botës. Në Britaninë e Madhe, e cila ishte fuqia më e madhe koloniale në botë, për herë të parë fillojnë të zhvillohen marrëdhëniet kapitaliste, kurse pasuritë e shumta natyrore të thëngjillit, hekurit dhe lëndëve të tjera të para të importuara nga jashtë nxisin zhvillimin e industrisë. Në fund të shekullit XVIII dhe fillim të shekullit XIX, në Britani të Madhe bëhen disa zbulime të rëndësishme teknike dhe teknologjike, të cilat e përparojnë dhe modernizojnë në masë të madhe prodhimtarinë industriale.

Ndër zbulimet më të rëndësishme janë makina me avull, fillimi i përdorimit të thëngjillit si lëndë djegëse për përfitim të energjisë, makina për tjerje dhe ende etj. Makina me avull mundëson lindjen dhe zhvillimin e trafikut hekurudhor, i cili mundëson bartjen më të shpejtë dhe më të lirë të njerëzve dhe mallrave. Në vitin 1825, në Britani të Madhe ndërtohet hekurudha e parë. Nëpër të lëviz lokomotiva me avull, e cila lidh qytetin e Stoktonit dhe atë të Darlingtonit. Industria bashkëkohore e këtij regjioni bazohet në aplikimin e madh të gjetjeve të fundit shkencore dhe arritjeve tekniko-teknologjike.

? Kush e ka zbuluar makinën me avull?

Përdorimi i thëngjillit, naftës dhe xeheve të hekurit mundësoi zhvillimin e metalurgjisë së zezë, të makinave, kimike, të anijendërtimtarisë, të tekstilit, industrisë elektronike, të automobilave etj.



132

Edhe pse në bujqësi angazhohet një numër i vogël i popullsisë, ajo është intensive dhe bashkëkohore. Kujtojmë se në Britaninë e Madhe me bujqësi merret vetëm 3 % e popullsisë, në Belgjikë 4 %, kurse në Holandë 5 %. Aplikimi i mjeteve agroteknike dhe njohurive të fundit shkencore mundëson arritjen e rendimenteve të larta. Si rrjedhojë krijohen teprica të prodhimeve bujqësore të cilat eksportohen në regjionet e tjera të Evropës dhe më gjerë. Veprimtari shumë të rëndësishme ekonomike dhe fitimprurëse janë edhe detaria dhe tregtia. Shtetet e Evropës Perëndimore kanë flota të mëdha detare përmes të cilave zhvillojnë tregtinë me vende të ndryshme të botës. Janë të zhvilluara të gjitha format e komunikacionit tokësor, ujor dhe ajror. Porti i Roterdamit në grykëderdhjen e lumit Rajna është më i madhi në botë.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Marrëdhëniet pyetje-përgjigje**

Mësimdhënësi/ja përdor metodën e pyetjeve të ndryshme për ta ushtruar hartën e Evropës Perëndimore në përgjithësi.

Mësimdhënësi/ja parashtron pyetje, nxënësi/ja përgjigjet në mënyrë individuale. Përgjigjet duhen shoqëruar me dmostrim në hartë.


- Bëni përkufizimin e Evropës Perëndimore përmes hartës.
- Arsye toni në hartë pozitën gjeografike.
- Duke përdorur hartën/atlasin trego vendet në nivelin e detit në Evropën Perëndimore.

Vazhdohet me pyetje të tjera.



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatim i të nxënit
Organizues grafik i analogjisë**

Përmes pemës së mendjes do të përsërisim njohuritë e marra. Nxënësit e plotësojnë atë në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të angazhimit në hartë, pyetjeve dhe përgjigjeve të dhëna saktë gjatë orës mësimore dhe analizimit të çështjes mësimore rreth Evropës Perëndimore.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Perëndimore – shtetet

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:

I. 1; 2; 3 4, 6; II. 1 ,2 ;3, 4, 5, ;8. III. 1, 3, 4; 5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Britania e Madhe

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Përkufizon Britaninë e Madhe dhe identifikon shtetet që e përbëjnë atë;
- Vlerëson veçoritë natyrore dhe shoqërore të saj;
- Arsyeton zhvillimin ekonomik të saj.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë gjeografike, atlas, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësve

Stuhi mendimesh

Nxënësve iu kërkohet që të mendojnë për pak çaste në bazë të shtrirjes gjeografike dhe veçorive natyrore të Britanisë,



Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore është shteti më i madh ishullor i kontinentit të Evropës. Ajo përfshin ishullin e Britanisë së Madhe, pjesën veriore të ishullit të Irlandës dhe një numër të madh të ishujve më të vegjël, si: Shetlandet, Orkinet, Hebridet etj. Në perëndim del në oqeanin Atlantik, ndërsa në lindje kufizohet me Detin Verior. Nga pjesa kontinentale e Evropës ndahet përmes kanalit të La Manshit. Gjiret, bregdeti i lartë shkëmbor i klifeve, fjordet dhe estuaret e shumta e bëjnë vijën bregdetare të Britanisë së Madhe mjaft të përblyer. Relievi i Britanisë së Madhe është modëruar nga veprimtaria e akullnajave. Në perëndim e fundit të akullzimit, këto akullnaja ishin lëshuar deri te lumi Temza, ndërsa sot, gjurmët e tyre hasen më shumë në Skoci. Në relievin e saj dallojmë Britaninë e Lartë. Edhe pse quhet e tillë, malet nuk janë edhe aq të larta. Kërcë në veri shtrihen malet Grempien. Maja më e lartë e kësaj zone dhe e gjithë Britanisë së

Madhe është Ben-Nevisi, me 1,345 m dhe ndodhet në Skoci. Në jug të tyre shtrihen malet Penine, të cilat janë më të ulëta se 1,000 m. I takojnë grupit të maleve mollake dhe janë të pasura me thëngjill dhe xehe të hekurit. Në perëndim shtrihen malet Kambrike. Të gjitha këto male janë vazhdimësi e atyre të Irlandës. Tek Irlanda dominon relievi kodrinor dhe malor i ulët, ndërmjet të cilit ndodhen fushat pjellore. Britania e ulët përfshin ultësirat në jug dhe perëndim të ishullit. Ultësira më e madhe është ajo e basenit të Londrës.

Qyteti më i madh dhe kryeqyteti i Britanisë së Madhe është Londra me rreth 7 milionë banorë, ndërsa zona aglomeruese e Londrës ka 14 milionë banorë. Është zhvilluar në grykëderdhjen e lumit Temza.

Në afërsi të Londrës ndodhen edhe dy qendrat e vjetra universitare, e Oksfordit dhe e Kembrixhit, të themeluara 800 vjet më parë. Qendrat më të mëdha industriale në veriperëndim të Anglisë janë Mançestri, Liverpuli dhe Lidsi. Në brigjet jugore të Uellsit është zhvilluar Kardifi, qendër e madhe e anijendërtimitarisë, ndërsa qendrat më të mëdha të Skocisë janë Edinburgu dhe Glasgovi.

! Me rëndësi të dihet

- Në Edinburg ndodhen shtatë parqe teknologjiko-shkencore, të cilat merren kryesisht me hulumtime bioteknologjike. Më i njohuri ndër ta është Roslin Biocentre, ku është klonuar kafsha e parë, delja Dolly.
- Universiteti i Kembrixhit, i themeluar në vitin 1209, është universiteti më i vjetër në botë.
- Irlanda Veriore ndryshe quhet edhe Alsteri (Ulster), edhe pse treva historike e Alsterit ka një sipërfaqe më të madhe sesa Irlanda e sotme.
- IRA është armata republikane (irlandeze) katolike, e cila ka luftuar për ta bashkuar Irlandën Veriore me Republikën e Irlandës. Qeveria britanike dhe ajo irlandeze pas disa vjetësh negociata kanë arritur që në vitin 2005 ta çarmatosin këtë armatë.
- "Qytete globale" janë ato qytete, të cilat kanë rëndësi të përmasave botërore. Në Evropë këtë epitet e kanë Londra, Parisi, Brukseli, Berlini, Madridi, Vjena, Frankfurti në Majnë, Moska, Barcelona, Cyrihu, Amsterdami, Gjeneva, Milano, Kopenhaga, Dablino, Budapesti, Praga dhe Varshava. Të gjitha këto qytete janë seli të organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe të kompanive multinacionale sikurse edhe bërthama të mëdha demografike, financiare, të biznesit, shërbimeve, industrisë dhe komunikacionit.

? Pyetje

1. Cilat janë tërësitë kryesore gjeografike të Britanisë së Madhe?
2. Përmendi lumenjtë më të gjatë të Britanisë së Madhe.
3. Cilët popuj kanë prejardhje keltë?
4. Çka është smogu dhe si krijohet ai?
5. Përmendi disa nga përmendoret më të njohura kulturore dhe historike të Londrës.

më pas mësimdhënësi/ja përmbledh shkurtimisht njësinë mësimore, kurse nxënësit identifikojnë në atlaste pozitën gjeografike, përkufizimin dhe veçoritë natyrore - shoqërore të Britanisë së Madhe në pika të shkurtra.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Ditari dypjesësh**

Arsimtari udhëzon nxënësit që ta lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht. Derisa nxënësit lexojnë, mësimdhënësi/ja shënon në tabelë disa pyetje, ku nxënësit, pas leximit, i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se i plotësojnë pyetjet e parashtruara.

Pyetje	Komente
Sa është sipërfaqja e Britanisë?	
Cilat shtete e përbëjnë BM-në?	
Çfarë klime ka?	
Trego lumenjtë kryesorë.	



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatim i të nxënit
Paragraf shpjegues**

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë një paragraf në fletoret e tyre të klasës me temën "Britania- veçoritë natyrore dhe shoqërore", duke përdorur atlasin.

Ata do të shkruajnë rreth Britanisë nga njohuritë që kanë marrë gjatë orës mësimore dhe duke e përdorur atlasin gjeografik. Më pas, 2 apo 3 nxënës e lexojnë atë që kanë shkruar.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të angazhimit në hartë, punës individuale në identifikimin e shteteve, vlerësimin se si janë zhvilluar këto shtete dhe shkrimin e lirë.

Detyrë:

Iu përgjigjen pyetjeve në librin bazë, fq. 137.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Perëndimore – shtetet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 3 4, 6; II. 1 ,2 ;3, 4, 5, ;8. III. 1, 3, 4; 5,;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Irlanda

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Irlandës;
- Identifikon popujt dhe kulturat e këtij shteti;
- Shpjegon nivelin e lartë të zhvillimit ekonomik në këtë vend.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike e Evropës, atlas, laptop, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit (2-3 prej tyre) do ta përsërisin njësinë e kaluar për Britaninë, kjo pasi edhe Irlanda gjendet brenda Britanisë



Rritja e shpejtë e ekonomisë irlandeze në shekulin XX në botë njihet si çudi ekonomike dhe i jep këtë vendi epitetin e "Tigrin kelt". Pas dy dekadave të rritjes marramendëse ekonomike, prej vitit 2007 shfaqen treguesit e parë të frenimit dhe rritjes më të ngadalshme ekonomike të Irlandës. Degët më të rëndësishme industriale janë ato që aplikojnë teknologji të avancuara si ato të informatikës dhe të telekomunikacionit, industria e kompjuterave, elektronike, e instrumenteve, medicinale, industria farmaceutike etj. Të ardhurat më të mëdha Irlanda i fiton prej veprimtarive shërbyese. Në veçanti vlen të theksohen bankat, ku përveç bankave vendore, aty kanë selitë edhe shumë banka nga ShBA-ja dhe vendet evropiane. Bukuritë natyrore, mjedisi i pastër dhe ekologjik, si dhe trashëgimia e pasur kulturore kanë mundësuar zhvillimin e turizmit. Qendra më e madhe dhe kryeqendra e Irlandës është Dublini, i cili në gjuhën irlandeze quhet Baile Atha Cliatha.



139

dhe do të bëhet një ndërlidhje temash; më pas, në bazë të njohurive paraprake, ata do të japin disa mendime dhe opinione që i dinë më herët rreth Irlandës.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Të nxënësit me këmbime - Grupet e ekspertëve

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup do të bëhet ekspert i pjesës që do t'i jepet për detyrë. Ata do ta lexojnë në grup, do ta diskutojnë, do ta përvetësojnë dhe do ta përgatisin për ta prezantuar para të tjerëve.

Grupi 1: Pozita gjeografike;

Grupi 2: Relievi;

Grupi 3: Klima;

Njëjtë vazhdohet edhe me grupet e tjera.

Secili grup përvetëson njohuritë e pjesës së vet dhe i transmeton ato te të tjerët në mënyrën më të mirë.



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënësit**

Krijoni mendimin tënd

Nxënësit udhëzohen ta shikojnë një dokumentar me vendet më atraktive për Irlandën dhe parashtojnë ndonjë pyetje apo tregojnë ndonjë karakteristikë për Irlandën që ata dinë më herët.

<https://www.bing.com/videos/riverview/relatedvideo?&q=irlanda+english+documentary&&mid=-234F11A1FE83DDFB4740234F11A1FE83DDFB4740&&FORM=VRD GAR>

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të angazhimit në hartë, pyetjeve dhe përgjigjeve të dhëna saktë gjatë orës mësimore dhe analizimit të çështjes mësimore rreth Irlandës.

Detyrë:

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

Për mësimdhënësin/en

Mësimi 50

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Perëndimore – shtetet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 3 4, 6; II. 1 ,2 ;3, 4, 5, ;8. III. 1, 3, 4; 5,;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Franca

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon shtetin dhe analizon pozitën gjeografike;
- Përshekruan rajonin sipas specifikave natyrore e shoqërore;
- Arsyeton zhvillimin ekonomik duke e ndërlidhur me turizmin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë gjeografike, atlas, tabelë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi para nxënësve paraqet hartën fizike të Evropës së Mesme, duke u folur atyre pak për këtë vend.






Portreti i Mona Lizës

? Si quhet muzeu i njohur ku ruhet portreti i Mona Lizës?

Marseji është qyteti i dytë për nga madhësia në Francë. Atë e kanë themeluar fenikasit rreth 600 vjet para erës sonë. Lioni është një e madhe e komunikacionit dhe qendra më e madhe industriale e krahinës së Ronë-Saonës. Ka të zhvilluar industrinë e teknologjisë së lartë dhe atë kimike. Qyteti ka trashëgimi të pasur kulturore dhe historike dhe është qendër turistike e rajonit. Qytete të tjera të mëdha të Francës janë edhe Lile, Bordo, Nansi, Strazburi, Tuluzi etj.



Lioni



Strazburi

Mësimdhënësi bën disa pyetje për të nxitur interesim të nxënësve për mësim, si:

1. Çfarë pozite gjeografike ka Franca?
2. Cilat lloje të klimës i hasim në Francë?

.....
Për t'u përgjigjur në pyetje përdoret ndihma e hartës dhe e atlasit.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Sistemi ndërveprues i shënimeve (INSERT)

Udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë e re duke i përdorur shenjat e INSERTIT (√). Pastaj diskutojnë me radhë se cilat informata ishin të njohura, cilat të reja dhe sqarohen pyetje nga mësimdhënësi, të shënuara nga nxënësit.

√	+	-	?
Informacion i njohur	Informacion i ri	Informacion që ndryshon nga ai që di	Sqarime për informacionin



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatim i të nxënët**
Rrjet i diskutimit

Për të reflektuar rreth temës, nxënësit do të tregojnë:

- 3 – tri gjëra të reja që mësuam;
- 2 – dy gjëra që duhen mbajtur mend për ekonominë dhe turizmin e Francës;
- 1 – një gjë që i bën kureshtarë të dinë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të angazhimit në hartë, pyetjeve dhe përgjigjeve të dhëna saktë gjatë orës mësimore dhe angazhimit në diskutim për ekonominë dhe turizmin në Francë.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, faqe 66 – 67.

● *Reflektim për rojedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Perëndimore – veçoritë natyrore dhe shoqërore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon pozitën gjeografike, rëndësinë e detit për jetën dhe luftën e njerëzve me të dhe rëndësinë e Oqeanit dhe rrymës së Golfit në klimë dhe jetën e njerëzve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I. 1; 2; 3, 4, 6; 8 II. 1, 2; 3, 4, 5, 6, 8. III. 1, 3, 4; 5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Aktivitet – Evropa Perëndimore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikimi i saktë i regionit të Evropës Perëndimore dhe i shteteve të saj;
- Analizë e hartës së Evropës Perëndimore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta e Evropës, atlas, fleta, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Teknologjia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Veprimtari praktike


Mësimdhënësi përgatit nga një hartë memece të Evropës për secilin nxënë dhe u shpërndan atyre. Në projektor



Franca me pozitën e saj gjeografike dhe daljen e saj të gjerë në oqeanin Atlantik bën pjesë në shtetet e Evropës Perëndimore. Ajo meqenëse me një bregdet relativisht të gjatë del edhe në detin Mesdhe është edhe shtet i Evropës Mesdhetare, ndërsa depërtimi i Alpeve Perëndimore në pjesën juglindore të saj i jep asaj epitetin edhe të shtetit alpin.

Tërësitë kryesore të relievit ultësor të Francës janë ultësira bregdetare, baseni i Parisit, i Akuitanit dhe Ronë-Saonës, të cilat së bashku përbëjnë 60 % të territorit francez. Masivi Qendror, Vozezet, Ardenet, trevat kodrinore të Bretanjës e Normandisë janë male mollake, të cilat për nga vjetërsia i takojnë moshës së paleozoikut. Në juglindje ngrihen vargmalet e reja të Alpeve, mbi to mali i vjetër shkëmbor i Jurës, kurse në jugperëndim ndodhen Pirinejet.


Në kufirin ndërmjet Francës dhe Italisë ndodhet maja Mont Blank (4.810 m) dhe është maja më e lartë brenda kufijve politikë të Evropës. Në aspektin klimatik, pjesa dërrmuese e Francës ndikohet nga masat ajrore të oqeanit Atlantik me shumë lagështi dhe reshje gjatë tërë vitit. Prandaj klima është atlantike me vera të lagështa e të ngrohta dhe dimra të butë.



Portreti i Mona Lizës

? Si quhet muzeu i njohur ku ruhet portreti i Mona Lizës?

Marseji është qyteti i dytë për nga madhësia në Francë. Atë e kanë themeluar fenikasit rreth 600 vjet para erës sonë. Lioni është një e madhe e komunikacionit dhe qendra më e madhe industriale e krahinës së Ronë-Saonës. Ka të zhvilluar industrinë e teknologjisë së lartë dhe atë kimike. Qyteti ka trashëgimi të pasur kulturore dhe historike dhe është qendër turistike e rajonit. Qytete të tjera të mëdha të Francës janë edhe Lille, Bordo, Nansi, Strazburi, Tuluzi etj.



Lioni



Strazburi

paraqitet harta e Evropës në tërësi dhe nxënësit, në mënyrë individuale, e kanë për detyrë të vizatojnë kufirin ndarës të Evropës Perëndimore.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Aktivitet në grupe

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe, për secilin shtet të Evropës Perëndimore nga një grup.

Ata kanë për detyrë të ngjyrosin shtetin e grupit të tyre në hartën memece me ngjyrë të kuqe, kurse pjesën tjetër të regjionit me të kaltër, dhe të shkruajnë për gjërat kyçe që e veçojnë atë shtet.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënës

Prezantimi i punimit

Nxënësit prezantojnë shtetin e tyre dhe lexojnë shkrimin me karakteristikat e shtetit që kanë pasur.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të angazhimit në hartë, pyetjeve dhe përgjigjeve të dhëna saktë gjatë orës mësimore dhe prezantimit të punimit.

Detyrë:

Plotëso fletore pune, nga faqe 62 – 64.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Perëndimore – shtetet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre,

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 3 4, 6; II. 1 ,2 ;3, 4, 5, ;8. III. 1, 3, 4; 5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Monako dhe Luksemburgu

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Monakos dhe Luksemburgut në Evropën Perëndimore,
- Identifikon popujt dhe kulturat e këtyre shteteve;
- Shpjegon nivelin e lartë të zhvillimit ekonomik në këto shtete.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlas, hartë, projektor, laptop, foto.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi para nxënësve paraqet hartën fizike të Evropës Perëndimore, duke u folur atyre pak për këtë vend. Mësimdhënësi bën disa pyetje për të nxitur interesim të nxënësve për mësim, si:



Monakoja është principatë e cila shtrihet në hapësirën e ngushtë bregdetare të gjatë rreth 3 km dhe të gjerë deri 1 km. Hapësira urbane e Monakos është me dendësi shumë të madhe të banimit. Ajo është e ndarë në lagje, ndër të cilat më e njohura është Monte Karloja, ku ndodhen hotele të shumta e vila luksoze. Lagjia më e vjetër dhe njëherësh kryeqyteti i principatës është Monakoja. Kjo principatë kultivon lidhje të ngushta me Francën për shkak të gjuhës dhe shumicës së popullsisë, e cila është me origjinë franceze. Veprimtaritë kryesore nga të cilat realizohet pjesa më e madhe e të ardhurave janë turizmi dhe tregtia.



Harta e Luksemburgut

Luksemburgu është një nga shtetet më të vogla të Evropës i cili deri në vitin 1890 ishte në kuadër të Holandës. Ka një shkallë shumë të lartë të zhvillimit ekonomik. Ai e zë vendin e parë në Evropë me bruto-prodhimin shoqëror për kokë banori. Gjuhë zyrtare në Luksemburg janë frëngjishtja, gjermanishtja dhe gjuha letzeburge, e cila është dialekt i gjuhës gjermane me elemente gjuhësore të frëngjishtes dhe është rezultat i pozitës së Luksemburgut në kufirin e gjuhëve gjermane dhe atyre romane. Mbi një të tretën e popullsisë e përbëjnë të huajt, ku më së shumti ka portugezë, francezë, belgë, gjermanë etj.



Kryeqyteti i Luksemburgut, Luxembourg - Ville

152

Industria është zhvilluar në sajë të pasurive të xehes së hekurit nga e cila prodhohet çeliku. Për shkak të shterjes së xeheroreve dhe rënies së çmimit të çelikut në tregun botëror, industria kohën e fundit gjithnjë e më tepër po orientohet kah degët që aplikojnë teknologji të larta. Qendra më e madhe dhe kryeqendra është vetë Luksemburgu. Është një qendër e rëndësishme ekonomike, universitare, kulturore dhe turistike e vendit. Aty ndodhet selia e Gjyqit Evropian të Drejtësisë, Bankës Evropiane për Investime, Parlamentit Evropian, prandaj është një qendër e rëndësishme politike dhe ndërkombëtare.

1. Çfarë pozite gjeografike kanë këto shtete?
2. Në cilat zona jetojnë më shumë njerëzit dhe pse?
3. Si ka ardhur deri te zhvillimi ekonomik i këtyre vendeve dhe me çfarë merren?



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Diagrami i Venit

Nxënësit ndahen në grupe dyshe (sipas bankës) dhe i ndajnë detyrat që ua cakton mësimmshënësi/ja dhe i komentojnë në tabelën e vizatuar në fletoret e tyre të klasës.

Nxënësi 1 i shkruan karakteristikat e Monakos, kurse nxënësi 2, në tabelën tjetër i shkruan karakteristikat e Luksemburgut, më pas në mes i shkruajnë të përbashkëtat së bashku.



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Shpjegim i përparuar**

Mësimmshënësi/ja paraqet përmes slajdeve nga një foto për secilin grup, kurse nxënësit, atë që e kanë lexuar nga teksti dhe komentuar në fletore e shpjegojnë duke e lidhur me fotot që paraqiten në slajde.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për angazhimin gjatë orës dhe saktësinë e përgjigjeve që japin duke përcaktuar pozitën gjeografike në hartë, duke indentifikuar popujt dhe kulturat e këtyre vendeve dhe mënyrën e shpjegimit se si janë zhvilluar ekonomisht këto shtete.

Detyrë:

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Perëndimore – shtetet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I. 1; 2; 3 4, 6; II. 1 ,2 ;3, 4, 5, ;8. III. 1, 3, 4; 5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Belgjika

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon shtetin dhe analizon pozitën gjeografike;
- Përshruan regjionet sipas specifikave natyrore e shoqërore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë gjeografike, atlas, tabelë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
"DI"

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të tregojnë se çfarë dinë ata rreth popullsisë në botë. Pas çdo informacioni që ata theksojnë se dinë, dalin dhe e shkruajnë në tabelë te rubrika "DI".




Belgjika, së bashku me Holandën dhe Luksemburgun, përmes bashkimit të doganave, që nga viti 1947 kanë krijuar një tërësi të përbashkët ekonomike që quhet Beneluks. Ajo ka pozitë shumë të volitshme gjeografike pasi del në Detin Verior, ndërsa në afërsi të saj rrjedh Rajna, e cila paraqet rrugën më të rëndësishme lumore në Evropë. Dominon relievi ultësor i cili në perëndim përfundon me malet e ulëta mollake të Ardeneve. Klima është e lagësht atlantike me lagështi të madhe dhe reshje të shumta. Belgjika me 340 b/km² është një nga shtetet me dendësinë më të madhe në Evropë, ndërsa me 97 % të popullsisë urbane ajo është një ndër vendet me shkallën më të lartë të urbanizimit në botë. Popullsinë e Belgjikës e përbëjnë flamanët dhe valonët. Të parët janë të prejardhjes gjermane dhe jetojnë në veri të vendit, kurse të dytët janë fise kelte të romanizuara, të ngjashëm me francezët dhe jetojnë në jug të Belgjikës. Në lindje të Belgjikës jeton edhe pakica autoktone gjermane. Përveç tyre, në Belgjikë jeton edhe një numër i konsiderueshëm i të huajve, nga të cilët më të numërt janë italianët, marokenët, turqit etj. Gjuhë zyrtare janë gjuha flamane (holandeze) dhe gjuha valone (frënge), ndërsa në lindje flitet edhe ajo gjermane.

Belgjika është vend shumë i zhvilluar industrial. Përparimin dhe zhvillimin e lartë Belgjika e ka arritur në saje të pozitës së volitshme gjeografike dhe përparësive që i ofron dalja në det, pasurive të shumta të xeheve të thëngjillit dhe hekurit, si dhe shfrytëzimit të pasurive koloniale në të kaluarën. Sot Belgjika është një shtet i fuqishëm bujqësor. Ka të zhvilluar mjaft pëmetarinë dhe perimtarinë, ndërsa sipërfaqe po ashtu të konsiderueshme janë të mbjella më drithëra, bimë industriale dhe foragjere. Përveç lavëtarisë, e ka të zhvilluar edhe blegtorinë, në veçanti rritjen e gjedhëve të mishit e qumështit. Qendra më e madhe dhe kryeqyteti i Belgjikës është Brukseli. Është një e madhe e komunikacionit, qendër e madhe kulturore dhe seli e shumë organizatave botërore. Në të ndodhet selia e Bashkimit Evropian dhe e NATO-s. Antverpeni është porti kryesor i Belgjikës dhe një ndër më të mëdhenjtë në Evropë. Është i vendosur në estuarin e lumit Shelda, i cili është i lundrueshëm dhe përmes kanaleve është i lidhur edhe me Rajnën dhe Mezën.



Brukseli - kryeqyteti i Belgjikës



Kanali i Albertit që lidh lumin Shelda në Antverpen dhe lumin Meza në Liezh.

Pyetje

1. Çka është Beneluxi dhe kur është krijuar ai?
2. Çfarë male janë Ardenet dhe ku shtrihen ato?
3. Cilat janë gjuhët zyrtare në Belgjikë?
4. Cili është porti më i madh i Belgjikës?

148

Di	Dua të di	Mësova
- Ka dalje ne detin e Veriut. - Kryeqytet e ka Brukselin. - Në Belgjikë ndodhet selia e NATO – s. - Ky shtet kufizohet me Francën dhe Holandën		



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

"Dua të di"

Nxënësit parashtrojnë pyetje rreth popullsisë së botës ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj mësimdhënësit. Të gjitha i vendosin në rubrikën "Dua të Di".

Di	Dua të di	Mësova
- Ka dalje ne detin e Veriut. - Kryeqytet e ka Brukselin. - Në Belgjikë ndodhet selia e NATO – s. - Ky shtet kufizohet me Francën dhe Holandën.	- Cilët popuj jetojnë? - Me çka merren popullsia e këtij vendi? - Cila seli ndodhet në Belgjikë? - Me çfarë pasurish natyrore cilësohet?	

Më pas, nxënësit e lexojnë njësinë mësimore në heshtje.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

"Mësova"

Pasi që nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore, ata shpjegojnë pjesë-pjesë mësimin që mësuuan gjatë orës.

Di	Dua të di	Mësova
- Ka dalje ne detin e Veriut. - Kryeqytet e ka Brukselin. - Në Belgjikë ndodhet selia e NATO – s. - Ky shtet kufizohet me Francën dhe Holandën.	- Cilët popuj jetojnë? - Me çka merret popullsia e këtij vendi? - Cila seli ndodhet në Belgjikë?	- Flamanët dhe Valonët. - Bujqësi dhe Industri. - Selia e BE-së. - Me thëngjill dhe hekur.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke e pasur parasysh saktësinë në përgjigje për pozitën gjeografike, veçoritë natyrore e shoqërore – ekonomike.

Detyrë:

Iu përgjigjen pyetjeve në librin bazë, fq. 148

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Perëndimore – shtetet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I. 1; 2; 3 4, 6; II. 1 ,2 ;3, 4, 5, ;8. III. 1, 3, 4; 5,;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Holanda

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Holandës;
- Analizon specifikat natyrore e shoqërore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta e Evropës, atlas gjeografik, laptop, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Asociacion

Mësimdhënësi/ja, për të ngritur kureshtjen dhe koncentrimin te të gjithë nxënësit, njësinë mësimore e fillon me një asociacion të shkurtër të paraqitur në projektor dhe, në këtë mënyrë, ata vetë do ta gjejnë njësinë mësimore që do zhvillojnë sot.



Harta e Holandës

Porti i Roterdamit



Holanda, së bashku me Belgjikën dhe Luksemburgun e përbëjnë unionin doganor dhe ekonomik të Beneluxit. Për shkak të pozitës së volitshme gjeografike, Holanda shumë herët e ka zhvilluar detarinë dhe tregtinë. Gjatë shekullit XVI dhe XVII, ajo ka qenë fuqia më e madhe detare në botë, përmes së cilës ajo ka arritur të krijojë një perandori të madhe koloniale sidomos me kolonitë e saj në Azinë Juglindore.

Relievi i Holandës është ultësinor, ndërsa në bregdet ai është nën nivelin e detit. Megjithatë, qysh nga shekulli XVII, me punën e palodhshme, holandezët kanë arritur të thajin detin e cekët duke zgjeruar hapësirën bregdetare në drejtim të detit. Tokat e reja, të krijuara nga shterria e ujit të detit, janë shndërruar në hapësira shumë pjellore, të cilat quhen poldere. Klima është me lagështi oqeanike dhe rrjetin hidrografik e përbëjnë Rajna me degët e saj, Meza dhe Shelda si dhe shumë kanale ujore. Holanda është një nga shtetet me dendësi më të madhe të popullsisë në Evropë ku mbi 90 % e popullsisë jetojnë në qytete. Pjesën më të madhe të popullsisë e përbëjnë holandezët me prejardhje gjermane.

Zhvillimi ekonomik i Holandës bazohet në tregtinë ndërkombëtare dhe të ardhurat nga shërbimet që ofrojnë portet. Shumë shtete evropiane, por më së shumti Gjermania dhe Zvicra, shfrytëzojnë portet holandeze për bartjen e mallrave të tyre në destinacionet e shumta tejoqeanike. Në tokat e poldereve është zhvilluar pemëtaria dhe perimtaria, ndërsa këto toka njihen për mbjelljen dhe kultivimin e luleve, sidomos të tulpanëve. Blegtoria e Holandës është e zhvilluar në një nivel shumë të lartë, prandaj ajo është një prodhuese e madhe e produkteve të qumështit dhe të mishit.



Mullinjte e erës në Holandë

Kultivimi i tulpanëve

Pjesa dërrmuese e industrisë ndodhet në perëndim të vendit, ndërmjet qyteteve të Roterdamit, Hagës dhe Amsterdami. Kapacitetet industriale janë të lidhura ngushtë me portet ku është ngritur industria petrokimike, e cila mbështetet në përpunimin e naftës dhe gazit natyror të importuar. Industria elektronike, e anijendërtimitarisë si dhe ajo e përpunimit të diamanteve. Qendra më e madhe dhe kryeqendra e Holandës është Amsterdami, i cili po ashtu është qendër e madhe kulturore, universitare dhe turistike e Holandës. Qyteti i Den Hagës është selia politike e vendit, meqenëse aty ndodhen parlamenti, qeveria dhe Gjyqi Ndërkombëtar i Drejtësisë. Përmes kanaleve ujore ky qytet lidhet me Amsterdamin dhe Roterdamin. Në grykëderdhje të lumit Rajna është zhvilluar qyteti i Roterdamit.

A	B	C	D
Polderet	Beneluksi	Mullinjte e erës	Tulipanët
HOLANDA			



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Ditari dypjesësh

Nxënësit lexojnë tekstin. Në tabelë shënohen disa pyetje, ku nxënësit, pas leximit, i plotësojnë me ato fragmente.

Pyetje	Komente
1. Çka nënkupton me fjalën Beneluksi?	Bashkimin e 3 shteteve, BE – Belgjikë, NE – Netherland, Luks – Luksemburg.
2. Kush quhet poldere?	Tokat nën nivelin e detit (ujit).
....	



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Paragraf përshkrues

Nxënësit do të bëjnë një paragraf përshkrues për Holandën, duke përdorur vetëm atlasin dhe fletoren e tyre. Më pas, disa nga nxënësit e lexojnë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të saktësisë së përgjigjeve që kanë dhënë gjatë orës mësimore, duke identifikuar gjërat më të rëndësishme në Holandë, për saktësinë e përgjigjeve në asociacion dhe shkrimin e lirë.

Detyrë:

Iu përgjigjen pyetjeve në librin bazë, fq. 151

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Perëndimore – veçoritë natyrore dhe shoqërore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon pozitën gjeografike, rëndësinë e detit për jetën dhe luftën e njerëzve me të dhe rëndësinë e Oqeanit dhe rrymës së Golfit në klimë dhe jetën e njerëzve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 3, 4, 6; 8 II. 1, 2; 3, 4, 5, 6, 8. III. 1, 3, 4; 5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime: Evropa Perëndimore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon pozitën gjeografike për çdo shtet veç e veç;
- Identifikon shtetet dhe kryeqytetet e Evropës Perëndimore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë dhe atlas gjeografik

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Evropa Perëndimore - veçoritë natyrore



Deri para periudhës së zbulimeve të mëdha gjeografike, ky region i Evropës kishte pozitë të skajshme dhe ishte larg rrugëve kryesore detare të cilat e përshkonin detin Mesdhe. Pas zbulimit epokal të kontinentit të ri, përkundrazi që u bë një kthesë e madhe shoqërore dhe u ndryshuan perceptimet e gabuara për formën dhe madhësinë e Tokës, fillon e rritet rëndësia komunikative e qyteteve dhe vendeve që dalin në oqeanin Atlantik. Nga kjo kohë, prej porteve detare të Evropës Perëndimore nisnin ekspeditat e shumta pushtuese dhe kolonialiste, të cilat pushtojnë vende dhe popuj në të katër anët e botës, duke i dhënë këtij regjioni pozitë qendrore në kuadër të rrugëve lundruese botërore. Evropa Perëndimore ka sipërfaqe prej 936.000 km² ose 9% nga sipërfaqja e përgjithshme e Evropës.



Vija bregdetare e Evropës Perëndimore është mjaft e përtëyer. Kjo përtëryhmëri e madhe, përveç të tjerash, është edhe rezultat i estuareve të shumta, të cilat janë gryka të përmytura lumore që janë krijuar nga ulja e kores së Tokës. Estuaret krijohen gjatë shfaqjes së baticave dhe zbatave. Gjatë baticave, të cilat në këtë bregdet ngrihen edhe deri në 15 m, uji i detit depërton nëpër estuare dhe ngrë nivelin e ujit në lumenj. Prandaj gjatë baticës edhe anijet e mëdha oqeanike mund të futen thellë në brendësi të kontinentit. Valët e larta që ngrihen në oqeanin Atlantik, në shumë pjesë të bregdetit kanë formuar brigje të larta e të pjerrëta shkëmbore të cilat quhen klife.

? Gjej në hartë se cilat porte janë ngritur në estuaret e lumenjve.



Klif në bregdetin e Evropës Perëndimore



Pamje satelitore e estuarit të Temzes

Tërësitë kryesore të relievit të Evropës Perëndimore janë Ultësira e Evropës Perëndimore, malet mollake të Britanisë së Madhe, Ardenet në Belgjikë, Vogezet dhe Masivi Qendror

në Francë, Pirinejet dhe Alpet vetëm me pjesët e skajshme të tyre hyjnë në kuadër të këtij regionit të Evropës. Ultësira e Evropës Perëndimore shtrihet përgjatë brigjeve të oqeanit Atlantik. Kjo ultësirë është e ndërprerë nga rrjedhat e lumenjve të gjatë të Evropës. Disa pjesë të kësaj ultësire ndodhen nën nivelin e detit. Të tilla janë brigjet e Holandës. Këto pjesë të tokës quhen **depressione** dhe shtrihen ndërmjet bemeve ranore në perëndim, të cilat pengojnë depërtimin e ujit të detit dhe relievit të valëzuar e bregor në lindje të vendit. Holandezët janë një popull shumë i vyeshëm të cilët zhvillojnë një "luftë shekullore" me detin. Këtë "luftë" ata kanë arritur ta fitojnë duke ndërtuar përgjatë brigjeve të detit me mijëra kilometra bemeve ranore dhe penda mbrojtëse. Duke hequr ujin, ata kanë tharë moçatet dhe pjesët e ulët të detit, duke i shndërruar ato në "polderë". Polderet janë toka të thara në të cilat holandezët zhvillojnë bujqësinë intensive.

Klima e Evropës Perëndimore

Klima e Evropës Perëndimore është nën ndikimin e fuqishëm të oqeanit Atlantik. Rryma e Golfit e cila kalon përkaj brigjeve të Evropës Perëndimore sjell me vete ujin e ngrohtë të oqeanit i cili e zbut klimën. Prandaj, në pjesën dërrmuese të këtij regionit, klima është e lagësht dhe e butë. Moti gjatë pjesës dërrmuese të vitit është me vranësira, i lagësht dhe me shi, ndërsa për shkak të lagështisë së madhe dukuri e shpeshtë janë edhe mjegullat. Kështu, për shembull, në Irlandë, mesatarisht gjatë vitit, 260 ditë janë të vrenjtura dhe me shi, kurse në Holandë, rreth 200 ditë gjatë vitit kanë mot të vrenjtur dhe me shi. Verat janë të freskëta, dimrat e butë, ndërsa bora arrin të mbulojë vetëm malet më të larta. Në Alpe, për shkak të lartësisë, ndodhen akullnajat, kurse në brigjet e Mesdheut klima është mesdhetare.

129

Në fillim të orës mësimore, mësimdhënësi/ja ua kontrollon nxënësve detyrat e shtëpisë.

Pastaj u kalon fjalën 2 – 3 nxënësve të harta e Evropës Perëndimore, dhe përsërisin pozitën gjeografike të shteteve që janë diskutuar në orët e kaluara.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Rrethi i pyetjeve

Mësimdhënësi/ja krijon një rreth me nxënës të mes të klasës. Kërkohej nga nxënësit që të shikojnë këmbët e tyre dhe, kur mësuesja thotë "tash", ata ngulin sytë te njëri nga nxënësit që kanë përballë. Dy nxënës që ndeshin shikimet e tyre te njëri-tjetri, do t'i bëjnë nga një pyetje që lidhet me Evropën Perëndimore njëri-tjetrit dhe do të duhet të përgjigjen në ato pyetje. Ai nxënës që nuk e di përgjigjen largohet nga rrethi. Kjo vazhdon derisa të mbesin dy nxënësit e fundit.



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatim i të nxënës

Veprimtari praktike me përdorimin e hartës

Mësimdhënësi e përmend një numër të ditave dhe ai nxënës do ta përmendë një shtet dhe një numër; numri të cilin e përmend, do ta thotë kryeqytetin e atij shteti dhe do të dalë te harta për ta gjetur. Kështu vazhdon për të gjitha shtetet e Evropës Perëndimore.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të angazhimit në hartë, pyetjeve dhe përgjigjeve të dhëna saktë gjatë orës mësimore dhe analizimit të çështjes mësimore rreth Evropës Perëndimore.

Detyrë:

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore – veçoritë natyrore

Rezultatet e të nxënit të temës: Analizon pozitën gjeografike;
 Vlerëson ndikimin e detit dhe të klimës në këtë rajon; Përshkruan relievin dhe arsyet shkaqet e lumenjve të shkurtër, sasi të madhe uji e fuqi energjetike, dhe numrin e madh të liqeneve; - Dallon ndërrimin e bimësisë dhe kafshëve nga veriu në jug.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 3, 4, 6; 8 II. 1, 2 ;3, 4, 5, 6, 8. III. 1, 3, 4; 5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2., 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa Veriore dhe Verilindore (shtetet baltike) – veçoritë natyrore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan relievin, ujërat dhe botën e gjallë;
- Analizon pozitën gjeografike të Evropës Veriore e Verilindore;
- Vlerëson ndikimin e detit dhe të klimës në këtë rajon.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta e Evropës, atlas gjeografik, fotografi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë para-prake

Nxënësit analizojnë hartën e Evropës Veriore dhe Verilindore. Më pas iu shtrohen pyetje:

Evropa Veriore dhe Verilindore – veçoritë natyrore



Fjord në Norvegji

Evropa Veriore, përfshirë vendet baltike, përfshin ekstremin verior dhe verilindor të Evropës. Veçohet me gjerësi të madhe gjeografike. Pika më jugore ndodhet në gjerësi gjeografike veriore 54°, ndërsa pika më veriore është Kepi Nordkap 71°. Evropa Veriore dhe Verilindore kanë dalje në Detin e Veriut, të Norvegjisë, Baltik. Pozita gjeografike veriore ka ndikuar në kushtet më të ftohta klimatike, ku dominojnë temperatura më të ulëta, dimra të ftohtë, akullnaja të përhershme. Derisa Dani-


marka, së bashku me vendet baltike, janë terrene fushore, Finlanda është rrafshnaltë, ndërsa Norvegjia, Suedia dhe Islanda dallohen për terrenet malore. Në Norvegji e Suedi shtrihen malet skandinave; male të vjetra, të cilat sot janë sheshuar nga faktorët e jashtëm, në veçanti nga akullnajat, ku në viset bregdetare janë krijuar fjorde të shumta - lugina të thella, të rripëritë në zonën bregdetare. Islanda është ishulli më i madh i Evropës Veriore dhe nga më të mëdhenjtë në gjithë Evropën. Ka origjinë vullkanike, ku sot hasen vullkane aktive, tërmete, gejzerë etj.



Harta fizike e Evropës Veriore dhe Verilindore

Evropa Veriore njihet për dallime të mëdha në klimë. Edhe pse ndodhet në gjerësi të mëdha, rryma oqeanike e Golfit ndikon që regjioni të ketë klimë më të butë, në veçanti në zonat përgjatë bregdetit. Regjioni në pjesën më të madhe të tij ka klimë oqeanike - me reshje gjatë gjithë vitit, vranësira të shumta, temperatura jo shumë të ulëta në dimër. Në viset me gjerësi më të mëdha (Islandë, Laponi) klima është subapolare me dimra shumë të ftohtë, erëra të fuqishme e të ftohta. Evropa Veriore njihet për liqenet e shumta, shumica prej të cilave kanë origjinë akullnajore. Në vendet e rrafshëta, moçalet janë të pranishme. Lumenjtë janë të shkurtër dhe rrjedhin në drejtim të deteve përreth, sikurse deti Baltik, i Veriut dhe i Norvegjisë. Të gjitha vendet e Evropës Veriore e Verilindore veçohen me sipërfaqe të mëdha të pyjeve. Në pjesën jugore të Evropës Veriore hasen pyjet gjethëbërëse, por më në veri hasen edhe pyjet gjethëbajtëse, të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm për zhvillimin e industrisë së drurit të vendeve nordike. Në cepin më verior, hasen tundra, kryesisht me myshqe dhe likene.

Evropa Veriore dhe Verilindore – veçoritë natyrore



Fjord në Norvegji

Evropa Veriore, përfshirë vendet baltike, përfshin ekstremin verior dhe verilindor të Evropës. Veçohet me gjerësi të madhe gjeografike. Pika më jugore ndodhet në gjerësi gjeografike veriore 54°, ndërsa pika më veriore është Kepi Nordkap 71°. Evropa Veriore dhe Verilindore kanë dalje në Detin e Veriut, të Norvegjisë, Baltik. Pozita gjeografike veriore ka ndikuar në kushtet më të ftohta klimatike, ku dominojnë temperatura më të ulëta, dimra të ftohtë, akullnaja të përhershme. Derisa Dani-

marka, së bashku me vendet baltike, janë terrene fushore, Finlanda është rrafshnaltë, ndërsa Norvegjia, Suedia dhe Islanda dallohen për terrenet malore. Në Norvegji e Suedi shtrihen malet skandinave; male të vjetra, të cilat sot janë sheshuar nga faktorët e jashtëm, në veçanti nga akullnajat, ku në viset bregdetare janë krijuar fjorde të shumta - lugina të thella, të rrëpirëta në zonën bregdetare. Islanda është ishulli më i madh i Evropës Veriore dhe nga më të mëdhenjtë në gjithë Evropën. Ka origjinë vullkanike, ku sot hasen vullkane aktive, tërmete, gejzerë etj.



Harta fizike e Evropës Veriore dhe Verilindore

Evropa Veriore njihet për dallime të mëdha në klimë. Edhe pse ndodhet në gjerësi të mëdha, rryma oqeanike e Golfit ndikon që regjioni të ketë klimë më të butë, në veçanti në zonat përgjatë bregdetit. Regjioni në pjesën më të madhe të tij ka klimë oqeanike - me reshje gjatë gjithë vitit, vranësira të shumta, temperatura jo shumë të ulëta në dimër. Në viset me gjerësi më të mëdha (Islandë, Laponi) klima është subapolare me dimra shumë të ftohtë, erëra të fuqishme e të ftohta. Evropa Veriore njihet për liqenet e shumta, shumica prej të cilave kanë origjinë akullnajore. Në vendet e rrafshëta, moçalet janë të pranishme. Lumenjtë janë të shkurtër dhe rrjedhin në drejtim të deteve përreth, sikurse deti Baltik, i Veriut dhe i Norvegjisë. Të gjitha vendet e Evropës Veriore e Verilindore veçohen me sipërfaqe të mëdha të pyjeve. Në pjesën jugore të Evropës Veriore hasen pyjet gjethërrënëse, por më në veri hasen edhe pyjet gjethëmbajtëse, të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm për zhvillimin e industrisë së drurit të vendeve nordike. Në cepin më verior, hasen tundra, kryesisht me myshqë dhe liqene.

153


- Çfarë pozite gjeografike mund të kenë këto pjesë dhe a dallojnë mes vete sa i përket pozites?
- Si është relievi i këtyre regjioneve?
- Cila pjesë ka më shumë male e cila fusha? etj.

Për t'u përgjigjur në këto pyetje, nxënësit përdorin hartën dhe atlasin.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Harta e koncepteve

Klasa ndahet në grupe dhe secilit grup do t'i jepet për detyrë të plotësojnë hartën e koncepteve. Pasi kryhet puna në grup, diskutohet me të gjitha grupet. Mësuesja plotëson hartën e koncepteve në tabelë me ndihmën e nxënësve.



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit Rrjet i diskutimit

Për të reflektuar rreth temës, nxënësit do të tregojnë:

3 – tri gjëra të reja që mësuam;

2 – dy gjëra që duhen mbajtur mend për Evropën Veriore e Verilindore;

1 – një gjë që i bën kureshtarë të dinë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të angazhimit në hartë, pyetjeve dhe përgjigjeve të dhëna saktë gjatë orës mësimore dhe analizimit të çështjes natyrore të Evropës Veriore e Verilindore.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 70 dhe 71.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore – veçoritë shoqërore - ekonomike

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Identifikon popujt që banojnë në këtë regjion dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike;

Nxjerr përfundime pozitive se si kanë arritur njerëzit nivelin e lartë të zhvillimit kulturor e ekonomik në kushte të vështira natyrore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 3, 4, II. 1, 2 ;3, 4, 8. III. 1, 3, 4; 5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2., 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa Veriore dhe Verilindore – veçoritë shoqërore-ekonomike

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Dallon në hartë shtetet e Evropës Veriore dhe Verilindore;
- Identifikon popujt që banojnë në këtë regjion dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta e Evropës, atlas gjeografik, fotografi, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Rikujtim i njohurive të kaluara

Evropa Veriore dhe Verilindore – veçoritë shoqërore dhe ekonomike

Në Evropën Veriore dhe Verilindore jetojnë popujt me origjinë gjermane (danezë, suedezë, norvegjezë, islandezë), ugrofine (finlandezë, estonezë, sami-laponë) dhe baltike (lituanezë dhe letonë). Shtetet nuk kanë numër të madh të popullsisë. Shteti më i madh me popullsi është Suedia (10.2 mil. banorë), ndërsa më i vogli është Islanda (355 mijë banorë). Dendësia më e madhe e popullsisë është më e madhe përgjatë bregdetit dhe në skajet jugore të vendeve përkatëse. Të gjitha shtetet njihen për shkallë të lartë të urbanizimit. Sistemi arsimor është nga më të avancuarit në botë. Të ardhurat për kokë banori janë nga më të lartat në botë.

Nga vendet e Evropës Veriore, Suedia njihet për prodhimin e automobilitave dhe çelikut cilësor. Norvegjia për hidroenergjë dhe peshkim, Islanda për gejzerë, vullkane e peshkim, Danimarka për prodhime blegtorale, Finlanda për prodhimin e letrës dhe celulozës, pajisjet telekomunikative, Estonia si vendi më digjital në Tokë. Derisa vendet nordike njihen për shkallë të lartë të zhvillimit ekonomik, vendet baltike kishin probleme pas pavarësimit të tyre nga Bashkimi Sovjetik (1991) në kalimin në ekonomi të tregut. Vende anëtare të Bashkimit Evropian janë: Suedia, Danimarka, Finlanda, Lituania, Letonia dhe Estonia. Të anëtarësuar në NATO janë: Danimarka, Islanda, Norvegjia, Lituania, Letonia dhe Estonia. Disa prej vendeve kanë pranuar euron si monedhë kryesore, si: Finlanda, Lituania dhe Letonia.

Pyetje

1. Përshkruaj pozitën gjeografike të vendeve të Evropës Veriore dhe Verilindore.
2. Tregoni cilat vende kanë reliev malor e cilat fushor.
3. Në cilat organizata janë të anëtarësuarat vendet e Evropës Veriore e Verilindore?

Evropa Veriore dhe Verilindore – veçoritë shoqërore dhe ekonomike

Në Evropën Veriore dhe Verilindore jetojnë popujt me origjinë gjermane (danezë, suedezë, norvegjezë, islandezë), ugrofine (finlandezë, estonezë, sami-laponë) dhe baltike (lituanezë dhe letonë). Shtetet nuk kanë numër të madh të popullsisë. Shteti më i madh me popullsi është Suedia (10.2 mil. banorë), ndërsa më i vogli është Islanda (355 mijë banorë). Dendësia më e madhe e popullsisë është më e madhe përgjatë bregdetit dhe në skajet jugore të vendeve përkatëse. Të gjitha shtetet njihen për shkallë të lartë të urbanizimit. Sistemi arsimor është nga më të avancuarit në botë. Të ardhurat për kokë banori janë nga më të lartat në botë.

Nga vendet e Evropës Veriore, Suedia njihet për prodhimin e automobilitave dhe kullon cilësor, Norvegjia për hidroenergjë dhe peshkim, Islanda për gejzerë, vullkane e peshkim, Danimarka për prodhime blegtorale, Finlanda për prodhimin e letres dhe celulozës, pajisjet telekomunikative, Estonia si vendi më digjital në Tokë. Derisa vendet nordike njihen për shkallë të lartë të zhvillimit ekonomik, vendet baltike kishin probleme pas pavarësimit të tyre nga Bashkimi Sovjetik (1991) në kalimin në ekonomi të tregut. Vende anëtare të Bashkimit Evropian janë: Suedia, Danimarka, Finlanda, Lituania, Letonia dhe Estonia. Të anëtarësuar në NATO janë: Danimarka, Islanda, Norvegjia, Lituania, Letonia dhe Estonia. Disa prej vendeve kanë pranuar euron si monedhë kryesore, si: Finlanda, Lituania dhe Letonia.



Pyetje

1. Përshkruaj pozitën gjeografike të vendeve të Evropës Veriore dhe Verilindore.
2. Tregoni cilat vende kanë reliev malor e cilat fushor.
3. Në cilat organizata janë të anëtarësuar vendet e Evropës Veriore e Verilindore?

154



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Ditari dypjesësh


Arsimtari/ja udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin në heshtje dhe individualisht. Deri sa nxënësit lexojnë, arsimtari/ja shënon në tabelë disa pyetje, ku nxënësit, pas leximit, i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

Pyetje	Komente
1. Trego shtetet e Evropës Veriore e Verilindore.	
2. Pse quhen shtete baltike e nordike?	
3. Çfarë origjine kanë popujt e këtyre vendeve?	



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit *Organizues grafik*

Nxënësit do të plotësojnë shtetet e Evropës Veriore e Verilindore në rrrathë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të angazhimit dhe pyetjeve e përgjigjeve të dhëna saktë gjatë orës mësimore rreth Evropës Veriore e Verilindore, sidomos në pjesën e dytë, dhe për organizuesin grafik.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore – shtetet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur dallimet dhe ngjashmëritë mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 3, 4, 6; 8 II. 1, 2 ;3, 4, 5, 6, 8. III. 1, 3, 4; 5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Suedia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Suedisë;
- Analizon veçoritë natyrore dhe shoqërore të Suedisë;
- Shpjegon nivelin e zhvillimit të lartë ekonomik.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta e Evropës, atlas gjeografik, tabelë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
 "DI"

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të tregojnë se çfarë dinë rreth popullsisë në botë. Pas çdo informacioni që ata theksojnë se dinë, dalin dhe e shkruajnë në tabelë te rubrika "DI".

Suedia

Sipërfaqja: 449.964 km²
 Popullsia: 10.2 milionë
 Kryeqyteti: Stokholmi

Suedia është shteti më i madh skandinav dhe vendi i katërt më i madh në Evropë me sipërfaqe. Së bashku me Norvegjinë ndajnë Gadishullin Skandinav. Ka shtrirje të gjatë veri-jug. Në aspektin relievor mund të ndahet në katër tërësi: veriu që është kryesisht malor, me pyje dhe lumenj të gjatë; qendror që është fushor me liqene të shumta dhe jugor që përfshin Smalandin me kodra të pyllëzuara dhe më jugorin që përfshin "Skane"-n (Skania) ku haset tokë pjellore. Malet skandinave që shtrihen në Suedi kanë lartësi deri 2.111 m. Terreni pjerrësohet në drejtim të juglindjes.

Edhe pse ndodhet në gjerësi të mëdha gjeografike, oqeani ka ndikim të madh në klimën e Suedisë. Temperatura mesatare e janarit në Stokholm është -5 °C, ndërsa e korrikut është 18 °C. Në klimën e Suedisë ka dallime të mëdha ndërmjet jugut dhe verit. Në veri hasen dimra të gjatë deri në 7 muaj, kurse vera të freskëta deri në 3 muaj. Reshjet mesatare vjetore janë rreth 600 mm. Suedia njihet për numër të madh të liqeneve (rreth 100.000) që gjenden gjithandej nëpër vend. Origjina e tyre është akullnajore. Më të mëdhenjtë janë: Venern, Vetern dhe Malaren që janë ndër liqenet më të mëdha në Evropë. Për shkak të kushteve klimatike, lumenjtë janë të shumtë dhe rrjedhin në drejtim të juglindjes. Dalohen për ujëvara të shumta dhe gryka të ngushta. Pjesa më e madhe e Suedisë është e mbuluar me pyje. Përhapje të madhe kanë pyjet gjethebabjtëse, kurse nga llojet kryesore janë mështekna, bredhi, pisha, plepi etj., që shërbejnë si lëndë e parë në industrinë e drurit. Suedezët janë popull skandinav me origjinë gjermane. Në veri hasen laponët. Rreth 12 % e popullsisë përbëhet nga të huajt. Popullsia jeton kryesisht nga jugu i vendit, në afërsi të bregdetit. Rreth 85 % e popullsisë jeton në qendra urbane. Suedia është vend me industri të zhvilluar.

Harta e Suedisë


155

Kalimi nga bujqësia në industri nisi që nga vitet '30 dhe u zhvillua me shpejtësi pas Luftës së Dytë Botërore. Njihet për prodhimet industriale me kualitet të lartë, prodhimin e makinave, çelikut cilësor. Rreth 6 % e sipërfaqes është tokë bujqësore, në të cilën angazhohet rreth 2 % e popullsisë. Pyjet zënë rreth 70 % të sipërfaqes dhe luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e industrisë së drurit në vend. Është ndër eksportuesit më të mëdhenj të letërës në botë. Standardi jetësor në Suedi është nga më të lartët në botë. Dallohet për arsimimin cilësor, jetëgjatësinë e madhe të njerëzve, shkallë të ulët të papunësisë. Sipas indeksit të zhvillimit njerëzor, gjithmonë radhitet ndër vendet e para në botë. Suedia për një kohë të gjatë, ka eksportuar lëndë të parë ose gjysmëprodukte në drejtim të vendeve industriale, por sot, Suedia i kthen në produkte finale vetë, përfshirë motorë, pajisje elektronike, çelik, mobilie, qelq etj. Shumica e këtyre produkteve janë të bazuara në resurse lokale, përfshirë rezerva të shumta të hekurit në Kiruna e cila gjendet në pjesën veriore të vendit. Manufaktura suedeze në krahasim me atë të vendeve perëndimore evropiane është e përqendruar në qytete të mesme dhe të vogla, ku në shumicën e rasteve është e specializuar në produkte të caktuara. Suedia ishte pioniere në zhvillimin e energjisë bërthamore, por me debate të shumta për rrezikun e kësaj energjie ka ndryshuar qasje. Suedia është anëtare e BE-së që nga viti 1995, por ka refuzuar hyrjen në eurozonë.



Fabrika moderne e Volvo-së

Eksportet kryesore të Suedisë janë pajisjet telekomunikative, medicinale, farmaceutike, hekuri dhe çeliku, pajisje transporti, letër etj., ndërsa importon lëndë të parë industriale, lëndë konsumi, naftë etj. Suedia është vendi me ndikimin më të madh në Evropën Veriore. Historikisht, Suedia ka dominuar Norvegjinë dhe Danimarkën. Qytetet më të njohura në Suedi janë: Stokholmi (kryeqytet), Goteborgu, Malmoja, Uppsala etj.



Stokholmi - kryeqyteti Suedisë

156

Di	Dua të di	Mësova
- Ka dalje në detin Baltik - Kryeqytet e ka Stokholmin. - Ky shtet kufizohet me Norvegjinë dhe Finlandën. - Gjendet në gadishullin Skandinav.		



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
"Dua të di"

Nxënësit parashtrojnë pyetje rreth popullsisë së botës, ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj mësimdhënësit. Të gjitha i vendosin në rubrikën "Dua të Di".

Di	Dua të di	Mësova
- Ka dalje në detin Baltik. - Kryeqytet e ka Stokholmin. - Ky shtet kufizohet me Norvegjinë dhe Finlandën. - Gjendet në gadishullin Skandinav.	- Sa banor jetojnë? - Me çka merret popullsia e këtij vendi? - Çfarë klime ka ky shtet? - Me çfarë pasurish natyrore cilësohet?	

Më pas, nxënësit e lexojnë njësinë mësimore në heshtje.



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënës
"Mësova"

Pasi që nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore, shpjegojnë pjesë-pjesë mësimin që mësuuan gjatë orës.

Di	Dua të di	Mësova
- Ka dalje në detin Baltik. - Kryeqytet e ka Stokholmin. - Ky shtet kufizohet me Norvegjinë dhe Finlandën. - Gjendet në gadishullin Skandinav.	- Sa banorë jetojnë? - Me çka merret popullsia e këtij vendi? - Çfarë klime ka ky shtet? - Me çfarë pasurish natyrore cilësohet?	- Jetojnë mbi 10 milionë banorë. - Telekomunikacion dhe industri. - Selia e BE-së. - Subpolare dhe kontinentale.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke e pasur parasysh saktësinë në përgjigje për pozitën gjeografike, veçoritë natyrore e shoqërore-ekonomike.

Detyrë:

Përgjigjiuni pyetjeve në faqe 157, në librin bazë.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore – shtetet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur dallimet dhe ngjashmëritë mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 3, 4II. 1, 2; 3, 6, . III. 1, 3, 4; 5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Norvegjia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Norvegjisë;
- Identifikon popujt dhe kulturat e këtij shteti;
- Shpjegon nivelin e lartë të zhvillimit ekonomik në këtë vend.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta gjeografike e Evropës, atlas, laptop, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë


Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit diskutojnë për njësinë e kaluar për Suedinë, kjo pasi edhe Suedia gjendet brenda Gadishullit Skandinav, dhe do të bëhet një ndërlidhje temash. Më pas, në bazë të njohurive paraprake, ata do të japin disa mendime dhe opinione që i dinë më herët rreth Norvegjisë.



Harta e Norvegjisë

Norvegjia ndodhet në anën perëndimore të Gadishullit Skandinav, me dalje në oqeanin Atlantik. Relievi është kryesisht malor, me maja të thepisura, të modeluara nga akullnajat. Maja më e lartë është Galdhøpiggen (2469 m). Malet u modeluan në formë të rrafshnaltave nga akullnajat. Norvegjia është e famshme për numrin e madh të fjardeve të modeluara nga akullnajat, që e bëjnë gjatësinë e vijës bregdetare (22000 km) nga më të gjatat në Tokë. Fjordet futen thellë në tokë duke mundësuar porte natyrore. Në brendi të vendit ndodhen rreth 1700 akullnaja. Vetëm 20 % e sipërfaqes ndodhet në lartësi nën 150 m. Një pjesë e madhe e vendit shtrihet në veri të rrethit polar verior. Një pjesë prej lumenjve burojnë nga shkrija e akullnajave. Lumenjtë janë turbulentë, kanë lugina të ngushta dhe gryka shkëmbore. Glama është lumi më i gjatë (563 km) në Skandinavi. Rol të rëndësishëm për norvegjezët ka Deti i Veriut, jo vetëm për ndikim në klimë, por edhe në veprimtaritë ekonomike. Norvegjezët janë të lidhur ngushtë me detin. Vija bregdetare është e përthyer, me ishuj dhe fjorde të shumta. Në veri të Norvegjisë ndodhet Nordkapi, që paraqet pikën më veriore të Evropës. Ujërat e nxehta të Rymës së Golfit kanë ndikuar në klimën e Norvegjisë. Edhe pse ndodhet në gjerësi të mëdha gjeografike, klima është mesatare. Jugu është më i nxehtë se veriu, ashtu sikurse perëndimi është më i nxehtë se lindja. Temperaturat lëvizin ndërmjet - 7 °C dhe - 2 °C në janar, deri në 13 °C dhe 22 °C në korrik. Në pjesën veriore të vendit, gjatë verës, paraqiten ditët polare, kur Dielli nuk perëndon fare për 24 orë dhe e kundërta ndodh nga nëntori deri në janar, kur paraqitet nata polare dhe Dielli nuk lind fare.



Osloja - kryeqyteti i Norvegjisë

Pyjet zënë rreth 27 % të sipërfaqes. Kryesisht janë pyje gjettherënëse, po hasen edhe halorët më në veri. Në skajin më verior hasen tundra, kryesisht me myshqe dhe likene. Për dallim nga Suedia e cila është dashur të zhvillojë energjinë nukleare, Norvegjia ka shfrytëzuar burime afër detit dhe në lumenj. Industria e peshkimit në Norvegji është tani e fokusuar në ferma të peshkimit duke qenë bazë e rëndësishme e ekonomisë së vendit, kur tregtarët e shumtë janë zgjeruar nëpër botë. Që nga vitet '70, ekonomia e Norvegjisë është transformuar në një vend me standard të lartë jetësor falë naftës dhe gazit natyror që u zbuluan në Detin

e Veriut. Me sipërfaqe të kufizuara të tokës bujqësore, reliev të lartë, pyje të shumta, pjesën veriore me klimë të ftohtë, fjarde të shumta, Norvegjia nuk ka asgjë për t'u krahasuar me zhvillimin industrial e bujqësor të Suedisë. Qytetet norvegjeze si: Osloja, Trondheimi, Bergen, deri te Hamarfesti arktik shtrihen përgjatë detit. Brenda e vendit, edhe pse malore, ka lidhje të mira komunikative. Norvegjia ka të organizuar edhe flotën detare, e cila është ndër më të mëdhatë në botë.



Qendra e Nobellit në Oslo

Norvegjia është gati vend homogjen. Norvegjezët, pasardhës të popujve gjermanë, janë shumicë. Provinca e veriore e Finmarkut është e izoluar, në të cilën jetojnë popujt sami (laponët), të cilët merren me kultivimin e drerëve. Shpërndarja e popullsisë norvegjeze (5 milionë banorë) i ngjan një "qaforeje" ku popullsia është e koncentruar përgjatë bregdetit. Norvegjia karakterizohet nga shtetet me përqindjen më të vogël të popullsisë në Evropë dhe njëherësh ndër vendet me të ardhurat më të larta në Evropë dhe botë.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Marrëdhëniet pyetje-përgjigje**

Kërkohet nga nxënësit të lexojnë temën. U kërkohet që të nxjerrin shënime me informacionet kyçe të temës. Pastaj ndahen ata në dy grupe për të hapur diskutimin me temën "Pyetje dhe përgjigje".

Pyetje	Përgjigje
Çfarë pozite gjeografike ka Norvegjia dhe me kë kufizohet ajo?	
Shpjegoni relievin e saj?	
Çfarë klime ka dhe sa dallon nga vendi në vend?	
Si ka arritur ta zhvillojë ekonominë në këtë standard kaq të lartë?	



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatim i të nxënit
Krijë mendimin tënd**

Nxënësit udhëzohen ta shikojnë një dokumentar me vendet më atraktive për Norvegji dhe parashtojnë ndonjë pyetje, apo tregojnë ndonjë karakteristikë për Norvegjinë, që ata dinë më herët.

<https://www.bing.com/videos/riverview/relatedvideo?&q=norvegjia&&mid=4F1E77F281A22DD220274F1E-77F281A22DD22027&&FORM=VRDGAR>

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në bazë të angazhimit në hartë, pyetjeve dhe përgjigjeve të dhëna saktë gjatë orës mësimore dhe analizimit të çështjes mësimore rreth Norvegjisë.

Detyrë:

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore – shtetet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur dallimet dhe ngjashmëritë mes tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; 2; 3, 4II. 1, 2; 3, 6, . III. 1, 3, 4; 5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke, 2.1 dhe 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Danimarka

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson pozitën gjeografike të Danimarkës, lidhjen me shtetet e tjera dhe rëndësinë që i jep pozita;
- Analizon veçoritë natyrore – shoqërore të Danimarkës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Harta e Evropës, atlas gjeografik, fotografi dhe të dhëna nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Nxënësve iu parashtrihen disa pyetje nga mësimdhënësi, në mënyrë që t'i nxisë ata të mendojnë rreth pozitës gjeografike të Danimarkës dhe, në bazë të njohurive paraprake që ata kanë marrë, mund të japin disa mendime për pozitën gjeografike të këtij shteti. Mësimdhënësi/ja merr disa mendime dhe i shkruan në tabelë.




Kopenhaga - kryeqyteti i Danimarkës

Krahasuar me vendet e tjera skandinave, Danimarka ka territor më të vogël. Ka popullsi prej 5.8 milionë banorësh dhe në vendet nordike zë vendin e dytë pas Suedisë. Përbëhet nga gadishulli Jutland dhe ishuj të shumtë, ku ndërmjet tyre kalojnë rrugët që lidhin detin Baltik me oqeanin Atlantik. Në ishullin Sjaelland është i vendosur kryeqyteti - **Kopenhaga**, që shërben si port i rëndësishëm i mbledhjes së mallrave dhe transportit të tyre në gjithë botën. Këtë funksion, Kopenhaga e ka për faktin se anijet e mëdha nuk mund të hyjnë në ujërat e cekëta të Baltikut. Me ndërtimin e urës Oresund, lidhja me jugun e Suedisë i ka shtuar rëndësinë e pozitës gjeografike të Kopenhagës.

Danimarka është mbretëri, ku dominimi i saj në të kaluarën i ka kaluar kufijtë e shtetit. Grenlanda është nën qeverisjen e Danimarkës. Në vitin 1953, statusi i Grenlandës u ndërrua nga kolonia në provincë. Danimarka është anëtare e Bashkimit Evropian që nga viti 1973. Grenlanda është shumë e varur financiarisht nga Danimarka. Pas shumë hulumtimeve, nafta është gjetur në bregun perëndimor të Grenlandës. Nën udhëheqjen e Danimarkës janë edhe Ishujt Faroe, të cilët gjenden ndërmjet Skocisë dhe Islandës. Janë rreth 17 ishuj të vegjël, me popullsi prej 50000 banorësh, të cilëve u është garantuar vetëqeverisja që nga viti 1948, por nuk kanë pavarësi të plotë nga Danimarka. Mbretëria e Danimarkës është mbretëria më e vjetër në Evropë. Ekziston që nga shekulli X. Danezët u takojnë popujve gjermanë. Në territoret e administruara nga Danimarka, përveç danezëve, jetojnë edhe faroët dhe inuitët (eskimo). Në jug të vendit jetojnë gjermanët, ndërsa nga migrantët jetojnë turqit, iranianët, somalezët etj. Danimarka tradicionalisht ka qenë vend agrar. Që nga Lufta e Dytë Botërore filloi zhvillimi i manufakturës që sot kontribuon me shumë në bujqësinë në të ardhurat kombëtare.



162 Prodhimi i energjisë nga era në Danimarkë



Bujqësia intensive në Danimarkë



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Të nxënësit me këmbime - Grupet e ekspertëve

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup do të bëhet ekspert i pjesës që do t'i jepet për detyrë. Ata do ta lexojnë në grup, do ta diskutojnë, do ta përvetësojnë dhe e përgatisin për ta prezantuar para të tjerëve.

Grupi 1: Pozita gjeografike;

Grupi 2: Relievi;

Grupi 3: Klima;

Njëjtë vazhdohet edhe me grupet e tjera.

Secili grup ka për detyrë të përvetësojë njohuritë e pjesës së vet dhe t'i shpjegojë ato të tjerët në mënyrën më të mirë.

Më pas argumentohen ato mendime dhe arsyetohet pozita e mirë gjeografike e Danimarkës.



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatim i të nxënësve Organizues grafik

Nxënësit do të plotësojnë një organizues të përgjithshëm për Danimarkën.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për angazhimin gjatë orës dhe saktësinë e përgjigjeve që japin, duke përcaktuar pozitën gjeografike në hartë, dhe mënyrën e analizimit të veçorive natyrore dhe shoqërore të shtetit.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 75 dhe 76.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë natyrore; Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë shoqëro-ekonomike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon pozitën gjeografike, veçoritë natyrore, shoqërore dhe lidhjen e tyre në zhvillimin ekonomik të Finlandës

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Finlanda

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon shtetin e Finlandës;
- Identifikon prej hartës/atlasit elementet natyrore të Finlandës;
- Përshekruan strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore;
- Vlerëson ndërlidhjen e resurseve humane me pasuritë natyrore në zhvillimin ekonomik të Finlandës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomike të Finlandës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Stuhi mendimesh



Finlanda njihet si vend i pyjeve gjethembajtëse dhe liqeneve akullnajore, ku rol të rëndësishëm në të ardhurat kombëtare kanë luajtur eksportet e prodhimeve të drurit. Tani, finlandezët kanë ndërthur një ekonomi më të llojlojshme, duke përfshirë edhe drithërat dhe në veçanti manufakturën e makinerisë precize dhe pajisjeve telekomunikative. Finlanda dallohet për sistemin edukativo-arsimor nga më të mirët në gjithë botën. Turizmi është degë e rëndësishme, ku vend të posaçëm zënë sportet dimërore, kështjellat e akullit e në veçanti saunat (banjat me avull).

Sfidat mjedisore të Finlandës dhe pozita relative kanë krijuar një peizazh kulturor të ngjashëm me Suedinë dhe Norvegjinë, edhe pse finlandezët nuk janë popull skandinava; veçoritë gjuhësore dhe historike e lidhin me estonezët. Finlanda njihet për prodhimet e drurit dhe nënprodukteve të tij (përfshirë edhe letrën). Ndërsa, nga resurset minerale njihet për argjend, hekur, bakër, zink.

! Me rëndësi të dihet

- Laponia është krahinë e cila ndodhet në veri të Finlandës, Suedisë dhe Norvegjisë. Njihet edhe si vendbanimi i "Babadimit", Zyrat e "Babadimit" (Santa Klausit) ndodhen në qytetin Rovaniemi të Finlandës.

? Pyetje

1. Përshkruaj pozitën gjeografike të Finlandës.
2. Tregoni strukturën etnike (kombëtare) të Finlandës.
3. Cilat janë qendrat kryesore urbane në Finlandë?

165

Pyetje e mundshme:

Çka dini ose mendoni se dini për Finlandën?

Nxënësit ta përdorin atlasin gjeografik për t'i marrë informacionet rreth elementeve natyrore.

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Pyetja sjell pyetjen

Paraqitet video ose harta politike dhe fizike e Finlandës. Gjatë shikimit të videos ose të hartës, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:

1. Me cilat shtete kufizohet Finlanda?
2. Cilët ishin malet, fushat, lumenjtë, liqenet kryesore të saj?
3. Cilët tipa klimatikë i ka Finlanda?
4. Cilët popuj jetojnë në Finlandë?



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Paragraf argumentues

Kërkohet nga nxënësit që në mënyrë individuale të punojnë një paragraf, duke arsyetuar ndërlidhjen e resurseve natyrore dhe resurseve humane në zhvillimin ekonomik të Finlandës. Disa nga punimet lexohen nga nxënësit, pjesa e palexuar merret nga arsimtari dhe vlerësohet në shtëpi.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore, për përshkrimin e strukturave shoqërore dhe për vlerësimin e ndërlidhjes mes resurseve humane dhe natyrore në zhvillimin ekonomik.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 76 dhe 77, si dhe pyetjet faqe 165 te libri bazë

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë natyrore; Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë shoqëro-ekonomike

Rezultatet e të nxënimit të temës:
 Identifikon veçoritë natyrore dhe shoqërore të Islandës

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Islanda

Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:

- Identifikon prej hartës/atlasit elementet natyrore të Islandës;
- Përshkruan strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, elementeve natyrore dhe shoqëro-ekonomike të Islandës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Stuhi mendimesh

Pyetje e mundshme:
 Çka dini ose mendoni se dini për Islandën?
 Nxënësit ta përdorin atlasin gjeografik për t'i marrë informacionet rreth elementeve natyrore.

Islanda

Sipërfaqja: 103.000 km²
 Popullsia: 355 mijë
 Kryeqyteti: Reykjaviku

Është vendi më perëndimor i Evropës, i rrethuar në të gjitha anët nga oceani Atlantik. Ishulli ndërtohet nga rrafshnalta qendrore vullkanike me lartësi 700-800 m. Në aspektin gjeologjik, ishulli ndodhet në dy kontinente: Euroazia (lindje) dhe Amerika (perëndim). Përveç shkëmbinjve vullkanikë, ishulli mbulohet edhe nga akullnajat e përhershme. Për nga moshja, ishulli është i ri dhe akoma vazhdon krijimi i tij. Pjesa më fushore ndodhet në jug dhe në perëndim të vendit. Gërryerja akullnaje ka luajtur rol të rëndësishëm për krijimin e relievit, në veçanti të luginave lumore. Maja më e lartë në vend është **Oraefajokulli** (2119 m). Në Islandë ka vullkane aktive si Vetnajokulli, sipër të cilit është akullnaja më e madhe kontinentale në Evropë (sipërfaqja 8300 km², trashësia 1000 m). Islanda njihet si vend i vullkanëve, burimeve të nxehta, gezerëve, akullnajeve. Ka shumë liqene, të cilat kanë origjinë tektonike, vullkanike, akullnajeve. Për shkak të reshjeve, lumenjtë janë të shumtë. Thjorsa është një lumë i gjatë (237 km). Lumenjtë dallohen për ujën e pastër që vjen edhe nga shkërrja e akullnajeve. Nga erozioni akullnajor janë krijuar ujëvara të shumta.

Edhe pse gjendet në gjerësi të mëdha gjeografike (afër rrethit polar), klima është mesatare ku ndikim të madh ka rryma e Golfit. Temperatura mesatare e korrikut në Reykjavik është 11 °C, kurse në janar është -1 °C (sa e Prishtinës). Dimrat janë të gjatë, kurse verat të freskëta dhe të shkurtra.

166



Gullfoss -
ujëvare në
Islandë

Ishulli i Islandës filloi të banohej që në shekullin e 9-të, kur norvegjezët lundruan në drejtim të ishullit. Sot në Islandë jetojnë rreth 355.600 banorë. Vendi karakterizohet me dendësi të vogël të popullsisë. Dendësia më e madhe është në pjesën periferike të ishullit, në veçanti në pjesën perëndimore, ku ndodhet edhe kryeqyteti - Reykjaviku. Gjuha zyrtare është islandishtja, një gjuhë gjermanike

e cila ka ndryshuar shumë pak në 700 vitet e fundit për shkak të izolimit të ishullit. Ekonomia e Islandës dikur ishte e bazuar në bujqësi, ndërsa sot më tepër në industrinë e procesimit të peshkut. Islandezët merren me kultivimin e deleve dhe kuajve. Eksportet kryesore të vendit janë peshku dhe produktet e tij (60 %), alumini, pajisjet elektrike, veshmbathjet etj. Përparsi e jashtëzakonshme e vendit është prodhimi i energjisë nga energjia gjeotermale. Të ardhura të rëndësishme paraqesin turistët, të cilët vizitojnë vulkanet, gejzerët, akullnajat, ujëvarat etj.



Gejzeri
"Strokur"
në Islandë

Kultivimi i
deleve në
Islandë

167

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbytjes
Pyetja sjell pyetjen


Paraqitet video ose harta politike dhe fizike e Islandës. Gjatë shikimit të videos ose të hartës, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:

1. Cilat ishin malet, fushat, lumenjtë, liqenet kryesore të saj?
2. Cilët tipa klimatikë i ka Islanda?
3. Cilët popuj jetojnë në Islandë?



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënës
Organizues grafik

Në mënyrë individuale nxënësit përgatitin organizues grafik për Islandën – Pozita, elementet natyrore dhe shoqërore. Pastaj, secili në mënyrë individuale i shënon idetë e tij/saj në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore, për përshkrimin e strukturave shoqërore.

Detyrë:

Pyetjet faqe 168, te libri bazë.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë natyrore; Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë shoqërore ekonomike

Rezultatet e të nxënësve të temës: Krahason pozitën gjeografike, veçoritë natyrore, shoqërore dhe lidhjen e tyre në ekonominë e shteteve Skandinave

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime: Shtetet Skandinave

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Dallon prej hartës shtetet Skandinave;
- Identifikon prej hartës/atlasit elementet natyrore të tyre;
- Krahasaon strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore;
- Vlerëson ndërlidhjen e resurseve humane me pasuritë natyrore në zhvillimin ekonomik të Skandinave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomike të Shteteve Skandinave.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Diagrami i Venit

Mësimdhënësi u shpërndan nxënësve fletat të përgatitura me Diagramin e Venit me tre rrrathë, brenda rrrathëve të shënohen të veçantat për Norvegjinë, Suedinë dhe Finlandën, kurse në mes të shënohen të përbashkat e tri shteteve.





Gullfos -
ujëvarë në
Islandë

Ishulli i Islandës filloi të banohej që në shekullin e 9-të, kur norvegjezët lundruan në drejtim të ishullit. Sot në Islandë jetojnë rreth 355,600 banorë. Vendi karakterizohet me dendësi të vogël të popullsisë. Dendësia më e madhe është në pjesën periferike të ishullit, në veçanti në pjesën perëndimore, ku ndodhet edhe kryeqyteti - Rejkjaviku. Gjuha zyrtare është islandishtja, një gjuhë gjermanike

e cila ka ndryshuar shumë pak në 700 vitet e fundit për shkak të izolimit të ishullit. Ekonomia e Islandës dikur ishte e bazuar në bujqësi, ndërsa sot më tepër në industrinë e procesimit të peshkut. Islandezët merren me kultivimin e deleve dhe kuajve. Eksportet kryesore të vendit janë peshku dhe produktet e tij (60 %), alumini, pajisjet elektrike, veshmbathjet etj. Përparsi e jashtëzakonshme e vendit është prodhimi i energjisë nga energjia gjeotermale. Të ardhura të rëndësishme paraqesin turistët, të cilët vizitojnë vullkanet, gejzerët, akullnajat, ujëvarat etj.



Gejzeri
"Strokur"
në Islandë



Kultivimi i
deleve në
Islandë

Pasi ta kenë përfunduar detyrën në mënyrë individuale, mësimmhënësi i udhëzon që në mënyrë individuale t'i shënojnë idetë e tyre në tabelë.



Në këtë fazë të orës mësimmhënësi shtron pyetje: a ka rendësi struktura e popullsisë në zhvillimin ekonomik?

Nxënësit i shprehin dhe argumentojnë mendimet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore, për përshkrimin e strukturave shoqërore.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë natyrore; Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë shoqëro-ekonomike

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përkruan pozitën gjeografike, veçoritë natyrore dhe shoqërore të Estonisë, Letonisë dhe Lituaniës.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Estonia, Letonia dhe Lituania


Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon prej hartës /atlasit elementet natyrore të Estonisë, të Letonisë dhe të Lituaniës.
- Përkruan strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore të këtyre shteteve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqëro-ekonomike të Estonisë, të Letonisë dhe të Lituaniës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Historia.




Është republika më e vogël e shteteve baltike. Gjenet në pjesën verilindore të Evropës. Në lindje kufizohet me Rusinë, ndërsa në jug me Letoninë. Në perëndim e veri ka dalje në detin Baltik dhe gjirin e Finlandës. Në perëndim të vendit ndodhen mijëra ishuj të vegjël, ndërsa më i madhi është Sarema (2.714 km²). Estonia është vend fushor, me kodra mesatare. Lartësia më e madhe në vend është 318 m dhe ndodhet në juglindje në kufi me Rusinë. Dalja në detin Baltik ka ndikuar që Estonia të ketë klimë mesatare përkundër që shtrihet në gjerësi të mëdha gjeografike. Vera është e freskët me temperatura që arrijnë deri 18 °C, kurse dimrat janë të ftohtë. Sasia mesatare e reshjeve luhatet ndërmjet 500-700 mm. Shpeshherë, reshjet dhe shkrirja e borës ndikojnë në paraqitjen e vërshimeve në lumenj. Lumi më i gjatë është lumi Parnu (144 km). Rrjedh në drejtim të jugperëndimit në gjirin e Rigës. Rreth 20 % e sipërfaqes konsiderohet me moçale. Nga sipërfaqja e përgjithshme, 25 % është tokë e punueshme, ndërsa 11 % janë livadhe. Rreth 44 % e sipërfaqes është e mbuluar me pyje, kryesisht nga drurët e pishës, mëshhtëknës, lisit etj.

Estonia ka lidhje të ngushta kulturore e historike me Finlandën. Estonezët dhe finlandezët i takojnë të njëjtit grup të popujve - ugrofin. Dendësia më e madhe e popullsisë është në pjesën veriore. Rreth 73 % është shkalla e urbanizimit në vend. Rreth 1/3 e popullsisë jeton në kryeqytetin Talin. Qendra të tjera të rëndësishme janë Tartu (qendër kulturore dhe industriale) dhe Parnu (qytet bregdetar). Gjatë viteve 1940-1991, struktura demografike e Estonisë ka ndryshuar në mënyrë drastike.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Pyetje e mundshme:
 Çka dini ose mendoni se dini për shtetet Baltike; Estoninë, Letoninë dhe Lituanië?
 Nxënësit ta përdorin atlasin gjeografik për t'i marrë informacionet rreth elementeve natyrore dhe shoqërore.



Letonia është njëra nga republikat baltike, të cilat shtrihen në Evropën Verilindore, ndërmjet Estonisë në veri dhe Lituanisë në jug, Rusisë në lindje dhe Bjellorusisë në juglindje. Në perëndim ka dalje në detin Baltik. Vendi është i rrafshët dhe ndërtohet nga fusha e kodra të ulëta. Kodrat kanë origjinë akullnajore (morena) të modeluara gjatë periudhës akullnajore në Evropë. Rreth 10 % e sipërfaqes është nën nivelin e detit. Ka klimë mesatare, me vera të freskëta dhe dimra jo shumë të ftohtë. Ndikim të madh në klimë kanë masat e ajrit, të cilat vijnë nga deti Baltik. Reshjet mesatare vjetore janë rreth 600 mm. Për shkak të masave të ajrit me origjinë detare, vetëm 72 ditë gjatë vitit në Riga ka diell, kurse 180 ditë të tjera janë me shi. Lumi më i rëndësishëm në Letoni është *Dougava* (Dvina). Burimet e lumit janë në Rusi dhe rrjedh në drejtim të gjirit të Rīgës. Lumi është burim i rëndësishëm për prodhimin e hidroenergjisë. Moçalet hasen gjithandej vendit dhe mbulojnë rreth 10 % të sipërfaqes.

Tereni i rrafshët është i përshtatshëm për bujqësi. Pjesa më e rëndësishme agrare është zona qendrore. Reshjet e shumta nënkuptojnë drenimin e ujit të tepërt nga toka, andaj janë realizuar kanale të shumta kullimi. 46 % e sipërfaqes mbulohet nga pyjet, kryesisht pishë, bredh, mështekën etj., të cilat edhe eksportohen jashtë vendit. Letonia është shtet multietnik, ku letonët përbëjnë pjesën më të madhe të popullsisë (62 %), pastaj rusët (25 %), bjellorusët (2 %), ukrainasit (2 %) dhe të tjerët. Pas pavarësisë, tensionet ndërmjet letonezëve dhe rusëve u nxitën.

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Të nxënësit me këmbime- Grupet e ekspertëve.


Në fillim klasa ndahet në grupe të vogla fillestare, p.sh. (1, 2, 3), (1, 2, 3), (1, 2, 3); në raste të tjera ky varg vazhdon. Më pas ftohen nxënësit t'i hapin librat, por para se të ftohen të lexojnë, mësimdhënësi formon grupet e ekspertëve me njëshet nga të gjitha grupet, po ashtu formohet një grup me dyshet dhe një me treshet (ky varg mund të vazhdojë). Njësheve iu jepet pjesa e parë, Estonia; dysheve pjesa e dytë, Letonia; dhe tresheve pjesa e tretë, Lituania. Të gjithë nxënësit lexojnë pjesët e veta, t'i mësojnë ato pjesë, të diskutojnë në grupet punuese dhe më pastaj të kthehen në grupet dhe shpjegojnë pjesët e njësheve, të dysheve dhe të tresheve.



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatim i të nxënit**

Diagrami i Venit afik

Mësimdhënësi u shpërndan nxënësve fletat të përgatitura me Diagramin e Venit me tre rrahë. Brenda rrethit të shënohen të veçantat për Norvegjinë, Suedinë dhe Finlandën, kurse në mes të shënohen të përbashkëtat mes tri shteteve. Nxënësit shënojnë idetë e tyre në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore dhe për përshkrimin e strukturave shoqërore.

Detyrë:

Pyetjet në faqe 174 te libri bazë, dhe libri i punës faqe 78 deri 80.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë natyrore; Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë shoqëro-ekonomike

Rezultatet e të nxënësve të temës:
 Krahason pozitën gjeografike, veçoritë natyrore dhe shoqëro-ekonomike të Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Aktivitet: Evropa Veriore (Shtetet Baltike)

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Dallon prej hartës shtetet Baltike;
- Identifikon prej hartës/atlasit elementet natyrore të tyre;
- Krahason strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore;
- Vlerëson ndërlidhjen e resurseve humane me pasuritë natyrore në zhvillimin ekonomik të shteteve Baltike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqëro-ekonomike të shteteve të Evropës Veriore- Shtetet Baltike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësve
 Aktiviteti:



Lituania është republika më jugore baltike. Njëherësh është shteti më i madh baltik. Ndodhet në bregun juglindor të detit Baltik. Shtrihet ndërmjet Letonisë në veri, Bjellorusisë në lindje, Polonisë në jug dhe Kaliningradit në jugperëndim. Relievi është i ndërthurur me luginat dhe kodrat, lartësia e të cilave nuk kalon 300 m. Pika më e lartë në vend është **Juozapine** (292 m). Në pjesën më të madhe të vendit klima është kontinentale, me ndikim të masave të ajrit nga deti Baltik. Klima bëhet më e ashpër nga perëndimi në drejtim të lindjes. Reshjet mesatare vjetore janë rreth 600 mm. Lituania është vend i lumenjve dhe liqeneve. Nemani është lumi më i gjatë, i cili vjen nga Bjellorusia. Sipërfaqet e mëdha me moçale të dikurshme janë tharë duke u shndërruar në toka bujqësore. Rreth 28 % e sipërfaqes është e mbuluar nga pyjet.

Lituania ka popullsi prej 2.8 milionë banorësh (2018). Në vitin 2001, Lituania kishte 3.6 milionë banorë. Popullsia ka pësuar rënie për shkak të shkallës së ulët të lindshmërisë dhe migrimit të popullsisë. Lituanezët përbëjnë 84 % të popullsisë, pastaj polakët me 6.6 %, rusët me 5.8 % dhe të tjerët. Vendi ka shkallë të lartë të urbanizimit (73 %). Qendrat më të mëdha urbane janë **Vilniusi** (kryeqyteti), pastaj Kaunas, Klaipeda etj. Tregtia dikur ishte e lidhur me Bashkimin Sovjetik, ndërsa tani zhvillohet me shumë vendet perëndimore. Produktet minerale, tekstili dhe veshmbathjet si dhe makineria përbëjnë eksportin kryesor të vendit.



Vilnius - kryeqyteti i Lituanië



Insekt në rrëshirën e glutur në Lituani

! Me rëndësi të dihet

- Estonisë i takojnë edhe rreth 800 ishuj në detin Baltik, prej të cilëve më të mëdhenjtë janë Hiluma dhe Sarema.
- Lituania dhe Letonia janë eksportuesit më të mëdhenj të qelbarit.
- Shtetet baltike deri në vitin 1991 ishin në kuadër të Bashkimit Sovjetik. Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, Estonia, Letonia dhe Lituania bëhen shtete të pavarura.

? Pyetje

1. Shkruaj emrat e shteteve dhe kryeqytetet përkatëse të vendeve baltike.
2. Trego strukturën etnike të vendeve baltike.
3. Cilat probleme i patën vendet baltike pas pavarësisht në vitin 1991?

Të nxënë të këmbime: grupet e ekspertëve
 Mësimdhënësi e ndan klasën në tri grupe të barabarta, pastaj tre flipçarta i vendos në tri kënde të klasës. Secili grup i jepet nga marker, p.sh. Grupi 1 - markeri me ngjyrë të kuqe, tema; Elementet natyrore të Estonisë; grupi 2 - markeri me ngjyrë të kaltër, tema: Letonia; grupi 3 - markeri me ngjyrë të zezë, tema: Lituania. Mësimdhënësi u jep kohë nxënësve që për 5 minuta të shkruajnë sa më tepër informacione për temën e caktuar. Kur të përfundojë koha prej 5 minutash, nxënësit ndalojnë dhe mësimdhënësi i rekomandon që, së bashku me markerin me ngjyrë të njëjtë, nxënësit të bëjnë një lëvizje, pra grupi 1 lëviz te grup 2; grupi 2 lëviz te grup 3; grupi 3 lëviz te grup1. Fillimisht, ata duhet të lexojnë pjesën që e ka shkruar grupi paraprak, që mos të përsëriten shkrimet e njëjta, dhe pastaj për 5 minuta fillojnë të shkruajnë mbi temën e caktuar. Kështu vazhdohet deri sa të përfundojë një cikël.

Në fund, nxënësit kthehen te tema fillestare dhe secili prej grupeve i lexon të gjitha pjesët (të gjitha ngjyrat e markerave), i analizojnë për saktësinë, cilësinë dhe sasinë. Kështu, njëri grup duhet të shpallet fitues mbi cilësitë e lartpërmendura.

Në këtë fazë të orës mësimdhënësi shtron pyetje: a ka rëndësi struktura e popullsisë në zhvillimin ekonomik?

Nxënësit i shprehin - argumentojnë mendimet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore, për përshkrimin e strukturave shoqërore.

Detyrë:

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: E. L. me Bashkësitë e Shteteve të Pavarura - veçoritë natyrore

Rezultatet e të nxënimit të temës: - Identifikon në hartë shtetet e Evropës Lindore dhe sqaron Bashkësinë e Shteteve të Pavarura;

- Analizon deri ku shtrihet Evropa Lindore dhe deri ku Bashkësia e Shteteve të Pavarura si dhe sqaron pozitën tranzitive socio-ekonomike dhe politike të këtyre shteteve;

- Dallon tërësitë e mëdha relievore: Ultësirën e Evropës Lindore, Ultësirën Perëndimore të Sibirit, të Turanit, vargmalet e Karpateve, Kaukazit të Madh, të Vogël, Malet e Azisë Qendrore deri te lumi Amur dhe Gadishulli Kamçatka.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa Lindore – veçoritë natyrore - Pozita gjeografike dhe kufijtë

Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:

- Identifikon nga harta e Evropës shtetet dhe tërësitë relievore; Ultësirën e Evropës Lindore, Ultësirën Perëndimore të Sibirit, të Turanit, vargmalet e Karpateve, Malet e Azisë Qendrore deri te lumi Amur dhe Gadishulli Kamçatka;
- Analizon pozitën tranzitive të shteteve të Evropës Lindore në ndikimin e zhvillimit socio-ekonomik dhe politik.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të Evropës Lindore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Biologjia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Evropa Lindore - veçoritë natyrore



Evropa Lindore shtrihet prej detit Baltik dhe Karpateve në perëndim e deri te mali Ural dhe lumi Ural në lindje. Në veri, ajo del në Oqeanin e Ngjirë të Veriut kurse Deti i Zi, mali Kaukaz dhe liqeni Kaspik paraqesin kufirin më jugor të shtrirjes së saj. Ultësirat e mëdha ndodhen thellë në brendësi të kontinentit, prandaj janë larg ndikimeve të oqeanit Atlantik. Prandaj, edhe pse Evropa Lindore del në disa dete, pozita gjeografike e saj dallohet me shkallën shumë të shprehur të kontinentalitetit. Nëper Bjellorusi, Ukrainë dhe Moldavi kalojnë rrugë të rëndësishme, të cilat lidhin Federatën Ruse me Evropën e Mesme dhe brigjet e deteve të ngrohta. Lidhjet e Evropës Lindore me rajonet dhe detet e tjera bëhen përmes rrugëve të brendshme lundruese të cilat kalojnë nëpër lumenjtë dhe kanalet e shumta. Lumi Volga është rruga më e rëndësishme lundruese, e cila lidh Detin e Bardhë, detin Baltik, Detin e Zi, detin Azov dhe liqenin Kaspik.

Më tepër se një shekull ajo ka qenë në kuadër të Mbretërisë Ruse, kurse pas Luftës së Parë Botërore e deri në vitin 1991 ajo bëhet pjesë e Bashkimit Sovjetik. Rajoni i Evropës Lindore është hapësirë kaluese në të cilën ndeshen ndikimet politike dhe ekonomike të lindjes dhe perëndimit. Bjellorusia dhe Moldavia nuk kanë dalje në det, kurse Ukraina dhe pjesa evropiane e Rusisë dalin në dete relativisht të mbyllura.

Relievi dhe përthyeshmëria e bregdetit

Vija bregdetare përgjatë detit Baltik është pak e përthyer. Në bregdetin verior ndodhet gadishulli Kola, kurse ishulli më i madh është Ishulli i Tokës së Re. Dy gjiret më të mëdha të këtij bregdeti janë gjiri i Finlandës dhe gjiri i Rigës. Vijen bregdetare të Detit të Zi e përthyen gadishulli i Krimesë, ndërsa ndërmjet Detit të Zi dhe detit Azov ndodhet ngushtica e Kerçit. Rajoni i Evropës Lindore dominohet nga relievi ultësior. Kjo është Ultësira e Madhe e Evropës Lindore. Bazamentin e kësaj ultësire e përbën Plaka Ruse, e cila është një tokë e vjetër dhe stabile në aspektin gjeologjik.

Njëtrajshmërinë e relievit ultësitor të Evropës Lindore e prishin deri diku Pllaja e Valdajit dhe ajo e Rusisë së Mesme. Në skajin e poshtëm, ultësira e Evropës Lindore përfundon në depresionin e Ultësirës Pranëkaspike. Në skajet perëndimore të kësaj ultësire ngrihen vargmalet e Karpateve, në jug mali i Krimesë dhe Kaukazi. Në brezin kufitar ndërmjet Evropës dhe Azisë shtrihet mali Ural. Lartësia mesatare mbidetare e relievit është 170 m, ndërsa relievi i ngritur nuk është më i lartë se 370 m. Për shkak të largësisë së madhe nga masat oqeanike dhe të lagështa ajrore, klima e Evropës Lindore është e karakterit të theksuar kontinental me sasi shumë të vogël të reshjeve, jo më shumë se 500 mm. Ajo në drejtimin verijug ndërrohet nga ajo shumë e ftohtë dhe e ashpër në veri



Ultësira e Evropës Lindore

e deri te klima stepike në jug. Në rajonin e liqenit Kaspik klima është gjysmëshkretinore, ndërsa përgjatë bregdetit të Detit të Zi është e pranishme klima e ndryshueshme mesdhetare.



Lumi Volga

Nëper ultësirën e Evropës Lindore rrjedh Volga, e cila buron në pllajën e Valdajit dhe derdhet në liqenin Kaspik. Përveç Volgës, nëper këtë ultësirë rrjedhin edhe lumenj të tjerë të gjatë si Dnjeprri, Dnjestri dhe Doni, të cilët derdhen në Detin e Zi. Dvina Perëndimore është lumi më i madh që i takon pellgut të detit Baltik, ndërsa Dvina Veriore dhe Peçora janë lumenjtë më të mëdhenj që rrjedhin në drejtim të Oqeanit të Ngrirë të Veriut. Nëper rrjedhat e lumenjve të mëdhenj të Evropës Lindore janë ngritur shumë liqene artificiale. Shumica e tyre ndodhen përgjatë shtritit të Volgës. Liqeni Kaspik është liqeni më i madh në botë. I takon grupit të liqeneve relikte dhe ka ujën e njelmët. Liqenet Ladoga dhe Onjega, të cilat shtrihen në veri të rajonit janë të origjinës akullnajore. Në Evropën Lindore kanë përhapje të madhe tokat e zezë dhe të përmbajtje të lartë të humusit të cilat quhen cernozem. Tokat pjellore të cernozemit e kanë bërë rajonin e Evropës Lindore një rajon të madh lavërtar ku kultivohen lloje të ndryshme të drithërave. Në këtë rajon nga veriu drejt jugut ndërrohen disa zona natyrore të bimësisë. Në brigjet e veriut ndodhen bashkësitë e thjeshta bimore të tundrave. Poshtë tyre ndodhen tajgat pastaj stepat. Afër detit Mesdhe bimësia është mesdhetare, kurse afër Kaspikut bimësia është gjysmëshkretinore.



Tajga me pyje halore



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Diskutim për njohuritë paraprahe

Drejtohemi me pyetje:

1. Cilat janë shtetet e Evropës Lindore?
2. Cili është shteti më i madh?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Pyetja sjell pyetjen


Paraqitet video ose harta me shtetet e Evropës Lindore. Gjatë shikimit të videos ose të hartës, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:

1. Cilat shtete bëjnë pjesë në Evropën Lindore?
2. A ka rëndësi pozita e shteteve të Evropës Lindore në zhvillimin socio-ekonomik dhe atë politik?
3. Cilat ishin tërësitë relievoe, malet dhe ultësirat më të njohura të këtij rajoni të Evropës?



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënë
Organizues grafik

Në mënyrë individuale, nxënësit përgatitin organizues grafik për Evropën Lindore – veçoritë natyrore - Pozita gjeografike dhe kufijtë. Pastaj, secili në mënyrë individuale i shënon idetë e tij/saj në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e identifikimit të shteteve, analizën e pozitës së Evropës Lindore në ndikimin socio-ekonomik dhe atë politik, si dhe për dallimin e tërësive relievoe; ultësirat dhe malet.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 81.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Lindore me Bashkësitë e Shteteve të Pavarura - veçoritë natyrore

Rezultatet e të nxënimit të temës: - Analizon tipat e klimave prej Evropës Lindore e deri në bregdetin e Pacifikut dhe prej Oqeanit të Ngrirë të Veriut e deri te vargmalet e larta në jug;

- Ndërlidh klimën me tipat e vegjetacionit sipas zonave;

- Identifikon, rrjedhjet, drejtimin e rrjedhjes dhe veçoritë specifike të lumenjve;

- Identifikon, emërton dhe të krahason liqenet më të njohura të Evropës Lindore dhe Bashkësisë së Shteteve të Pavarura sipas veçorive të tyre;

- Identifikon në hartë shtrirjen e shkretëtirave, emrat e tyre dhe arsyet prandinë e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa Lindore – veçoritë natyrore - Pozita gjeografike dhe kufijtë

Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:

- Analizon tipat klimatikë të Evropës Lindore prej bregdetit kah malet dhe ndërlidh klimën me zonalitetin vertikal të vegjetacionit;
- Tregon prej hartës drejtimin e rrjedhjes së lumenjve;
- Shënon në hartën memece të Evropës Lindore liqenet dhe shkretëtirat;
- Arsyet prandinë e shkretëtirave në këtë zonë të Evropës Lindore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të Evropës Lindore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

Evropa Lindore - veçoritë shoqërore dhe ekonomike

Së bashku me pjesën evropiane të Rusisë, Evropa Lindore ka sipërfaqen prej 5.6 milionë km², prandaj është regjioni më i madh, i cili përfshin thuhajse gjysmën e kontinentit evropian. Pa Federatën Ruse ajo ka 1.02 milion km² në të cilën jetojnë 65 milionë banorë, me dendësi prej 64 b/km², kurse me të dendësia është vetëm 30 b/km² që e bën atë pas Evropës Veriore regjionin më së paku të banuar të Evropës. Hapësirat më të banuara të këtij regjioni ndodhen rreth aglomeracioneve urbane të Moskës, Shën Peterburgut, Kijevit, hasenit të Donjeckut. Më rrallë të banuara janë viset subarkitike të verut dhe hapësirat gjysmëshkretinore të Ultësirës Pranëkaspike. Shtetet e Evropës Lindore kanë përbërje të komplikuar etnike, gjuhësore dhe fetare. Grupit të popujve sllavë i takojnë rusët, bjellorusët dhe ukrainasit, si dhe aty jetojnë edhe moldavët që janë popull roman si dhe pjesëtarët e shumë pakicave etnike, si: karelet, bashkirët, komët, tatarët etj. Gjuhë zyrtare janë gjuha ruse, ukrainase, bjelloruse dhe moldave. Përveç tyre, fliten edhe gjuhët të tjera sllave, indoevropiane, urale dhe alltaje. Në shtetet e Evropës Lindore janë të pranishme feja ortodokse, katolike, protestante dhe hebreje.

Në deceniet e fundit arrihet deri te rënia e shtimit natyror në shumë vende të Evropës Lindore. Regjioni paraqet një hapësirë të migrimeve intensive, të cilat me krijimin e shteteve të reja pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik janë orientuar kah Evropa Qendrore, Perëndimore dhe Jugore. Shtimi i ulët natyror dhe migrimet kanë bërë që në shumicën e vendeve të Evropës Lindore të shfaqet fenomeni i shpërpullimit që ka filluar të prekë sidomos vendbanimet rurale. Përkundër kushteve të volitshme natyrore, Evropa Lindore është më pak e zhvilluar se regjionet e tjera. Ajo ka sipërfaqe të mëdha të tokave pjellore, pyje, lumenj me fuqi të madhe ujore dhe një llojlojshmëri të pasurive xeherore, sidomos të lëndëve djegëse të thëngjillit, naftës dhe gazit natyror. Në ultësirën e madhe të Evropës Lindore kultivohen drithërat dhe patatet. Në zhvillimin e industrisë prijnë degët e industrisë, sidomos ajo e metalurgjisë së zezë dhe e makinerisë. Në fazat fillestare të sistemit ekonomik komunist, menaxhimi i planifikuar i aktiviteteve ekonomike ka sjellë rezultate të caktuara, mirëpo me kalimin e kohës ka forcuar monopolin dhe ka eliminuar konkurrencën. E gjithë kjo është reflektuar në ngecjen ekonomike të regjionit. Tranzicioni jo i mirë nga sistemi i centralizuar ekonomik në atë të ekonomisë së tregut sikundër edhe teknologjia e vjetruar kanë ofruar aso produkte industriale të cilat nuk janë të denja për tregun evropian.

Kjo është manifestuar me rënien e përgjithshme të prodhimit industrial në ekonomitë e këtyre shteteve. Deri në vitin 1990, në regjionin e Evropës Lindore ekzistonte vetëm shteti i Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS). Në vazhdim e ndryshimeve të mëdha gjeopolitike që ndodhën në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar, vjen deri te shpërbërja e BRSS-së nga e cila krijohen 15 shtete. Të gjitha shtetet, përveç atyre baltike (Estonia, Lituania dhe Letonia), krijojnë një integrim të përbashkët regional, politik dhe ekonomik që njihet si Bashkësia e Shteteve të Pavarura.

! Me rëndësi të dihet

- Rruga lundruese e Vollgës është për nga gjatësia e dyta në Evropë. Ajo përbëhet nga lumenjtë e lundrueshëm, kanalet dhe liqenet. Kanali Vollga-Don është ndërtuar në vitin 1952 dhe është i gjatë 101 km. Ky kanal te qyteti i Volgogradit e lidh Vollgën me liqenin e Cimianit në lumin Don duke mundësuar lidhjen e Detit të Zi me liqenin Kaspik. Lundrimi zhvillohet nëpër disa kaskada sepse është 26 m më i ulët se niveli i detit botëror. Për shkak të rrugës lundruese të Vollgës, Moskua quhet "Porti i pesë deteve".

? Pyetje

1. Evropa Lindore del në shumë dete, por ka pozitë kontinentale! Si e shpjego-ni këtë?
2. Cili është kufiri lindor i Evropës Lindore?
3. Cilët popuj jetojnë në Evropën Lindore?
4. Përmendi resurset natyrore të Evropës Lindore.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Diskutim për njohuritë paraprake

- Drejtohemi me pyetje:
1. Çfarë klime ka Evropa Lindore?
- Përgjigje e mundshme:
1. Klimë kontinentale, malore...

Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Pyetja sjell pyetjen

- Paraqitet video ose harta e Evropës Lindore për klimën, lumenjtë, liqenet dhe bimësinë. Gjatë shikimit të videos ose hartës, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:
1. Çfarë klime ka Evropa Lindore?
 2. Cilët janë lumenjtë, liqenet dhe shkretëtirat kryesore të saj?

Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit
Tabela e koncepteve

Mësuesi i udhëzon nxënësit si të formohet tabela, ose tabela iu jepet e gatshme. Një model i mundur:

Evropa Lindore – veçoritë natyrore - Pozita gjeografike dhe kufijtë	Klima	Liqenet	Lumenjtë	Shkretëtirat

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e analizës së tipave klimatikë, identifikimit dhe drejtimit të rrjedhës së lumenjve, emërtimit të liqeneve dhe të shkretëtirave.

Detyrë:
 Të plotësohet fletore pune, faqe 81.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Lindore me Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, veçoritë shoqërore; Evropa Lindore me Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, veçoritë ekonomike

Rezultatet e të nxënit të temës: Dallon popujt më të njohur në Evropën Lindore dhe Bashkësinë e Shteteve të Pavarura sipas përkatësisë etnike e fetare;
- Identifikon në hartat e punës qytetet më të njohura dhe më të mëdha të Evropës Lindore dhe të Bashkësisë së Shteteve të Pavarura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Evropa Lindore – veçoritë shoqërore dhe ekonomike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon popujt e Evropës Lindore për nga përkatësia etnike dhe fetare;
- Identifikon prej hartës qytetet më të mëdha të Evropës Lindore;
- Shpjegon shtetet e Evropës Lindore sipas sipërfaqes, numrit të popullsisë, nivelit të arsimit, shkallës së urbanizimit dhe strukturës ekonomike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomike të Estonisë, të Letonisë dhe të Lituanisë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh



Njëtrajshmërinë e relievit ulltësor të Evropës Lindore e prishin deri diku Pllaja e Valdajit dhe ajo e Ruisisë së Mesme. Në skajin e poshtëm, ulltësira e Evropës Lindore përfundon në depressionin e Ulltësirës Pranëkaspike. Në skajet perëndimore të kësaj ulltësire ngrihen vargmalet e Karpateve, në jug mali i Krimesë dhe Kaukazi. Në brezin kufitar ndërmjet Evropës dhe Azisë shtrihet mali Ural. Lartësia mesatare mbidetare e relievit është 170 m, ndërsa relievi i ngritur nuk është më i lartë se 370 m. Për shkak të largësisë së madhe nga masat oqeanike dhe të lagështa ajrore, klima e Evropës Lindore është e karakterit të theksuar kontinental me sasi shumë të vogël të reshjeve, jo më shumë se 500 mm. Ajo në drejtimin veri-jug ndërrohet nga ajo shumë e ftohtë dhe e ashpër në veri e deri te klima stepike në jug. Në rajonin e liqenit Kaspik klima është gjysmëshkretinore, ndërsa përgjatë bregdetit të Detit të Zi është e pranishme klima e ndryshueshme mesdhetare.

Ulltësira e Evropës Lindore



Lumi Vollga



Taiga dhe pylltore

Nëper ulltësirën e Evropës Lindore rrjedh Vollga, e cila buron në pllajën e Valdajit dhe derdhet në liqenin Kaspik. Përveç Vollgës, nëper këtë ulltësirë rrjedhin edhe lumenj të tjerë të gjatë si Dnjepr, Dnjestri dhe Doni, të cilët derdhen në Detin e Zi. Dvina Perëndimore është lumi më i madh që i takon pellgut të detit Baltik, ndërsa Dvina Veriore dhe Peçora janë lumenjtë më të mëdhenj që rrjedhin në drejtim të Oqeanit të Ngrirë të Veriut. Nëper rrjedhat e lumenjve të mëdhenj të Evropës Lindore janë ngritur shumë liqene artificiale. Shumica e tyre ndodhen përgjatë shtratit të Vollgës. Liqeni Kaspik është liqeni më i madh në botë. I takon grupit të liqeneve relikte dhe ka ujën e njelmët. Liqenet Ladoga dhe Onjeja, të cilat shtrihen në veri të rajonit janë të origjinës akullnajore. Në Evropën Lindore kanë përhapje të madhe tokat e zeza me përmbajtje të lartë të humusit të cilat quhen cernozem. Tokat pjellore të cernozemit e kanë bërë rajonin e Evropës Lindore një rajon të madh lavëtar ku kultivohen lloje të ndryshme të drithërave. Në këtë rajon nga veriu drejt jugut ndërrohen disa zona natyrore të bimësisë. Në brigjet e veriut ndodhen bashkësitë e thjeshta bimore të tundrave. Poshtë tyre ndodhen taigat pastaj stepat. Afër detit Mesdhe bimësia është mesdhetare, kurse afër Kaspikut bimësia është gjysmëshkretinore.

Evropa Lindore - veçoritë shoqërore dhe ekonomike

Së bashku me pjesën evropiane të Rusisë, Evropa Lindore ka sipërfaqen prej 5.6 milionë km², prandaj është regjioni më i madh, i cili përfshin thuajse gjysmën e kontinentit evropian. Pa Federatën Ruse ajo ka 1.02 milion km² në të cilën jetojnë 65 milionë banorë, me dendësi prej 64 b/km², kurse me të dendësia është vetëm 30 b/km² që e bën atë pas Evropës Veriore regjionin më së paku të banuar të Evropës. Hapësirat më të banuara të këtij regjioni ndodhen rreth aglomeracioneve urbane të Moskës, Shën Peterburgut, Kijevit, basenit të Donjeckut. Më rrallë të banuara janë viset subarktkike të veriut dhe hapësirat gjysmëshkretinore të Ultësirës Pranëkaspikë. Shtetet e Evropës Lindore kanë përbërje të komplikuar etnike, gjuhësore dhe fetare. Grupit të popujve sllavë i takojnë rusët, bjellorusët dhe ukrainasit, si dhe aty jetojnë edhe moldavët që janë popull roman si dhe pjesëtarët e shumë pakicave etnike, si: karelet, bashkirët, komët, tatarët etj. Gjuhë zyrtare janë gjuha ruse, ukrainase, bjelloruse dhe moldave. Përveç tyre, fliten edhe gjuhët të tjera sllave, indoevropiane, urale dhe alltaje. Në shtetet e Evropës Lindore janë të pranishme feja ortodokse, katolike, protestante dhe hebreje.

Në deceniet e fundit arrihet deri të rënia e shtimit natyror në shumë vende të Evropës Lindore. Regjioni paraqet një hapësirë të migrimeve intensive, të cilat me krijimin e shteteve të reja pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik janë orientuar kah Evropa Qendrore, Perëndimore dhe Jugore. Shtimi i ulët natyror dhe migrimet kanë bërë që në shumicën e vendeve të Evropës Lindore të shfaqet fenomeni i shpopullimit që ka filluar të prekë sidomos vendbanimet rurale. Përkundër kushteve të vulltshme natyrore, Evropa Lindore është më pak e zhvilluar se regjionet e tjera. Ajo ka sipërfaqe të mëdha të tokave pjellore, pyje, lumenj me fuqi të madhe ujore dhe një llojlojshmëri të pasurive xeherore, sidomos të lëndëve djegëse të thëngjillit, naftës dhe gazit natyror. Në ultësirën e madhe të Evropës Lindore kultivohen drithërat dhe patatet. Në zhvillimin e industrisë prijnë degët e industrisë, sidomos ajo e metalurgjisë së zezë dhe e makinerisë. Në fazat fillestare të sistemit ekonomik komunist, menaxhimi i planifikuar i aktiviteteve ekonomike ka sjellë rezultate të caktuara, mirëpo me kalimin e kohës ka forcurar monopolin dhe ka eliminuar konkurrencën. E gjithë kjo është reflektuar në ngecjen ekonomike të regjionit. Tranzicioni jo i mirë nga sistemi i centralizuar ekonomik në atë të ekonomisë së tregut sikundër edhe teknologjia e vjetruar kanë ofruar aso produkte industriale të cilat nuk janë të denja për tregun evropian.

177

Pyetje e mundshme:

1. Çka dini për veçoritë shoqërore dhe ekonomike të Evropës Lindore?

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Shpjegim i përparuar

Me pak fjalë paraqitet përmbajtja e temës. Prej nxënësve kërkohet që të diskutojnë për çështjen e parë të mësimin, të bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin dhe idetë t'i shkruajnë për atë që dëgjuan.

Pastaj zhvillohet pjesa e parë e shpjegimit, ku mësimdhënësi paraqet video ose foto të ndryshme të veçorive shoqërore dhe ekonomike të Evropës Lindore. Pasi mbaron pjesa e parë e leksionit, iu kërkohet nxënësve të shohin shënimet - listat e tyre. Në vijim bëhet pyetje: Çka ka të përbashkët midis listave tuaja dhe atyre që u panë në video- foto apo lexim? Cilat gjëra të reja mësuat? Vazhdohet me leksion dhe kërkesa - pyetje.

<https://tinyurl.com/yxwvys2e>



Përforcimi:

Konsolidim dhe zbatimi i të nxënit

Rishikim me rigrupim

Secilit grup iu jepet një fletë në të cilën kërkohet të shkruajnë mendimet e tyre për temën apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e dallimit të popullsisë së Evropës Lindore për nga përkatësia etnike dhe fetare, identifikimin e qyteteve më të mëdha dhe analizimin e vlerësimit mbi nivelin e arsimimit, shkallën e urbanizimit dhe strukturat ekonomike.

Detyrë:

Të plotësohen pyetjet nga libri faqe 178.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Lindore me Bashkësitë e Shteteve të Pavarura -veçoritë natyrore

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përkruan pozitën gjeografike, veçoritë natyrore dhe shoqërore të Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Federata Ruse

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon Federatën Ruse;
- Identifikon prej hartës/atlasit elementet natyrore të saj.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomike të Federatës Ruse.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Historia, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Stuhi mendimesh

Pyetje e mundshme:

Çka dini ose mendoni se dini për Federatën Ruse?


Nxënësit ta përdorin atlasin gjeografik për t'i marrë informacionet rreth elementeve natyrore.

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.



Federata Ruse është shtet evropian dhe aziatik, i cili përfshin pjesën më të madhe të Evropës Lindore dhe Azisë Veriore. Ajo shtrihet nga deti Baltik dhe i Zi në perëndim e deri tek oceani Paqësor në lindje. Mali Ural e ndan këtë shtet në pjesën evropiane dhe aziatike. Federata Ruse përfshin hapësirën ndërmjet Kaukazit, Detit të Zi, Ukrainës, Bjellorusisë, Letonisë, Estonisë, detit Baltik, Finlandës, Norvegjisë, Oqeanit të Ngrirë të Veriut, oqeanit Paqësor, Koresë Veriore, Kinës, Mongolisë, Kazakistanit, dhe liqenit Kaspik. Asaj i takon edhe eksklava e Kaliningradit. Një e treta e territorit të Rusisë ndodhet në veri të brezit polar. Në relievin e Rusisë veçohen ultësirat, pllajtat, malet e vjetra dhe vargmalet e reja.

Pjesën e ulët të relievit e përbëjnë ultësira e Evropës Lindore dhe ultësira e Siberisë Perëndimore. Ultësira e Evropës Lindore është pjesë e bërthamës më të vjetër të kontinentit evropian. Nga ultësira ngrihen pllajtat jo më të larta se 500 m me lugina lumore ndërmjet tyre. Gjatë së kaluarës gjeologjike, në platformën e vjetër ruse janë shtresuar sedimentet e ndryshme. Shtresën e epërme e përbëjnë akumulimet morenike, lesi dhe materialet lumore të akumuluarra përgjatë një periudhe prej më shumë se 1.5 milionë vjetësh. Relievi i ulët dhe tokat e zeza pjellore kanë krijuar kushtet e volitshme për zhvillimin e bujqësisë dhe popullimin e këtyre hapësirave. Prandaj ultësira e Evropës Lindore është pjesë e "trekëndëshit pjellor" dhe njihet për prodhimtarinë e madhe bujqësore dhe blegtorale. Në veri të këtij trekëndëshi shtrihen pyjet të cilat gradualisht kalojnë në tundra.



Ky trekëndësh shtrihet ndërmjet Shën Peterburgut, Kaukazit Jugor dhe ultësirës së Siberisë Perëndimore.

Mali Ural, përveç që merret si kufi ndërmjet Evropës dhe Azisë, ai po ashtu, ndan edhe ultësirën e Evropës Lindore nga ultësira e Siberisë Perëndimore. Ai është mal i vjetër dhe i takon paleozoikut. Është i pasur me xehe të hekurit dhe metale me ngjyra. Pasuritë e shumta minerale dhe nafta e thëngjilli të sjella nga lindja dhe perëndimi kanë mundësuar zhvillimin e industrisë pas Luftës së Dytë Botërore. Ndërmjet malit Ural dhe lumit Jenisej ndodhet ultësira e Siberisë Perëndimore dhe njëherësh është ultësira më e madhe në botë. Njëpër këtë ultësirë rrjedhin lumenjtë e mëdhenj të Obi dhe Jenisejit.

Duke shkuar në drejtim të jugut, kjo ultësirë fillon të ngrihet gradualisht kah jugu dhe juglindja. Klima e ashpër, terreni moçalar dhe largësia e madhe nga pjesa evropiane vështirësojnë shfrytëzimin e rezervave të shumta të naftës dhe gazit natyror, me të cilat kjo ultësirë është jashtëzakonisht e pasur. Në drejtim të jugut kjo ultësirë është pjellore dhe prandaj njerëzit janë orientuar në prodhimtarinë bujqësore. Në hapësirën burimore të lumit Ob ndodhet baseni i Kuznjecit, i cili ka rezervatë të mëdha të thëngjillgurit, hekurit dhe xeheve të tjera metalike. Ndërmjet Jenisejit dhe lumit Lena ndodhet pllaja e Siberisë Qendrore. Në shkëmbinjte e vjetër të kësaj pllaje hasen vendburimet e mineraleve të çmuara të arit dhe diamantit, pastaj të xeheve të hekurit etj. Shfrytëzimin e tyre e vështirësojnë kushtet ekstreme të ftohta klimatike. Vargmalet e reja të Rusisë janë Kaukazi dhe malet e Siberisë Lindore. Në lindje ndodhen mali Çersk, Verhojansk, i Kolimës dhe i Çukotit si dhe malet në kufi me Mongolinë dhe Kinën në jug. Pasuritë natyrore të këtyre maleve janë xehet dhe sipërfaqet e mëdha të pyeje. Në këtë regjion në vitin 1935 është matur temperatura më e ulët në hemisferën veriore (Ojmakon, - 68 °C). Në klimën e Rusisë ndikojnë pozita gjeografike, shkalla e madhe e kontinentalitetit, relievi dhe shpërndarja e tokës dhe e detit. Gjatë dimrit dhe verës, temperaturat zvogëlohen prej jugut kah veriu dhe lindja. Gjatë stinës së verës toka ngrohet më shpejt se deti, prandaj ajri në tokë është më i ngrohtë se në det.

180



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes *Pyetja sjell pyetjen*

Paraqitet video ose harta politike dhe fizike e Federatës Ruse.

Gjatë shikimit të videos ose të hartës, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:

1. Me cilat shtete kufizohet Federata Ruse?
2. Cilat ishin malet, fushat, lumenjtë, liqenet kryesore të saj?
3. Çfarë klime ka Federata Ruse?
4. Tregoni shtrirjen horizontale të bimësisë.

<https://www.bing.com/videos/riverview/related-video?&q=geography+federata+russe&&mid=6299B-7C269F218B94D1C6299B7C269F218B94D1C&&-FORM=VRDGAR>



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatim i të nxëniet *Rishikim me rigrupim*

Secilit grup iu jepet një fletë, në të cilën kërkohet të shkruajnë mendimet e tyre për temën apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit dhe për identifikimin e elementeve natyrore.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 82.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi
Lënda: Gjeografi
Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII
Tema: Evropa Lindore me Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, veçoritë shoqërore; Evropa Lindore me Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, veçoritë ekonomike

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Vlerëson strukturat e popullsisë dhe ndërlidhjen e tyre në zhvillimin ekonomik

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:
 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Popullsia dhe zhvillimi ekonomik i Federatës Ruse

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore.
- Vlerëson ndërlidhjen e resurseve humane me pasuritë natyrore në zhvillimin ekonomik të Federatës Ruse.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomike të Federatës Ruse.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Pyetje e mundshme:

Çka dini ose mendoni se dini për popullsinë dhe zhvillimin ekonomik të Federatës Ruse?



Gjatë stinës së dimrit, toka më shpejt ftohet, në veçanti në pjesët më veriore, prandaj shfaqen dallimet e mëdha ndërmjet temperaturave të verës dhe të dimrit. Më shumë reshje marrin malet e skajshme të Rusisë, kurse më pak pjesa më veriore e vendit. Skaji më verior ka klimën e tundrave. Pjesa kryesore e vendit ka klimën e pyjeve dhe të borës me verat e freskëta dhe të ngrohta si dhe dimrat shumë të ftohtë e të thatë. Klimë diçka më të ngrohtë dhe të lagësht ka brezi bregdetar në jug të vendit, kurse në juglindje klima është e thatë stepike. Klima ka kushtëzuar zhvillimin e bimësisë. Në veri ndodhen tundrat e në jug të tyre tajgat. Tajgat janë sipërfaqet më të mëdha me pyje në botë nga të cilat përfitohen lëndët e para për industrinë e drurit dhe atë kimike. Në drejtim të jugut, tajgat e pyjeve gjethembajtëse të cilat gradualisht kalojnë në pyje të përziera dhe ato gjethëhënëse, pyjet stepike, stepat barishtore etj. Me punën e njeriut hapësirat stepike janë shndërruar në sipërfaqe të punuara. Në territorin e gjerë të Rusisë janë zhvilluar lumenjtë të gjatë të cilët janë lidhur nëpërmjet kanaleve të shumta duke krijuar sisteme të mëdha lumore. Këto përveç për transport lumor, shfrytëzohen edhe për prodhimin e energjisë, ujti dhe peshkimit. Lumenjtë i takojnë pellgut të Detit të Zi, detit Baltik, liqenit Kaspik, Oqeanit të Ngrirë të Veriut dhe oqeanit Paqësor. Lumi i parë për nga rëndësia është Vollga. Përgjatë lumit Vollga janë ngritur hapësira të mëdha të urbanizuara dhe të industrializuara. Në pjesën evropiane të Rusisë ndodhen disa liqene të mëdha akullnajore si Ladoga dhe Onjega. Liqeni i Bajkallit, i cili ndodhet në pllajën e Siberisë së Mesme, është më i madhi i Rusisë aziatike dhe më i thelli në botë.

Klimati kontinental i ashpër

Shfrytëzimi i masës drusore në tajgat ruse

Ojmjakoni në Siberi

181

Nxënësit të përdorin atlasin gjeografik dhe video të ndryshme për t'i marrë informacionet.

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Pyetja sjell pyetjen

Paraqitet video ose harta politike e Federatës Ruse. Gjatë shikimit të videos ose të hartës, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:

1. Cilat janë strukturat e popullsisës sipas moshës, gjinisë, arsimimit, religjionit dhe ekonomisë?

<https://www.bing.com/videos/riverview/related-video?q=geography+federata+russe+structur+population&&mid=BD3B52907F3988E246A2BD3B-52907F3988E246A2&&FORM=VRDGAR>



Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatim i të nxënësve
Paragraf argumentues

Kërkohej nga nxënësit që në mënyrë individuale të punojnë një paragraf, duke arsyetuar ndërlidhjen e resurseve natyrore dhe resurseve humane në zhvillimin ekonomik të Federatës Ruse. Disa nga punimet lexohen nga nxënësit, pjesa e palexuar merret nga arsimtari dhe vlerësohet në shtëpi.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përshkrimit të strukturave shoqërore dhe për vlerësimin e ndërlidhjes mes resurseve humane dhe atyre natyrore në zhvillimin ekonomik.

Detyrë:

Të plotësohen pyetjet nga libri, faqe 185.

Reflektim për rryjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Lindore me Bashkësitë e Shteteve të Pavarura - veçoritë natyrore; Evropa Lindore me Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, veçoritë shoqërore

Rezultatet e të nxënit të temës:

- Dallon tërësitë e mëdha relievore: Ultësirën e Evropës Lindore, Ultësirën Perëndimore të Sibirit, të Turanit, vargmalet e Karpateve, Kaukazit të Madh, të Vogël, Malet e Azisë Qendrore deri te lumi Amur dhe Gadishulli Kamçatka;
- Analizon tipat e klimave prej Evropës Lindore e deri në bregdetin e Pacifikut dhe prej Oqeanit të Ngrirë të Veriut e deri te vargmalet e larta në jug;
- Identifikon rrjedhjet, drejtimin e rrjedhjes dhe veçoritë specifike të lumenjve;
- Analizon shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, populative, nivelit të arsimit,...

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime: Evropa Lindore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon elementet natyrore të Evropës Lindore.
- Përshkruan veçoritë shoqërore të saj.
- Arsyeton faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimin ekonomik.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqëro-ekonomike të Evropës Lindore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia, Edukatë qytetare.

Evropa Lindore - veçoritë natyrore



Evropa Lindore shtrihet prej detit Baltik dhe Karpateve në perëndim e deri te mali Ural dhe lumi Ural në lindje. Në veri, ajo del në Oqeanin e Ngrirë të Veriut kurse Deti i Zi, mali Kaukaz dhe liqeni Kaspik paraqesin kufirin më jugor të shtrirjes së saj. Ultësirat e mëdha ndodhen thellë në brendësi të kontinentit, prandaj janë larg ndikimeve të oqeanit Atlantik. Prandaj, edhe pse Evropa Lindore del në disa dete, pozita gjeografike e saj dallohet me shkallën shumë të shprehur të kontinentalitetit. Nëper Bjellorusi, Ukrainë dhe Moldavi kalojnë rrugë të rëndësishme, të cilat lidhin Federatën Ruse me Evropën e Mesme dhe brigjet e deteve të ngrohta. Lidhjet e Evropës Lindore me rajonet dhe detet e tjera bëhen përmes rrugëve të brendshme lundruese të cilat kalojnë nëpër lumenjtë dhe kanalet e shumta. Lumi Volga është rruga më e rëndësishme lundruese, e cila lidh Detin e Bardhë, detin Baltik, Detin e Zi, detin Azov dhe liqenin Kaspik.

Më tepër se një shekull ajo ka qenë në kuadër të Mbretërisë Ruse, kurse pas Luftës së Parë Botërore e deri në vitin 1991 ajo bëhet pjesë e Bashkimit Sovjetik. Rajoni i Evropës Lindore është hapësirë kaluese në të cilën ndshihen ndikimet politike dhe ekonomike të lindjes dhe perëndimit. Bjellorusia dhe Moldavia nuk kanë dalje në det, kurse Ukraina dhe pjesa evropiane e Rusisë dalin në dete relativisht të mbyllura.

Relievi dhe përthyeshmëria e bregdetit

Vija bregdetare përgjatë detit Baltik është pak e përthyer. Në bregdetin verior ndodhet gadishulli Kola, kurse ishulli më i madh është Ishulli i Tokës së Re. Dy gjiret më të mëdha të këtij bregdeti janë gjiri i Finlandës dhe gjiri i Rigës. Vijen bregdetare të Detit të Zi e përthyen gadishulli i Krimesë, ndërsa ndërmjet Detit të Zi dhe detit Azov ndodhet ngushtica e Kerçit. Rajoni i Evropës Lindore dominohet nga relievi ultësior. Kjo është Ultësira e Madhe e Evropës Lindore. Bazamentin e kësaj ultësire e përbën Plaka Ruse, e cila është një tokë e vjetër dhe stabile në aspektin gjeologjik.

Njëtrajshmërinë e relievit ultësitor të Evropës Lindore e prishin deri diku Pllaja e Valdajit dhe ajo e Rusisë së Mesme. Në skajin e poshtëm, ultësira e Evropës Lindore përfundon në depresionin e Ultësirës Pranëkaspike. Në skajet perëndimore të kësaj ultësire ngrihen vargmalet e Karpateve, në jug mali i Krimesë dhe Kaukazi. Në brezin kufitar ndërmjet Evropës dhe Azisë shtrihet mali Ural. Lartësia mesatare mbidetare e relievit është 170 m, ndërsa relievi i ngritur nuk është më i lartë se 370 m. Për shkak të largësisë së madhe nga masat oqeanike dhe të lagështa ajrore, klima e Evropës Lindore është e karakterit të theksuar kontinental me sasi shumë të vogël të reshjeve, jo më shumë se 500 mm. Ajo në drejtimin veri-jug ndërrohet nga ajo shumë e ftohtë dhe e ashpër në veri e deri te klima stepike në jug. Në rajonin e liqenit Kaspik klima është gjysmëshkretinore, ndërsa përgjatë bregdetit të Detit të Zi është e pranishme klima e ndryshueshme mesdhetare.



Ultësira e Evropës Lindore



Lumi Voliga



Rajona me pyje halore

Nëpër ultësirën e Evropës Lindore rrjedh Voliga, e cila buron në pllajën e Valdajit dhe derdhet në liqenin Kaspik. Përveç Vollgës, nëpër këtë ultësirë rrjedhin edhe lumenjtë tjerë të gjatë si Dnjepr, Dnjestri dhe Doni, të cilët derdhen në Detin e Zi. Dvina Perëndimore është lumi më i madh që i takon pellgjit të detit Baltik, ndërsa Dvina Veriore dhe Peçora janë lumenjtë më të mëdhenj që rrjedhin në drejtim të Oqeanit të Ngjirë të Veriut. Nëpër rrjedhat e lumenjve të mëdhenj të Evropës Lindore janë ngritur shumë liqene artificiale. Shumica e tyre ndodhen përgjatë shtatit të Vollgës. Liqeni Kaspik është liqeni më i madh në botë. I takon grupit të liqeneve relikte dhe ka ujën e njelmët. Liqenet Lladoga dhe Onjega, të cilat shtrihen në veri të rajonit janë të origjinës akullnajore. Në Evropën Lindore kanë përhapje të madhe tokat e zezë me përmbajtje të lartë të humusit të cilat quhen cernozem. Tokat pjellore të cernozemit ku kultivohen lloje të ndryshme të drithërave. Në këtë rajon nga veriu drejt jugut ndërrohen disa zona natyrore të bimësisë. Në brigjet e veriut ndodhen bashkësitë e thjeshta bimore të tundrave. Poshtë tyre ndodhen tajgat pastaj stepat. Afër detit Mesdhe bimësia është mesdhetare, kurse afër Kaspikut bimësia është gjysmëshkretinore.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Aktiviteti:

Të nxënësit me këmbime: grupet e ekspertëve Mësimdhënësi e ndan klasën në tri grupe të barabarta, pastaj tre fliçarta i vendos në tri kënde të klasës. Secilit grup i jepet nga një marker, p.sh. Grupi 1 - markeri me ngjyrë të zezë, tema; Elementet natyrore të Evropës Lindore; grupi 2 - markeri me ngjyrë të kuqe, tema; Veçoritë shoqërore të Evropës Lindore; grupi 3 - markeri me ngjyrë të kaltër, tema; Zvhillimi ekonomik i Evropës Lindore. U jepet kohë nxënësve që për 5 minuta të shkruajnë sa më tepër informacione për temën e caktuar. Kur të përfundojë koha prej 5 minutash, nxënësit ndalojnë dhe mësimdhënësi u rekomandon që, së bashku me markerin me ngjyrë të njëjtë, nxënësit të bëjnë një lëvizje. Kështu vazhdohet deri sa të përfundojë një cikël.

Në fund, nxënësit kthehen te tema fillestare dhe secili prej grupeve i lexon të gjitha pjesët (të gjitha ngjyrat e markerave); i analizojnë për saktësinë, cilësinë dhe sasinë. Kështu, njëri grup duhet të shpallet fitues mbi cilësitë e lartpërmendura.

Në këtë fazë të orës mësimdhënësi shtron pyetje: a ka rëndësi struktura e popullsisë në zhvillimin ekonomik?

Nxënësit i shprehin - argumentojnë mendimet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen në mënyrë individuale për saktësinë e përshkrimit të elementeve natyrore, të strukturave shoqërore dhe për vlerësimin e ndërlidhjes mes resurseve humane dhe atyre natyrore në zhvillimin ekonomik.

Detyrë:

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Lindore me Bashkësitë e Shteteve të Pavarura - veçoritë natyrore; Evropa Lindore me Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, veçoritë shoqërore; Evropa Lindore me Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, veçoritë ekonomike.

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon pozitën gjeografike, veçoritë natyrore, shoqërore dhe lidhjen e tyre në zhvillimin ekonomik të Ukrainës

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ukraina

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:


- Përkufizon shtetin e Ukrainës;
- Identifikon prej hartës/atlasit elementet natyrore të saj;
- Përshekruan strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore;
- Vlerëson ndërlihdjen e resurseve humane me pasuritë natyrore në zhvillimin ekonomik të Ukrainës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomike të Ukrainës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Ukraina (pa Rusinë evropiane) është shteti më i madh i Evropës, ndërsa ka qenë pjesa më e pasur e Bashkimit të dikurshëm Sovjetik. Në jug del në Detin e Zi dhe Azov, kurse në veri deri tek ultësira e madhe pjellore e Evropës Lindore dhe Bjellorusisë. Në relievin e Ukrainës dominojnë ultësirat, luginat lumore dhe kodrinat. Nëper pjesën e mesme shtrihet ultësira e Dnjeprit e cila krejt në jug kalon në ultësirën e Detit të Zi. Në pjesën lindore shtrihen kodrinat dhe lugina e lumit Donjec; në veri ndodhen moçalishtet e Pripjatës, kurse malet shtrihen në kufi në Rumaninë, Sllovakinë dhe gadishullin e Krimesë. Lugina e Donjecit dhe ultësira e Dnjeprit kanë dendësinë më të madhe të popullsisë. Struktura etnike e popullsisë së Ukrainës është mjaft e pëzier. Rreth 78 % të popullsisë janë ukrainas, ndërsa prej pakicave të shumta etnike më së shumti ka rusë (rreth 17 %). Rreth gjysma e sipërfaqeve të Ukrainës janë nën ara, në të cilat tokat e zeza dhe klima e përshtatshme mundësojnë arritjen e rendimenteve të larta të drithërave, rrepës së sheqerit etj. Për këtë arsye Ukraina ka pasur epitetin e "hambarit" të Bashkimit Sovjetike, ndërsa edhe sot e kësaj dite, ajo është një ndër prodhuesit më të mëdhenj të ushqimit në Evropë. Kjo vërehet edhe në strukturën e të ardhurave sipas sektorëve, në të cilën bujqësia e zë vendin e parë. Në strukturën ekonomike përpos sektorit primar rëndësi kanë edhe ai sekondar e terciar. Industria e rëndë është zhvilluar në saje të pasurive të thengjillit në basenin e Donjecit. Përveç thengjillit, shfrytëzohen edhe xehet e hekurit, manganit dhe uranit. Hidrocentralet e shumta të ngritura në Dnjepr, por edhe termocentralet dhe centralet atomike, prodhojnë sasi të madhe të energjisë duke e bërë Ukrainën një nga prodhuesit më të mëdhenj të energjisë në Evropë. Rajonet industriale janë: i Donbasit, i Dnjeprit, hapësira rreth Kievit, Lavovit etj.



Ukraina renditet ndër prodhuesit më të mëdhenj botërorë të thengjillit



Kievi

Degët më të rëndësishme industriale janë industria e rëndë e prodhimit të hekurit, çelikut, metaleve me ngjyra, kimike, ushqimore dhe e automobilave etj. Edhe në Ukrainë sikurse në vendet e tjera të Evropës Lindore industria tek tani ka nisur procesin e modernizimit për t'u bërë konkurrenë në ekonominë e tregut të lirë. Qendra më e madhe dhe kryeqyteti i Ukrainës është Kievi me rreth 5 milionë banorë. Është ngritur përgjatë brigjeve të lumit Dnjepër. Kievi është qyteti i tretë për nga madhësia në hapësirën e ish-Bashkimit Sovjetik. Është qendër e madhe industriale, kulturore, universitare, turistike etj. Qendra të tjera të mëdha janë Harkovi, Dnjepropetrovski, Odesa dhe Donjecku.

! Me rëndësi të dihet

- Në Çernobil të Ukrainës në vitin 1986 ka ndodhur katastrofa më e madhe nukleare ndonjëherë në botë. Reshjet radioaktive që kanë rënë pas aksidentit nuklear në veri të Ukrainës dhe juglindje të Bjellorusisë kanë ndotur tokën, pyjet dhe ujin. Edhe sot rreth 4 milionë ukrainas jetojnë në hapësirat e kontaminuara me radioaktivitet. Reaktori i fundit nuklear në Çernobil është mbyllur më 15 dhjetor të vitit 2000.

- Krimeja është gadishull, i cili ndan detin Azov prej Detit të Zi. Pjesën më të madhe të popullsisë e përbëjnë rusët të cilët janë vendosur gjatë periudhës sovjetike. Rusët në këtë gadishull kanë shpallur autonominë, ndërsa në vitin 2014 Rusia ka bërë aneksimin e saj. Për këtë arsye nis konflikti ndërmjet forcave lokale të mbështetura nga Rusia dhe ushtrisë së Ukrainës.

? Pyetje

1. Cilat janë tërësitë kryesore gjeografike të Ukrainës?
2. Çfarë është struktura etnike e popullsisë së Ukrainës?
3. Pse Ukraina ishte shteti më i zhvilluar i Bashkimit Sovjetik?

187



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatimi i të nxënësve *Rishikim me rigrupim*

Secilit grup iu jepet një fletë, në të cilën kërkohet të shkruajnë mendimet e tyre për temën apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore, për përshkrimin e strukturave shoqërore dhe për vlerësimin e ndërlidhjes mes resurseve humane dhe natyrore në zhvillimin ekonomik.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 83.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:



Parashikimi: Përgatitja për të nxënësve *Stuhi mendimesh*

Pyetje e mundshme:

Çka dini ose mendoni se dini për Ukrainën?

Nxënësit ta përdorin atlasin gjeografik për t'i marrë informacionet rreth elementeve natyrore.

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbytjes *Pyetja sjell pyetjen*

Paraqitet video ose harta politike dhe ajo fizike e Ukrainës.

Gjatë shikimit të videos ose të hartës, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:

1. Me cilat shtete kufizohet Ukraina?
2. Cilat ishin malet, fushat, lumenjtë, liqenet kryesore të saj?
3. Çfarë klime ka Ukraina?

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Lindore me Bashkësitë e Shteteve të Pavarura - veçoritë natyrore; Evropa Lindore me Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, veçoritë shoqërore.

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përkufizon pozitën gjeografike dhe identifikon veçoritë natyrore dhe shoqërore të Bjellorusisë

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bjellorusia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon shtetin e Bjellorusisë;
- Identifikon prej hartës/atlasit elementet natyrore të saj;
- Përshekruan strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomike të Bjellorusisë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Stuhi mendimesh

Pyetje e mundshme:



Bjellorusia është shtet kontinental dhe ndodhet ndërmjet Polonisë, Lituanisë, Letonisë, Federatës Ruse dhe Ukrainës. Pjesën dërrmuese të territorit të saj e përbën ultësira e Evropës Lindore. Në pjesën veriore të vendit ndodhen kodrimat morenike dhe liqenet akullnajore, kurse në lindje rrafshinat e lesit. Në jug, përgjatë lumit Pripijat ndodhet hapësira më e madhe moçalore në botë. Afër 50 % e sipërfaqes është e mbuluar me pyje. Kushtet jo edhe aq të volitshme klimatike dhe pasuritë e vogla natyrore kanë bërë që dendësia e banimit të jetë e vogël. Mbi tri të katërtat e popullsisë e përbëhet nga bjellorusët, kurse nga pakicat jetojnë rusët, polakët, ukrainasit dhe tatarët. Për shkak të procesit të shpejtë të industrializimit, një pjesë e madhe e popullsisë është vendosur në qytete në të cilat sot jetojnë rreth 75 % e popullsisë.

Deri në vitet '80 të shekullit të kaluar, Bjellorusia ishte një shtet i varfër bujqësor. Që nga atëherë, zbatimi i politikave ekonomike të Bashkimit Sovjetik bën të mundur zhvillimin e industrisë së rëndë, e cila mbështetet në lëndët e para të importuara nga Rusia dhe Ukraina. Për shkak të teknologjisë së vjetruar, ajo nuk ka mundur të jetë konkurrenente në tregun e jashtëm. Për këtë arsye edhe në Bjellorusi së fundi nisi procesi i modernizimit të industrisë. Një përqindje të konsiderueshme të të ardhurave ajo e siguron edhe nga prodhimet e industrisë së lehtë ushqimore. Përveç lëndëve të para bujqësore dhe biegtorale, për ekonominë e Bjellorusisë janë të rëndësishme edhe vendburimet e gjetura së fundi të naftës, kripës së gurit dhe kripës së kaliumit. Industria punëson rreth një të tretën e popullsisë dhe siguron pjesën më të madhe të të ardhurave.



Minsku

Qendra më e madhe dhe kryeqyteti i Bjellorusisë është Minsku me rreth 2 milionë banorë. Është qendër e madhe industriale, universitare dhe kulturore. Qendra të tjera të mëdha janë edhe Homeli, Mahiljovi, Vicebsku dhe Hrodna.

! Me rëndësi të dihet

- Pylli Bjelovjeshka ndodhet në perëndim të Bjellorusisë dhe është pjesë e pyjeve native (të paprekura), të cilat dikur kishin mbuluar pjesën më të madhe të Evropës. Ky pyll sot është i mbrojtur dhe është strehë dhe habitat për disa lloje të rralla shtazore.

? Pyetje

1. Gjej në hartë dhe shëno me cilat shtete kufizohet Bjellorusia.
2. Në cilat pjesë të vendit hasen gjurmët e veprimtarisë akullnajore.
3. Shkruaj për strukturën etnike të Bjellorusisë.

Çka dini ose mendoni se dini për Bjellorusinë?
Nxënësit ta përdorin atlasin gjeografik për t'i marrë informacionet rreth elementeve natyrore.

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**
Pyetja sjell pyetjen

Paraqitet video ose harta politike dhe ajo fizike e Bjellorusisë.


Gjatë shikimit të videos ose të hartës, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:

1. Me cilat shtete kufizohet Bjellorusia?
2. Cilat ishin malet, fushat, lumenjtë, liqenet kryesore të saj?
3. Çfarë klime ka Bjellorusia?



**Përforcimi:
Konsolidim dhe zbatim i të nxënësve**
Organizues grafik

Në mënyrë individuale, nxënësit përgatitin organizues grafik për Bjellorusinë – Pozita, elementet natyrore dhe shoqërore. Pastaj, secili në mënyrë individuale i shënon idetë e tij/saj në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore, për përshkrimin e strukturave shoqërore.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 84.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Gjeografi

Shkalla e kurrikulës: 3 **Klasa:** VII

Tema: Evropa Lindore me Bashkësitë e Shteteve të Pavarura - veçoritë natyrore; Evropa Lindore me Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, veçoritë shoqërore

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përkufizon pozitën gjeografike dhe identifikon veçoritë natyrore dhe shoqërore të Moldavisë

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I-6, II-6, III-5, VI-8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Moldavia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon shtetin e Moldavisë;
- Identifikon prej hartës/atlasit elementet natyrore të saj;
- Përshekruan strukturat shoqërore sipas përkatësisë etnike, fetare, moshore, arsimore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, harta apo edhe video të ndryshme të pozitës, të elementeve natyrore dhe shoqërore-ekonomike të Moldavisë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Historia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Stuhi mendimesh

Pyetje e mundshme:



Moldavia shtrihet në jugperëndim të ultësirës së Evropës Lindore, ndërmjet lumenjve Prut dhe Dnjestër. Ka pozitë gjeografike kontinentale dhe kufizohet me Rumaninë dhe Ukrainën. Nëpër relievin ultësitor rrjedhin lumenjtë me degët e veta, kurse ndërmjet tyre ngrihen kodrinat jo më të larta se 500 m. Është shteti me dendësinë më të madhe të banimit në Evropën Lindore. Pjesën më të madhe të popullsisë e përbëjnë moldavët, të cilët me gjuhën që flasin i takojnë grupit të popujve romanë. Megjithatë prania e disa pakicave të tjera sjell problem dhe tensione etnike, sidomos ndërmjet moldavëve dhe pakicës ukrainase dhe ruse. Moldavia është një nga shtetet më pak të zhvilluara jo vetëm të Evropës Lindore por edhe të tërë kontinentit. Një përqindje e lartë e popullsisë merren me bujqësi dhe jeton në fshat. Fushat dhe kodrinat janë të përshtatshme për drithëra, pemë, perime, duhan dhe hardhi të rrushit. Lëndët e para nga bujqësia kanë mundësuar zhvillimin e industrisë së lehtë ushqimore në qytete. Varësia nga lëndët e para dhe burimet energjetike të importuara krijon vështirësi për ekonominë e vendit. Prandaj ajo është e detyruar që edhe më tutje të lidhet ekonomikisht për Rumaninë dhe Bashkësinë e Shteteve të Pavarura. Qendra më e madhe dhe kryeqyteti i Moldavisë është Kishinau me rreth 800 mijë banorë. Qendra të tjera të rëndësishme janë Tiraspoli dhe Balti.



Kismina - Eryeqyteti i Moldavisë

Me rëndësi të dihet

- Moldavia dikur është quajtur Besarabi. Një kohë të shkurtër (shekulli XIV) është zhvilluar si principatë e pavarur, kurse më vonë ka rënë nën sundimin e Hungarisë, Polonisë, Perandorisë Osmane, Rusisë dhe Rumanisë. Moldavia është shtet i pavarur që nga viti 1991.

Pyetje

1. Cilët lumenj paraqesin kufijtë natyrorë lindorë dhe perëndimorë të Moldavisë?
2. Me cilën veçori demografike të popullsisë, Moldavia dallohet prej shteteve të tjera të regjionit?
3. Cilat veprimtari ekonomike mund të zhvillohen në saje të pasurive natyrore që ka Moldavia?

Çka dini ose mendoni se dini për Moldavinë? Nxënësit ta përdorin atlasin gjeografik për t'i marrë informacionet rreth elementeve natyrore.

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Pyetja sjell pyetjen

Paraqitet video ose harta politike dhe fizike e Moldavisë.


Gjatë shikimit të videos ose të hartës, nxënësit duhet të kenë parasysh pyetjet:

1. Me cilat shtete kufizohet Moldavia?
2. Cilat ishin malet, fushat, lumenjtë, liqenet kryesore të saj?
3. Çfarë klime ka Bjellorusia?



Përforcimi: Konsolidim dhe zbatim i të nxënësve Organizues grafik

Në mënyrë individuale, nxënësit përgatitin organizues grafik për Moldavinë - Pozita, elementet natyrore dhe shoqërore. Pastaj, secili në mënyrë individuale i shënon idetë e tij/saj në tabelë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përkufizimit, për identifikimin e elementeve natyrore, për përshkrimin e strukturave shoqërore.

Detyrë:

Të plotësohet fletore pune, faqe 84, dhe pyetjet faqe 191 të libri bazë.

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:





